REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

rrok
Rrjeti i Organizatave
të Kulturës në Prizren

PLANI I MENAXHIMIT I QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT 2021-30



Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

FALENDËRIM 5
EKIPI HARTUES 6
KONTRIBUAN NË PROCES 6
SHKURTESAT 7
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 8
2. HYRJE 9
3. PLANET E MENAXHIMIT NË VEPRIM 11
4. METODOLOGJIA 19
5. VLERAT DHE DEKLARATA E RËNDËSISË 20
6. VIZIONI ME QASJE TË PEISAZHIT HISTORIK URBAN TË UNESCO-S 30
7. PLANI I VEPRIMIT 36
8. DISPOZITAT E ZBATIMIT DHE MBIKËQYRJA 54
9. BIBLIOGRAFIA 55

ANEKS 1 ANALIZA E KONTEKSTIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT 59

1.1 Historia
1.2 Korniza ligjore
1.3 Lokacioni dhe struktura urbane
1.4 Palët e interesit dhe gjithpërfshierja në process
1.5 Hulumtimi i gjendjes ekzistuese
1.6 Analiza SWOT
1.7 Analiza socio-demografike
1.8 Zhvillimi ekonomik
1.9 Programi i edukimit për trashëgimi kulturore
1.10 Identiteti vizual dhe brendimi
1.11 Turizmi i trashëgimisë kulturore
1.12 Vlerat, rëndësia dhe autenticiteti

ANEKS 2 TABELA E ASETEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT DHE STATUSI I MBROJTJES SË TYRE 256

ANEKS 3 HARTAT E ANALIZËS SË GJENDJES EKZISTUESE TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT 260

ANEKS 4 HARTAT DHE KARTELAT E HAPËSIRAVE PUBLIKE TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT 290

ANEKS 5 ZYRA PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT 331

Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit 2021-30

REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

rrok
Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren



Foto 1 Në anën e kundërt nga maja: qyteti i vjetër, kalaja, ura e gurit, Xhamia e Sinan Pashës, ndërtesa e Lidhjes së Prizrenit, Sheshi Shadërvan, Konkatedrala Zonja Ndihëmtare, Hamami i Gazi Mehmet Pashës, Kisha e Shën Premtës (Kisha e Levishës) dhe Prizreni gjatë mbrëmjes.

FALENDËRIM

Falënderojmë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për inicimin, financimin dhe përkrahjen e parezervë gjatë procesit të hartimit të Planit të Menaxhmit të Qendrës Historike të Prizrenit.

Falëndërojmë Komunën e Prizrenit për përkrahjen e procesit të hartimit dhe zotimin për zbatim të dispozitave të dala nga ky Plan.

Për përkrahje profesionale dhe financiare në pjesë të veçanta të procesit të hartimit të Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit falëndërojmë OSBE-në zyra në Kosovë, EC Ma Ndryshe (të financuar përmes Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS) dhe Autostrada Bienale (të financuar përmes Trashëgimisë Kulturore pa Kufij - CHwB Kosova).

Falënderim i dedikohet edhe gjithë organizatave anëtare dhe pjesëmarrësve të këtyre organizatave në kuadër të Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren (RrOK).

Falëndërim të veçantë i dedikohet gjithë palëve të interesit: përfaqësues të institucioneve qendrore, lokale, profesionistëve të pavarur, organizatave profesionale, atyre të shoqërisë civile si dhe qytetarëve të Prizrenit të kyqur në proces.

Ekipi Hartues

EKIPI HARTUES

Enes Toska, *koordinatori i projektit (EC Ma Ndryshe)*
Rand Eppich, *ekspert ndërkombëtar për trashëgimi kulturore*
Nora Arapi-Krasniqi, *eksperte lokale për konservim të trashëgimisë kulturore (QRTK Prizren)*
Artnet Haskuka, *eksperte lokale për planifikim hapësinor (KTK QHP)*
Dita Dobranja, *konsulente për ekonomi dhe demografi*
Ruzhdi Halili, *konsulent për legjislacion*
Arif Muharremi, *konsulent për edukim*
Vesel Hoxhaj, *konsulent për histori*
Stan McGahey, *konsulent për turizëm (Ambasada Amerikane në Prishtinë / Fulbright Scholar)*
Eliza Hoxha, Yll Rugova dhe Jeton Jagxhiu, *konsulentë për brendim dhe promovim*
Edona Shala-Morina, *konsulente për GIS (Sistemi i Informatave Gjeografike)*
Enes Toska, *udhëheqës i hulumtimit në terren (EC Ma Ndryshe)*
Eni Arapi, *hulumtuese*
Veron Tara, *hulumtues*
Fulin Derviş, *hulumtuese*
Gresa Berisha, *hulumtuese*
Labëri Dakaj, *hulumtuese*
Malbora Krajku, *asistente e projektit (Fondacioni Lumbardhi)*
Ares Shporta, *zyrtar për komunikim (Fondacioni Lumbardhi)*
Tringa Kasemi dhe Julind Thana, *zyrtarë për financa (Fondacioni Lumbardhi)*

Egzon Bytyqi, *fotografia e ballinës*

KONTRIBUAN NË PROCES

Ekipi Punues është themeluar me Vendim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporit me datë 21 Qershor 2016 (nr. protokolli 1914/2016) dhe është udhëhequr nga Vjollca Aliu, drejtoreshë e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore. Anëtarë tjerë të Ekipit Punues: Feim Hoxha, Brikena Mulliqi, Imer Hakaj (MKRS), Samir Hoxha (QRTK Prizren), Mytaher Haskuka (Komuna e Prizrenit), Shafi Gashi (KKTK), Agim Gërguri (IKMM), Milot Berisha (IAK), Arbnor Morina (KTK-QHP), Elvida Pallaska (MMPH[1]/UBT[2]), Suzana Goranci, Luan Nushi (MMPH), Edon Mullafetahu (OJQ EC Ma Ndryshe), Vesel Hoxhaj, (arkeolog), Ares Shporta (RrOK Prizren, OJQ Lumbardhi), Sali Shoshi (OJQ CHwB Kosova), Lorika Hisari (UNDP[3]/profesionite e pavarur[4]), Ylber Veseli (OSCE) dhe Florina Jerliu (UP-FNA). Poashtu në proces kanë kontribuar edhe: Jusuf Xhibo dhe Fitore Bytyqi (QRTK-Prizren), Ardiana Qorraj (IKMM), Dafina Morina (MKK), Fatmir Memaj, Ehat Oreshka, Islam Thaçi, Sevil Kazazi (Komuna e Prizrenit) dhe Nol Binakaj (OJQ CHwB Kosova).

[1] Institucioni i përcaktuar në Vendim të MKRS-së
[2] Institucioni I përcaktuar në përmbyllje të hartimit të PMQHP
[3] Institucioni i përcaktuar në Vendim të MKRS-së
[4] Pozita në përmbyllje të hartimit të PMQHP

SHKURTESAT

IAK – Instituti Arkeologjik i Kosovës

IKMM – Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve

KKTK - Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

KTK - Këshilli për Trashëgiminë Kulturore për QHP

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MF - Ministria e Financave

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PMQHP - Plani i Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit

QHP - Qendra Historike të Prizrenit

QRTK - Qendra Rajonale për Trashëgmi Kultrurore

RrOK – Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren

TK – Trashëgimia kulturore

TKN – Trashëgimia kulturore dhe natyrore

UNDP - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNESCO - Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara

UP-FNA – Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë e Arkitekturës

ZQHP - Zyra për Qendrën Historike të Prizrenit

ZVM - Zonat e Veçanta të Mbrojtura

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qendra Historike e Prizrenit sipas nenit 1 të Ligjit Nr. 04/L-066 (2012) trajtohet si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike ***në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur*** *me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.*

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Rrjetin e Organizatave të Kulturës në Prizren, me nënshkrim të Memorandumit të Mirëkuptimit në gusht të vitit 2016 ka inicuar hartimin e Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit 2021-30. Kjo iniciativë ka lindur si domosdoshmëri për adresimin e problemeve të akumuluara ndër vite në qendrën historike dhe gjithashtu për përmbushjen e obligimit nga Ligji për Trashëgimi kulturore Nr. 02/L-88 dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit Nr. 04/L-066. **Ky Plan është rezultat i përpjekjeve shumë vjeçare të institucioneve dhe shoqërisë civile të Prizrenit** për mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrës historike të qytetit. Si vazhdimësi e këtyre përpjekjeve, palët janë dakorduar të shtrijnë bashkëpunimin e tyre për realizimin e objektivave të përbashkëta mbi mbrojtjen e karakterit historik të qendrës së qytetit, rritjen e mirëqenies shoqërore dhe zhvillim të qëndrueshëm urban dhe ekonomik.

Qëllimi i Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit (së këtejmi PMQHP) është përcaktimi i politikave strategjike për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit. Kjo qendër historike, sipas legjislacionit në fuqi është identifikuar si fushë e konservimit arkitekturor (nr.rend. 1327), pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike nën mbrojtje të përhershme si dhe Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.
Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit 2029-30 ka filluar të hartohet që nga Marsi i vitit 2017, dhe **është dokument i pari i këtij lloji që hartohet për një qendër historike në Kosovë.** Plani i adreson sfidat e kësaj zone dhe zgjidhjet për të njëjtat duke u bazuar në praktika dhe standarde më të avancuara ndërkombëtare. Ky dokument, si i tillë është edhe i pari i llojit të vet ku krijon partneritet mes institucioneve publike të nivelit qendror e lokal dhe shoqërisë civile në Prizren.

Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit është i strukturuar në dy tërësi të veçanta, në atë ekzekutive dhe analitike:
1. Pjesa e parë e Planit të Menaxhimit, gjegjësisht **pjesa ekzekutive** e dokumentit përmban informatat kryesore mbi metodologjinë e aplikuar, deklaratën e rëndësisë, vizionin e përcaktuar përfshi objektivat dhe Planin e Veprimit. Kjo pjesë, në veçanti përfshin edhe disa shembuj inspirues nga rajoni përfshi edhe mënyrat dhe sfidat e menaxhimit të tyre.
2. Pjesa e dytë e Planit të Menaxhimit, gjegjësisht **pjesa analitike** e dokumentit është e organizuar në formë të anekseve ku trajtohen tema të veçanta të Qendrës Historike të Prizrenit. Çdo aneks është i strukturuar në parashtrim të natyrës së problemit, analizës së problemit dhe përmbyllet me konkuluzione e rekomandime specifike. Mund të thuhet se Anekset analitike përbëjnë bazën kryesore të të gjitha projekteve/aktiviteteve të paraqitura në Planin e Veprimit të PMQHP që gjendet në pjesën e parë. **Aneksi 1** përmban analiza detaje të kontekstit të qendrës historike ku përfshihet historia, konteksti ligjor i zonës, analiza e strukturës urbane, palët e interesit dhe përfshierja e tyre në proces, gjetjet e hulumtimit në terren, SWOT analiza, profili socio-demografik, zhvillimi ekonomik, edukimi dhe vetëdijësimi, identiteti vizual dhe brendimi, zhvillimi i turizmit dhe përmbyllet me analizën e vlerave të trashëgimisë kulturore të zonës. Duke e pasur parasysh kompleksitetin e statusit të mbrojtjes ligjore të aseteve të ndryshme në QHP, ato në mënyrë tabelare janë paraqitur në **Aneksin 2.** Hartat e hulumtimit nga terreni gjenden në **Aneks 3** përderisa analizat më specifike për hapësira publike dhe kartelat e tyre të veçanta gjenden në **Aneks 4.** Dokumenti përmbyllet me **Aneks 5** ku janë paraqitur dispozitat e themelimit të Zyres së Qendrës Historike të Prizrenit që edhe paraqet një nga hapat e parë të zbatimit të këtij Plani.

2. HYRJE

Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 627 km2 (5.94 % teteritorit të Kosovës) gjendet ne jugperendim të Kosovës dhe me 76 vendbanime dhe me 177781 banorë. Me populli urbane 94.517 banorë dhe me populli rurale 83.264 banorë. Prizreni me së shpeshti quhet: Ana e Prizrenit, bazeni i Prizrenit ose Rrafshi i Dukagjinit. Kufizohet me Komunat e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Shtërpces dhe Dragashit si dhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Për këtë arsye rafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 m të lartësis mbidetare. Klima e qytetit është jashtëzakonisht e Ilojllojshme. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë ndër të parat në Evropën juglindore me përparsitë e pakrasuheshme për kulturat bujqësore: hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset majore, dominon klima e alpeve, për q'arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasitë e bores me q'rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve.[5]

Sot, rritja e shpejtë e populli sisë (për momentin rreth 178.000 banorë), presioni i ndërtimeve dhe aktiviteteve komerciale, ngritja dramatike në numrin e veturave, lufta e fundit, dobësia e funksionimit të rendit, ligjit dhe institucioneve, si dhe mungesa e fondeve e kërcënojnë tej mase strukturën historike të qytetit si dhe cilësinë e jetës së qytetarëve në këtë zonë. Pronat publike e struktura urbane, arkitektura, peisazhi urban dhe vegjetacioni janë të gjitha nën rrezik të barabartë.

Qendra Historike e Prizrenit aktualisht menaxhohet me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit, të hartuar në vitin 2006 dhe të miratuar në vitin 2009. Ky plan vepron si Plan Rregullues Urban në bazë të ligjit për planifikim hapësinor. Përkundër mekanizmave të shumtë ligjor e institucional për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit, Plani i Konservimit dhe i Zhvillimit nuk është zbatuar në masë të madhe ndërsa qendra historike ka pësuar degradim të vazhdueshëm dhe ky process nuk është duke u ndalur edhe sot.

Baza ligjore e PMQHP përcaktohet në dispozitat ligjore vijuese: nenin 6, paragrafi 6.6 të Ligjit për trashëgimi kulturore Nr. 02/L-88; nenin 2, paragrafin 1,4 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit Nr. 04/L-066 si dhe duke marrë parasysh Objektivin 2, Masën 2.1.3 (Hartimi i planeve të menaxhimit dhe caktimi i njësive menaxhuese për lokalitetet madhore të trashëgimisë kulturore) dhe Objektivin 3, Masën 3.3.4 (Përvetësimi i qasjes së bazuar në Peisazhin Historik Urban për planifikim dhe menaxhim ndërkomunal të zonave/ territoreve më të gjera të trashëgimisë kulturore, sipas rekomandimeve të UNESCO-s (2011)) të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-27. Legjislacioni në fuqi përcakton poashtu se konservimi dhe mbrojtja e Qendrës Historike të Prizrenit duhet të bëhet në pajtim me parimet dhe standardet ndërkombëtare në pajtim me Ligjin e trashëgimisë kulturore, Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe dokumente ndërkombëtare të UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe traktatet e BE-së.

Plani i Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizreit 2021-30 synon ta ofrojë një analizë të detajuar të gjendjes aktuale, që e përfshin shqyrtimin dhe konsolidimin e planeve relevante dhe njohurive ekzistuese për Qendrën Historike, matjen e situatës socio-ekonomike dhe demografike, analizën e kornizës ligjore, skanimin e gjendjes fizike, si dhe hulumtimin e aspekteve tjera të rëndësisë për këtë zone. Dokumenti do të ketë edhe planin e veprimit që përfshin komponentë si konservimi, komunikimi vizual, planet ekonomike dhe turistike, programe edukative dhe aspekte tjera strategjike që do të identifikohen përgjatë procesit ku përfshihet edhe një nga rekomanimet kyqe themelimi i Zyres së Qendrës Historike të Prizrenit.

[5] https://kk.rks-gov.net/prizren/qyteti/siperfaqja/

Foto 2. Pamje e qendrës historike gjatë natës

3. PLANET E MENAXHIMIT NË VEPRIM

SHEMBUJ NGA QYTETET HISTORIKE

Nëse dështoni të planifikoni, atëherë ju planifikoni të dështoni! –

Benjamin Franklin

Ky citim përmbledh qëllimin e një plani të menaxhimit. Askund nuk është më e rëndësishme sesa në qytetet historike si Prizreni ku komuniteti dhe trashëgimia e ndërtuar janë zhvilluar së bashku me mjedisin përreth shekujsh. Disa vite të shkurtra të mos planifikimit janë shkatërrimtare pasi karakteri historik është i brishtë dhe paraqet një burim jo të ripërtëritshëm. Kjo mungesë e planifikimit është ajo që po ndodh në Prizren, me më shumë se gjysmën e shtëpive historike të shkatërruara në më pak se dhjetë vite. Me ritmin e shpejtë të ndërtimit modern të mekanizuar dhe materialeve të prodhuara në masë, ekziston një ndryshim i pakthyeshëm që po ndodh tani. Prizreni sot ka nevojë për një Plan Menaxhimi dhe duhet të zbatohet, përndryshe ky qytet unik do të bëhet sikur shumë vende me disa struktura të izoluara historike. Megjithatë, nuk është tepër vonë, me një plan të mirë të menaxhimit, institucione me staf të përkushtuar, zbatim të ligjit si dhe me përkrahjen e shoqërisë, me kohën është e mundur të parandalohet degradimi i mëtutjeshëm i Qendrës Historike të Prizrenit

Shumica e liderëve të cilët janë seriozë dhe të vendosur për mbrojtjen e trashëgimisë së qytetit të tyre historik kanë një plan menaxhimi, metoda për zbatim, komunikim të vazhdueshëm me komunitetin dhe një proces zbatimi. Ky kapitull nxjerrë në pah shembuj që janë shkruar, rishkruar dhe kanë marrë mbështetjen e komunitetit për planet e tyre të menaxhimit. Kjo përmbledhje do të tërheqë vëmendjen për praktikat e mira dhe si ato mund të zbatohen në Prizren. Këto shembuj janë përzgjedhur nga rajoni dhe është më se e kështillueshme që autoritetet përgjegjëse të Prizrenit të vizitojnë dhe intervistojnë agjencitë qeveritare dhe udhëheqësit e organizatave jofitimprurëse në këto qytete historike. Në këtë mënyrë, mund të shihen përfitimet dhe rezultatet e një plani menaxhimi në mënyrë konkrete. Vizitat dhe intervistat e tilla do t'i japin liderëve të Prizrenit një ide ndaj vështirësive me të cilat ballafaqohen qytetet e tjera historike, si dhe përfitimet sociale dhe ekonomike.

Në vijim gjeni një përmbledhje të dy qyteteve rajonale që kanë përditësuar së fundi planet e tyre të menaxhimit, Ohri në Maqedoni dhe Korfuzi në Greqi. Dubrovniku është shembulli i tretë që për vite nuk kishte një plan menaxhimi, por u inkurajua nga UNESCO dhe Europa Nostra që të zhvillonte një të tillë. Kuptohet që Dubrovniku ka përfunduar së fundi planin e menaxhimit, kështuqë mund të shërbejë si një pikë e mire referimi, pasi liderët në Prizren mund të mësojnë nga përvojat e tyre të fundit.

Çdo qytet është i ndryshëm por të gjithë përballen me sfida të një natyre të njëjtë dhe këto qytete të Trashëgimisë Botërore kanë shumë ngjashmëri dhe sfida të njëjta si Prizreni. Studimi i këtyre shembujve, mund të jetë ndihmesë e madhe në zhvillimin dhe miratimin e Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Ohër (Maqedoni)

Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Ohrit. I shtrirë në brigjet e liqenit të Ohrit, qyteti i Ohrit është një nga vendbanimet më të vjetra në Evropë. I ndërtuar kryesisht midis shekujve 7 dhe 19, ka manastirin më të vjetër sllav (Shën Pantelejmoni) dhe më shumë se 800 ikona të stilit bizantin që datojnë nga shekulli 11 deri në fund të shekullit të 14-të. Pas atyre të Galerisë së Tretiakov në Moskë, këtu konsiderohet të jetë koleksioni më i rëndësishëm i ikonave në botë. [6]

Foto 3. Ohër (Maqedoni)

Ohri ka shumë të përbashkëta me Prizrenin, është një vendbanim i lashtë përgjatë rrugëve tregtare, me manastiret dhe ikonat e tyre, trashëgiminë otomane, dhe çka është me rëndësi është gjithashtu një vend me trashëgimi natyrore, me një liqen dhe male. Prizreni është i ngjashëm në atë që është i rrethuar me male të mbrojtura dhe unike me lloje endemike të florës dhe faunës së kombinuar me një lum dhe që ndan kufirin me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Për sa i përket trashëgimisë së ndërtuar, Ohri është po ashtu i ngjashëm me Prizrenin me arkitekturën e tij urbane dhe "trashëgiminë e ndërtuar", "arkitekturën otomane të banimit nga shekujt 18 dhe 19 të ruajtur mirë " dhe "rrjetin e ngushtë të rrugëve.[7]" Ohri, si Prizreni, gjithashtu ka një fortesë në një kodër të rrethuar me lagje dhe një qytet të ri në periferi.

Së fundmi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë i ka dorëzuar një plan të përditësuar të menaxhimit UNESCO-s[8], i projektuar për të menaxhuar qytetin dhe rajonin për vitet 2014-2020. Ky plan ishte rezultat i punës ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor i cili u miratua zyrtarisht edhe nga Qeveria. Gjithashtu janë mbajtur edhe disa seminare rajonale si dhe punëtori ndërkombëtare të organizuara nga Zyra Rajonale e

[6] https://whc.unesco.org/en/list/99
[7] ibid
[8] Kërkesë për një pronë të Trashëgimisë Botërore

UNESCO-s në Venedik. Plani i menaxhimit është mire i organizuar me një hyrje që qartë që tregon vizionin për qytetin dhe rajonin, ndjekur me një prezantim që përfshin kufijtë e vendndodhjes, si dhe një përshkrim të shkurtër të vlerave, integritetit dhe autenticitetit si dhe vazhdon me qëllimin, statusin, kuadrin ligjor dhe procesin. Është me rëndësi të ceket që një kapitull i tërë dedikohet për të përshkruar në thellësi vlerat në tri pjesë, ato kulturore (peizazhi, të paluajtshme, urbane dhe arkitektonike), ato natyrore dhe socio-ekonomike (shkencore, edukative, ekonomike / turistike). Një tjetër kapitull përfshin faktorët e rrezikut, si dhe kapituj të tjerë të tillë si potencialet, vizioni i thelluar, objektivat e përgjithshme dhe çështjet kyçe. Të veçanta janë kapitujt përfundimtarë të cilat përfshijnë planin e veprimit dhe zbatimit (përgjegjësitë, financimin, monitorimin dhe rishikimin). Plani i menaxhimit është i shkruar në një anglishte lehtë për t'u kuptuar, i fokusuar në temë, i ilustruar mirë me fotografi dhe harta, dhe përmban referenca të shumta. Është gjithashtu e ndershme në kritikat e saj dhe e kujdesshme që qyteti të bëhet tepër i varur nga zhvillimi i turizmit. Plani i veprimit ndahet në qëllime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata dhe cakton përgjegjësi të qartë midis agjensive qeveritare. Kritikisht, ai ndërtohet mbi një plan menaxhimi të mëparshëm nga viti 2010. Kjo është esenciale në atë që udhëheqësit e Prizrenit duhet ta kuptojnë se menaxhimi është një proces, e jo veç një dokument.

Përderisa Ohri është pronë e Trashëgimisë Botërore në dy kategori (atë kulturore dhe natyrore), mund të shërbejë si një shembull i mirë për Prizrenin. Ka shumë ngjashmëri fizike dhe kulturore, gjithashtu edhe sfida. Një nga mënyrat që qyteti po mundohet të përmbushë këto sfida është nëpërmjet formimit të një Komisioni që shpërndahet si vertikalisht ashtu edhe horizontalisht, ndërmjet agjencive qeveritare. Ndonëse është i madh me mbi 20 anëtarë, kjo qasje është e ngjashme me Prizrenin, pasi që ekziston një zyrë e propozuar për qendër historike. Gjithashtu, këto sfida po plotësohen përmes një sërë programesh për të ndërtuar kapacitetet në planifikimin e menaxhim. Autoritetet në Ohër përfunduan kohët e fundit një pilot projekt[9] për të adresuar kërcënimet kryesore për rajonin, ku kanë dërguar individë në kurse të ndryshme për trashëgimi ndërtimore në ICCROM[10] dhe kanë kryer disa punëtori të planifikimit të menaxhimit[11] dhe marrin pjesë në projektet ndërkufitare të Bashkimit Evropian.

Si përmbledhje, praktika të mira që Prizreni mund të adoptojë nga Ohri:

- Themelimi i një zyre ose komisioni ndërinstitucional për të udhëhequr dhe zbatuar planin e menaxhimit
- Përcaktimi i një plan veprimi në tavolinë me përgjegjësi të qarta në afate të shkurtëra / të mesme / të gjata
- Përditësimi i planit të menaxhimit pas disa viteve
- Përfshirja e natyrës në planin e menaxhimit
- Inkorporimi i turizmit në plan
- Kërkimi proaktiv për përfshirjen në projektet ndërkufitare të BE-së
- Ndihma nga organizatat ndërkombëtare
- Përfshirja e mbetjeve arkeologjike në plan që gjenden jashtë qendrës së qytetit

[9] "Toward strengthened governance of the shared transboundary natural and cultural heritage of the Lake Ohrid Region"

[10] International Centre for the Study of the Preservation and Restoration of Cultural Property

11 https://whc.unesco.org/en/news/1252/
https://whc.unesco.org/en/events/1305/
http://www.southeast-europe.net/document.cmt?id=785

Korfuz (Greqi)

Qyteti i vjetër i Korfuzit, në ishullin e Korfuzit në brigjet perëndimore të Shqipërisë dhe Greqisë, gjendet në një pozicion strategjik në hyrje të detit Adriatik dhe ka rrënjët e saj në shekullin e 8 para Krishtit. Tre fortesat e qytetit, të dizajnuara nga inxhinierë të njohur venedikas u përdorën për katër shekuj për të mbrojtur interesat tregtare detare të Republikës së Venedikut kundër Perandorisë Osmane. Gjatë kohës, kalatë u riparuan dhe pjesërisht u rindërtuan disa herë, së fundmi nën sundimin britanik në shekullin e 19-të. Fondi neoklasik i banesave/shtëpive të qytetit të vjetër është pjesërisht nga periudha venedikase, pjesërisht nga ndërtimet e më vonëshme, sidomos në shekullin e 19-të. Si një port i fortifikuar i Mesdheut, tërësia urbane dhe porti i Korfuzit është i dukshëm për nivelin e lartë të integritetit dhe autenticitetit[12].

Vini re referimit specifik në përshkrimin e Trashëgimisë Botërore të "fondit të shtëpive". Kjo duhet të theksohet pasi që shumica besojnë se shtëpitë tradicionale kanë më pak vlerë në krahasim me arkitekturën monumentale siç janë xhamitë, kishat apo fortesat. Kriteri (iv) i Vlerës së Jashtëzakonshme Universale përcakton integritetin e qytetit me dominim nga një fortesë - shumë e ngjashme me Prizrenin. Mbi shtëpitë historike të Korfuzit është një fortesë që sapo është riparuar, gjithashtu e ngjashme me Prizrenin. Gjithashtu, ekziston një nivel i lartë mbrojtjeje, ku përgjegjësia ndahet në shumë agjenci të ndryshme si Ministria Helenike e Kulturës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Punëve Publike dhe Bashkia e Korfuzit. Kjo tregon se ndërkohë që shumë agjenci të ndryshme janë përgjegjëse, ato mund të bëhen të gjitha së bashku për mbrojtjen e këtij qyteti historik. Ekziston edhe një zyrë (gjysmë) e pavarur për mbikëqyrje dhe për mbrojtje, diçka e ngjashme e planifikuar për Prizrenin.

Foto 4. Korfuz (Greqi)

[12] World Heritage Centre UNESCO https://whc.unesco.org/en/list/978

Së fundi, ekziston plani i menaxhimit si dhe një plan veprimi urban. Ky plan është një përditësim i një plani të suksesshëm të viteve 2006-2012. Ky plan përfshin një vizion afatgjatë dhe prezanton konceptin e një "Komiteti Konsultativ" si një metodë për angazhimin e përhershëm të akterëve dhe vendimmarrësve dhe një plan veprimi të përditësuar. Përfshirë në planin e menaxhimit është krijimi i një Regjistri të Pronarëve dhe njohja e rëndësisë së financimit për zbatimin e planit. Një aspekt interesant dhe i dobishëm i planit ishte edhe përfshirja e komenteve nga palët e interesit dhe qytetarët.

Plani i Menaxhimit përfshin të gjithë komponentët standard duke përfshirë vizionin, përshkrimet, identifikimin e çështjeve dhe menaxhimin e rrezikut. Një aspekt kritik për Prizrenin është përfshirja e një plani të trafikut, parkimit dhe qasjes fizike. Përderisa nuk ka një studim për trafikun, plani i menaxhimit adreson edhe këtë çështje të rëndësishme. Në seksionin e përditësuar të trafikut, ka çështje të theksuara që tingëllojnë shumë të ngjashme me situatën në Prizren[13].

Si përfundim, asnjë plan nuk është i përsosur dhe qytetet historike si Korfuzi do të vazhdojnë të përballen me sfida të rëndësishme duke përfshirë zgjerimin e portit, ndryshimet e paligjshme dhe turizmin në rritje. Megjithatë, ata kanë një dokument ekzistues i cili i bën së bashku agjencitë dhe palët e interesuara.

Praktika të mira që Prizreni mund të adoptojë nga Korfuzi:

- Vlerësim i nevojës për një studim të trafikut dhe parkimit
- Formimi i një Komiteti Konsultativ për të angazhuar dhe koordinuar vazhdimisht palët e interesuara
- Përfshirja e një raporti të praktikave më të mira brenda planit të menaxhimit – i cili jep disa shembuj që ndihmojnë në zbatimin
- Duke ndjekur metodën SUSTCULT (sikur Ohri)
- Rrjet koordinues të qartë për aplikimin dhe ndikimin e Planit të Veprimit me treguesit dhe përgjegjësitë
- Përfshirja proaktive në hulumtimet e BE dhe projektet e bashkëpunimit ndërkufitar

[13] http://urbact.eu/corf%C3%B9

Dubrovnik (Kroaci)

"Perla e Adriatikut", e shtrirë në bregdetin dalmat, u bë një fuqi e rëndësishme detare mesdhetare që nga shekulli i 13-të e tutje. Megjithëse u dëmtua rëndë nga tërmeti i vitit 1667, Dubrovniku arriti të ruante kishat, manastiret, pallatet dhe fontanat e bukura Gotike, të Rilindjes dhe të Barokut.

Qyteti u dëmtua përsëri në vitet 1990 nga konflikti i armatosur dhe ishte fokus i një programi të rëndësishëm restaurimi të koordinuar nga UNESCO. Ky qytet i vogël bregdetar ishte futur në Listën e Trashëgimisë Botërore shumë herët, në vitin 1979.

Foto 5. Dubrovnik (Kroaci)

Dubrovniku gjithashtu ka shumë ngjashmëri me Prizrenin. Dubrovniku u ndërtua mbi rrjetet tregtare me lidhje të forta historike me Prizrenin. Një delegacion i vogël i tregtarëve të Raguzës[14] u themelua në mënyrë permanente në Prizren dhe ishte i suksesshëm në themelimin e një prej konsullatave të para i cili edhe përcaktoi rëndësinë e qytetit. Qyteti është i rrethuar nga malet dhe ka një kështjellë ekzistuese, si dhe përreth qytetit. Qyteti është krenar për ruajtjen e shtëpive, si dhe për arkitekturën monumentale. Sot qyteti përballet me sfida të shumta duke përfshirë transportin dhe çështje të mëdha me turizmin.

Dubrovniku për shumë vite nuk kishte një plan menaxhimi. Ka pasur vendime të shumta nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore dhe inkurajim nga Qendra e Trashëgimisë Botërore e UNESCO-s dhe Europa Nostra[15] për qytetin që të hartojë planin e menaxhimit. Ekzistojnë plane të menaxhimit rajonal[16], bregdetar dhe mjedisor, por jo një plan në mënyrë specifike për qendrën historike.

Në vitin 2017 Komiteti i Trashëgimisë Botërore në vendimin WHC/17/41.COM/8B.Add dhe WHC/17/41.COM/INF.8B1. deklaroi: 1. Referon modifikimin e propozuar në kufijtë e Qytetit të Vjetër të Dubrovnikut, Kroaci, që t'a lejojë shtetin pale të:
Sqarojë se si dhe kur Plani i Menaxhimit do të finalizohet dhe ndryshohet në mënyrë që të përfshijë masat e nevojshme rregullatore dhe menaxhuese për të lejuar që buffer zona të veprojë në mënyrë efektive si një shtresë shtesë e mbrojtjes për pronën në fjalë.

Por kjo nuk ishte hera e parë, një vendim i mëhershëm ishte edhe në vitin 2016: Të hartohet dhe dorëzohet Plani i Menaxhimit të pronës tek Qendra e Trashëgimisë Botërore për shqyrtim nga Organet Këshilldhënëse, duke përfshirë një strategji turistike, rregulloret ligjore për turizmin e

[14] Dubrovniku në të kaluarën është njohur me emërtimin Raguza
[15] Europa Nostra advocates sustainable development plan for Dubrovnik, Nov. 2013.
[16] http://medwet.org/2017/06/development-of-a-management-plan-for-the-neretva-delta-in-croatia/

anijeve të lundrimit, identifikimin e kapacitetit mbajtës të qëndrueshëm të qytetit, planin e veprimit për rreziqe dhe një strategji interpretimi.

Si dhe më 2014: Kërkon nga shteti palë të paraqesë Planin e Menaxhimit të pronës tek Qendra e Trashëgimisë Botërore për shqyrtim nga Organet Këshilldhënëse, duke përfshirë një strategji turistike, rregulloret ligjore për turizmin e anijeve të lundrimit, si dhe dokumentacionin e projektit dhe vlerësimin përkatës të ndikimit të trashëgimisë (HIA).

Sipas Institutit për Restaurimin e Dubrovnikut[17]: "Për momentin, Dubrovniku është në fazën e zhvillimit të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike dhe Zonat e Kontaktit, i koordinuar nga Instituti për Restaurimin e Dubrovnikut. Në kuadër të procesit "Qytetet me Mure & Shoqëritë e Hapura - Menaxhimi i Mureve Historike në Pronat e Trashëgimisë Botërore Urbane Siena, Itali. 26-27 janar 2017 (faqe 7), janë iniciuar disa aktivitete: komunikim me shoqërinë civile, grupe të ndryshme interesi dhe ekspertë, zhvillim të disa studimeve, prezantime, hulumtime, baza për GIS, punëtori, grupe fokusi, identifikimi i problemeve etj. Janë krijuar disa baza të dhënash për ta bërë Planin e Menaxhimit sa më funksional dhe me cilësi sa më të lartë të jetë e mundur."

Është e qartë se ka pasur një vonesë të madhe në zhvillimin e planit të menaxhimit. Kjo tregon se nuk është e lehtë të zhvillohet një dokument i tillë gjithëpërfshirës me kontributin e shumë palëve të interesuara. Kjo mungesë dhe vonesë e planit të menaxhimit, që kërkohet nga Qendra e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, mund të ketë qenë për disa arsye: 1) për shkak të ligjeve të rrepta të mbrojtjes dhe planifikimit ekzistues, 2) për shkak të institucioneve të forta lokale e shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse, 3) ndihmës ndërkombëtare duke pasur parasysh futjen e hershme në Listë 4) shkaku që planet e menaxhimit janë të vështirë për të shkruar dhe miratuar veçanërisht kur janë të përfshirë akterë të mëdhenj e të fortë dhe 5) presioni politik dhe zhvillimor duke pasur parasysh komponentin e fortë të turizmit.

Një vit më pare, Zyra e Venedikut e UNESCO-s mbajti një punëtori me titull Procesi i zhvillimit të planit të menaxhimit dhe zbatimi i tij për të ruajtur qytetin e vjetër të Dubrovnikut[18]. Në këtë seminar u përfshi edhe Instituti për Restaurimin e Dubrovnikut, Komisioni Kroat për UNESCO, Ministria e Kulturës dhe ekspertë të tjerë ndërkombëtarë. Temat e diskutuara ishin të ngjashme me atë që po përballet Prizreni tani duke përfshirë kufijtë, ndërtimin e paligjshëm ose restaurimet e papërshtatshme, strukturën e qeverisjes dhe prioritetet e planit të menaxhimit.

Dubrovniku sapo ka përfunduar planin e tij të menaxhimit. Kështuqë udhëheqësit e Prizrenit duhet të vizitojnë Dubrovnikun dhe të njoftohen me qytetin, shtetin, agjensitë jofitimprurëse, si dhe ata që përpiluan dhe përfunduan planin. Kjo do të japë një pasqyrë të qartë në vështirësitë e fundit me të cilat ballafaqohet qyteti dhe miratimin e planit nga shumë akterë të ndryshëm.

Derisa plani ende nuk është bërë publik, Dubrovniku ofron disa praktika të mira që mund të adoptohen.

- Përfshirja e një organizate nga shoqëria civile për menaxhimin dhe ruajtjen e qytetit, sidomos Shoqata e Miqve të Antikiteteve të Dubrovnikut.
- Një zyre specifike komunale që i kushtohet zhvillimit socio-ekonomik.
- Një kalendar i pasur i aktiviteteve sociale ku qytetarët përfitojnë ekonomikisht, si dhe tërheqjen e vizitorëve në qendrën historike.
- Organizimi i agjencive të ndryshme dhe një zyre specifike lokale dedikuar ruajtjes dhe menaxhimit.

[17] January 2017, Walled Cities & Open Societies: Managing Historic Walls in Urban World Heritage Properties, January 2017.

[18] http://www.unesco.org/new/en/venice/about-this-office/single-view/news/process_of_management_plan_development_and_of_its_applicatio/

- Përfshirja e zyrës së UNESCO-s në Venedik për të ndihmuar në miratimin e një plani menaxhimi.
- Organizimi i forumeve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë këtu takimet e Europa Nostra dhe "Best in Heritage", një konferencë vjetore globale për muze si dhe projekte të trashëgimisë dhe konservimit19.
- Menaxhimi i turmës dhe turizmit

Si përfundim, shkrimi i një plani të menaxhimit është i vështirë, ndërsa miratimi dhe zbatimi i tij edhe më i vështirë. Sidoqoftë, këta shembuj janë shumë të vlefshme dhe të nevojshme për çdo qytet që merr seriozisht mbrojtjen e karakterit historik. Rekomandohet fuqimisht që udhëheqësit e Prizrenit të kontaktojnë qytetet e përdorura si shembuj në këtë pjesë dhe të vizitojnë, takohen dhe mësojnë nga puna e tyre. Këto shembuj janë zgjedhur në mënyrë specifike pasi janë afër Prizrenit dhe mund të vizitohen brenda pak ditësh dhe mund të njoftohen edhe nga afër me autorët e këtyre planeve të menaxhimit. Këto qytete gjithashtu ndajnë shumë ngjashmëri, sfida dhe histori me Prizrenin. Jo vetëm që udhëheqësit e Prizrenit mund të mësojnë rreth planeve të menaxhimit ata gjithashtu mund të mësojnë rreth turizmit kulturor, festivaleve, marketingut etj. Këto takime mund të rezultojnë edhe me rrjetëzim në të ardhmen.

[19] https://www.thebestinheritage.com/

4. METODOLOGJIA



Tabela 1 Paraqaitja skematike e procesit të Burra Charter për hartim të Planeve të Menaxhimit dhe fazave të projektit të Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit

Metodologjia e Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit bazohet në parimet e Kartës së Burra-s dhe praktikat më të avancuara ndërkombëtare të menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Element shumë i rëndësishëm i këtij Plani është gjithëpërfshirja gjatë tërë procesit. Projekti, përmes formave të ndryshme të komunikimit si takime joformale, takime zyrtare, takime konsultative me grupe të ndryshme institucionale dhe ato të shoqërisë, punëtori e prezantime publike ka konsultuar palët e interesit me të drejtat, detyrimet dhe interes në fushat e mbrojtjes, ruajtjes, promovimit dhe shfrytëzimin socio-ekonomik të Qendrës Historike të Prizrenit.



5. VLERAT DHE DEKLARATA E RËNDËSISË

Vlerat, rëndësia dhe autenticiteti paraqesin tema të rëndësishme, pasi që janë baza themelore për përcaktimin dhe udhëzimin se çka është me rëndësi, çka duhet të ruhet, dhe ndihmojnë në përcakimin e prioriteteve për të ardhmen.

Vlerat përfshijnë aspektet historike, shkencore, shoqërore, ambientale, estetike dhe ekonomike, dhe në mënyrë që një lokalitet të konsiderohet autentik, këto vlera duhet të ruhen dhe të transmetohen në mënyrë të drejtë dhe të besueshme.

Konservimi i trashëgimisë kulturore dhe ruajtja e periudhave dhe shtresimeve historike bazohet në procesin e atribuimit të vlerave të caktuara një aseti apo lokacioni. Aftësia jonë për përcaktimin dhe kuptimin e këtyre vlerave bazohet në shkallën në të cilën burimet e informacionit në lidhje me këto vlera mund të kuptohen si të besueshme ose të vërteta. Njohuria dhe kuptimi i këtyre burimeve të informatave, në lidhje me karakteristikat thelbësore të trashëgimisë kulturore dhe domethënies së tyre, është parakusht për vlerësim të të gjitha aspekteve të autenticitetit.[20] Kjo deklaratë del nga Dokumenti i Nara-s mbi Autenticitetin. Dokumenti i Nara-s është hartuar duke u bazuar në Kartën Ndërkombëtare të Venedikut me qëllim të zgjerimit të fushëveprimit për adresim të shqetësimeve nga fusha e trashëgimisë kulturore. Ky dokument adreson nevojën për kuptim më të thellë të diversitetit kulturor dhe trashëgimisë kulturore, për sa i përket ruajtjes dhe nënvizon aftësinë për të na lejuar të bëjmë zgjedhje të ndryshme të ruajtjes. Mbështetja e filozofisë së konservimit mbi vlerat ka mundësuar korrigjimin e qasjes së vjetër që kishte në fokus ekskluzivisht ruajtjen e materialeve, restaurimet stilistike dhe njëkohësisht lejon një përkufizim më të gjerë të konceptit të konservimit. Kulturat e ndryshme kanë perceptime të ndryshme në lidhje me vlerat, dhe rrjedhimisht edhe qasje të ndryshme ndaj ruajtjes së tyre. Vlerësimet dhe gjykimet në lidhje me vlerat e atribuara ndaj aseteve kulturore, si dhe besueshmëria ndaj burimeve të informatave mund të ndryshojnë nga kultura në kulturë, si dhe edhe brenda një kulture të njëjtë. Prandaj gjykimi mbi përcaktim të vlerave dhe autenticitetit nuk mund të bazohet në kritere fikse.[21] Përkundrazi, përkufizimi dhe vlerësimi i aseteve kulturore duhet të bëhet duke marrë parasysh kontekstin kulturor të cilës i përkasin.

Ngritja e vetëdijes rreth procesit të vlerësimit dhe vlerave paraqet një parakusht kryesor dhe një nevojë të domosdoshme në mënyrë që të arrihet te përcaktimi i mjeteve me të cilët mbrohen dhe ruhen gjurmët e së kaluarës. Kjo nënkupton kuptimin thelbësor të vlerave të prezantuara nga asetet kulturore, si dhe respektimin e rolit të tyre në shoqërinë bashkëkohore.

Atëherë çka ruhet në qoftë se nuk ruhen ekskluzivisht vetëm materialet fizike?

Nëpërmjet përcaktimit të vlerave që i atribuohen aseteve të trashëgimisë kulturore ne ruajmë vlerat themelore që njerëzit i mbajnë në këto vende. Vlerat reflektojnë shumëllojshmërinë e mënyrave me të cilat njerëzit lidhen me asetet e trashëgimisë kulturore. Ato janë mjetet nëpërmjet të cilave përcaktohet autenticiteti dhe rëndësia. Nëpërmjet kësaj qasjeje mund të fillohet identifikimi se çka duhet të ruhet.

[20]The NARA Document on Authenticity, Japan, 1994, www.whc.unesco.org/document/116018, accessed January 09, 2018.
[21]Herb Stovel, Origins and Influence of the Nara Document on Authenticity, APT Bulletin, Vo. 39, No 2/3 2008 pp 9-17.

Procesi i vlerësimit paraqet një fazë të rëndësishme në përcaktimin e qasjes së konservimit, vendimeve për të ardhmen, vizionin dhe objektivat për Qendrën Historike të Prizrenit.

Qendra Historike e Prizrenit paraqet një lokalitet kompleks ku historia, arkitektura, zhvillimet urbane janë integruar me traditat, zakonet dhe jetën e përditshme të ndryshueshme. Për të krijuar një kuptim të thellë dhe të hollësishëm vlerësimi është strukturuar në disa nivele.

Vlerësimi i Qendrës Historike të Prizrenit është strukturuar në tri nivele:

1. **Niveli i ndërtesës**
   1.1. Asetet e listuara në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje;
   1.2. Ndërtesat individuale që shtrihen brenda perimetrit të Qendrës Historike të Prizrenit;

2. **Niveli i zonave**
   2.1. Kalaja e Prizrenit;
   2.2. Zona e Nënkalasë;
   2.3. Zona e banimit (me strukturë organike) – Pantelija;
   2.4. Zona e banimit me trende të ndërtimit (Potok Mahalla, Papaz Çarshija);
   2.5. Zona tradicionale e dyqaneve – Shadërvani, Kujumxhilluk, çarshia e Sinan Pashës;
   2.6. Zona e bregut të lumit – Kej;
   2.7. Zona perëndimore – Suzi Çelebi dhe Tabakhana;
   2.8. Zona e shfrytëzimit të përzier dhe e banimit – Atik Mahalla;
   2.9. Zona e aksit tregtar – Arasta Mahalla;
   2.10. Zona e aksit tregtar– Saraçhane;
   2.11. Zona e aksit tregtar– Mahalla e Kovaçëve dhe rruga Adem Jashari;
   2.12. Zona e shfrytëzimit të përzier dhe e banimit– Rahlin Mahalla;

3. **Niveli i qytetit**
   3.1 Kriteret e Trashëgimisë Botërore për përkufizimin e Vlerave të Veçanta Univerzale
   3.2 Nara Grid

1. <u>Niveli i ndërtesës</u>

Në këtë nivel vlerësimi është bërë në dy aspekte:

Aspekti i parë i trajton ndërtesat individuale të cilët janë të listuar në listën zyrtare të Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje, e cila është aprovuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Lista e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përkohshme është formalizuar në vitin 2011[22], dhe përditësohet për çdo vjet. Lista e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përkohshme 2017-2018[23] përfshin 61 monumente dhe 6 ansamble / komplekse të cilët shtrihen brenda perimetrit të Qendrës Historike të Prizrenit. Këto asete janë regjistruar në kategorinë Trashëgimia

[22] Memli KRASNIQI, "Positive changes in culture, sport, cultural heritage and youth in 2011" *in Kosovo's Culture, Youth and Sport Neësletter*, No.1, January-February 2012, 2.

[23] Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përkohshme 2017-2018, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, burimi: Arkivi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren, qasur Janar 09, 2018.

Arkeologjike, nën-kategoria: Monument / Ansambël, dhe në kategorinë: Trashëgimia Arkitektonike, nën-kategori: Monument / Ansambël. Qendra Historike e Prizrenit gjendet në nën-kategorinë: Fushë e Konservimit Arkitektural.

Në vitin 2016 është zyrtarizuar Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përhershme. Në këtë list gjenden 4 asete të trashëgimisë kulturore që ndodhen brenda perimetrit të Qendrës Historike të Prizrenit.[24]

Për këto monumente një studim paraprak i detajuar nga profesionistët të fushës së trashëgimisë kulturore, dhe dosjet me të dhëna relevante tekstuale, bibliografike dhe grafike janë dhënë në shërbim të hartimit të Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit.

Këto monumente janë ri-kontrolluar edhe njëherë në terren, dhe procesi i vlerësimit është freskuar.



Harta1. Harta me monumentet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje (statusi ligjor)

Aspekti i dytë trajton ndërtesat individuale të cilët gjenden brenda perimetrit të Qendrës Historike të Prizrenit. Për këtë nivel janë përcaktuar tri kategori të vlerësimit:

- Ndërtesë me vlera të trashëgimisë kulturore;
- Ndërtesë pa vlera mbresëlënëse të trashëgimisë kulturore, por në harmoni me kontekstin historik;
- Ndërtesë pa vlera mbresëlënëse të trashëgimisë kulturore, dhe në dis-harmoni me kontekstin historik;

[24] Lista e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përhershme, burimi: Arkivi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren, qasur Janar 09, 2018.

Përcaktimi dhe klasifikimi i vlerave është bërë duke u bazuar në konventa ndërkombëtare[25] dhe në ligjet dhe rregulloret kombëtare[26], si dhe në bazë të rekomandimeve të paraqitura në Planin e Konservimit dhe të Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit[27].

Për secilën ndërtesë është bërë studimi në terren dhe është plotësuar formulari i mëposhtëm.

Vlerat kulturore	**Historike** *(lidhur me kohën e tashme)*	**Artistike** *(ndijore dhe intelektuale)*	**Shkencore** *(teknike/ konstruktive)*	**Raritetit** *(bazuar në statistika)*	**Identiti** *(bazuar në përcaktim / njohje)*	**Ambientale** *(peizazhi natyror dhe historik)*
Vlerat shoqërore	**Shoqërore** *(kuptim për një grup / komunitet)*	**Edukative** *(na mëson diçka)*	**Politike** *(për njërin apo tjetrin grup)*			
Vlerat ekonomike	**Ekonomike***(turizmi, shfrytëzimi)*	**Funksionale** *(ende në shfrytëzim)*				

Në bazë të procesit të vlerësimit janë hartuar hartat me vlerat e trashëgimisë kulturore.



Harta2. Harta e vlerave të ndërtesave individuale

[25] Management Guidelines for Ëorld Cultural Heritage Sites", Rome: ICCROM, 1998.
[26]Rregullore Nr. 05/2008 mbi regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, http://ëëë.mkrs-ks.org/?page=1,111, qasur January 09, 2018.
[27]Enes TOSKA editor, *Plani i Konservimit dhe i Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, Përparësitë dhe sfidat e zbatimit*, Prishtinë: CHëB, 2010.

2. Niveli i Zonës

Struktura urbane e Zonës Historike të Prizrenit është paraqitur në kapitullin e kaluar (Shih Kapitulli 4.3). Ashtu si është paraqitur edhe në atë kapitull, struktura e qytetit gjatë kohës ka përjetuar transformime në aspektin urban, që ndërlidhet edhe me strukturat e reja të ndërtuara, si dhe transformimet në funksione të nën-zonave historike. Vlerësimi i bërë për ndërtesat individuale, në nivel të zonës do të plotësohet me vlerësim të tërësive urbanistike – zonave.

Ndarjet e 12 zonave – Mahallave janë si më poshtë:

2.1. Kalaja e Prizrenit
2.2. Zona e Nënkalasë
2.3. Zona e banimit (me strukturë organike) – Pantelija
2.4. Zona e banimit (sipas trendeve aktuale të ndërtimit) - Potok Mahalla, Papaz Çarshija
2.5. Zona e tregut tradicional – Shadërvani, Kujumxhilluk, çarshia e Sinan Pashës
2.6. Zona e bregut të lumit – Kej
2.7. Zona perëndimore –Tabakhana dhe Mahalla e Suzi Çelebisë
2.8. Zona e shfrytëzimit të përzier dhe e banimit – Atik Mahalla;
2.9. Zona e aksit tregtar – Saraçhane
2.10. Zona e aksit tregtar – Arasta Mahalla
2.11. Zona e aksit tregtar – Çarshia e Kovaçëve dhe rruga Adem Jashari
2.12. Zona e shfrytëzimit të përzier dhe e banimit – Rahlin Mahalla

Vlerësimi i 12 zonave (mahallave) brenda Qendrës Historike të Prizrenit është realizuar duke marrë parasysh këto aspekte:

- Atributet kryesore arkitektonike të zonës;
- Periudhat historike dhe stilet dominuese;
- Integrimi i vlerave materiale me ato shpirtërore: ndërtesat dhe funksionet e zonës, transformimi i tyre gjatë kohës, dhe çka ka mbetur që duhet të ruhet sot?
- Kualiteti i tipareve të dizajnit urban: vlerësimi i hapësirave publike.

Pas vlerësimit në bazë të aspekteve të lartpërmendura, për secilën zonë do të paraqiten, udhëzimet dhe kufizimet në lidhje me nivelin e ndërhyrjeve të propozuara, në mënyrë që vlerat e trashëgimisë kulturore të asaj zone të mbrohen, ruhen dhe të rikthehen.



Harta 3. Harta me zonat brenda Qendrës Historike të Prizrenit



Harta 4. Harta me ndërtesat me vlerë të trashëgimisë kulturore dhe perimetrat e zonave - mahallave

3. Niveli i qytetit

Prizreni është një prej qyteteve më të vjetra të Kosovës i pasur me një karakter të veçantë urban dhe arkitektonik. Qyteti ngërthen një trashëgimi të pasur kulturore me vlera të larta estetike, shpirtërore, shkencore dhe ekonomike.

Prizreni është një qytet i pasur me kulturë, histori, gjuhësi dhe natyrë. Kisha e Shën Premtes, e cila gjendet në Listën e Trashëgimisë Botërore në rrezik gjendet në qendër të saj[28]. Qyteti gjithashtu akomodon Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, një monument kandidat për t'u propozuar në Listën e Trashëgimisë Botërore. Lidhja Shqiptare e Prizrenit paraqet ngjarjen historike, kur gjatë pjesës së dytë të shek. 19, janë vënë themelet e formimit të shtetit Shqiptar.

Prizreni është kryeqendra kulturore dhe shpirtërore e Kosovës, dhe gjithashtu edhe rajonale, falë diversitetit të pasur kulturor, gjuhësor dhe fetar. Në Prizren fliten së paku katër gjuhë nga banorët lokal, dhe ekzistojnë tri religjionet kryesore, muslimane, krishtere dhe hebreje. Këto vlera shoqërore pasurohen edhe më tej me vlerat ambientale, pasi që qyteti rrethohet në dy anë me male, ku shtrihet edhe Parku Kombëtar i Sharrit, i cili është vendbanim i specieve të ndryshme endemike.

VLERAT UNIVERZALE TË DALLUARA

Si mund të arrihet vlerësimi i të gjitha këtyre vlerave në nivel të qytetit?

Një prej metodave të shfrytëzuara për përshkrimin e vlerave të një aseti të trashëgimisë kulturore, është shfrytëzimi i kritereve të përcaktuara nga UNESCO me rast të listimit të një lokaliteti në Listën Botërore të Trashëgimisë.

Këto 10 kritere paraqesin metodat kryesore të punës së Konventës së Trashëgimisë Botërore dhe bazohen në konceptin e identifikimit të Vlerës së Dalluar Univerzale; që nënkupton vlerat të cilët veçohen si tipare reprezentative për gjithë njerëzimin. Lokalitetet e listuara në Listën e Trashëgimisë Botërore duhet të ruajnë, mbi të gjitha, këto kritere të përcaktuara, dhe konservimi i këtyre lokaliteteve monitorohet dhe vlerësohet duke u bazuar në këto kritere. Aplikimet e reja në Listën e Trashëgimisë Botërore përgatiten dhe vlerësohen duke u bazuar në këto kritere[29]. Ky vlerësim i Prizrenit duke i shfrytëzuar këto kritere, në të ardhmen mund të transformohet në një draft të dosjes së nominimit të qytetit në Listën e Trashëgimisë Botërore.

10 Kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:

(i) Të përfaqësoj një kryevepër të gjenialitetit kreativ human;
(ii) Të prezantojë një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore, gjatë një periudhe kohore ose brenda një zonë kulturore të botës, mbi zhvillimet në arkitekturë, teknologji, arte monumentale, planifikim urban ose dizajn të peizazhit;
(iii) Të bart një dëshmi unike apo së paku të jashtëzakonshme të një tradite kulturore apo të një civilizimi që ka mbijetuar apo është zhdukur;
(iv) Të paraqet një shembull të shquar të një tipologjie të ndërtmit, ansamblit arkitektonik apo teknologjik apo peizazhi i cili përfaqëson një (disa) fazë(a) të rëndësishme në historinë e njerëzimit;
(v) Të paraqet një shembull të shquar të një vendbanimi tradicional, shfrytëzimit të tokës, ose detërave, që paraqet një shembull reprezentativ të një (disa) kultura (ve), ose shkëmbimit

[28]Update of the List of Ëorld Heritage in Danger (Retained Properties), http://ëhc.unesco.org/en/decisions/6926, accessed January 10, 2018.
[29] The Criteria for Selection, Operational Guidelines for the Implementation of the Ëorld Heritage Convention. http://ëhc.unesco.org/en/criteria/, accessed January 18, 2018.

ndërmjet humanes dhe ambientit, sidomos në rastet e pambrojtura nga ndikimet e ndryshimeve të pakthyeshme;

(vi) Të jetë i ndërlidhur në mënyrë direkte apo indirekte me ngjarjet apo traditat që jetojnë, me idetë ose besimet, me punimet artistike apo letrare me rëndësi unike universale. (Komiteti mendon që ky kriter do të duhej të përdoret në lidhje me kriteret tjera);

(vii) Të përmbajë fenomene superlative natyrore ose zona me bukuri të jashtëzakonshme natyrore dhe rëndësi estetike;

(viii) Të paraqet shembuj të shquar që përfaqësojnë fazat kryesore të historisë së tokës, duke përfshirë historinë e jetës, proceset gjeologjike të rëndësishme në zhvillim, në zhvillimin e formave të tokës ose karakteristika të rëndësishme gjeomorfike ose fiziografike;

(ix) Të paraqesin shembuj të shquar që përfaqësojnë procese ekologjike dhe biologjike të vazhdueshme në evoluimin dhe zhvillimin e ujërave tokësore, të burimeve, ekosistemet bregdetare dhe detare dhe komunitetet e bimëve dhe kafshëve;

(x) Të përmbajë habitatet më të rëndësishme dhe domethënëse natyrore për ruajtjen in-situ të diversitetit biologjik, duke përfshirë ato që përmbajnë specie të kërcënuara me vlera universale të shquara nga pikëpamja e shkencës apo konservimit.

Një ose më tepër kritere duhet të përmbushen në mënyrë që të fitohet e drejta për t'u nominuar në Listë. Bazuar në hulumtimet e kryera dhe në rezultatet e dala nga punëtoria e vlerësimit që është organizuar gjatë verës së vitit 2017 me palë të ndryshme të interesit, për Prizren janë përzgjedhë këto kritere:

V - Të paraqet një **shembull të shquar të një vendbanimi tradicional**, shfrytëzimit të tokës, ose detërave, që paraqet një shembull reprezentativ të një (disa) kultura (ve), ose shkëmbimit ndërmjet humanes dhe ambientit, sidomos në rastet e pambrojtura nga ndikimet e ndryshimeve të pakthyeshme;

Prizreni paraqet një shembull të një vendbanimi tradicional në lulëzim, që ende shfrytëzohet. Qyteti bart në vete dëshmi të kulturave të shumta nga periudha parahistorike, Romake, Bizantine, Osmane, Shqiptare dhe Serbe.
Prizreni nuk paraqet vetëm një vendbanim tradicional me arkitekturë vernakulare, por gjithashtu përmban shembuj të arkitekturës monumentale të shprehur në Xhaminë e Sinan Pashës e Kishën e Shën Premtes, vepra inxhinjerike sikurse Ura e Gurit, dhe arkitekturë të fortifikimit.
Gjetjet arkeologjike dëshmojnë se Kalaja e Prizrenit ka qenë e banuar që nga periudha e Bronzit, me të dhënat arkeologjike dhe historike që tregojnë një mbivendosje të vazhdueshme të shtresave kulturore që nga fundi i Eneolitit.
Kjo zonë dëshmon diversitetin urban dhe shoqëror nëpërmjet stileve të shtëpive të cilët kryesisht janë ndërtuar gjatë periudhës Osmane, që ofrojnë një ndjenjë përkatësie të komunitetit.
Është ky gërshetim i vendbanimit, arkitekturës dhe stileve që e bën Prizrenin një shembull të veçuar të një vendbanimi tradicional human.

VI - Të jetë i **ndërlidhur në mënyrë direkte apo indirekte me ngjarjet** apo traditat që jetojnë, me idetë ose besimet, me punimet artistike apo letrare me **rëndësi unike universale**.[30]

Prizreni është vendi i themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Të ballafaquar nga vendimet e marra në Traktet e nënshkruara në Evropë, përfaqësues të territoreve të banuara me Shqiptarë, nga Ballkani u mblodhën në Prizren, duke themeluar Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. [31] Kërkesa

[30] Komiteti mendon që ky kriter do të duhej të përdoret në lidhje me kriteret tjera.
[31] Jelavich, Barbara, "History of the Balkans: Eighteenth and nineteenth centuries", Cambridge University: Cambridge University Press, 1999, p. 361.

fillestare ishte ruajtja e integritetit në kuadër të Perandorisë Osmane, por kur kjo kërkesë nuk dha rezultate, kërkesa u drejtua rreth pavarësisë. Kjo është hera e parë ku qytetarët e territoreve të banuara me shqiptarë u bashkuan për të shprehur kërkesën themelore dhe universale për vetëvendosje dhe për ruajtjen nga coptimi i territoreve të banuar me shqiptarë. Ky takim paraqet një shembull për popujt tjerë në kuadër të Perandorisë Osmane për adresim të kërkesave të tyre, dhe një vizion për të ardhmen e rajonit.
Vlera univerzale e shprehur këtu është rëndësia e një ngjarjeje, ideje dhe besimi për të drejtën e vetëvendosjes së një kombi.
Krahas kësaj ngjarje të rëndësishme historike, Prizreni paraqet edhe një shembull të një qyteti unik ku tri religjionet kanë bashkëjetuar në harmoni për qindra vite me radhë.

II, III, IV Të prezantojë një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore; Të bart një dëshmi unike apo së paku të jashtëzakonshme të një tradite kulturore; dhe Të paraqet një shembull të shquar të një tipologjie të ndërtmit, ansamblit arkitektonik apo teknologjik apo peizazhi i cili përfaqëson një (disa) fazë(a) të rëndësishme në historinë e njerëzimit;

Këto kategori janë plotësuar dhe njohur në Kongresin e Trashëgimisë Botërore të UNESCOS në afreskat e shek. 14 që gjenden në enterier të Kishës së Shën Premtes. Kjo kishë paraqet një shembull të ndërthurjes së disa stileve, duke filluar nga stili Palaelogian i Rilindjes, me kombinim të ndikimeve të traditave Ortodokse Bizantine dhe Romanikës Perëndimore. Ky stil ka luajtur një rol vendimtar në artin pasardhës në Ballkan.

Kisha e Shën Premtes ngërthen në vete kultura të ndryshme, është një kishë mesjetare e shek. 14, e ndërtuar mbi themelet e një kishe paleokristiane, më vonë e shndërruar në xhami gjatë periudhës Osmane, dhe më pas përsëri e konvertuar në kishë në pjesën e parë të shek. 20.

Kriteret e ngjashme mund të aplikohen edhe në rastin e xhamisë së Sinan Pashës, e cila paraqet një shembull unik të arkitketurës monumentale fetare nga periudha Osmane.

VII - Të përmbajë fenomene superlative natyrore ose zona me bukuri të jashtëzakonshme natyrore dhe rëndësi estetike.

Në anën lindore, jugore dhe perëndimore Prizreni rrethohet me zonën e vazhdueshme malore me lartësi të madhe mbidetare të Maleve të Sharrit. Në këto male rriten bimë të ndryshme indigjene (vendore) sikurse Rrëqebulli i Ballkanit, specie e rrezikuar nga zhdukja.

Parku Nacional i Maleve të Sharrit shtrihet pjesërisht në territorin e Komunës së Ferizajit dhe të Prizrenit, dhe zë një sipërfaqe rreth 54 hektarësh. Ky Park gjendet në pjesën veriore të Maleve të Sharrit, të cilët vazhdojnë në pjesën veriore të Shqipërisë, në juglindje të Kosovës, dhe në veriperëndim të Maqedonisë.

Parku ngërthen në vete terren të ndryshueshëm përfshirë liqenet akullnajore, peizazhe alpine dhe akulljnaja32. Malet që shtrihen në zonën rreth Prizrenit janë unike dhe dallojnë nga malet që shtrihen përgjatë kufirit me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Kosovën.

Ky peizazh unik i bukurisë së paprekur natyrore, edhepse nuk gjendet në qendër të Prizrenit, po është ngjit me te, do të duhej të vlerësohej si Vlerë Univerzale e Dalluar.

Në bazë të analizave të hollësishme të vlerave, vijmë në përfundim të deklaratës së mëposhtme:

[32]EuroNatur Shar mountain National Park, https://www.euronatur.org/en/what-we-do/project-areas/project-areas-a-z/shar-mountains/.

DEKLARATA E RËNDËSISË SË PRIZRENIT:

Qendra Historike e Prizrenit është bërthama e qytetit, që gjendet në kryqëzimin e rrugëve antike, dhe përmban dëshmi të civilizimeve dhe kulturave të kaluara nga parahistoria, qytetërimi Dardan, deri në periudhat Para-Romake, Romake, Bizantine, Arbërore, Serbe, Osmane dhe Shqiptare.

QHP paraqet një shembull të një vendbanimi tradicional në lulëzim, që ende shfrytëzohet, me arkitekturë të dalluar vernakulare dhe monumentale, vepra inxhinjerike dhe arkitekturë të fortifikimit, të integruar me burimet natyrore të lumit dhe maleve në një mjedis të ndërthurur në harmoni.

Vlerat e QHP përfshijnë dëshmitë historike të jetës shoqërore në të kaluarën, konceptin tradicional dhe transformimet e familjes dhe shoqërisë, morfologjinë urbane dhe arritjet në teknologjinë e ndërtimit. Gjithashtu dëshmon për mënyrën e jetesës së komunitetit multietnik përgjatë një periudhe kohore më shumër se mijëravjeqare, gjatë së cilës qyteti është zhvilluar në mënyrë konstante, nën ndikim të kulturave të ndryshme që e pasurojnë diversitetin kulturor të sotëm.

Prizreni është vendi i themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur gjatë pjesës së dytë të shek. 19, janë vënë themelet e formimit të shtetit Shqiptar.Elementet që e përcaktojnë karakterin e qytetit janë trajtimi arkitektonik, teknikat tradicionale të ndërtimit, mjedisi në relacion me ndërtimet dhe rrjetin e rrugëve, dimenzioni shpirtëror i jetesës së përditshme dhe asaj fetare, jeta e pasur kulturore e gërshetuar me natyrën dhe mënyrën e jetesës, të përkthyer në peizazhin historik urban të qytetit.

Përpos dëshmisë materiale për të kaluarën, struktura historike urbane e qytetit luan një rol të rëndësishëm inspirues në formësimin dhe dizajnimin e ambientit të së nesërmes.



Foto 14. Imazhi i nxjerrë nga faqja 121 e vëllimit 2 të "UdhËtimeve në provincat sllave të Turqisë në Evropë", nga MACKENZIE, Georgina Mary Muir - më pas SEBRIGHT (Georgina Mary) Lady dhe IRBY (Adelina Paulina). Origjinal i mbajtur dhe i digjitalizuar nga Biblioteka Britanike. Kopuar nga Flickr.

Anlizat më detaje nëpër nën-zona, përfshi edhe rekomandimet dhe kufizimet si dhe aplikimi i Nara Grid në rastin e Prizrenit mund të gjendet në ANEKS 1. Analiza e kontekstit të Qendrës Historike të Prizrenit, tek kapitulli 1.12.

6. VIZIONI ME QASJE TË PEISAZHIT HISTORIK URBAN TË UNESCO-S

Deklarata e vizionit të një qyteti elaborohet në atë mënyrë që të reflektojë gjendjen ekzistuese, identitetin dhe ëndërrat për rolin që qyteti do të luajë në të ardhmen. Si do të duket qyteti pas 10, 20 apo 50 viteve të ardhshme? A do të jetë si shumë qytete të tjera në Ballkan me disa monumente historike të rrethuara me ndërtime të reja të papërshkrueshme apo do ta ruaj veçantinë, historinë dhe identitetin e saj?

Për qytete si Prizreni, përcaktimi i vizionit është më i komplikuar pasi kemi të bëjmë me palë të shumtë të interesit, qasje të ndryshueshme të partive të ndryshme politike, dhe një detyrë madhore e palodhshme për të ruajtur sistemin dinamik të funksionimit të qytetit. Vizioni i qytetit duhet të jetë afatgjatë, të tejkalojë parashikimet e gjeneratës aktuale, dhe të jetë një parashikim me të cilin të gjithë mund të pajtohen, dhe njëkohësisht të jetë i qartë dhe konciz. Për fat të mirë, për qytetet sikurse Prizreni, ekziston krenaria e përgjithshme për vlerat dhe identitetin e tij, që ndihmon në tejkalimin e dallimeve të vogla kulturore e shoqërore. Është gjithashtu një vend me histori të pasur dhe monumente të rëndësishme, si dhe arkitekturë vernakulare që jep një ndjenjë të jetëgjatësisë dhe gravitetit. Prizreni është gjithashtu një qytet aktiv me jetë të gjallë në rrugë, familje, miq dhe vizitorë.

Përcaktimi i vizionit si proces në vete nuk është i mjaftueshëm dhe ky veprim duhet të pasohet me hapa të tjerë konkret që duhet të ndërmiren për zbatim të këtij vizioni. Këta hapa emërtohen si qëllime, objektiva, strategji dhe veprime. Shpesh here shfrytëzohen si hapa të kombinuar ndërmjet veti, por secili prej këtyre veprimeve ka një përkufizim të caktuar:

- Qëllimi është synim afatgjatë drejt arritjes së vizionit;
- Objektivat janë synime afatmesme dhe duhet të kontribojnë drejt arritjes së qëllimit;
- Aktivitetet / detyrat janë veprime afat-shkurta specifike, strategji dhe qasje programatike se si të arrihen objektivat;

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të këtyre hapave mund t'i referohemi piramidës ku veprimet individuale formojnë bazën, së bashku me objektivat në mes dhe qëllimin si gur kurore në maje. Strategjitë paraqesin mënyrat se si dhe kur të vendosen gurët. Analiza e rreziqeve dhe plani emergjent është gjithashtu i rëndësishëm nëse disa veprime apo edhe objektiva ndryshojnë, dhe duhet të jenë të mjaftueshme për të penguar shembjen e piramidës.

Kjo strukturë na ndihmon në arritjen e vizionit gjatë kohës, por gjithashtu mundëson drejtimin e njerëzve që veprojnë në detyra të caktuara aktuale, drejt detyrave indirekte që mund të përcaktoj në mënyrë vendimtare përgjegjësitë, rolin dhe pozitën e tyre në të ardhmen. Kjo mundëson që iniciativat individuale të kontribuojnë në përmbushjen e qëllimeve dhe vizionit afatgjatë.



Skema 1 Piramida e aktiviteteve deri tek vizioni i planit

Duke marrë parasysh këtë qasje, ekipi hartues i projektit kanë organizuar punëtori dhe takime të ndryshme ku janë përfshirë një numër i madhë i palëve të interesit, duke filluar nga përfaqësues të shoqërisë civile, qytetarë, përfaqësues të institucioneve dhe profesionistë të pavarur. Në këto takime janë diskutuar dhe është punuar drejt përcaktimit të vizionit dhe objektivave për qytetin e Prizrenit. Në këto takime janë prezantuar edhe shembuj, të vizioneve të qyteteve të mëdha dhe të vogla dhe atë të konteksteve të ndryshme kulturore, dhe shembuj të qëllimeve, objektivave dhe mënyra se si këto planifikime kanë ndikuar në përmirësimin e jetesës së komuniteteve.

DEKLARATA E VIZIONIT

PRIZRENI 2050, qytet i Trashëgimisë Botërore dhe

kandidat për Kryeqytet Kulturor Evropian.

- Kryeqytet kulturor dhe shpirtëror i Kosovës me vend të merituar në ofertën turistike

të Evropës Juglindore

- Qytet i veçantë me diversitet kombëtar, gjuhësor e fetar që ofron

përvoja unike, jetë të gjallë kulturore dhe natyrë të pastër

Foto 6. Pamja e Qendrës Historike nga mahalla e Nënkalasë (autor:Shkelzen Rexha)

Vizioni i propozuar për Prizrenin është ambicioz, thekson një realitet aktual dhe bazohet në krenarinë e përgjithshme si element i përbashkët, i shfaqur nga palët e interesit gjatë takimeve të ndryshme të procesit të konsultimeve.

Në vizion fillimisht përcaktohet një datë, viti 2050, i cili është miratuar nga autorët e vizionit, të cilët kanë parashikur një gjendje afat-gjate që synon gjeneratën e fëmijëve dhe të nipërve të tyre. 30 vite nga tani nevojiten për arritjen e këtij qëllimi ambicioz, sikurse shndërrimi në Kryeqytetin Kulturor të Europës. Ky është një proces gjithëpërfshirës, i gjatë dhe i kushtueshëm, të cilin

qytetet Evropiane me ekonomi stabile janë në gjendje ta fitojnë. Ky qëllim është i arritshëm por kërkon ndërmarjen e hapave konkrete drejt zbatimit.

Vizioni pasqyron gjendjen ekzistuese - atë të një qyteti me Trashëgimi Botërore. Prizreni në qendrën historike e ka Kishën e Shën Premtes (Levisha) që është aset i listuar në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik të UNESCO-s. Edhepse gjendja e saj nuk është e dëshirueshme, prapseprap paraqet një prej aseteve më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Vizioni gjithashtu paraqet synimin vizionar për Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si një lokalitet më rëndësi të jashtëzakonshme për historinë e kombit Shqiptar, i cili mund të jetë një kandidat i mundshëm për aplikim në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Një aspekt tjetër me rëndësi që ekziston sot por duhet të përkrahet është fakti se Prizreni paraqet qendrën shpirtërore dhe kulturore të Kosovës. Në Prizren fliten shumë gjuhë, janë prezent tri religjione të mëdha dhe ka një histori të pasur. Ky pozicion, e forcon Prizrenin jo vetëm në nivel të Kosovës, por edhe në Evropën Juglindore.

Kryeqyteti Kulturor i Evropës është qytet i përcaktuar nga Bashkimi Evropian (BE) për një periudhë kalendarike njëvjeçare gjatë së cilës organizohen ngjarje kulturore të dimensionit të fuqishëm pan-evropian. Përgaditja për aplikim të statusit të Kryeqytetit Kulturor të Evropës është mundësi për qytetin për të gjeneruar përfitime të konsiderueshme kulturore, sociale dhe ekonomike dhe mund të ndihmojë të stimulojë regjenerimin urban, të ndryshojë imazhin e qytetit dhe të rrisë vizibilitetin dhe profilin ndërkombëtar[33].

Iniciativa e Kryeqyteteve Europiane të Kulturës është hartuar për:
- Theksim të pasurisë dhe diversitetit të kulturave në Evropë
- Festim të tipareve kulturore të Evropës
- Rritjen e ndjenjës së qytetarëve evropianë të përkatësisë në një zonë të përbashkët kulturore
- Nxitje e kontributit të kulturës në zhvillimin e qyteteve.

Komisioni i Bashkimit Evropian menaxhon këtë titull, dhe çdo vit Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian zyrtarisht emërojnë qytetet me këtë status. Deri më tani më tepër se 40 qytete janë përzgjedhur për këtë titull. Në vitin 2004 studimi i kryer për Komision, i njohur edhe si "Raporti Palmer"demonstroi që përzgjedhja e një qyteti për Kryeqyteti Kulturor të Evropës ka shërbyer si katalizator për zhvillimin e kulturës dhe transformimin e qytetit. Si rezultat i kësaj, përfitimet socio-ekonomike dhe ndikimi në qytetin e zgjedhur tani konsiderohen lartë gjatë përcaktimit dhe përzgjedhjes së qyteteve kandidate. Në mars të vitit 2018, për herë të parë, Kosova është shënuar si një vend pjesëmarrës në Programin Evropa Kreative[34].

Në Kosovë është i pranuar epiteti i Prizrenit si qendër kulturore, por vizioni e tejkalon këtë fakt duke përfshirë edhe shtetet fqinje dhe rajonin. Në fakt qyteti vizitohet nga vizitorë të shumtë nga vendet të ndryshme që vizitojnë asetin në Listën Botërore të Trashëgimisë dhe monumentet tjera, por duhet të gjenden mënyra për të përfshirë dhe për të nxitur që vizitorët të hulumtojnë edhe vendet tjera dhe të qëndrojnë më gjatë në Prizren. Si plotësim, edhe fjala natyrë është shfrytëzuar në vizion. Prizreni është i rrethuar nga dy anë me malet e paprekura të egra që ofrojnë mundësi të shumta dhe lumin që e përshkojnë qendrën e qytetit.

Vizioni paraqet Prizrenin si një vend të hapur për vizitorë që ofron përvojë unike, qytet të festivaleve e me jetë të pasur kulturore me një këndvështrim drejt mundësive ekonomike të cilat qyteti duhet t'i shfrytëzojë.

[33] https://ec.europa.eu/programmes/creative-europe/actions/capitals-culture_en

[34] https://eacea.ec.europa.eu/sites/eacea-site/files/22032018-eligible-countries_en.pdf (Subject to the signing and notification of an Agreement with the European Commission)

Së fundi, është e rëndësishme të përmendet se një vizion për Qendrën Historike të Prizrenit nuk është krijuar për të parandaluar ndryshimet, por për të frymëzuar. Vizioni nuk ka të bëjë me ngrirjen e së kaluarës, por shikimi pozitiv drejt së ardhmes. Gjithashtu nuk ka të bëjë me parandalimin e zhvillimit, por me udhëzimin dhe menaxhimin e zhvillimit.



Foto 7. Pozita e Qendrës Historike të Prizrenit në raport me Kosovën (sipër majtas) dhe zonën urbane të qytetit të Prizrenit (sipër djathtas).

Qasja e Peisazhit Historik Urban të UNESCO-s

Prizreni është një qytet historik që po përjeton një ndryshim të shpejtë. Ndryshimet të cilat janë njëkohësisht pozitive dhe negative. Këto ndryshime përfaqësojnë një qytet që është i gjallë, zhvillohet dhe përshtatet me botën moderne dhe nevojat e komunitetit të tij. Shumë nga këto ndryshime përmirësojnë jetët e banorëve të Prizrenit si: transportin e lehtë, ndriçimin e mjaftueshëm rrugor, ujin e pijshëm dhe kanalizimin, dhe ajër të kondicionuar. Një qytet pa ndryshim është statik, i ngrirë në të kaluarën dhe në rrezik të braktisjes. Megjithatë, ndryshimet e tjera ndikojnë negativisht në karakterin, atmosferën dhe shpirtin e Prizrenit, i cili gradualisht evoluoi për qindra vjet. Këto ndryshime përfshijnë rrënimin e shtëpive tradicionale për parkim, fshehjen e fasadave dekorative me shenja të mëdha, ose ngritjen e ndërtesave më të larta jashtë shkallës dhe përqindjes ndaj lagjeve të tyre historike. Këto ndryshime të pafavorshme ndodhin ngadalë, njëra pronë pas tjetrës me pak vëmendje, megjithatë çdo strukturë historike dhe elementet e saj përcaktuese, megjithëse në dukje të parë të parëndësishme, kontribuojnë në tërësi dhe nuk mund të zëvendësohen kurrë. Prandaj, të gjitha ndryshimet duhet të menaxhohen me kujdes, jo domosdoshmërisht të parandalohen, me qëllim që të akomodohen si ndryshimi dhe mbrojtja e Prizrenit historik.

Këto ide janë në thelbin e qasjes së Peisazhit Historik Urban të UNESCO-s (Historic Urban Landscape - HUL). Qasja HUL kërkon të arrijë një ekuilibër delikat ndërmjet ruajtjes dhe zhvillimit përmes menaxhimit dhe planifikimit, i cili pranon se qytetet duhet të jenë të gjalla dhe të jetueshme, duke mbrojtur gjithashtu atë që është unike dhe me vlerë. Kjo qasje kundërshton ndarjen e një qyteti në zona të veçanta të ruajtjes për të krijuar muze të qytetit statik dhe synon të ruajë dhe përmirësojë cilësinë e jetës dhe produktivitetin e komuniteteve urbane. Qasja HUL synon të menaxhojë ndryshimet në vend që të ruajë vetëm të kaluarën - për të integruar shqetësimet mjedisore, sociale, kulturore dhe ekonomike. Ajo gjithashtu inkurajon përfshirjen e palëve të interesit në të gjitha nivelet[35].

Duke pranuar se përmirësimi i cilësisë së jetës në qendrat historike të qytetit si Prizreni është thelbësor, qasja HUL e pranon këtë rëndësi dhe integron parimet e zhvillimit në menaxhimin konservues dhe planifikues. Ky integrim është thelbësor për qytete të tilla si Prizreni, ku përparimi ekonomik ka qenë i shpejtë, turizmi po rritet dhe disponueshmëria e materialeve moderne dhe teknikave të reja të ndërtimit është evidente. Qasja HUL pranon që komuniteti dëshiron dhe ka nevojë për komoditete bashkëkohore dhe se projektet e reja të ndërtimeve duhet të ndërlidhen me kulturën lokale, ndërsa autoritetet gjithashtu dëshirojnë të mbrojnë peizazhin historik urban dhe Vlerat Univerzale të Jashtëzakonshme.

HUL shtrin mendimin nga burime specifike të trashëgimisë për të trajtuar kontekstin më të gjerë urban dhe kontekstin e saj gjeografik. Prizreni duhet të kuptohet jo vetëm si një shumë e monumenteve të saj, por të trajtohet si një qytet i tërë me ansambël të strukturave, monumenteve dhe peizazheve, vizurave, lumenjve dhe fortifikimeve, të formësuar nga njerëzimi dhe natyra me kalimin e kohës, gjë që rezultoi me një karakter të veçantë urbanistik . Qasja e Peizazhit Historik Urban synon të ruajë cilësinë e mjedisit njerëzor, duke rritur përdorimin produktiv dhe të qëndrueshëm të hapësirave urbane duke njohur karakterin e tyre dinamik dhe duke promovuar diversitetin social dhe funksional. Ajo integron synimet e konservimit të trashëgimisë urbane dhe ato të zhvillimit social dhe ekonomik. Koncepti është i rrënjosur në një marrëdhënie të balancuar dhe të qëndrueshme mes mjedisit urban dhe natyror, midis nevojave të gjeneratave të sotme dhe të ardhshme dhe trashëgimisë të së kaluarës.[36]

[35] UNESCO. (2011). *Recommendation on the Historic Urban Landscape*. UNESCO. Retrieved from http://whc.unesco.org/en/activities/638

[36] ibid

Për këtë arsye është thelbësore që në kuadër të Deklaratës së Vizionit për Prizrenin të adoptohen parimet e qasjes së Peisazhit Historik Urban të UNESCO-s.

Foto 8. Pjesëmarrësit e punëtorsë ku u përcaktua drafti i parë i vizionit të Qendrës Historike të Prizrenit

7. PLANI I VEPRIMIT

Qendra Historike e Prizrenit në dhjetë vitet e ardhshme do të jetë shtyllë e rëndësishme e promovimit të Kosovës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Komunës së Prizrenit. Në funksion të kësaj, Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit, Komuna e Kosovës dhe partnerë të tjerë do të punojë në avansimin e mëtejmë të sistemit të mbrojtjes, në bashkëpunimin efektiv dhe rritjen e pjesëmarrjes në proceset e planifikimit dhe të menaxhimit të zhvillimeve, si dhe në promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore.

Në bazë zë vizionit të përzgjedhur është përgaditur një Plan Veprimi detaj me të gjitha projektetet dhe aktivitetet që përkojnë me synimet dhe objektivat e parashturara.

DEKLARATA E VIZIONIT

PRIZRENI 2050, qytet i Trashëgimisë Botërore dhe

kandidat për Kryeqytet Kulturor Evropian.

- Kryeqytet kulturor dhe shpirtëror i Kosovës me vend të merituar në ofertën turistike

të Evropës Juglindore

- Qytet i veçantë me diversitet kombëtar, gjuhësor e fetar që ofron

përvoja unike, me jetë të gjallë kulturore dhe natyrë të pastër

SYNIMET	OBJEKTIVAT
1. QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT ME TRASHËGIMI TË MBROJTUR KULTURORE E NATYRORE DHE MENAXHIM EFIKAS	1.1. Themelimi dhe funksionalizimi i Zyres së Qendrës Historike 1.2. Mbrojtja dhe promovimi i QHP përmes nominimit të monumenteve në Listën e Trashëgimisë Botërore në UNESCO 1.3. Implementimi i ligjeve dhe plotësimi i bazës ligjore për funksionim të mirëfilltë të procesit të mbrojtjes, menaxhimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore 1.4. Inventarizimi i plotë i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe prioritizimi i ndërhyrjeve konservuese në QHP 1.5. Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore përmes procesit të planifikimit hapësinor dhe zhvillimin urban 1.6. Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i QHP përmes qasjes së rigjenerimit urban të nënzonave dhe revitalizimit të ndërtesave publike 1.7. Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe rritja e kapaciteteve muzeale të qytetit 1.8. Shndërrimi i QHP në mjedis miqësor për ruajtjen dhe promovimin e natyrës
2. QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT SI VEND I NDËRLIDHJES SË VLERAVE ME EDUKIM TË GJENERATAVE TË ARDHSHME	2.1. Zhvillimi i edukimit formal dhe joformal rreth trashëgimisë dhe diversiteti kulturor 2.2. Ngritja e vetëdijes në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore 2.3. Rritja e cilësisë së festivaleve dhe shëndrrimi i qytetit në qendër të festivaleve gjatë tërë vitit

3. SIGURIMI I BANIMIT DINJITOZ ME KUSHTE BASHKËKOHORE DHE OFRIMI I POTENCIALIT PËR ZHVILLIM TË OBJEKTEVE TË BANIMIT BRENDA QHP	3.1. Dokumentimi i të gjitha shtëpive tradicionale brenda QHP dhe kategorizimi i tyre për intervenim dhe potenciale për të ardhmen 3.2. Ngritja e vetëdijes së pronarëve të shtëpive tradicionale rreth vlerave të trashëgimisë dhe menaxhimit të pronave të tyre
4. BRENDIMI I QYTETIT TË PRIZRENIT: KRYEQYTET KULTUROR I EVROPËS SI SHTYTËS PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK	4.1. Promovimi dhe brendimi i qytetit të Prizrenit 4.2. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik përmes turizmit kulturor 4.3. Rritja e cilësisë së festivaleve dhe shëndrrimi i qytetit në qendër të festivaleve gjatë tërë vitit
5. QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT, ZONË MIQËSORE PËR KËMBËSORË, ME HAPËSIRA PUBLIKE KUALITATIVE DHE INFRASTRUKTURË BASHKËKOHORE	5.1. Hartimi i dokumentacioneve relevante për të siguruar lëvizhmëri të sigurtë, ambient të pastër dhe infrastrukturë sipas standardeve bashkëkohore 5.2. Zhvillimi i politikave të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse për menaxhim të hapësirave publike

SYNIMI 1. QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT ME TRASHËGIMI TË MBROJTUR KULTURORE E NATYRORE DHE MENAXHIM EFIKAS						
OBJEKTIVI 1.1. Themelimi dhe funksionalizimi i Zyres së Qendrës Historike						
Nr.	**Projektet / Aktivitetet**	**Prioriteti**	**Afati i projektit**	**Përgjegjës kryesor**	**Kostoja e përafërt (€)**	**Referencë / Koment**
1.1.1	**Themelimi i Zyres së Qendrës Historike** 1. Plotësim - Ndryshimi i Vendimit të Kuvendit Komunal të Prizrenit për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës së Komunës i vitit 2012. 2. Përfshirja e rolit dhe përgjegjësive të Zyres së QHP në këtë vendim 3. Hartimi i përshkrimeve të vendeve të punës për zyrtarët që duhet të punësohen në zyrë. 4. Ndjekja e procedurave administrative për zyrtarizim të zyrtarëve të punësuar për t'u pajisur me statusin e nënpunësit civil. 5. Ndjekja e e procedurave ligjore dhe administrative për rritjen e numrit të stafit përmes: rialokimit të stafit, dhe / apo planifikimit buxhetor. 6. Rekrutimi i stafit	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit	17.000,00	Sipas nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit (Nr. 04/L-066) për Qendren Historike të Prizrenit Kosotja për staf / për vit
1.1.2	**Funksionalizimi i Zyres së Qendrës Historike dhe Implementimi i Mandatit të caktuar në dokumentin e Planit të Menaxhimit (Shih Kapitulli 6)** 1. Koordinim i veprimeve që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë asistencën ndërkombëtare. 2. Informimi i publikut mbi rëndësinë dhe statusin e mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit. 3. Promovimi dhe zhvillimi i Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashëgimi kulturore të pasur; 4. Promovimi dhe zhvillimi i Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashëgimi kulturore të pasur	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit	/	Sipas nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit (Nr. 04/L-066) për Qendren Historike të Prizrenit
1.1.2.1	**Koordinim i veprimeve që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë asistencën ndërkombëtare** 1. Krijimi i një tryeze të përbashkët mes palëve të interesit për QHP 2. Hartimi i një plani afatmesëm për identifikimin e të gjitha aktiviteteve dhe projekteve brenda QHP 3. Sinkronizimi dhe Prioretizimi i projekteve të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, brenda QHP 4. Krijimi i një liste të përbashkët të prioriteteve për projektet në QHP 5. Krijimi i një grupi të përbashkët konsultues për trajtim të lëndëve / kërkesave për ndërhyrje brenda QHP (Grupi i përbërë nga Komuna e PZ: DUPH, DI, Këshilli i QHP dhe QRTK Prizren) 6. Identifikimi i donatorëve potencial dhe aplikimi për fonde për investime në QHP	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Zyra e QHP	/	Sipas nenit 21 paragrafi 3 të Ligjit (Nr. 04/L-066) për Qendren Historike të Prizrenit

1.1.2.2	**Informimi i publikut mbi rëndësinë dhe statusin e mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit** 1. Krijimi i një grupi të përbashkët punues për koordinim të procesit të informimit të publikut në lidhje me aktivitetet brenda QHP. 2. Pranimi i infomatave nga institucionet lokale dhe qendrore (Komuna, MKRS, QRTK Pzdhe shoqëria civile), verifikimi, përpunimi, saktësimi dhe plasimi të publiku *Shënim: Elaborimi i këtij mandati bëhet me koordinim të intstitucioneve relevante qendrore dhe lokale lidhur me nenin 21 pika 3*	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Zyra e QHP	/	Sipas nenit 21 paragrafi 3 të Ligjit (Nr. 04/L-066) për Qendren Historike të Prizrenit
1.1.2.3	**Promovimi dhe zhvillimi i Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashëgimi kulturore të pasur** 1. Krijimi i një grupi të përbashkët punues për koordinim të procesit të promovimit të aktivitetet brenda QHP ((Komuna, QRTK Pz dhe shoqëria civile) 2. Sigurimi dhe shpërndarja e informatave dhe materialeve promovuese në lidhje me Qendrën Historike të Prizrenit, përfshirë hartat informuese, listën e shërbimeve të ofruara, agjendat kulturore dhe reklamat *Shënim: Elaborimi i këtij mandati bëhet me koordinim të intstitucioneve relevante qendrore dhe lokale lidhur me nenin 21 pika 3*	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Zyra e QHP	/	Sipas nenit 21 paragrafi 3 të Ligjit (Nr. 04/L-066) për Qendren Historike të Prizrenit

OBJEKTIVI 1.2. Mbrojtja dhe promovimi i QHP përmes nominimit të monumenteve në Listën e Trashëgimisë Botërore në UNESCO

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
1.2.1	**Sigurimi i kushteve për të mundësuar largimin e Kishës së Shën Premtes nga Lista e Trashëgimisë Kulturore Botërore në rrezik** 1. Hartimi i planit të konservimit, në bazë të vlerësimit të gjendjes fizike; 2. Hartimi i planit të mirëmbajtjes dhe menaxhimit; 3. Restaurimi dhe rehabilitimi i Kishës së Shën Premtes në bazë të Planit të Konservimit; 4. Shenjimi adekuat i Kishës në qytet për të ofruar qasje më të lehtë për vizitorë; 5. Hartimi i kampanjës së promovimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; 6. Caktimi i orarit të vizitave për vizitorë;	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	KKTK, KZM dhe MKRS	/	Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention Ligji (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

1.2.2	**Nominimi i kompleksit të Lidhjes së Prizrenit në Listën Tentative të Trashëgimisë Botërore** 1. Sigurimi i bashkëpunimit dhe koordinimi i përgjegjësive ndërmjet insittucioneve të nivelit lokal dhe qendror : Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit. 2. Emërimi i komisionit special për inicimin, hulumtimin dhe promovimin e nominimit të këtij lokacioni që të përfshihet në Listën e Trashëgimisë Botërore 3. Hartimi i Planit dinamik të veprimeve për Komisionin e emëruar për përgaditje të dosjes për Listën Tentative. 4. Implementimi i Planit Dinamik të veprimeve: 4.1 Mbledhja e dokumenteve bazë të nevojshme për mbështetjen e dosjes së nominimit 4.2 Studimi i dosjeve tjera të nominimit 4.3 Alokimi i buxhetit për të mbështetur procesin e nominimit 4.4 Ndërtimi i literaturës së dosjeve të tjera të nominimit nga shembujt e suksesshëm 4.5 Dërgimi i përfaqësuesëve të Komisionit në Kongresin e Trashëgimisë Botërore dhe ICOMOS për të filluar lobimin. 4.6. Promovimi i procesit të nominimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	MKRS dhe KKTK	/	Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention Ligji (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore
1.2.3	**Hulumtimi i aseteve tjera të trashëgimisë kulturore në QHP rreth potencialit për aplikim në Listën Tentative të Trashëgimisë Botërore - UNESCO** 1. Emërimi i grupit punues për inicimin dhe implementimin e analizës 2. Analiza dhe vlerësimi i dosjeve ekzistuese të Aseteve të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme - që gjenden brenda perimetrit të QHP 3. Analiza dhe vlerësimi i dosjeve ekzistuese të Aseteve të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme - që gjenden brenda perimetrit të QHP	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	MKRS dhe KKTK	5.000,00	Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention Ligji (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore

OBJEKTIVI 1.3.Implementimi i ligjeve dhe plotësimi i bazës ligjore për funksionim të mirëfilltë të procesit të mbrojtjes, menaxhimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
1.3.1	**Propozimi i Qendrës Historike të Prizrenit në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përhershme si zonë urbane historike me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar** *Shënim: Të dhënat e përgaditura rreth analizës së gjendjes ekzistuese dhe vlerësimit, në lidhje me QHP gjatë procesit të hartimit të Planit të Menaxhimit, mund të shërbejnë si bazë për plotësim të aplikacionit.*	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	MKRS, KKTK dhe QRTK Prizren	/	Ligji (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore Rregullorja për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente (Nr. 06/2017)
1.3.2	**Amandamentimi i ligjit aktual (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore** *Shënim: Përfshirja e bazës ligjore për hartim të Planeve të Menaxhimit për lokalitete të trashëgimisë kulturore*	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	KKTK, MKRS	/	

1.3.3	**Hartimi dhe adoptimi i Ligjit për Muzetë**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	KKTK, MKRS	/	
1.3.4	**Hartimi i rregullores së punës për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të Inspektoratit të trashëgimisë kulturore (MKRS)** *Shënim: Përkufizimi i marrëdhënies ndërmjet detyrave të tyre në lidhje me obligimet që dalin nga Ligji për Qendrën Historike dhe Ligji për ZVM .*	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	MKRS	/	Ligji (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore Ligji (Nr. 04/L-066) për Qendren Historike të Prizrenit Ligji (Nr. 03/L-039) për Zonat e Veçanta të Mbrojtura
1.3.5	**Hartimi i një rregullore të përbashkët ndërmjet MMPH dhe MKRS, për përcaktimin dhe ndarjen e përgjegjësive dhe fushat e bashkëpunimit ndërmjet Inspektoriatit të MMPH (niveli qendror dhe ai lokal) dhe Inpsektoratit të MKRS në lidhje me QHP**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	MKRS MMPH	/	
1.3.6	**Amandamentimi i kufirit të QHP bazuar në hulumtimet dhe rekomandimet Planit të Menaxhimit të QHP**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	MMPH, Komuna e Prizrenit, KKTK, MKRS	/	
1.3.7	**Plotësimi dhe sinkronizimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në mes të Listës së trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme (2017-2018) dhe Shtojcës II së ligjit të QHP-së** - Analiza dhe vlerësimi I ndërtesave të listuara në Shtojcën II të ligjit të QHP-së - Përgaditja e dosjeve të inventarizimit - Sinkronizimi dhe përfshierja në Listën e TK nën mbrojtje të përkohshme - Amandamentimi i Shtojcës II të ligjit të QHP-së	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	MKRS	/	

OBJEKTIVI 1.4. Inventarizimi i plotë i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe prioritizimi i ndërhyrjeve konservuese në QHP

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
1.4.1	**Krijimi i databazës së të dhënave për QHP** - Dokumentimi i ndërtesave në platformën GIS; - Skanimi i të gjitha dokumenteve zyrtare (vendimet, strategjitë, planet urbane, hartat dhe fotografitë e vjetra); - Vendosja e të dhënave në platformën digjitale (databazë); - Promovimi i të dhënave të databazës për publikun - Përditësimi i të dhënave në baza vjetore *Shënim: qasja e plotë në të gjitha të dhënat, i lejohet institucioneve lokale dhe qendrore, kurse për publik (student, krijues, studjues shkencor etj) me kërkesë dhe leje të veçantë*	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit (Zyra e QHP)	100.000,00	Kjo databazë do të shërbej për nevojat e Komunës së Prizrenit (Urbanizmi, Kadastri, Këshilli i QHP) si dhe të Qendrës Rajonale për TK në Prizren

1.4.2	**Inventarizimi i monumenteve të cilët nuk janë përfshirë në Shtojcën II të Ligjit të QHP, dhe në Listën e TK nën Mbrojtje të përkohshme.** - Përgaditja e dosjeve për propozim në Listën e TK nën mbrojtje të përkohshme *Shënim: këtu përfshihen edhe asete nga pjesa e dytë e shek XX - shembuj të arkitekturës moderne*	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	QRTK Prizren	/	
1.4.3	**Plotësimi i dokumentacionit teknik për ansamblet e listuara në Listën e TK nën Mbrojtje të Përkohshme 2017-2018: Kompleksi Nënkalaja, Pantelija, dhe Potokmahalla; Kompleksi i Mahallës së Marashit, dhe Tabakhane** - Ri-përcaktimi i saktë i kufijve të ansambleve; - Identifikimi i aseteve të TK që duhet të mbrohen; - Përcakimi i kritereve të sakta për zhvillim për këto ansamble.	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	QRTK Prizren	/	
1.4.4	**Hartimi i listës së prioriteteve për ndërhyrje emergjente në asete të trashëgimisë kulturore në QHP në bazë të nevojave dhe gjendjes në terren**	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	KKTK, MKRS, QRTK Prizren	/	Ligji për Trashëgimi Kulturore neni 4.9
1.4.5	**Dokumentimi dhe inventarizimi i sheshit Shadërvan, dhe Përgaditja e dosjes për propozim në Listën e TK nën mbrojtje të përkohshme (2019-2020)**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	QRTK Prizren	/	
1.4.6	**Dokumentimi dhe inventarizimi i rrugës Adem Jashari dhe Përgaditja e dosjeve për propozim në Listën e TK nën mbrojtje të përkohshme (2019-2020)**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	QRTK Prizren	/	
1.4.7	**Dokumentimi dhe inventarizimi i të gjitha aseteve të trashëgimisë kulturore në Zonën e Dytë të Mbrojtjes së QHP dhe përgatija e dosjes për propozim nën mbrojtje të përkohshme.**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	QRTK Prizren	/	

OBJEKTIVI 1.5. Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore përmes procesit të planifikimit hapësinor dhe zhvillimin urban

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
1.5.1	**Vlerësimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimi i Hartës Zonale të Komunës**	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit / DUPH	/	Ligji Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor
1.5.2	**Ridefinimi i Zonës së Dytë të Mbrojtjes së QHP sipas propozimit të PM QHP dhe integrimi i saj ne Hartën Zonale të Komunës** - Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën së Dytë të Mbrojtjes së QHP	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit / DUPH	30.000,00	Ligji Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor
1.5.3	**Hartimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për QHP, si Plan Rregullues i Hollësishëm** *Shënim: Dokument komplementar i Planit të Menaxhimit të QHP në aspekte teknike të mbrojtjes dhe zhvillimit të zonës*	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit / DUPH	40.000,00	Ligji Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor

OBJEKTIVI 1.6. Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i QHP përmes qasjes së rigjenerimit urban të nënzonave dhe revitalizimit të ndërtesave publike						
Nr.	**Projektet / Aktivitetet**	**Prioriteti**	**Afati i projektit**	**Përgjegjës kryesor**	**Kostoja e përafërt (€)**	**Referencë / Koment**
1.6.1	**Hartimi i projektit të regjenerimit urban dhe rehabilitim të fasadave për: zonën Nënkalaja dhe Pantelia**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit	20.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.2	**Hartimi i projektit të konservimit, rehabilitim të fasadave dhe regjenerimit urban për: rrugën Marin Barleti**	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	QRTK Prizren	56.000,00	Projekti: "REVITALIZIMI DHE INTEGRIMI SOCIO-EKONOMIK I KOMUNITETIT LOKAL NË RRUGËN MARIN BARLETI NË PRIZREN" në bashkëpunim ndërmjet MKRS / QRTK Prizren, OJQ EC MA Ndryshe, Zyra e Bashkimit Europian, dhe Amsabada Britanike në Prishtinë Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.3	**Hartimi i projektit për rehabilitim të fasadave dhe trajtim i kubëzave për Sheshin Shadërvan** *Shënim:Sheshi i Shadërvanit, si pika e referimit për shumë qytetarë e turistë duhet të shkarkohet nga disa funksione në mënyrë të mos cënohet integriteti urban dhe historik i saj. Operatorët e ndryshëm duhet të gjejnë alternativa tjera që aktivitetet e tyre të organizojnë në hapësira tjera të cilat nuk janë plotësisht të shfrytëzueshme.*	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	QRTK Prizren dhe Komuna e Prizrenit (DSHP)	20.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.4	**Hartimi i projektit të regjenerimit urban për: Kujumxhillëk (rr.Pushkatarët) - ridizajnimi dhe shndërrimi në zonë zejtare**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit	20.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.5	**Hartimi i projektit të regjenerimit urban për: Brigjet e lumit Lumbardhi**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit	35.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.6	**Hartimi i një Master Plani për Sheshin e Lidhjes (Arasta)** *Shënim: Ky plan do të integrojë dhe do të prezantojë monumentet nga periudhat e ndryshme kohore: Lokaliteti arkeologjik, Minarja Arasta, kroi i vjetër i Beledijes, monumenti i LII Botërore, Monumenti i luftës së UÇK-së .*	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit	20.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.7	**Hartimi i projektit të regjenerimit urban dhe rehabilitim të fasadave për: rruga Adem Jashari**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit	35.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.8	**Hartimi i projektit të regjenerimit urban për: Lagjia e Tabakhanes**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit	20.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
1.6.9	**Identifikimi i ndërtesave publike të përshtatshme për ridestinim të funksioneve alternative dhe hartimi i projekteve të adaptimit** 1. Ridestinimi i objekteve ekzistuese publike për krijim të institucioneve kulturore: Galeria e Artit, Qendër kulturore shumëfunksionale, Sallë të koncerteve etj 2. Instalimi i misioneve diplomatike apoinstitucioneve tjera administrative në QHP; 3. Ridestinimi i funksioneve kulturore / artistike në ndërtesat publike të pashfrytëzuara: Kinemaja e parë e qytetit, Ambasada e vjetër Austro-Hungareze, ndërtesa e Beledijes, Ruzhdija, etj.	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit	/	Projekti i rikonstruimit të Ruzhdijes është duke u hartuar nga TIKA; Ky projekt do të implementohet nga TIKA;

OBJEKTIVI 1.7. Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe rritja e kapaciteteve muzeale të qytetit

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
1.7.1	**Dokumentimi dhe inventarizimi i trashëgimisë shpirtërore në Komunën e Prizrenit që ndërlidhet me QHP**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit (DKRS) dhe MKRS - DTK	50.000,00	
1.7.2	**Krijimi i listës së trashëgimisë shpirtërore në Komunën e Prizrenit që ndërlidhet me QHP, me kategoritë përkatëse**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit (DKRS) dhe MKRS - DTK	/	
1.7.3	**Rritja e kapaciteteve dhe funksioneve të muzeve ekzistuese të qytetit** 1. Lidhja Shqiptare e Prizrenit; 2. Muzeu Arkeologjik i rajonit të Prizrenit; *Shënim: Sigurimi me parkingje për vizitorë, sigurimi i qasjes për Persona me nevoja të veçanta, audio-guide, kënde për shitje të suvenirëve, interpretimi i plotë i fondit të muzeve, në gjuhët zyrtare.*	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	MKRS – DTK dhe Komuna e Prizrenit	50.000,00	
1.7.4	**Themelimi dhe funksionalizimi i plotë i muzeve ekzistuese të qytetit** 1. Muzeu i Nënës Tereze; 2. Muzeu i Hidroelektroekonomisë; 3. Muzeu Etnologjik i Prizrenit-Shtëpia e Shehzades; *Shënim: Përcaktimi i statusit të Muzeut (Komunal, Rajonal, Kobëtar); Hartimi i statutit të Muzeut; Hartimi i Planit të promovimit dhe të menaxhimit; Rekrutimi i stafit profesional, dhe Përgaditja e ekspozitës.*	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	MKRS – Muzeu I Kosovës dhe Komuna e Prizrenit	280.000	
1.7.5	**Themelimi i Muzeut të qytetit ku do të reflektohej historia e qytetit dhe diveristeti kulturor i saj** *Shënim: përcaktimi i lokacionit, statusit, hartimi I statutit, rekrutimi I stafit dhe përgatitja e ekspozitës.*	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit dhe MKRS – Muzeu i Kosoves	30.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin / ndërtimin
1.7.6	**Themelimi i Muzeut të artistëve të Prizrenit** *Shënim: përcaktimi i lokacionit, statusit, hartimi I statutit, rekrutimi I stafit dhe përgatitja e ekspozitës.*	I ulët	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit dhe MKRS – Muzeu i Kosoves	30.000,00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin / ndërtimin

OBJEKTIVI 1.8. Shndërrimi i QHP në mjedis miqësor për ruajtjen dhe promovimin e natyrës

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
1.8.1	**Dokumentimi dhe inventarizimi i trashëgimisë natyrore**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit (DSHP) dhe MMPH - IKMM (Insituti i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit)	30.000,00	Ligji (Nr. 03/L-025) për Mbrojtjen e Mjedisit
1.8.2	**Futja nën mbrojtje e trashëgimisë natyrore të dokumentuar**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit (DSHP) dhe MMPH - IKMM	/	Ligji (Nr. 03/L-025) për Mbrojtjen e Mjedisit

1.8.3	**Promovimi i biodiversitetit brenda QHP**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit (DSHP)	5.000,00	
1.8.4	**Themelimi i asociacionit për mbrojtje të mjedisit brenda QHP**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit (DSHP) dhe OJQ-të lokale	8.000,00	Kostoja për një vit
1.8.5	**Rritja e gjelbërimit dhe mbjellja e fidaneve tek hapësirat publike**	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit (DSHP) dhe OJQ-të lokale	/	

SYNIMI 2. QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT SI VEND I NDËRLIDHJES SË VLERAVE ME EDUKIM TË GJENERATAVE TË ARDHSHME

OBJEKTIVI 2.1. Zhvillimi i edukimit formal dhe joformal rreth trashëgimisë dhe diversiteti kulturor

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
2.1.1	**Integrimi i kurrikulës së universitetit publik të Prizrenit me nevojat që ka sektori i trashëgimisë kulturore**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	UPZ	/	
2.1.2	**Përfshirja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në plan program të shkollave fillore dhe të mesme dhe përdorimi i metodave të ndryshme kreative të edukimit joformal mbi trashëgimi** - Program i trajnimit për mësimdhënës me aktivitete të propozuara - Doracak për mësuesit për kulturën dhe diversitetin	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DASh	10.000,00	Korniza Kurrikulare për arsimin parauniversitar (MASHT)
2.1.3	**Trashegimia nëpër shkolla** 1. Java e trashëgimisë në shkollë (shkolla fillore – klasa 6-9) 2. Klubet e trashëgimisë (shkolla e mesme – klasa 10-13) 3. Programi i ligjeratave dhe vizitave edukative për nxënës në monumente te trashegimise kulturore për shkolla fillore dhe te mesme te qytetit 4. Kuizi i trashegimise kulturore per shkollat e qytetit	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DASh	50.000,00	Nënaktivitetet mund të mbulohen pa kosto shtesë përderisa nënaktiviteti 3. do të përfshinte ligjerata dhe 60 vizita edukative për 3 vite (20.000€) Aktiviteti nëpn 4. do të përfshinte ligjerata dhe gara mes shkollave për 3 vite (30.000€)
2.1.4	**Trashëgimia jashtë shkollës** 1. Përvetëso (adopto) një lokalitet të trashëgimisëhapësirë (shkolla e mesme – klasa 10- 13) 2. Çfarë më kanë treguar gjyshërit e mi79 (shkolla fillore – klasa 6-9; shkolla e mesme – klasa 10-13) 3. Muzetë e Hapur/Nata në Muze (shkollat e mesme – klasa 10-13) 4. Kino Trashëgimia (+ diskutim) (shkolla të mesme – klasa10-13) 5. Shkolla Verore e Trashëgimisë / Olimpiadat e Trashëgimisë (për të dy nivelet)	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DKRS dhe DASh	130.000,00	
2.1.5	**Organizimi i kampanjave të kampeve të restaurimit për shtëpitë tradicionale duke i targetuar të rinjtë, mjeshtrit dhe pronarët**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	MKRS – DTK QRTK Pz Zyra e QHP	50.000,00	Kampet Rajonale të Restaurimit nëpër Ballkan (CHwB Shqipëri)

2.1.6	**Themelimi i një qendre për rijetësim të zejeve tradicionale dhe edukimi i gjeneratave të reja për këto zeje** Zhvillim i programit të rijetësimit të artizanateve të vjetra që janë në zhdukje duke ndërlidhur zejtarinë tradicionale me potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor o Identifikimi i zanateve të vjetra që kanë mbijetuar o Dokumentimi i zanateve të vjetra o Ngritja e kapaciteteve profesionale për tajnim dhe edukim të zejeve tradicionale	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit Bizneset	150.000,00	Projekti ekzistues i shoqatës Esnaf "Shkolla e zejes së filigranit"

OBJEKTIVI 2.2. Ngritja e vetëdijes në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
2.2.1	**Shënimi i Diteve të Trashegimsië Evropiane në Prizren**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DKRS dhe DASh	40.000,00	Tematika e aktiviteteve mund të ndërrohet për çdo vit Kostoja për një vit
2.2.2	**Edukimi përmes Argëtimit** 1. Shtegu i zbulimeve (lojë elektronike) 2. Zbulo Qendrën Historike - lojë në tavolinë 3. Klasat e artizanëve	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DKRS dhe DASh	70.000,00	Kostoja për një vit
2.2.3	**Organizmi i kampanjave të vetëdijësimit rreth zbatimit të ligjjit për mbrojtje të trashëgimisë kulturore**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	MKRS Komuna e Prizrenit Shoqatat profesionale	1.500,00	Kostoja për një vit
2.2.4	**Organizmi i seminareve lokale dhe ndërkombëtare për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	KKTK, MKRS Komuna e Prizrenit Shoqatat profesionale	20.000,00	Kostoja për një vit
2.2.5	**Ngritja e kapacitetve lokale në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore programit të vizitave studimore, bursa studimi, etj**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	KKTK, MKRS Komuna e Prizrenit Shoqatat profesionale	35.000,00	Kostoja për një vit

SYNIMI 3. SIGURIMI I BANIMIT DINJITOZ ME KUSHTE BASHKËKOHORE DHE OFRIMI I POTENCIALIT PËR ZHVILLIM TË OBJEKTEVE TË BANIMIT BRENDA QHP

OBJEKTIVI 3.1. Dokumentimi i të gjitha shtëpive tradicionale brenda QHP dhe kategorizimi i tyre për intervenim dhe potenciale për të ardhmen

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
3.1.1	**Kategorizimi i shtëpive të vjetra tradicionale bazuar në vlerat e tyre, dhe përcaktimi i kritereve se cilat veprime / ndërhyrje mund të bëhen në ato shtëpi**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	MKRS / QRTK Prizren	20,000.00	Kosotja e projektit përfshin vetëm hartimin dhe nuk përfshin implementimin
3.1.2	**Hartimi i planit të veprimit për restaurim dhe revitalizim të shtëpive të vjetra brenda QHP**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	MKRS / QRTK Prizren dhe Komuna e Prizrenit (DUPH)	10,000.00	
3.1.3	**Hartimi i udhëzuesit për revitalizim dhe rifunksionalizim të shtëpive tradicionale (si p.sh në bujtina)**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	MKRS / QRTK Prizren	25,000.00	
3.1.4	**Hartimi i udhëzuesit për metodat e lira të mirëmbajtjes së shtëpive tradicionale**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	MKRS / QRTK Prizren	25,000.00	
3.1.5	**Implementimi i planeve, manualeve të hartura**	I ulët	Afatgjatë 5-10 vjet	MKRS / QRTK Prizren dhe Komuna e Prizrenit (DUPH, DSHP)	2,000,000.00	

OBJEKTIVI 3.2. Ngritja e vetëdijes së pronarëve të shtëpive tradicionale rreth vlerave të trashëgimisë dhe menaxhimit të pronave të tyre

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
3.2.1	**Themelimi i shoqatës së pronarëve të shtëpive tradicionale**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Shoqëria civile / RrOK Pz dhe Zyra e QHP	5,000.00	
3.2.2	**Organizimi i kampanjave të vetëdijësimit tek pronarët**	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Shoqëria civile / RrOK Pz dhe Zyra e QHP	20,000.00	Kostoja për 10 vite
3.2.3	**Hartimi i broshurës informative dhe dokumentacioneve relevante teknike për <u>pronarë të aseteve të trashëgimisë kulturore</u>** *Shënim: Informim në lidhje me procedurat për paisje me leje, intervenime dhe mirëmbajtje të aseteve të trashëgimisë kulturore*	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Zyra e QHP	7,500.00	
3.2.4	**Hartimi i broshurës informative dhe dokumentacioneve relevante teknike për <u>pronarë të ndërtesave të reja në QHP</u>** *Shënim: Informim në lidhje me procedurat për paisje me leje, intervenime dhe mirëmbajtje të aseteve të trashëgimisë kulturore*	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Zyra e QHP	7,500.00	

SYNIMI 4. BRENDIMI I QYTETIT TË PRIZRENIT: KRYEQYTET KULTUROR I EVROPËS SI SHTYTËS PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK

OBJEKTIVI 4.1. Promovimi dhe brendimi i qytetit të Prizrenit

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
4.1.1	**Brendimi i qytetit te Prizrenit** Përpilimi i detyrës projektuese të konkursit për brendim të qytetit bazur në strukturës së mëposhtme: 1. Hapja e konkursit (ndërkombëtar) 2. Organizimi i punëtorive specifike tematike për brendim të qytetit dhe formulimin e narracionit kolektiv sipas fushave të mësipërme. 3. Aplikimi i metodave të ndryshme të gjithpërfsherjes qytetare në tematikë të brendimit (pyetësor në terren, pyetësor online në uebfaqen e komunës, konkurs fotografie, dhe konkurse tjera të ngjashme gjithpërfshirëse etj) 4. Dizajnimi dhe zhvillimi i brendit (përfshirë anën tekstuale, konceptuale dhe pamore) 5. Dizajnimi i elementeve dhe shenjave urbane bazuar në brendimin e përgjithshëm të qytetit (përfshirë edhe shenjat orientuese për këmbësorë për trashëgimi kulturore e natyrore) 6. Aplikimin e brendit në mediume të ndryshme dhe target audienca të ndryshme 7. Monitorimi i brendit dhe menaxhimi	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	50,000.00	Kosoja e projekti përfshin aktivitetet nën 1 deri 4.
4.1.2	**Aplikimi për status të Kryeqytetit Kulturor të Evropës** o Formimi i komisioni dhe hartimi i dosjes së aplikimit o Shqyrtimi i shembujve tjerë të suksesshëm të Kryeqyteteve të Kulturës o Përcaktimi i planit dinamik, buxhetit të nevojshëm dhe personave me ndikim për të punuar rreth kësaj objektive o Formimi i komitetit drejtues për shqyrtim o Kryerja e studimit ekonomik me analizën e kostos - përfitimeve të këtij procesi o Nxjerrja në pah e përfitimeve ekonomike afatgjate nga statusi i Kryeqytetit Kulturor të Evropës –rritja e turizmit, vëmendjes dhe vendosja e Prizrenit "në hartë"	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Kabineti i kryetarit MKRS	150,000.00	Projekti mund të jetë pjesë e platformës së gjërë Evropa Kreative të EU-së dhe mund të bashkëfinancohet mes MKRS dhe Komunës së Prizrenit.
4.1.3	**Përpilimi i web-faqes së turizmit të qytetit përfshi edhe aplikacionin për telefona të mençur**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	/	
4.1.4	**Tabelat interpretuese për monumentet e trashëgimisë kulturore të ndërlidhura me barkod me faqen e turizmit të qytetit** Ofrimi i Wi-fi falas brenda QHP dhe promovimi i qytetit brenda këtij rrjeti	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	10,000.00	Kostoja për tabela të 20 monumenteve
4.1.5	**Pjesëmarrja në konventat turistike dhe sponzorimi i standeve për promovimin e Prizrenit** - Panairet në Kosovë - Panairet në rajon - Anltarësimi në Organizata Botërore e Turizmit (Madrid) - ITB Berlin	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE MTI / KIESA	20,000.00	Kostoja për vit

OBJEKTIVI 4.2. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik përmes turizmit kulturor						
Nr.	**Projektet / Aktivitetet**	**Prioriteti**	**Afati i projektit**	**Përgjegjës kryesor**	**Kostoja e përafërt (€)**	**Referencë / Koment**
4.2.1	**Hartimi i strategjise se turizmit si pjesë të strategjisë së përgjithshme të zhvillimit ekonomik të qytetit** - Identifikimi i pervojes se vizitoreve ne qytetin e Prizrenit (mbledhja e statistikave nga vizitoret, kenaqesia me sherbimet e ofruara) - Programi vjetor i zhvillimit te aktiviteteve te turizmit - Zhvillimi dhe ofrimi i paketave të udhëtimit që përfshijnë Prizrenin si pjesë e paketave më të gjera turistike. Inkurajimi i Zhvillimit të Ekoturizmit	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	/	
4.2.2	**Subvencionimi i pronarëve të shtëpive tradicionale për shëndrrim në bujtina (BnB)**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	160,000.00	Kostoja do të përfshinte hartimin e projekteti dhe investim deri në 10.000 Euro për shtëpi (gjithsej 15 shtëpi për 3 vite). Projekti do të kryhej përmes konkursit pubpublic vet pronarët do të shprehnin vullnetin për ofrim të shtëpisë si bujtinë përderisa Komuna do të investonte në përmirësime teknike.
4.2.3	**Investime kapitale ne restaurim te objekteve të trashëgimisë kulturore**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	/	Numri i ndërtesave dhe kostoja e intervenimit përcaktohet në bazë të analizave specifike të ndërtesave
4.2.4	**Ngritja e kapaciteteve profesionale për zhvillim të turizmit:** • Aftesimi profesional • Vizitat studimore • Trajnime për guida turistike dhe certifikimi i tyre te profiluara	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	25,000.00	Kostoja për vit
4.2.5	**Përforcimi i kapciteteve të info qendrës turistike dhe paisja me materiale të duhura promovuese** Hartimi i një broshure mujore për promovim të aktiviteteve kulturore që zhvillohen në QHP dhe Prizren	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE Tur operatorët	10,000.00	Kostoja për vit
4.2.6	**Zonifikim i aktiviteteve biznesore brenda QHP** - Kategorizimi i llojit të biznesit që mund të zhvillohet brenda QHP - Krijimi i zonave tregtare me rijetësim të zejeve të vjetra dhe sjellja e bizneseve të reja. (Rimodelim i rrugës Adem Jashari)	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE	/	
4.2.7	**Zhvillimi i ofertës kulinare** o Tregu i ushqimit tradicional një herë në javë në QHP o Promovimi i ushqimit tradicional në restaurante të qytetit	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	ESNAf dhe Shoqata e Zejtareve	/	

4.2.8	**Krijimi i burimeve financiare për investime brenda QHP** o Krijimi i një fondi të investimeve të dedikuar për QHP nga të hollat e gjeneruara brenda QHP o Themelimi i fondit të veçantë për revitalizim dhe mirëmbajtje të QHPz o Pakot stimuluese dhe promovuese për bizneset e vogla dhe për inovacion. Në bashkëpunim me qendrat e inovacionit dhe inkubatorët e biznesit, duhet të bëhet përmirësimi i mjedisit për idetë e reja dhe të qëndrueshme të biznesit. o Lëshimi i lejeve për idetë e bizneseve pop-up, dhe në afat të mesëm duke siguruar infrastrukturën fizike për ta bërë këtë (siç janë ofrimi i kabinave), në të cilat mund të operojnë bizneset specifike.	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DTZhE MZHE	/	
4.2.9	**Krijimi i politikave fiskale për lehtësim të investimeve brenda QHP** o Modifikimi / zgjerimi I listës së produkteve të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar të TVSH-së prej 8 %, të përdorura në veprimtari kulturore, artistike, turistike dhe rekreative. o Zbatimi i Udhëzimi Administrativ për pushimet në tatime, të kufizuara për investime në sektorë me potencial të punësimit, përfshirë turizmin.	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DEF MF	/	

OBJEKTIVI 4.3. Rritja e cilësisë së festivaleve dhe shëndrrimi i qytetit në qendër të festivaleve gjatë tërë vitit

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
4.3.1	**Hartimi i strategjisë kulturore që do të ofrojë kushtet për zhvillim, menagjim dhe promovim të trashëgimisë shpirtërore, institucioneve kulturore dhe aktiviteteve kulturore.** **-** Hartimi i rregullores dhe caktimi i kritereve për financim të aktiviteteve kulturore - Ri-Organizimi i aktiviteteve kulturore vjetore për një shtrirje të distribuar gjatë tërë vitit - Përditësimi dhe zyrtarizimi i kalendarit kulturor - Promovimi i kalendarit kulturor vjetor	I lartë	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DKRS dhe DASh RROK Pz	20,000.00	
4.3.2	**Themelimi i festivaleve për promovim të vlerave të trashëgimisë** (Ushqimi tradicional, Muzika tradicionale: qytetare, dhe folklori, etj)	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DKRS OJQ-të	20,000.00	Kostoja për vit

SYNIMI 5. QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT, ZONË MIQËSORE PËR KËMBËSORË, ME HAPËSIRA PUBLIKE KUALITATIVE DHE INFRASTRUKTURË BASHKËKOHORE

OBJEKTIVI 5.1. Hartimi i dokumentacioneve relevante për të siguruar lëvizhmëri të sigurtë, ambient të pastër dhe infrastrukturë sipas standardeve bashkëkohore

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
5.1.1	**Hartimi i Planit të mobilitetit, ku do të trajtoheshin të gjitha çështjet relevante (qarkullimi në zonë, rregullimi dhe standardizimi i parkingjeve, teleferiku, shtegu i çiklistëve, etj)**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	50,000.00	Neni 12 i Ligjit te QHP
5.1.2	**Zbatimi i Planit ekzistues të menaxhimit të mbeturinave dhe amandamentimi e funksionalizimi i saj në QHP**	I mesëm	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	/	Neni 11 i Ligjit te QHP
5.1.3	**Hartimi i Planit te Emergjencve per QHP** Masat e mbrojtjes ndaj zjarrit apo fatkeqësive natyrore 1. Komuna harton planin për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit kundër zjarrit, rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. 2. Çdo lokacion, monument kulturor në pronë private apo publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës, në pajtim me ligjet në fuqi si dhe me doracakun e masave mbrojtëse ndaj fatkeqësive natyrore dhe të zjarrit.)	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	10,000.00	Neni 13 i Ligjit te QHP
5.1.4	**Masat preventive për objektet e trashëgimise në gjendje të keqe fizike që paraqesin rrezik për kalimtarë**	I lartë	Afatshkurtë 0-2 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	150,000.00	Ky fond do të përdorej për konsolidim fizik të afërsisht 20 ndërtesave
5.1.5	**Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore dhe modernizimi i saj në harmoni me kontekstin e QHP**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	500,000.00	Harta zonale e Prizrenit
5.1.6	**Hartimi i projektit për qasje në monumente dhe ndërtesa publike, ku parashihen pjerrinat dhe shënjëzimi adekuat për personat me aftësi të kufizuara**	I mesëm	Afatgjatë 5-10 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	20,000.00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
5.1.7	**Hartimi i udhërrëfyesit për shenjëzim vertikal dhe horizontal të komunikacionit, përfshi edhe ato për lokalitete të trashëgimisë kulturore e natyrore në nivel komune, qyteti dhe QHP** • Shenjëzimi për rrugë • Shenjëzimi për monumente të trashëgimisëkulturore • Tabela interpretuese për monumente të trashëgimisë kulturore • Shenjëzimi për lokalitete të trashëgimisë natyrore • Tabela interpretuese për lokalitete të trashëgimisë natyrore	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	MKRS, MI, Komuna e Prizrenit/DSHP	80,000.00	Pjesa e projektit duhet të zbatohet pasi të hartohet rregullorja nga niveli qendror

OBJEKTIVI 5.2. Zhvillimi i politikave të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse për menaxhim të hapësirave publike

Nr.	Projektet / Aktivitetet	Prioriteti	Afati i projektit	Përgjegjës kryesor	Kostoja e përafërt (€)	Referencë / Koment
5.2.1	**Zhvillimi i një kornize/ udhëzuesi për rritje të numrit të hapësirave publike si dhe rregullim të shfrytëzimit të tyre (ndriçimi publik, këndi i lojërave për fëmijë, fontana për ujë të pijes, WC publike, rregullimi i kejit të Lumbardhit, etj)**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	15,000.00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
5.2.2	**Hartimi i një udhëzuesi për dizajn dhe mobileri urbane**	I mesëm	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP dhe DUPH	10,000.00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin

5.2.3	**Krijimi i shtandeve të veçanta dhe me dizajn adekuat për shitës ambulant dhe kioska në QHP**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	20,000.00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin
5.2.4	**Hartimi i rregullores dhe udhëzuesit teknik për reklamat në QHP**	I lartë	Afatmesëm 3-5 vjet	Komuna e Prizrenit/DSHP	10,000.00	Kosotja e projektit përfshin hartimin e dizajnit dhe nuk përfshin implementimin

8. DISPOZTAT E ZBATIMIT DHE MBIKËQYRJA

Konsultimi publik

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si inicuese dhe financuese e projektit të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit (PMQHP), duke u mbështetur në nenin 6, paragrafi 6.6 të Ligjit për trashëgimi kulturore Nr. 02/L-88; nenin 2, paragrafin 1,4 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit Nr. 04/L-066 si dhe duke marrë parasysh Objektivin 2, Masën 2.1.3 dhe Objektivin 3, Masën 3.3.4 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-27, përveç konsultimeve të bëra gjatë procesit të hartimit ka përmbyllur dhe procesin përfundimtar publik. Ky proces është bërë përmes Platformës Online të Zyres për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (https://konsultimet.rks-gov.net/) duke filluar nga 30 Maj deri 20 Qershor 2020.

Aprovimi

Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit aprovohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në konsultim paraprak me MMPH-në, Komunën e Prizrenit dhe palët tjera të përfshira në proces. Miratimi i dokumentit është publikuar më datë 17.12.2020 nga MKRS.[1]

Zbatimi dhe Mbikëqyrja

Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit është plan strategjik multisektorial dhe zbatimi i tij involvon institucione të ndryshme të nivelit qendror, lokal dhe agjencitë tjera zbatuese. Përderisa nuk përcaktohet me Ligjin e ri për trashëgimi kulturore institucioni kompetent për mbikëqyrje të zbatimit të planeve të menaxhimit, mbikqyrjen e zbatimit të PMQHP ta bëjë një Komision Mbikëqyrës i veçantë qe përcaktohet nga MKRS, duke përfshirë te gjitha palët e interesit.
Komisioni rekomandohet të ketë përbërje nga: 1. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), 2. Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit (MKRS), 3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), 4. Komuna e Prizrenit, 5. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren (QRTK PZ), 7. Këshilli për Trashëgiminë Kulturore për QHP (KTK) dhe 5. Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren (RrOK).
Ky Komision harton Detyrat dhe Përgjegjësitë e saja në bazë të legjislacionit përkatës.
Komisioni Mbikqyrës rekomandohet që të informojë instancat e ndryshme ndërkombëtare rreth aprovimit dhe zbatimit të PMQHP sikurse UNESO, ICCROM, Europa Nostra, etj. Këto instanca mund të shërbejnë edhe në ngritje të kapaciteteve dhe përkrahje në zbatim e financim të aktiviteteve të derivuara nga PMQHP.

Kohëzgjatja dhe revidimi

Plani Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit është hartuar për periudhën dhjetëvjeçare 2021-2030, dhe parashikohet të revidohet përgjatë zbatimit të tij.
Vlerësimi i parë i zbatueshmërisë së dokumentit bëhet në fund të vitit 2022, përderisa revidimet e dokumentit parashikohet të bëhen në fund të vitit 2025, 2028 dhe 2030.
Baza e të dhënave dixhitale në në GIS (Sistemin Gjeografik të Informatave) parashikohet të përditësohet në baza vjetore.

[1] https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2429

9. BIBLIOGRAFIA

Assembly of Republic of Kosovo. Law on Cultural Heritage No.02/L-88. 2006. http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_en.pdf (accessed November 12, 2018).

Assembly of Republic of Kosovo. Law on Spatial Planning No. 04/L-174. 2013. https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20spatial%20planning.pdf (accessed November 12, 2018).

Assembly of Republic of Kosovo. Law on Special Protective Zones No. 03/L-039. 2006. http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L039_en.pdf (accessed November 12, 2018).

Assembly of Republic of Kosovo. "Law on Special Protective Zones, Law no. 03/ L-039." 2008. http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,248 (accessed November 12, 2018).

Assembly of Republic of Kosovo. "Constitution of the Republic of Kosovo." 2008. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf (accessed December 24, 2018).

Assembly of Republic of Kosovo. Law on Construction No. 04-L-110. 2012. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2567 (accessed November 12, 2018).

Council of Europe. Convention for the Protetion of the Architectural Heritage of Europe. Granada: Council of Europe, 1985.

Council of Europe. "Regional Heritage Plan East 2015-2018." European Union and Council of Europe, Prishtina, 2015.

Ahtisaari, Martti. "Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's future status." 2008. https://www.osce.org/kosovo/24787?download=true (accessed Novemeber 12, 2018).

Andrea Lucarelli & Per-Olof Berg. "City branding: a state-of-the-art review of the research domain." Journal of PLace Management and Development, 2011: 9-27.

Balen, Koenraad Van. "The NARA Grid: An evaluation scheme based on the Nara Document on authenticity." APT Bulletin, 2011: 39-45.

Bernard M. Feilden, Jukka Jokilehto. Management Guidelines for World Heritage Sites. Rome, 1993.

Council of Europe. European Landscape Convention. Florence: Council of Europe, 2000.

Council of Europe. Njësi mësimore për trashëgiminë kulturore. Prishtinë, 2012.

Council of Europe. Tregimet e gjyshërve tanë. Prishtina: Council of Europe, 2012.

Drancolli, Jahja. "Historia e Prizrenit." In Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren – Advantages and Challenges of Implementation, by Enes Toska, 17-19. Prizren: CHwB, 2011.

Elsie, Robert. Albania and Kosova in Colour 1913 – The Autochromes of the Albert Kahn Collection. Tirana: Skanderbeg Books, 2008.

Emin Riza & Nijazi Haliti. Banesa Qytetare Kosovare e shek. 18-19. Prishtina: Grafika, 2006.

Erik Braun, Jasper Eshuis & Hans-Erik Klijn. "The effectiveness of place brand communication." In Cities, 64-70. 2014.

Hadzic, Lejla. ""Vernacular Heritage Forget or Reuse, Case Study – Stolac, Bosnia & Hercegovina",." 2008. http://www.hdm.lth.se/alumni/alumni_papers/by_course_and_year/cmhb/cmhb_2008_212a/. (accessed June 25, 2019).

Haskuka, Esat. Analiza Historiko Gjeografike e Funksioneve Urbane të Prizrenit. Prizren: Kosova, 2004.

ICOMOS. The Nara Document on Authenticity. 1994. https://www.icomos.org/charters/nara-e.pdf (accessed June 25, 2019).

ICOMOS. Charter for Conservation and Restoration of Monuments and Sites - Venice Charter. 1964. https://www.icomos.org/charters/venice_e.pdf (accessed June 25, 2019).

ICOMOS. Charter on the Built Vernacular Heritage. 1999. https://www.icomos.org/images/DOCUMENTS/Charters/vernacular_e.pdf (accessed June 25, 2019).

ICOMOS Australia. " ." The Burra Charter: The Australia ICOMOS Charter for Places of Cultural Significance. 2000. https://australia.icomos.org/wp-content/uploads/The-Burra-Charter-flow-chart.pdf (accessed June 25, 2019).

ICOMOS. Charter on Built Vernacular Heritage. Mexico: ICOMOS, 1999.

ICOMOS. Principles for the Analysis, Conservation and Structural Restoration of Architectural Heritage. 2003. https://www.icomos.org/charters/structures_e.pdf (accessed June 25, 2019).

Jaenen, Marieke. "Safeguarding the Spirit of an Historic Interior on the Basis of the Nara-Grid." Finding the spirit of place – between the tangible and the intangible. Quebec: ICOMOS, 2011.

Jelavich, Barbara. History of the Balkans: Eighteenth and nineteenth centuries. Cambridge: Camgridge University Press, 1999.

Jerliu, Florina. Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027 (National Strategy for Cultural Heritage). National Strategy, Ministry of Culture, Youth and Sports, Prishtina: MCYS, 2016.

Jokilehto, Jukka. A History of Architectural Conservation. London: Liber Fabrica, 1999.

Maksimovic, Branko. "Funkcionalne i Esteticke Vrednosti Zivotne Sredine u Staroj Strukturi Prizrena." Zbornik zastite spomenika kulture, 1974: 21-31.

Malcolm, Noel. Kosovo a Short History. London: Pan Books, 2002.

Mary Alexander & Edward Porter. Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums. Plymouth: Altamira Press, 2008.

Mason, Randal. "Assessing Values in Conservation Planning: Methodological issues and choices." In Assessing the Values of Cultural Heritage, 5-13. Los Angeles: J.Paul Getty Trust, 2002.

Ministry of Culture, Youth and Sports. "Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme." 2018. http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/LISTA_E_TRASHEGIMISE_KULTUR (accessed November 12, 2018).

Ministry of Environment and Spatial Planning. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020. 2010. https://mmph.rks-gov.net/repository/docs/Plani_Hap%C3%ABsinor_i_Kosov%C3%ABs_2010-2020+_569640.pdf (accessed November 12, 2018).

Partners, Nixha &. "Urban Development Plan of Prizren 20043– 2013." Urban Development Plan, Prizren, 2004.

Paul Drury & Anna Mcpherson. Conservation Principles Policies and Guidance - for the Sustainable Management of the Historic Environment. London: English Heritage, 2008.

Petrovic, Zoran. "Monografija o Kulturnoj Istoriji Prizrena." Bastina, 1997/1998: 241-243.

Petzet Michael and John Ziesemer. International Charters for Conservation and Restoration. Munchen: Lipp GmbH, 2004.

Planque V & Sonnier J. Préservation et mise en valeur du patrimoine monumental de Prizren, province de Kosovo. Paris: UNESCO, 1976.

Porter, Michael. Competitive Advantage of Nations. Harvard: Free Press, 1998.

Ringbeck, Birgitta. Management Plans for World Heritage Sites. Edited by Angus Fowler Claudia Brincks-Murmann. Bonn: German Commission for UNESCO, 2008.

Riza, Emin. Banesa Popullore e Prizrenit. Tirana, 2013.

Robert Pickard & Florent Çeliku. "State of Cultural Heritage Policies in South-East Europe - Kosovo (UNMIK)." In Analysis and Reform of Cultural Heritage Policies in South-East Europe, 61-70. Strasbourg: Council of Europe, 2008.

S. Zenker & E. Braun. "Questioning a “one size fits all” city brand: Developing a branded house strategy forplace brand management." Journal of Place Management and Development, 2017: 270-287.

Sarancic, Amra. Methods of Understandin Heritage Significance. Gjirokastra: CHwB Albania, 2016.

Saur, K.G. "National reports – Yugoslavia." In Heritage at Risk – ICOMOS World Report 2001-2002 on Monuments and Sites in Danger, 211-214. Munchen: ICOMOS, 2002.

Serafin, Nikolic. Prizren od Srednjeg Veka do Savremenog Doba – Urbanisticko – Arhitektonski Razvoj. Prizren: Grafika, 1998.

Shukriu, Muhamet. Prizreni i Lashtë – Morfologjia e Ecurive për Ruajtjen e Kulturës Materiale. Prizren: Kosova, 2001.

Simon Anholt & Plagrave Macmillan. Competitive Identity. 2006.

Simon Guy & Simon Marvin. Understanding Sustainable Cities: Competing Urban Futures. Newcastle: European Urban and Regional Studies, 1999.

Torre, Marta de la. " Introduction." In Heritage Values in Site Management Four Case Studies, 5-9. Los Angeles: The Getty COnservation Institute, 2005.

Torre, Marta De La. Assessing the Values of Cultural Heritage. Los Angeles: The Getty COnservation Institute, 2002.

Toska, Enes editor. Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren – Advantages and Challenges of Implementation. Prishtina: CHwB, 2011.

Toska, Enes editor. Integrated Conservation – Challenges, Opportunities and Integration Experiences of Cultural and Natural Heritage into Spatial and Urban Planning in Kosovo. Prishtina: CHwB, 2011.

UNESCO. Convention concerning the Protection of the World Cultural and Natural Heritage. (World Heritage Convention). 1972. http://whc.unesco.org/en/conventiontext (accessed November 12, 2018).

UNESCO. Cultural Landscapes. 2018. https://whc.unesco.org/en/culturallandscape (accessed June 25, 2019).

UNESCO. New Life for Historic Cities - The historic urban landscape approach explained. Paris: UNESCO, 2013.

UNESCO World Heritage Centre. Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention. 2015. http://whc.unesco.org/en/guidelines/ (accessed Novemeber 12, 2018).

Vesna Vujicic-Lugassy and Laura Frank. Managing Disasters Risks for World Heritage. Paris: UNESCO, 2010.

Zoran Petrovic & Branislav Milenkovic. Prizren Grad Spomenik – Slika Grada. Belgrade: Bodex, 2006.

ANEKS 1

ANALIZA E KONTEKSTIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

1.1

Historia

1.1 HISTORIA

Prizreni është një prej qyteteve më të lashta në Kosovë dhe posedon një karakter të veçantë urban dhe arkitektonik. Qyteti përmban trashëgimi të pasur kulturore me vlera të larta estetike, shpirtërore, shkencore dhe ekonomike. Gjurmët e trashëgimisë kulturore materiale ofrojnë dëshmi se kjo trashëgimi përfshin një vazhdimësi që nga kohët parahistorike në antikitet, mesjetë, rilindje e deri më sot. Kjo i jep Prizrenit një shpirt dhe arkitekturë unike, të karakterizuar nga integrimi i kulturës lokale me ndikimet, besimet dhe qytetërimet e sjellura nga tregtarët dhe pushtuesit e ndryshëm.[1]

Qyteti njihej si Theranda, Prizdriniana, Peneropolis, Praeserem, Prizna, Prizrenum, Presarin, Prisareno, Prizirendi, Prezren, Prozdren, Pruzrenin, Zorin, Torzerin, Perserin dhe Prizrend. Duke pasur një pozicion të mirë gjeografik dhe gjeopolitik, Prizreni ishte gjithmonë i vendosur në udhëkryqet e kulturave të mëdha, në rrugët e rëndësishme tregtare nga bregu i Adriatikut drejt Ballkanit.[2]

Antikiteti

Zona e luginës së Prizrenit fillimisht ishte banuar nga Fisi Dardan i Ilirëve. Më vonë rajoni i Kosovës bie nën sundim të romakëve, pas luftës në mes tyre dhe daradanëve, në shekullin e ll-të p.e.s. Prizreni fillimisht është njohur si qytet romak i Therandës, në gjeografinë e Ptolemeut në shekullin e ll-të pas erës sonë dhe më vonë si Petrizen nga Procopius i Cezaresë në *De aedificii* në shekullin e V-të.[3]



Harta 1- Prizreni ndodhet përgjatë rrugëve të lashta tregtare që lidhin rrafshnaltat malore me Mesdheun dhe lidhjet ndërmjet Gadhishullit Ballkanik dhe Detit Egje (Harvard DARMC, 2016)

Periudha mesjetare shek. XI-XII

[1] Nixha & Partners, "Mbrojtja e Trashëgëmisë Kulturore", in Planin Zhvillimor Urban të Prizreitn 2003-2013, 1.
[2] Noel MALCOLM, "Prezantimi" në *Kosova një histori e shkurtër*, (Londër: Pan Books, 2002), 5.
[3] "Ndërtesat e Prokopit", e publikuar në Loeb Classical Library, 1940, arritur më 17 April, 2012, http://penelope.uchicago.edu/Thayer/E/Roman/Texts/Procopius/Buildings/4B*.html.

Periudha bizantine e gjen qytetin me emërtimin Prisdriana. Në Kartën e Perandorit Bizantin Basil II, qyteti përmendet si Dioqezë nën juridiksionin e Kryepeshkopit të Ohrit. Në fillim të shekullit të XIII-të qyteti bie nën sundimin bullgar, me përjashtim të viteve 1214-1216 kur Prizreni u pushtua nga Stefan Prvovençani (i pari i kurorëzuar) nga Dinastia Serbe Nemanja.[4] Gjatë kësaj periudhe, qyteti ishte i mbrojtur nga një fortifikatë dhe disa fortifikata në rrethe të saj.[5] Prizreni ishte qytet i tregtisë së lirë, rezidencë e ipeshkvit katolik dhe peshkopit bizantin, bullgar dhe serb, si dhe qendër e artit dhe kulturës.

Orientimi mesjetar i Prizrenit përbëhej nga një aks midis Kalasë së qytetit që ndodhej në maje të kodrës dhe bazilikës së Shën Premtes. Ndërtesa të tjera fetare dhe profane supozohet të jenë ndërtuar përgjatë këtij aksi në mes të Kalasë dhe Bazilikës përgjatë lumit Lumbardh. Gjatë shekujve XII-XIII-të, në zhvillimin urban-arkitekturor të Prizrenit përveç Bazilikës dhe Kalasë ka pak tregues të tjerë.[6] Rrjedha e lumit supozohet të ketë pasur një rrugë tjetër nga lokacioni i tij aktual.[7]

Periudha mesjetare e shek. XIV

Prizreni arriti kulmin e zhvillimit të tij historik, duke e marrë pamjen tipike të qyteteve perëndimore mesjetare me fortifikime të sofistikuara, *civitas* (qendër administrative dhe ekonomike) dhe *castrum* (qytet kala). Gjatë gjysmës së parë të shekullit të XIV-të, Prizreni priti një koloni të madhe të tregtarëve Raguzanë (Dubrovniku i sotëm). Për të mbrojtur interesat e tyre, tregtarët raguzianë që vepronin në Prizren kërkuan emërimin e një konsulli në qytet. Kjo shënoi fillimin e jetës konsullore në Kosovë.[8]

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV-të, qyteti u dobësua për shkak të konflikteve dhe ndarjeve politike. Në atë kohë, pas vdekjes së perandorit Dushan (në 1355), qyteti u qeveris nga mbreti serb Vukashin (1360-1371) dhe më vonë pas vdekjes së Vukashinit në 1371, Prizreni u qeveris nga një princ arbëror nga familjet e Balshajve dhe Kastriotëve.[9]

Përveç karakterit urban të Prizrenit si një qendër tregtare, qyteti gjithashtu mori karakteristikat e një kryeqyteti rajonal, duke ndikuar në zhvillimin e strukturës urbane dhe themelimin e insitucioneve publike.[10] Gjatë shek. XIV u ngritën monumente të njohura si Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë - Bogodorica Ljeviska, e cila u adaptua nga një bazilikë tre nëfshe në kishë me kupollë dhe këmbanare (në vitin 1307) dhe gjatë vitit 1352 u ndërtua Manastiri i Kryeengjujve, mbi rrënojat e një kompleksi kishtar të mëhershëm.

4 Noel MALCOLM, "Kosova Mesjetare para Princit Lazar: 850-1380" në Kosova një histori e shkurtër, (Londër: Pan Books, 2002), 41-44.
5 Jahja DRANÇOLLI, "Historia e Prizrenit" në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit, avantazhet dhe sfidat e zbatimit, (Prishtina: CHwB, 2010), 17-19.
6 Serafin NIKOLIC, Prizreni nga mesjeta deri në epokën moderne – urbanistik – zhvillimi arkitekturor, (Prizren: Grafika, 1998), 68-74.
7 Ibid, 68-74.
8 Jahja DRANÇOLLI, "Historia e Prizrenit" në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit, avantazhet dhe sfidat e zbatimit, (Prishtina: CHwB, 2010), 17-19.
9 Ibid, 17-19.
10 Serafin NIKOLIC, Prizreni nga mesjeta deri në epokën moderne – urbanistik – zhvillimi arkitekturor, (Prizren: Grafika, 1998), 68-74.



Foto 1. Pamje e gërmimeve në Manastirin e Kryeengjujve gjatë vitit 1927 (burimi http://www.wikiwand.com/sr/)

Prizreni nën Perandorinë Osmane shek. XV-XIX

Prizreni u pushtua nga Perandoria Osmane në vitin 1455.[11] Qyteti dëshmoi një periudhë tjetër zgjerimi nga shekulli i XVI-të kur ajo u bë qendra kulturore dhe tregtare e rajonit. Duke përfituar nga pozicioni i tij i favorshëm gjeografik në rrugët e rëndësishme tregtare që e lidhën atë brenda Perandorisë Osmane, Prizreni u bë një nga qendrat më të rëndësishme artizanale dhe tregtare gjatë shekujve XVIII-XIX.[12]

Prizreni u shndërrua në një qendër të rëndësishme kulturore, fetare dhe administrative me *vakife* (fondacione bamirëse) të rëndësishme, xhami, medrese (shkolla fetare), shkolla fillore, hamame (banjë publike) dhe ura. Shumëllojshmëria etnike dhe fetare e Prizrenit u inkurajua nga sundimi osman dhe shquhej me bashkëjetesën e popullsisë muslimane shqiptare, katolike shqiptare dhe serbëve e shqiptarëve ortodoks.[13]

Në fund të shekullit të XIX-të, Prizreni u bë qendra kryesore politike ku Lidhja e Prizrenit u organizua për herë të parë për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve në rajon dhe fillimisht për të avokuar për autonomi më të madhe brenda Perandorisë Osmane.[14] Gjatë kësaj periudhe

[11] Noel MALCOLM, "Kosova e hershme osmane: 1480-1580" në *Kosova një histori e shkurtër*, (Londër: Pan Books, 2002), 91-105.
[12] Emin RIZA & Nijazi HALITI, *Banesa qytetare Kosovare e shek. 18-19*, (Prishtina: Grafoprint, 2006), 30.
[13] Noel MALCOLM, "Lufta, rebelimi dhe jeta fetare: 1580-1680" *n*ë *Kosova një histori e shkurtër*, (Londër Pan Books, 2002), 126.
[13] Noel MALCOLM, "Lidhja e Prizrenit me revolucionin e ri turk: 1878-1908" *n*ë *Kosova një histori e shkurtër*, (Londër: Pan Books, 2002), 215-238.
[14] Ibid.

vendimtare qyteti vazhdoi të zgjerohej në perimetrin e tij duke ruajtur strukturën e tij organike dhe të hapur.

Foto 2- Kisha e Shën Premtes (Levishës) e shndërruar në Xhami

Foto 3 - Pamje e Kalasë së Prizrenit gjatë periudhës Osmane, fundi i shek. XIX

Foto 4. Pamje nga Kalaja e Prizrenit në vitin 1913

Shek. XX – Vitet 1912-1999

Kjo periudhë karakterizohet nga përfundimi i sundimit të Perandorisë Osmane dhe ndërhyrjet drastike urbane me qëllim të modernizimit. Kapitullimi i Perandorisë Osmane në vitin 1912 dhe fundi i sundimit të saj në Gadishullin Ballkanik, ishte një pikë kthese për shumë kombe. Me largimin e ushtrisë Osmane, Kosova u pushtua shpejt nga Mbretëria e Serbisë.[15] Në vitin 1918, Prizreni si dhe Kosova, u bënë pjesë e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, e cila pas vitit 1929 u quajt Mbretëria e Jugosllavisë.[16] Pas themelimit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Kosovës i është dhënë statusi i një province autonome, me të drejta të rëndësishme dhe vetëqeverisje.

Struktura urbane e Prizrenit përbëhej nga elemente urbanistike ekzistuese, lagje banimi dhe pazare, lumi dhe urat, rrjetet rrugore dhe përrockat.

Një studim gjeodezik i kryer nga inxhinierë ushtarakë në vitin 1913 paraqet përpjekjen e parë në drejtim të inçizimit të gjendjes ekzistuese urbane. Më pas në vitin 1924 është hartuar plani për ri-urbanizim të qytetit.[17] Sipas këtij plani, modeli organik-oriental i qytetit ishte planifikuar të zëvendësohet me rrjet të rregullt ortogonal. Për shkak të kufizimeve ekonomike, ky plan nuk u zbatua dhe deri në fund të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, zhvillimi urban i Prizrenit vazhdoi në mënyrë të pa planifikuar.

Për të përmbushur nevojat bashkëkohore të qytetit në rritje, gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore u ndërtuan shumë ndërtesa të reja publike, ekonomike, arsimore dhe banimi: Hidrocentrali i parë; Gjimnazi; Shkolla fetare katolike pranë Kishës Katolike; Hotelet e para;

[15] Noel MALCOLM, "Rebelime të mëdha, pushtimi serb, Lufta e Parë Botërore: 1908-1918"" *në Kosova një histori e shkurtër*, (Londër: Pan Books, 2002), 239-263.
[16] Ibid, 239-263.
[17] Serafin NIKOLIC, *Prizreni nga mesjeta deri në epokën moderne – urbanistik – zhvillimi arkitekturor*, (Prizren: Grafika, 1998), 332-369.

Ndërtesat e banimit të cilat ndryshojnë nga ndërtesat e banimit të shekullit të XIX-të ku ndikimi i stilit evropian është i dukshëm.

Foto 5. Pamje të qytetit në fillim të shek. 20 (vitet 1930')

Gjatë periudhës socialiste, qyteti përjetoi një zhvillim të hovshëm nën moton e 'modernizimit', e cila rezultoi me humbje të modelit oriental të trashëguar nga shekulli i XIX-të. [18] Qendra e vjetër e Prizrenit përjetoi ndryshime drastike, me shkatërrim të çarshive tradicionale dhe zëvendësimin me ndërtesa shumë katëshe nga betoni.

Zhvillimi urban ka filluar të planifikohet me themelimin e Entit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të përmendoreve dhe rariteteve natyrore në vitin 1967 dhe hartimin e Planit të Parë Zhvillimor Urban në vitin 1977. Ligji i parë për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore u miratua gjithashtu në vitin 1977. Objektivat kryesore të këtij plani ishin përcaktimi i pjesëve të vjetra dhe të reja të qytetit, zgjerimi i qytetit drejt veriut dhe perëndimit, zhvillimi i zonave të

[18] Ibid, 401-432.

reja të banimit në veri, zhvillimi i zonës industriale në perëndim dhe përqendrimi i aktiviteteve arsimore, shëndetësore dhe sportive në perëndim. [19]

Aktivitetet e zejtarisë u rritën në një shkallë më të shquar me krijimin e një zone industriale në pjesën veri-perëndimore të qytetit. Janë ngritur shumë ndërtesa të reja publike: dy kinema, një qendër kulturore, një stacion radioje, shkolla fillore dhe të mesme, qendra sportive, ndërtesa bankare, qendra shëndetësore dhe është përcaktuar një zonë ushtarake në veri të qytetit.



Foto 6. Ndryshimi i nivelit të shtratit të lumit dhe ndërtimet e reja në sheshin Arasta

Situata e pa qëndrueshme politike në Jugosllavi u shkaktua me vdekjen e Titos në vitin 1980. Në vitin 1991, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë u shpërbë dhe Kosova mbeti nën sundimin serb, ku situata politike dhe shoqërore u përkeqësua veçanërisht për banorët shqiptarë. [20] Disa dekada pas instalimit të qeverisjes supresive serbe në Kosovë dhe Prizren, qyteti përsëri u bë një nga qendrat e luftës shqiptaro-kosovare për pavarësi. [21]

Shek. XXI – Vitet 1999-2012

Nga pranvera e vitit 1998 deri në verën e vitit 1999, Kosova ishte skenë e konfliktit të armatosur dhe spastrimit të egër etnik. Fundi i luftës dhe vendosja e Kosovës nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara paraqiti pikënisjen e një epoke të re për banorët e saj.

Në shkurt të vitit 2008, u deklarua shteti i pavarur i Kosovës, duke u dhënë të drejta specifike të gjithë banorëve të saj, veçanërisht pakicave.

Ndryshimi në situatën politike u shpreh edhe në zhvillimin urban të qytetit. Zhvillimi i pa kontrolluar urban dhe ndërtimet masive e karakterizojnë këtë periudhë. Sistemi socialist i planifikimit i karakterizuar nga ndërtimet në shkallë të gjerë, blloqe apartamentesh me dendësi të banimit është trashëguar tani nga zhvilluesit privat.

Pavarësia u pasua nga liberalizimi i ekonomisë, privatizimi i përgjithshëm i pronës publike i shoqëruar me më pak rregulla ndërtimi. Kjo rezultoi në një ndryshim dramatik në strukturën shoqërore, si dhe në karakterin dhe natyrën e bërthamës historike urbane. Në kuadër të ndërtimit të hovshëm u ngritën ndërtesat shumëkatëshe në periferi të qendrës si dhe brenda

[19] Ibid, 387-390.
[20] Noel MALCOLM, "Kosova pas vdekjes së Titos: 1981-1998"" *në Kosova një histori e shkurtër*, (Londër: Pan Books, 2002), 346.
[21] Jahja DRANÇOLLI, "Historia e Prizrenit" në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit, avantazhet dhe sfidat e zbatimit, (Prishtina: CHwB, 2010), 17-19.

saj. Këto ndërtesa nuk ishin në përputhje me karakterin historik dhe shprehej përdorimi i materialeve të reja sikurse betoni, alumini dhe qelqi. Kjo ndikoi në ngritjen e vlerës së pronës dhe rezultoi me një maksimizim të zonave të shfrytëzuara për ndërtim duke vën nën presion strukturat historike. Katet përdhes të banimit u zëvendësuan me zona komerciale, duke pasur një ndikim të rëndësishëm në strukturën urbane dhe siluetën e qytetit.

Me qëllim të kontrollimit të zhvillimit të hovshëm dhe hartimit të strategjive për zhvillim të planifikuar, institucionet qendrore dhe lokale hartuan plane zhvillimore urbane dhe rregulluese për qytetin e Prizrenit. Në vitin 2008, këto ndryshime janë vërejtur dhe adresuar me një master plan të njohur si Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit. Ky plan është adoptuar në Kuvendin Komunal të Prizrenit, dhe përkundër faktit që respektohet në masë të madhe, nuk ka arritur të sigurojë mbrojtjen e përgjithshme të pronave individuale dhe ruajtjes së tërësisë historike urbane.

Në fushën politike, integrimi evropian paraqet një qëllim të rëndësishëm në agjendën aktuale të Kosovës, si dhe në shtetet e tjera të Ballkanit. Konservimi dhe promovimi i diversitetit etnik dhe trashëgimia kulturore luan një rol jetësor në këtë drejtim.

Deri tani, janë hartuar shumë plane, ligje, dhe rregullore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore. Masat ligjore të miratuara në Kosovë përfshijnë Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, në vitin 2006; Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, në vitin 2008; Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit në vitin 2012, Ligji për Fshatin e Hoçës së Madhe në vitin 2012, Ligji për fshatin Zym i Hasit i vitit 2013.

Në fillim të vitit 2016 me iniciativë dhe financim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, si dhe zbatimin e Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren, ka filluar procesi i hartimit të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit.

1.2

Korniza ligjore

1.2 KORNIZA LIGJORE

Institucionet përgjegjëse për ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore

Trashëgimia kulturore në Kosovë menaxhohet nëpërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është agjenci e pavarur e themeluar në vitin 2007, nga Kuvendi i Kosovës në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88. Mandati kryesor i Këshillit fokusohet në vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojte të përhershme, vlerësimin e projekteve dhe përcaktimin e prioriteteve financiare në fushën e trashëgimisë kulturore, dhe bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për avancimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e themeluar në vitin 2002, paraqet institucionin kryesor qendror për menaxhimin e fushës së kulturës në përgjithësi në Kosovë. Departmaneti i Trashëgimisë Kulturore në kuadër të kësaj Ministrie, nëpërmjet institucioneve vartëse paraqet organin përgjegjës për menaxhim dhe ruajtje të trashëgimisë kulturore të Kosovës.[1] Ky departament ka në vartësi: IKMM, IAK MKK dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore, nëpërmjet të cilëve zhvillohen politikat programore për zhvillim të strategjive për inventarizim, për ruajtjen dhe mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore, hartimin e planeve të ndërhyrjeve për ruajtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore.

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren është themeluar në vitin 1967[2], si Enti për Urbanizëm dhe Mbrojtje të përmendoreve dhe rariteteve natyrore, i cili ka qenë nën administrim të nivelit lokal. Në vitin 2001 ky institucion bartet nën përgjegjësi të institucioneve qendrore me emërtimin Instituti për Mbrojtje të Monumenteve Prizren, kurse në vitin 2010 ndryshon emërtimin në Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren. QRTK është institucion përgjegjës për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në komunat jugore të Kosovës, respektivisht në Komunën e Prizrenit, Suharekës, Rahovecit, Dragashit, Malishevës dhe Mamushës.

Inspektorët e Trashëgimisë Kulturore, sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturore, janë emëruar rishtas nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.[3] Mandati dhe rregullimi i detyrave të

[1] Robert PICKARD and Florent ÇELIKU, "State of cultural heritage policies in South-East Europe - Kosovo (UNMIK)" në *Analysis and Reform of Cultural Heritage Policies in South-East Europe,* Strasbourg: Council of Europe, 2008, 61-70.

[2] Jusuf XHIBO, "Sfidat në mbrojtjen e Zonës Historike të Prizrenit"', në *Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, përparësitë dhe sfidat e implementimit*, (Prishtinë: CHwB, 2010), 162-165

[3] MKRS-ja në vitin 2017 prezantoi të arriturat dhe sfidat e saj, qasur Janar 29, 2018, http://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,1648#.Wm8l5q6nHcs.

tyre është përcaktuar me Rregulloren Nr.01/2020 për Kompetencat, autorizimet dhe procedurat e inspektimit dhe të ankesave të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore [4].

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është themeluar në vitin 2002, dhe ka mandat kryesor në krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm në fushën e mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit e banimit. Në bazë të legjislacionit të adoptuar, kjo Ministri është përgjegjëse për zbatim dhe implementim të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, ku hyn edhe Qendra Historike e Prizrenit, dhe ligjeve tjera që janë hartuar bazuar në këtë ligj, përfshirë këtu edhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor funksionon në kuadër të kësaj Ministrie, dhe ka mandat mbikëqyrjen inspektuese të Qendrës Historike të Prizrenit, e cila ka status të zonës së veçantë të mbrojtur.[5]

Këshilli Zbatues Monitorues[6] është themeluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe ka për detyrë të monitorojë zbatimin e dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë, duke përfshirë në veçanti dispozitat e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Qendrën Historike të Prizrenit dhe Fshatit Hoçë e Madhe.

Në nivelin lokal, **Komuna e Prizrenit** është institucion përgjegjës për menaxhim të zhvillimit të qytet. Çështjet në lidhje me trashëgiminë kulturore trajtohen nëpërmjet Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor[7], Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, Drejtorisë së Inspektorateve dhe Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit, në bashkëpunim me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren.

Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit është themeluar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe ka rol këshillues në lidhje me aktivitetet që zhvillohen në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore.[8]

Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit, sipas Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, parashihet të themelohet nga Komuna e Prizrenit. Mandati kryesor i kësaj zyre fokusohet në koordinim të veprimeve që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit; ngritjen e vetëdijes së publikut rreth rëndësisë dhe statusit të qendrës historike, si dhe promovimin

[4] https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Rregullorja_nr_01.2020_p%C3%ABr_Inspektoriatin_e_Trashigimis%C3%AB_Kulturore.pdf
[5] Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, qasur më Mars 12, 2018, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8910.
[6] Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, qasur më Janar 12, 2018, http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,248.
[7] Shpresa OSMANOLLAJ, "Plani Rregullues Urban për Zonën Historike të Qytetit të Prizrenit, si Udhërrëfyes për Zhvillim Lokal të Qytetit", *Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, përparësitë dhe sfidat e implementimit*, (Prishtinë: CHwB, 2010), 166-169.
[8] Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, qasur më Janar 12,2018, http://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836

dhe zhvillimin e saj si destinim turistik.[9] Përkundër faktit se ligji është aprovuar në vitin 2012, kjo zyre ende nuk është themeluar.



Skema 1. Diagrami i menaxhimit të trashëgimisë kulturore në nivel qendror dhe lokal në Kosovë

[9] Ibid.

Mekanizmat Ligjor

Ligji (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore është hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me mbështetje të Këshillit të Europës dhe është aprovuar në vitin 2006.[10] Ky ligj paraqet mjetin ligjor për rregullim të procesit të inventarizimit, dokumentimit, përzgjedhjes, mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, zhvillimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në përputhje me kartat dhe konventat ndërkombëtare.[11] Ky ligj ka për synim përcaktimin e skemës organizative të institucioneve kompetente të cilët do të miren në mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatimin e përgjegjësive të dala nga ky ligj.

Gjatë implementimit të këtij ligji janë gjetur mangësi në aspektin e funksionimit, dhe me këtë qëllim në vitin 2012 ka filluar amandamentimi i tij, proces ky që ende nuk ka përfunduar.

Në kuadër të këtij ligji janë hartuar rregullore që ndihmojnë në qartësimin e detyrave dhe përgjegjësive dhe sigurojnë një zbatim të efektshëm të tij.

Rregullorja (MKRS) Nr.06/2017 për përcaktimin e Institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në cilësinë e institucioneve kompetente[12], përcakton detyrat dhe përgjegjësitë specifike të Instituteve Kombëtare dhe të Qendrave Rajonale për Trashëgimi Kulturore në përgjithësi, dhe përgjegjësitë shtesë të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, që ndërlidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e tërësisë së Qendrës Historike të Prizrenit.

Ligji (Nr. 04 – L/174) për Planifikim Hapësinor është adoptuar së pari në vitin 2003, kurse në vitin 2013 është amandamentuar. Ky ligj ka për qëllim promovimin e një zhvillimi racional të planifikimit hapësinor, duke arritur një balancë ndërmjet zhvillimit dhe ruajtjes së hapësirave si dhe ruajtjen e ambientit.[13] Ligji për Planifikimin Hapësinor në parimet themelore të tij përcakton se planifikimi hapësinor dhe rregullimi, përveç tjerash duhet të bazohen edhe në promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të Kosovës, duke mbrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm.

Integrimi i trashëgimisë kulturore në procesin e planifikimit hapësinor urban trajtohet me qasjen e konservimit të integruar që ka paraqitur një koncept të ri për institucionet e Kosovës. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm dhe i konservimit të integruar paraqiten në këtë ligj, nëpërmjet neneve ku paraqitet nevoja për përcaktimin e një regjimi të veçantë për organizim, zhvillim, shfrytëzim dhe ruajtje për zonat e veçanta me karakteristika të veçanta.

[10] Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Ligji nr. 02/L-88/2006, http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,205, qasur Janar 12, 2018.
[11] Ibid.
[12] Qasur nga arkiva e QRTK Prizren, më datë 11 Janar 2018.
[13] Ligji për Planifikim Hapësinor, qasur më Janar 12,2018, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20spatial%20planning.pdf .

Ligj tjetër që përforcon ruajtjen e trashëgimisë kulturore, me theks të veçantë asaj fetare, është **Ligji (Nr. 03/L-039) mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura**[14], i cili ka dalë nga rekomandimet për deklarimin e pavarësisë së Shtetit të Kosovës[15] dhe është adoptuar në vitin 2009. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të sigurojë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve fetare Serbe, si dhe të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë për komunitetet që jetojnë në Kosovë, nëpërmjet themelimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura.

Një prej rekomandimeve që dalin nga ky ligj ishte themelimi i Zonës së Veçantë të Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit, që do të përfshijë zonat e rëndësishme të trashëgimisë kulturore të periudhave të ndryshme historike.

Bazuar në rekomandimet e këtij ligji është hartuar **Ligji (Nr. 04/L-066) për Qendrën Historike të Prizrenit**, i cili është adoptuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në vitin 2012[16]. Ky ligj është hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me mbështetje të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), dhe në bashkëpunim me përfaqësues të MKRS, QRTK Prizren, dhe të Komunës së Prizrenit.

Qendra Historike e Prizrenit paraqet një zonë me rëndësi të veçantë, dhe mbrohet me një ligj të veçantë, qëllimi i të cilit është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e **trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme** dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.[17] Për administrim të Qendrës Historike të Prizrenit sipas këtij ligji parashihen mekanizma që do të veprojnë brenda saj. Këto mekanizmat janë trupa të pavaruar institucional që janë përgjegjës për të gjitha aktivitetet brenda zonës me kompetenca të ndara dhe veprojnë sipas përgjegjësive që përcaktohen me ligj. Ligji gjithashtu përcakton aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara në territorin e Qendrës Historike, si dhe ndërhyrjet në infrastrukturë, shenjëzimi, lëvizja e automjeteve dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore.

Nëpërmjet këtij ligji përcaktohen mënyrat dhe proceduat e pajisjes me leje, konsultimi dhe informimi i palëve.

Përkundër faktit që në ligj shkruhet se Qendra Historike e Prizrenit klasifikohet si pronë e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme, kjo zonë vazhdon të mbetet në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme.[18]

14 Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, qasur më Janar 12, 2018, http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,248.
15 Martti AHTISAARI," Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's future status", qasur Prill 05, 2012, http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf.
16 Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, qasur më Janar 12,2018, http://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836.
17 ibid.
18 Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme 2017-2018, Burimi: Arkiva e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore, qasur Janar 09,2018.



Skema 2. Diagrami i kategorive të trashëgimisë kulturore sipas Ligjit të Trashëgimisë Kulturore

Përgjegjësitë e institucioneve në lidhje me Qendën Historike të Prizrenit

Bazuar në Ligjin (Nr.04/L-066) për Qendrën Historike të Prizrenit përgjegjësitë institucionale për ruajtjen, mbrojtjen, menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore brenda kësaj qendre ndahen në mes të Komunës së Prizrenit si autoriteti lokal qeverisës dhe të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore[19] në Prizren, si institucion vartës i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Krahas Ligjit për Qendrën Historike, institucionet e lartpërmendura punojnë duke u bazuar në dokumente strategjike planifikuese, sikurse: Plani Zhvillimor Hapësinor i Kosovës 2010-2020; Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2013-2025; Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit 2003-2013, dhe Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, adoptuar në vitin 2008.

Pas amandamentimit të Ligjit për Planifikim Hapësinor në vitin 2013, emërtimet zyrtare dhe qasja në hartim të këtyre dokumenteve strategjike planifikuese ka ndryshuar. Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2017 ka filluar procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës. Përderisa nuk aprovohet Harta e re Zonale, dispozitat e prezantuara në dokumentet e vjetra janë të vlefshme, rrjedhimisht edhe Plani i Konservimit dhe i Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit ende është në zbatim.

Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit nëpërmjet drejtorive përkatëse, me theks të veçantë nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor është institucion përgjegjës për planifikim dhe zbatim të dokumenteve të planifikimit hapësinor, për rregullim të transportit, sigurim të mbrojtjes nga rreziqet dhe për transparencë me publikun në lidhje me aktivitetet e zhvilluara brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit.

Përgjegjësi tjetër e komunës është themelimi i Këshillit për Trashëgimisë Kulturore dhe të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit.

Një fushëveprim tjetër tejet i rëndësishëm, i Komunës është menaxhimi dhe koordinimi i procesit të pajisjes me leje për çfarëdo ndërhyrje brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në koordinim me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren dhe me Këshillin për Trashëgimi Kulturore, duhet të sigurojë një proces efikas, transparent gjatë aplikimit të palëve për ndërhyrje fizike brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

Në anën tjetër, Drejtoria e Inspektorateve është përgjegjëse për përcaktimin e inspektorëve për mbikëqyrjen e aktiviteteve në fushën e urbanizmit, ndërtimit, trashëgimisë kulturore dhe shërbimeve publike në Qendrën Historike të Prizrenit.[20]

19 Shënim: Në ligj QRTK e Prizrenit përmendet me emërtimin e vjetër si: Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

20 Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, qasur më Janar 12,2018, http://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836.

Këshilli për Trashëgiminë Kulturore

Ka rol këshillues në lidhje me aktivitetet e zhvilluara në Qendrën Historike të Prizrenit. Një prej detyrave kryesore të Këshillit është dhënia e rekomandimeve në afat prej 15 ditësh ndaj lëndëve të dërguara nga Drejtoria e Urbanizmit.

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren

Bazuar në **Rregulloren e (MKRS) Nr.06/2017,** QRTK e Prizrenit është institucion përgjegjës për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve në fushën e urbanizmit, ndërtimit, trashëgimisë kulturore dhe shërbimeve publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ate të Inspektoratit.



Skema 3. Procedura e pajisjes me leje për aktivitetet e ndryshme brenda Qendrës Historike të Prizrenit

Në rast të mospajtimeve palët kanë të drejtë ankese në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Shqyrtimet e ankesave bëhen nga MMPH në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sprotit dhe Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.[21]

Ankesat në lidhje me Kishën Ortodokse Serbe, duhet t'i referohen Këshillit Zbatues Monitorues përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Kulturës Rinisë e Sportit, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe nëse është e nevojshme Gjykatës Kompetente.[22]

[21] Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, qasur më Janar 12,2018, http://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836.
[22] Ibid.

1.3

Lokacioni dhe struktura urbane



1.3 LOKACIONI DHE STRUKTURA URBANE

''Imagjinoni një qytet simpatik Ballkanik. Një qytet që shtrihet përgjatë brigjeve të një lumi të cekët dhe i mbështetur nga malet e gjelbërta, një qytet i lidhur me bregdetin dhe me brendësinë nga rrugët e lashta tregtare, një qytet i mbushur me ndërtesa elegante të vjetra të ndërtuara gjatë shumë shekujsh, një qytet i mbuluar me borë gjatë dimrit të ftohtë dhe nga pluhuri gjatë verës së nxehtë, një qytet që ka parë shumë njerëz të ndryshëm dhe sundues që kanë ardhur dhe shkuar, një qytet që ka parë shumë shkatërrime dhe restaurime, një qytet që ka mbijetuar dhe kapërcyer vështirësitë, një qytet që është tani duke kërkuar në mënyrë të vendosur të ardhmen. Ky qytet është Prizreni''[1].

Qyteti i Prizrenit ndodhet në jug të Kosovës dhe përfshin një sipërfaqe prej 3194 ha, me lartësi mbidetare prej 412-500m, ku mbretëron klima kontinentale dhe mesdhetare. Prizreni si kryeqendër e vendbanimeve rreth saj ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit të ndikuar nga faktorët e shumtë. Një ndër faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikuar në zhvillim konsiderohen kushtet e volitshme fiziko-gjeografike duke mos injoruar edhe ato shoqëroro-ekonomike që kanë pasur rol kyç në krijimin dhe zhvillimin e Prizrenit.

Ky kapitull do të elaboron analizën urbane të qytetit duke u bazuar në:

- Dokumente ekzistuese të planifikimit hapësinor;
- Struktura Urbane e Qendrës Historike sipas tipareve të trashëguara nga e kaluara dhe
- Struktura Urbane e Qendrës Historike duke u bazuar në ndarjen në nën-zona sipas Planit te Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit

1.3.1. Dokumente ekzistuese të planifikimit hapësinor - zhvillimet në komunë dhe qytetin e Prizrenit janë bazuar në dokumente planifikimit hapësinor si në vijim:

- Plani Hapesinor i Kosoves 2010-2020 – është Plan strategjik i nivelit qendror i cili Prizrenin e ka trajtuar në kaudër të Kopshteve të Kosovës si Hapësirë e Portokallt[2]. Sipas këtij Plani, Prizreni është qytet me vlera të lashta kulturore dhe historike që duhet të shpallet "Qytet muze", me aktivitete të zhvillimit si ato në arsim, tregti, turizëm, bujqësi, industri të lehtë ushqimore, tekstilit, farmaceutikës. Ndësa sa i përket Zonave të Veçanta të Mbrojtura, ato i përcakton duke u bazuar në Pakon e Ahtisarit[3] dhe jep aktivitetet që janë të ndaluara. Ky plan nuk elaboron detalisht ZVM dhe nuk përcakton parametra.
- Draft Harta Zonale e Kosovës (HZKos) 2020-2028+ është një ndër dokumentet kryesore të sektorit të planifikimit hapësinor që rrjedh nga Ligji për Planifikim Hapësinor. Qëllimi kryesor i hartimit dhe i hyrjes në fuqi të Hartës Zonale të Kosovës është koordinimi i zhvillimeve hapësinore në të gjithë territorin e vendit. Përmes veprimeve, masave dhe aktiviteteve që janë njëra nga pjesët e rëndësishme të dokumentit, do të bëhet e mundur implementimi i politikave, qëllimeve dhe objektivave të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës.
  Një ndër aktivitetet më të rëndësishme të HZKos është ndarja e territorit në rajone statistikore, të nevojshme për grumbullimin dhe grupimin e të dhënave sociale, ekonomike, kulturore, hapësinore, mjedisore dhe të sigurisë. Zona rajonale e Prizrenit me qendrën kryesore rajonale në Komunë të Prizrenit përfshin komunat e Dragashit, Mamushës dhe Suharekës. Në kuadër të sipërfaqeve të mbrojtura janë përfshirë edhe zonat me trashëgimisë kulturore si njëri ndër sektorët më të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Sipas HZKos degradimi i saj është duke vazhduar ende dhe kjo çështje

[1] Jeroen Van Marle, Tourist guide Prizren in Your Pocket, editor, 2010
[2] Instituti për Planifikim Hapësinor-MMPH, Plani Hapësinor i Kosovës
[3] Propozim gjithëpërfshirës për marrëveshjen për Statusin e Kosovës

obligon të gjitha institucionet relevante që në kuadër të qëllimitSHFRYTËZIM I QËNDRUESHËM I MJEDISIT DHE VLERAVE NATYRORE E KULTURORE, të realizojmë objektivin e rëndësishëm i cili merret me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, duke e përfshirë trashëgiminë arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme, shpirtërore dhe peisazhet kulturore. HZKos jep veprimet që duhet të ndërmerren për plotësimin e objektivave dhe për ndryshimin e gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore. [4]

- Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025 – është plan i nivelit lokal sipas ligji për planifikim hapësinor. Ky plan trajton komunën e Prizrenit përmes identifikimit të sfidave të komunës, prioritetet strategjike dhe përmes skenareve zhvillimore jep drejtim zhvillimit të Komunës. PZHK e Prizrenit nuk ka trajtuar hapësirën brenda kufirit urban së cilës i përket edhe Qendra Historike e Prizrenit. Por më vonë Qendra Historike është trajtuar me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit.
- Plani Zhvillimor Urban 2003-2013 - pas luftës së fundit (1999) Prizreni sikurse edhe qytetet tjera kanë përjetuar migrim të popullsisë prej viseve rurale në ato urbane dhe ndërtim të hovshëm, gjë që ka paraqitur sfidë për qytetet e papërgaditura për t'i dhënë drejtim të duhur zhvillimit. Komuna e Prizrenit edhe pse ka pasur Planin Gjeneral të vitit 1981[5] i cili ka qenë i vlefshëm deri në vitin 1991, ka qenë pothuajse e pamundur të kontrolloj zhvillimet dhe të jep drejtim të duhur zhvillimeve. Prandaj në vitin 2003 merret vendimi për hartimin e një plani të ri, Planin Zhvillimor Urban 2003-2013. Për hartim të këtij Plani janë marrë për bazë një sërë faktorësh dhe parametrash. Në këtë plan mbrojtja e vlerave urb-arkitektonike ka qenë pikësynim kryesor dhe ka shërbyer në profilim të qytetit[6]. Sipas Planit Zhvillimor Urban 2003-2013, tërësia qendrore[7] përfshin tre zona (shiqo skemën) ;
  - zona e parë e mbrojtjes - qendra ekzistuese e qytetit të vjetër të Prizrenit,
  - zona e dytë e mbrojtjes dhe
  - zona e kontaktit.

Zona e parë e ka të definuar kufirin e saj (shiqo hartën-vjollcë errët) dhe përfshin sipërfaqen qendrore të qytetit me Kalanë e Prizrenit jashtë kufirit të saj.

Në vazhdim është paraqitur në mënyrë skematike ndërlidhja e PZHU dhe tërësive qendrore me Planin e Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit.



[4] Draft Harta Zonale e Kosovës 2020-2028+

[5] NIXHA & Partners, Urban Development Plan of Prizren 20043– 2013, Prizren, 2004

6Ibid

7Ibid, zonimi urb-terrıtorıal i Prizrenit është elaboruar me tërësi qendrore dhe qarkore, fq 2

Skema 5 Skema e tërësisë qendrore sipas Planit Zhvillimor Urban 2003-2013



Harta 1 Zonat nën mbrojtje sipas Planit Zhvillimor Urban 2003-2013

- Plani i Konservimit dhe Zhvillimit per Zonen Historike te Prizrenit - duke pasur në konsideratë rëndësinë e qendrës në vititn 2008 është hartuar Plani i Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit i cili ka shërbyer si Plan Urban Rregullativ. Kufiri i zonës është definuar me Plan Zhvillimor Urban 2003-2013. Ndërkohë në qershor të vitit 2008 nga Kuvendi i Kosovës është aprovuar Ligji për Zona të Veçanta të Mbrojtura si pjesë përbërëse të Pako's së Ahtisarit[8] pjesë e së cilës ka qenë edhe Zona/Qendra Historike e Prizrenit. Kërkesë e Pako's së Ahtisarit ka qenë edhe hartimi i ligjeve për këto zona. Më vonë Qendra Historike e Prizrenit mbrohet edhe me ligj - Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066) por duke zgjeruar kufirin me përfshirje të Kalasë dhe disa ndërtesave tjera brenda kufirit të saj. Duhet të theksohet se në Plan të Konzervimit është përdurur shprehja *ZONË* ndërsa në Ligj (Nr.04/L-066) *QENDËR*.

  Qendra Historike e Prizrenit ndodhet mu në zemër të qytetit, e ndarë përgjatë aksit lindje – perëndim nga lumi Lumëbardh, me Kalanë në pjesën lindore dhe zonat e banimit rreth transversales që padyshim kanë ndikuar në zhvillim të saj.

8 Propozim gjithëpërfshirës për marrëveshjen për Statusin e Kosovës



Harta 2 Qendra Historike sipas Planit të Konzervimit dhe Ligjit për Qendër Historike të Prizrenit

Qendra Historike e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 62.88 ha dhe ka një numër të konsiderueshëm të zonave që ngërthejnë në veti një numër të kompleseve, numër të madhë të ndërtesave duke filluar nga ato religjioze deri tek ato të banimit, krojet dhe ndertesa publike me vlera të larta të trashëgimisë kulturore. Një veçori që e bën edhe më atraktive këtë pjesë është se ajo nuk shtrihet në sipërfaqe të rrafshët por lartësia mbidetare e saj variron. Në pikën më të lartë - në siluetë të qendrës dominon Kalaja që supozohet të jetë bërthama e parë e qytetit. Ajo ka fomën e zemrës dhe është një ndër lokalitetet më lashta.

- Draft Harta Zonale e Komunës së Prizrenit është dokument që përveç përmbushjes së kërkesës ligjore i ofron qeverisjes komunale vegël që përmban kushte për një planifikim të qëndrueshëm hapësinor dhe koordinon zhvillimet hapësinore. HZK është dokument multi-sektorial me karakter rregullues përmes së cilës definohet në hollësi ndarja e territorit të komunës së Prizrenit në zona (të tilla si hapësirat e lira, banim, industri, bujqësia, aktivitete ekonomike, etj.), ku për secilën zonë përcaktohen shfrytëzimet e lejuara dhe ato të ndaluara të tokës, kushtet zhvillimore dhe ato të ndërtimit. Në kuadër të zonave mbishtresore trajtohet trashëgimia kulturore duke dhënë kushte për shfrytëzime të lejuara, të lejuara të veqanta dhe të ndaluara për territorin e komunës së Prizrenit, ndërwsa Qendra Historike të Prizenit si zonë e veçantë e mbrojtur nuk trajtohet nga (draft) HZK e Prizrenit.

1.3.2. Struktura Urbane e Qendrës Historike sipas tipareve të trashëguara nga e kaluara

''Qyteti është mjedis në të cilën zhvillohet procesi i jetës së kondenzuar njerëzore. Ky mjedis kushtëzohet nga klima natyrore, ekonomike, teknike, sociale, estetike dhe intelektuale. E VJETRA dhe E REJA formojnë proces unik të klimës në një mjedis të tillë...Qyteti krijohet dhe lëviz. Përjeton tensione. Bëhet ideal, simbol dhe frymëson. Prizreni si i tillë është një nga anëtarët e qyteteve POLIS me vlerë'' Bashkim Fehmiu (''Prizren-Kryevepër e mjeshtërve të panjohur'')[9].

Gjatë shekujve XV-XX tregtia në Prizren arrin një shkallë të lartë të zhvillimit dhe bëhet qendër tregtare dhe adminsitrative[10] gjë që ndikon në ndërtimin e një sërë aseteve të trashëgimisë

9 NIXHA & Partners, Urban Development Plan of Prizren 2004– 2013,
10 HASKUKA Esat, Analiza Historiko Gjeografike e Funksioneve Urbane të Prizrenit, [Historic Geographic Analysis of the Urban Functions of Prizren], Prizren: Kosova, 2004.

kulturore që klasifikohen në mesin e monumenteve me vlera të larta historiko-arkitektonike. Luftërat dhe dyndjet në qytet kanë ndikuar në formimin e karakterit të qytetit, por zhvillimi ekonomik ka pasur rolin kyç në formësimin e imazhit të saj. Gjatë kësaj kohe janë krijuar lagjet (mahallat) që karakterizohen me fizionominë e tyre të veçantë, rrjetin e rrugëve në formë organike, afërsinë e tyre me burime të ujit, prania e ujit në oborre formë të jazeve[11], sheshet dhe hapësirat publike, komplekset me rëndësi kulturore dhe historike dhe shumë ndërtesa religjioze dhe profane. Struktura e qytetit ndahej në dy njësi të mëdha organizative që sipas funksionit janë të ndryshme: zonat e banimit – MAHALLAT dhe ÇARSHITË[12]. Edhe pse njësitë organizative kanë humbur autenticitetin ato janë të pranishme edhe sot në kuadër të qendrës historike. Në vazhdim të tekstit do të elaborohen:

a) Çarshitë në kontekstin e zhvillimit historik dhe transformimet gjatë kohës
b) Mahallat në kontekstin e zhvillimit historik dhe transformimet gjatë kohës

a) Çarshitë në kontekstin e zhvillimit historik dhe transformimet gjatë kohës

Zhvillimi i lartë ekonomik, shoqëror dhe politik i qytetit të Prizrenit ka ndikuar në ndërtimin e shumë ndërtesave tregtare, gjegjësisht tregjeve *(çarshive) si trajtë specifike urbane* që janë zhvilluar në udhëkryqin e rrugëve të rëndësishmë të qytetit. Për funksion më cilësor ndërtesat tregtare janë ndërtuar në afërsi të burimeve të ujit, lumit dhe afër ndërtesave të rëndësishmë publike dhe kanë qenë të grupuara apo të vendosuara në mënyrë lineare. Kanë qenë në dy etazha, në përdhesë është zhvilluar aktiviteti tregtar, kurse kati ka shërbyer si punëtori apo hapësirë për pushim. Çarshia si tërësi arkitektonike është klasifikuar në dy tipe[13]:

Tipi 1 – përfshin çarshinë që zhvillohet në grup rreth objekteve fetare kryesisht dhe me formë të lirë organike e cila ka përfshirë Saraqhanën (2), Arastën (1) dhe Sinan Pashën (5). E përbashkëta e çarshivë ishte se kanë qenë të grupuara rreth xhamive jo të mbuluara por të hapura. Përjashtim kishte Arasta e cila ka qenë e mbuluar.

Saraqhana rrjedhë nga fjala arabe serxhun që do të thotë shalë[14]. Në këtë çarshi kryesisht kanë qenë SARAQËT që kanë përpunuar lëkurën e meshinin, breza dhe pajisje tjera për kuaj. Ka pasur KALLAJXHI që kanë punuar pajisjet shtëpiake, FARKATARË që kanë punuar veglat bujqësore, BRISKAXHI ku janë punuar thika, çekanë [15].

Arasta rrjedhë nga gjuha persiane që do të thotë e mbuluar dhe arsye kryesore pse ka qenë e mbuluar është të mbrohet nga reshjet atmosferike dhe njëkohësisht nga vjedhjet. Ajo ka përfshirë 41 shitore dhe për shkaqe sigurie në mbrëmje është mbyllur. Ka qenë çarshia më e pasur në Prizren dhe 2 herë është djegur dhe pas vitit 1913 zhduket[16]. Në këtë çarshi kryesisht është shitur porcelani, tekstili dhe ka pasur zejtarë si jorganxhi, pemëshiës, rrobaqepës, qebaptore etj.

Çarshia **Sinan Pasha** ka marrë emrin ngase ka qenë e vendosur rreth xhamisë së Sinan Pashës. Në këtë çarshi është hapur shitorja e parë fotografist por ka pasur edhe pemëshitës, shitës të tekstilit, librari dhe shitore për rregullimin e këpucëve.

11HASKUKA Esat, Analiza Historiko Gjeografike e Funksioneve Urbane të Prizrenit, [Historic Geographic Analysis of the Urban Functions of Prizren], Prizren: Kosova, 2004.
12NIKOLIC Serafin, Prizren od Srednjeg Veka do Savremenog Doba – Urbanisticko – Arhitektonski Razvoj, [Prizren from the Middle Ages to the Modern Period – urban architectural development], Prizren: Grafika, 1998
13Ibid
14 Haskuka Esat, Ura, Çarshia dhe Lagjja Arasta 1999
15 Muhamed Shukriu, Prizreni I lashtë
16 Haskuka Esat, Ura, Çarshia dhe Lagjja Arasta 1999

Tipi 2 – përfshin çarshinë që zhvillohet në vijën frontale të rrugës; Çarshia e Kovaçëve (4).

Çarshia e Kovaçëve ka qenë e vendosur përgjatë rrugës kryesore. Këtu kryesisht kanë qenë të koncentruar zejet që janë marrë me përpunimin e hekurit.

Fatëkeqësisht sot disa nga çarshitë e lartëpërmendura si ajo e Saraqëve, Arasta, një pjesë e Kujunxhillukut tërësisht janë të shkatërruara. Pjesa tjetër edhe pse nuk e ka të ruajtur autenticitetin (sidomos çarshia e Kovaçëve) haset në Qendrën Historike të Prizrenit. Në çarshinë e Kujunxhillukut ka kanë qenë të përqëndruar argjendarët dhe gërshërpunues, Çarshia e Tabakhanes kanë qenë të përqëndruar zdrukthtarët. Sa i përket autencititetit më së shumti origjinalitetin e ke ruajtur qendra e Shatërvanit ku aktivitetet tregtare zhvillohen në përdhesë dhe në kate. Mirëpo, mungesa e planeve detale – adekuate, rrethanat shoqëroro-politike kanë dhe vazhdojnë të rrezikojnë ruajtjen e vlerave dhe komoditetit vizuel që afron çarshia.

Harta 3 Pozita e çarshive gjatë shek.XVI-XVII

b) Mahallat në kontekstin e zhvillimit historik dhe transformimet gjatë kohës

Mahallat janë lagje / vendbanime që kanë përfshirë ndërtesat e banimit, xhamitë, shkollat, shitoret, krojet dhe sheshet e vogla. Ato janë krijuar në bazë të interesave të banorëve (që të jenë afër burimeve të ujit, krojeve, ndërtesave tregtare dhe religjioze), zhvillimit të rrjetit të rrugëve dhe cilësisë së lartë të tokës. Mahallat kanë qenë të ndryshme për nga madhësia dhe kanë pasur emërtime të caktuara.

Dallimet mes mahallave kanë ekzistuar dhe ekzistojnë edhe tani. Tek disa prania e ujit ka qenë evidente, disa kanë qenë në terren të pjerrët dhe shtëpitë e banimit janë përshtatur terrenit bashkë me rrjetin e rrugëve

Foto 10 Pamje e dikurshme e Nënkalasë

duke marrë formë organike. Një faktor tjetër që ka ndikuar ka qenë edhe statusi ekonomik i banorëve.

Në strukturën urbane ndikim të madh kanë pasur edhe jazet që kanë kaluar nëpër shtëpi për këtë arsye disa mahalla janë më të dendura dhe janë më afër burimit të ujit. Katër degë kryesore janë degëzuar nga Lumbardhi dhe janë shpërndarë në formë të kanaleve nëpër mahalla, duke depërtuar në formë të jazeve edhe në oborre të shtëpive. Fatkeqësisht jazet nuk janë ruajtur dhe sot hasen vetëm si struktura të ruajtura në oborre të shtëpive.

Mahallat zakonisht kanë pasur formë organike si rezultati zhvillimit të natyrshëm. Prania e lumit është edhe një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në zhvillimin urban të Prizrenit. Lumi ka ndikuar në përbërjen dhe funksionin e shumicës së ndërtesave rreth saj.

Foto 11 Pamje të mahallave në fillim të shekullit XX

Mahallat kanë qenë të emërtuara në bazë të ndërtesave arkitektonike ku ato ruajnë edhe sot emërtimet e tyre qoftë edhe në formë jozyrtare. Zhvillimi ekonomik dhe social ka ndikuar në ndërrimin e trendeve të jetesës që është reflektuar jo vetëm në ndërtim por edhe në transformim të strukturës urbane të mahallave.

Në mënyrë që të kuptohen më mirë mahallat në vazhdim do të përfshihet shembulli nga shekulli XIX. Mahallat më të njohura kanë qenë: Atik Mahalla, Suzi Çelebi Mahalla, Arasta Mahalla, Ilijaz Kuka Mahalla, Mehmet Pasha Mahalla, Çatib Sinan Mahalla, Kurilla Mahalla, Marash Mahalla, Myderiz Ali Efendi Mahalla, Sejdi Beg Mahalla, Sinan Pasha Mahalla, Nënkalaja[17].

Harta në vazhdim përfshin mahallat e shekullit XIX dhe kufirin e Qendrës Historike të Prizrenit dhe mund të vërehet se cilat nga mahallat janë brenda kufirit të QHP.

17NIKOLIC Serafin, Prizren od Srednjeg Veka do Savremenog Doba – Urbanisticko – Arhitektonski Razvoj, [Prizren from the Middle Ages to the Modern Period – urban architectural development], Prizren: Grafika, 1998



Harta 4 Mahallat në shekullin XIX

1.3.3. Struktura Urbane e Qendrës Historike duke u bazuar në ndarjen në zona sipas Planit te Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit

Prizreni është një ndër qytetet më të vjetra të Kosovës me një strukturë të jashtëzakonshme urbanistike-arkitektonike dhe me fond të pasur të trashëgimisë me vlera të larta të kulturës materiale e shpirtërore të krijuar me lindjen dhe shtresimin e vazhdueshëm nëpër shekuj. Gjurmët e kulturës materiale dëshmojnë se kjo trashëgimi zë gamën kohore që nga parahistoria, antika e mesjeta deri në historinë bashkëkohore dhe e bën Prizrenin qytet me frymë dhe arkitekturë të veçantë, të karakterizuar me gërshëtimin e kulturës vendase dhe ndikimet e kulturat që i sollën tregtarët dhe pushtuesit e ndryshëm.

Plani i Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit është aprovuar në vitin 2009 si Plan Rregullativ Urban. Ky plan bën ndarjen e Qendrës Historike në 8 njësi[18] dhe i quan zona. Zonat në kuadër të PKZHZHP janë: Zona e Tregut Tradicional (zona I), Zonën e Tregut Tradiciona (zona II), Zona e Bregut të Lumit (zona III), Banimi/Shfrytëzimi i Përzier (zona VI), Zona e Aksit Tregëtar (zona V), Banimi/Shfrytëzimi i Përzier (zona VI), Zona Organike e Banimit (VII) dhe Zona e Banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit (zona VIII)

Për analizë të mëtutjeshme në kapitullin e ardhshëm do të mirren për bazë ndarjet sipas Planit të Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit që është e paraqitur në hartën pasuese.

18 TOSKA Enes editor, Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren – Advantages and Challenges oflmplementation, Prishtina: CHëB, 2011

Harta 5 Ndarjet e zonave sipas Planit të Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit

Nëse analizojmë ndarjet dhe emërtimet e mahallave të shekullit XIX dhe ate të Planit të Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit atëherë vërehet se ekzistojnë dallime si në emërtim ashtu edhe në ndarje që është reflektim i zhvillimeve që ka pësuar qendra gjatë viteve. Harta në vazhdim përfshin dy shtresa; mahallat e shekullit XIX dhe ndarjet e zonave sipas Planit të Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit dhe jep pasqyrim se mahallat ku ndodhen sot dhe se cilës zonë i përkasin:

- Nënkalaja dhe Pantelija e cila ka qenë një ndër mahallat më të mëdha në Plan të Konzervimit është ndarë në dy pjesë njëra Nënkala dhe tjetra Zona Organike e Banimit (zona VII).
- Mahalla e Sinan Pashës dhe një pjesë e Sejdi Beg mahallës janë të përfshira në Zonën e Tregut Tradicional (zona I).
- Myderiz Ali Efendi Mahalla është e përfshirë në Zonën e Banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit (zona VIII).
- Një pjesë e Atik mahallës, Suzi Celebisë dhe Saraqhanës janë të përfshira në Zonën e Bregut të Lumit (zona III), ndërsa pjesa tjetër në Zonën e Banimit/Shfrytëzimit të Përzier (zona VI).
- Ilijaz Kuka mahalla dhe një pjesë e Mehmet Pasha mahallës janë përfshirë në Zonën e Aksit Tregtar (zona V).
- Saraqhana dhe Arasta janë të përfshira në Zonën e Tregut Tradiciona (zona II); dhe
- Mehmet Pasha mahalla Marash mahalla në Zonën e Banimit/Shfrytëzimit të Përzier (zona VI).



Harta 6 Kufiri dhe ndarjet e zonave sipas Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe mahallat e shekullit XIX

Emërtimet e njësive në Plan të Konzervimit janë shumë pak të njohura për qytetarë të Prizrenit prandaj propozohet që në të ardhmen gjatë hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të rishqyrtohen zonat që kanë karakteristika të përbashkëta, të kthehen edhe emërtimet që edhe sot e kësaj dite përdoren në jetë të përditshme nga banorët e kësaj zone. Me këtë veprim të pasuar edhe me veprime tjera të ndërhyrjeve fizike dhe urbane krijohen kushtet për rikthim të identitetit dhe përtrirjes së memories kolektive qytetare.
Në vazhdim mahallat dhe çarshitë do të trajtohen në kuadër të ndarjeve sipas Planit të Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit si në vijim:

1.1 Kalaja e Prizrenit
1.2 Nënkalaja (zona IV) – (Varosh Mahalla)
1.3 Zona Organike e Banimit (VII) – (Pantelia)
1.4 Zona e Banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit (zona VIII) – (Papas Çarshia)
1.5 Zona e Tregut Tradicional (zona I) – (Çarshia e Shatërvanit, Kujumxhilluk dhe Sinan Pasha)
1.6 Zona e Bregut të Lumit (zona III) – (Keji)
1.7 Suzi Çelebi dhe Tabakhane
1.8 Banimi/Shfrytëzimi i Përzier (zona VI) – (Atik Mahalla)
1.9 Zonën e Tregut Tradiciona (zona II) – (Saraqhana)
1.10 Zonën e Tregut Tradiciona (zona II) – (Arasta Mahalla)
1.11 Zona e Aksit Tregëtar (zona V) – (Çarshia e Kovaqëve)
1.12 Banimi/Shfrytëzimi i Përzier (zona VI) – (Ralin Mahalla)

1. Kalaja e Prizrenit

Kalaja shtrihet në lindje të Qendrës Historike të Prizrenit, e vendosur mbi një kodër në formë konike, në pikën më të lartë të qendrës së qytyetit. Pozicioni i saj topografik, dominues mbi qytetin, peisazhi natyror mjaft tërheqës dhe konfigurimi arkitektonik i menduar mjaft mirë, e bëjnë këtë lokalitet me vlera të padiskutueshme ambientale, shkencore, historike dhe ekonomike. Kalaja trajtohet me PZHU 2003-2013 në kuadër të komplekseve të veçanta me vlera të rëndësishme kulturore. Plani propozon valoriziminin e kompleseve dhe monumenteve brenda si dhe hartimin e planeve detaje/rregullative për këto komplekse.

Harta 7 Kalaja e Prizrenit

Plani i Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit nuk trajton Zonën e Kalasë pasi që është jashtë kufirit të zonës së përkufizuar në këtë plan. Ligji NR. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit sipas Nenit 7 për Zonën e Kalasë i ndalon të gjitha veprimtaritë ndërtimore dhe të infrastrukturës, përveç atyre që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konservimin, restaurimin, rekonstruimin/ rindërtimin dhe menaxhimin e kësaj zone.

Nga CHëB është hartuar projekti në mënyrë që ky lokalitet të ketë një përmbajte të përzier në aspektin e mundësive të shfrytëzimit në kuptimin që pjesa e qytetit të epërm të shndërrohet në një mjedis ku kishin me u organizu ngjarje të ndryshme kulturore. Është shfrytëzuar konfiguracioni i terrenit për me kriju një amfiteatër fleksibil, i cili do të mundëson shfaqjen e performancave të ndryshme, si koncerte, filma e çkado tjetër. Është punuar në infrastrukturë; është ndërtuar kthina sanitare për vizitorë. Gjithashtu, një element shumë i rëndësishëm që projekti adreson është edhe çasja për të gjithë; çasja edhe për njerëz me nevoja të veçanta[19].

Shenjëzimi si element i rëndësishëm duhet të jetë prezent sipas standardave botërore dhe njëkohësisht i unifikuar në të gjitha zonat tjera.



Foto 12 Fotografia historike e Kalasë së Prızrenit

19 HALITI Senat, CHëB, https://xk.usembassy.gov/sq/kalaja-e-prizrenit/

2. Nënkalaja (zona IV) - Varosh Mahalla

Shtrihet në pjesën lindore të Qendrës Historike dhe me formën e saj organike, ndërtimit amfiteatral me ndërtesa të banimit të dukshme kudo në e qytet. Me elemente të theksuara të banimit ka ofruar pamje të veçantë qytetit e cila fatëkeqësisht është humb autencititeti. Forma e saj amfiteatrale ka siguar që secila shtëpi të ketë pamje nga qyteti, dritë dhe insolim të mjaftueshëm[20] Respekti i ndërsjelltë fqinjësor jo vetëm në këtë zonë por në tërë qytetin, ka dëshmuar për etikë të lartë të ndërtimit.

Pas luftës së fundit (1999) dhe trazirave të Marsit 2004 zona e Nënkalasë është dëmtuar. Me këtë rast Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me orgnaizatat ndërkombëtare formuan Komisionin për Rindërtim dhe Zbatim (KIR)) që kishte për detyrë të vlerësoj dhe më pas edhe të sanojë dëmtimet e shkaktuara.

Në vitin 2005, Komisioni për Rindërtim dhe Zbatim (KIR) vlerëson dëmet dhe zbaton projekte të rindërtimit për monumente dhe struktura të banimit të dëmtuara. Zona e Nënkalasë së bashku me Pantelinë dhe Potokmahallën janë komplekse të cilët gjenden në Listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme.

Nënkalaja si zonë ende mban në vehte gjurmët e lashtësisë por intevenimet e bëra gjatë kohës nuk kanë qenë në pajtim me kriteret që dalin nga PZHU dhe Plani Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit gjë që ka ndikuar në zbehjen e lashtësisë së saj. Plani i Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit jep katër kritere që janë bazë për mbrojtjen e imazhit të zonës: karakteristikat e vëllimit, karakteristikat e fasadave, karakteristikat e detaleve dhe ornamenteve dhe karakteristikat e pamjes së rrugës ku secili kriter përmban parametra që duhet të respektohen gjatë intervenimeve të ndryshme. Nëse zona e Nënkalasë analizohet në aspektin e përmbushjes së kritereve si: marrëdhënja në mes të ndërtesave, raporti mes hapësirave të ndërtuara dhe të lira që nuk duhet të tejkalojë 50% shfrytëzueshmëri të parcelës, lartësinë që nuk duhet të tejkalojë 1 deri 2 kate, kulmet dy apo katër ujorë, materialet e fasadës që parashihen të jenë nga çerpiçi dhe dritaret dhe dyert nga druri, përdorimi i ngjyrave të zbehta, rruga me kalldërëm, prania e gjlbërimit në zonë shihet që respektimi i kritereve nuk është në nivel të kënaqshëm. Prania e ndërtesa në kundërshtim me kriterët e lartëpërmenduar ka ndikuar në shkatërrim të strukturës urbane e cila kontribon në mënyrë negative në imazhin e zonës.

Lëvizshmëria dhe çasja e lehtë në objekte është një tjetër element i rëndësishëm që ndikon në cilësinë e jetës. Prania e modelit organik të rrugëve është ende evidente. Në disa pjesë të zonës çasja është e vështirësuar. Për këtë arsye shtrimi i të gjitha rrugëve brenda zonës është i domosdoshëm duke mos injoruar edhe ndriçimin që duhet të jetë në harmoni me arkitekturën e zonës. Në zonë hasen disa lloje të shenjëzimeve që nuk janë të unifikuara gjë që është një tjetër element që nuk kontribon pozitivisht në imazhin e saj.

20 NIKOLIC Serafin, Prizren od Srednjeg Veka do Savremenog Doba – Urbanisticko – Arhitektonski Razvoj, [Prizren from the Middle Ages to the Modern Period – urban architectural development], Prizren: Grafika, 1998



Foto 13 Fotografia historike e Nënkalasë datuar nga gjysma e shekullit XX

3. Zona Organike e Banimit (zona VII) - Pantelia

Shtrihet në pjesën jug-lindore të Qendrës Historike dhe është vazhdimi i Nënkalasë me karakteristikë të terrenit të pjerrët dhe banimit të dendur. Ndërtesat kryesisht janë në dy dhe tre etazha dhe nuk shquhen me ndonjë arkitekturë të mirëfilltë. Terreni i pjerrët i cili ka mundësuar që secila shtëpi të ketë dritë të mjaftueshme tani është vlerë e humbur për shkak të ndërtimeve të larta jo të kontrolluara. Mund të konsiderohet se kjo zonë aspak nuk e ka të ruajtur strukturën e vjetër urbane edhe më pak aspektin e jetesës në komunitet.

Harta 9 Zona Organike e Banimit – Pantelia

Foto 14 Fatografia historike me pamje të Pantelisë

Zona Organike e Banimit si kompleks gjendet në Listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme.

Sipas Planit të Konzervimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit përcaktohen kriteret për vëllim, madhësinë e ndërtesave që nuk duhet të tejkalojnë 50% të parcelës, etazhitetin maksimal në 2 kate, kulmet dy ose katër ujore, dyert dhe dritaret të jetë me dimesione të hapjeve tradicionale, gjelbërimi të jetë i pranishëm dhe të përdoret ngjyra e bardhë dhe të zbehta. PKZHZH propozon ruajtjen e modelit tradicional dhe përdorimin e kalldërëmit me gurë natyror dhe për raste urgjente duhet të parashikohet rregullimi i rrugëve shërbyese. Situata e tanishme nuk është në përputhje me kritere të lartëpërmendura. Sot në këtë zonë apo Panateli proporcioni ndërtesë-oborrë është i madh dhe nuk jep hapësirë për krijimin e oborreve të brendshme me prani të gjelbrimit, etazhiteti është më i lartë dhe i ndryshueshëm, elementet dhe materialet të fasadës nuk janë në harmoni me arkitekturën tradicionale dhe si rezultat kemi një pamje jo konsistente e cila reflektohet në imazh dhe në strukturë. Modeli organik i rrugëve është i ruajtur në përjashtim të materiali i përdorur ku në disa vende hasen kubëza betoni e në disa gurë. Nëse merren parasysh kriteret që duhet të zbatoheshin gjatë zhvillimeve të ndryshmë atëherë shihet qartë se në realitet kemi një situatë ndryshe, një imazh dhe siluetë që është larg asaj që ka qenë në të kaluarën. Situata e tanishme nuk kontribon në ruajtjen e origjinalitetit dhe vlerës ambientale të zonës. Në pjesët ku pjerrtësia e terrenit është e madhe është e dobishme parashikimi i përdorimit të shkallëve në mënyrë që të lehtësohet lëvizshmëria. Në këtë zonë nuk është përdorur shenjëzimi. Ndriçimi ka hapësirë të përmirësohet dhe të jetë në harmoni me arkitekturë tradicionale.

Foto 15. Pamje e tanishme Zona Organike e Banimit - Pantelia

4. Zona e Banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit (zona VIII)Papas Çarshia

Shtrihet në pjesën jug-perëndimore të qendrës dhe lidhet me Panteli dhe vazhdon kah qendra deri në kufi të bregut të lumit. Në vehte përfshin një numër të madhë të ndërtesave me lartësi dhe etazhitet të ndryshëm duke filluar prej njëkatësheve deri tek katërkatëshet.

Si zonë nuk shquhet me arkitekturë të mirëfilltë dhe me strukturë të dikurshme urbane. Sipas kritereve bazë që i përcakton PKZHZH objektet duhet të jenë të lidhura me dhe dyqane në përdhesë, shfrytëzueshmëria e parcelës nuk duhet të tejkalojë 60%, lartësia 2 deri në 3 kate,

Harta 10 Zona e Banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit / Papas Çarshia

nuk lejohen kopshtet nga ana e përparme të objektit, hapjet duhet të jenë sipas dimensioneve tradicionale, dritaret nga druri, kulmet dy apo katër ujorë, ngyra e bardhë dhe të zbehta të përdoren, nga materialet asfalti të përdoret për rrugë ndërsa gurë për trotuare. Si rezultat i mos zbatimi i këtyre kritereve të lartëpërmendura është krijuar një situatë kaotike. Në siluetën e zonës dominon Kisha Katolike ku vizurat janë të ndërprera për shkak të etazhitetit të ndërtesave. Imazhi i cili krijohet nuk ofron kënaqësi vizuele për shkak të laraminisë si në hapje, materiale të fasadës, lartësi të objekteve, ngjyra dhe në material të përdorur për trotuare. Në rrugët që përdoren nga automjetet identifikohet edhe problemi i sigurisë së këmbësorëve për të

cilën edhe PKZHZH ka propozuar sigurimin e tyre. Për shkak të dendësisë së madhe të zonës vërehet mungesa e hapësirave gjalbëruese. Edhe pse zona përfshin disa ndërtesa të rëndësishmë ajo që mungon është shënjëzimi dhe informimi i mirëfilltë.

Foto 15 Qafa e Kishës, para dhe pas

Foto 16 Pamje e Xhamisë së Ilijas Kukla dhe mahallës para dhe pas

5. Zona e Tregut Tradicional (zona I) - Çarshia e Shatërvanit, Kujumxhilluk dhe Sinan Pasha

Kufizohet me zonën e Nënkalasë dhe Papas Çarshinë në jug dhe me bregun e Lumbardhit në veri. Zona që e përbën bërthamën e sotme të qytetit të Prizrenit përfshin kroin e Shadërvanit, prej nga e merr emrin sheshi dhe shton famën qytetit. Përreth dhe në pjesët anësorë gjenden një varg objektesh me vlera të larta trashëgimore. Këtë çarshi e bën të veçantë renditja e objekteve në formë organike rreth Shadërvanit.

Harta 11 Zona e Tregut Tradicional/Çarshia e Shatërvanit, Kujumxhilluk dhe Sinan Pasha

Rrjeti i rrugëve me njësi të vogla të dyqaneve të koncentruara sipas llojit të zejeve përbën një aglomeracion të jashtëzakonshëm arkitektoniko-urbanistik. Deri vonë ka qenë qendër

ekonomike e tërë qytetit, ndërsa sot është pikë e rëndësishmë me mundësi të mirë ekonomike dhe turistike.

Elementet përbërëse të imazhit të zonës si vëllimet origjinale, lartësitë e objekteve nuk janë të ruajtura tërësisht por nëse krahasohet me zonat tjera brenda Qendrës Historike, Zona e Tregut Tradicional është zonë që ofron më tepër komoditet vizuel. Të dy planet, PZHU edhe PKZHZHP propozojnë që zona duhet të ruhet dhe të bëhet ringjallja e zejeve tradicionale dhe të bëhet integrimi i veprimtarive të reja si faktorë shtytës për gjallërim të jetesës në këtë zonë. Edhe pse PKZHZHP parasheh që zona të jetë për këmbësorë ende është prezent qarkullimi i automjeteve dhe parkimi jashtë orarit të lejuar. Shenjëzimet që janë te vendosura në këtë zonë në disa raste paraqesin pengesë për vizura. Përdorimi i kubëzave nga graniti në sheshin Shatërvan dhe llojeve tjera në disa hapësira dhe në trotuare është një tjetër dukuri që haset dhe duhet të adresohet dhe harmonizohet me kritere që dalin nga PKZHZHP.

Element jo më pak i rëndësishëm është mobileria urbane dhe ndriçimi i cili haset në disa lloje. PKZHZHP parasheh që te gjitha elementet që përbëjnë imazhin të jenë në harmoni me arkitekturën tradicionale të Prizrenit. Zona ofron mumndësinë e shtimit të hapësirave të gjelbërimit që mund të shfrytëzohen nga ana e qytetarëve dhe vizitorëve.

Foto 18 Sheshi Shatërvan para dhe pas

6. Zona e Bregut të Lumit (zona III) - Keji

Shtrihet në pjesën qendrore të Qendrës Historike. Karakteristikë e saj është se ndahet përgjatë aksit lindje – perëndim nga lumi Lumbardh dhe rruga ku krijohen dy pjesë njëra anë me ndërtesa kolektive me 4 etazha ndërsa tjetra me ndërtesa të banimit të ulët. Pozita e saj lidhëse ka ndikuar që në përdhesë të objekteve të zhvillohen aktivitetet komerciale në të dy anët e lumit.

Harta 12 Zona e Bregut të Lumit - Keji

Kjo zonë me praninë e Lumëbardhit, të urave në distanca të logjikshme që bashkojnë dy brigjet paraqet një trashëgimi të jashtëzakonshme natyrore dhe ambientale dhe ofrojë mundësi që kjo hapësirë me intervenime të mbrohet dhe me prezentim të mirëfilltë të jetë atraksion për vizitorë. Mirëpo, në pjesën e djathtë të kufizuar me lumin paraqitet një siluetë dinamike që nuk reflektorën arkitekturën tradicionale. Dy planet, PZHU dhe PKZHZHPZ përcaktojnë kriteret për mbrojtje ndërsa ajo që shihet është rezultat i një zhvillimi të pakontrolluar. Përdorimi i materialeve, ngjyrave që janë në kundërshtim me kriteret nga PKZHZHP kanë rezultuar me një zonë që nuk pasqyron vlera ambientale dhe si imazh nuk ofron kënaqësi vizuele. Shtimi i hapësirave gjelbëruese do të shtonte cilësinë e jetës së qytetarëve. Ndriçimit dhe shenjëzimi janë dy elemente që duhet të jenë prezente dhe të përgjigjen kritereve të kërkuara. Shtimi i mobilerisë urbane do të ofronte mundësi që hapësirat e lira të përdoren për socializim të qytetarëve.



Foto 19 Ura e Gurit, para dhe pas

7. Suzi Çelebi Mahalla dhe Tabakhane

Suzi Çelebi Mahalla dhe kompleksi i Tabakhanës gjenden në perëndim të Qendrës Historike të Prizrenit. Tabakhana shtrihet në bregun verior të të Lumbardhit në mes të Xhamisë së Ahmed-Beut, Xhamisë së Suziut dhe ndërtesës së Beledijes. Lagjja e Tabakhanës ka marrë këtë emër pasi që aty bëhej përpunimi i lëkurës me të gjitha proceset përkatëse: larja, tharja, ngjyrosja etj.

Harta 13 Suzi Çelebi Mahalla dhe Tabakhane

Pas vërshimeve të vitit 1979, Tabakhana pothuajse tërësisht u shkatërrua dhe humbi pamjen e vet karakteristike, kështu që tani kanë mbetur vetëm mulliri dhe depoja e lëkurës. Tabakhana në PZHU trajtohet në zonën e dytë të mbrojtjes ku propozohet integrimi i zonës në rrjedha bashkëkohore duke respektuar dhe rivendosur vlerën urb-arkitektonike dhe ambientale të Tabakhanës. PKZHZHP nuk e trajton pasi që është jashtë kufirit të përcaktuar. Megjithatë Tabakhana me ligjin nr. 04L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit përfshihet brenda kufirit mbrojtës. Edhe pse jo e dukshme prania e lumit Lumëbardhë si element natyror që e ndan në

dysh zonën shton vlerën natyrore dhe ambientale. Përmes metodave bashkëkohore të planifikimit integrimi i lumit brenda zonës do të përmirësontë imazhin e qytetit. Në disa pjesë ofrohet mundësia e shtimit të hapësirave gjelbëruese që mund të shëndrohen në vende për socializim të rinjëve. Përdorimi i duhur i ndriçimit, mobilerisë së duhur urbane, ngjyrave në harmoni me arkitekturën tradicionale janë kushte që shtojn edhe më tepër vlerën ambientale të zonës.

Foto 20 Pamje nga vërshimët e vitit 1979

8. Banimi/Shfrytëzimi i Përzier (zona VI) - Atik Mahalla

Shtrihet në pjesën veri-perëndimore të Qendrës Historike dhe ngërthen në vete një numër të madhë të ndërtesave të banimit. Kjo zonë e dendur inkorporon në vehte monumente dhe një numër të vogël të objekteve që kanë ruajtur vlerat e tyre. Zhvillimet e pakontrolluara kanë ngulfatjen një sërë ndërtesa me vlera të larta të trashëgimisë kulturore.

Harta 14 Banimi/Shfrytëzimi i Përzier - Atik Mahalla

Edhe pse PKZHZHP përcakton kritere të qarta për zhvillime ku shfrytëzueshmëria nuk duhet të tejkalojë 60%, maksimumi i lartësisë duhet të jetë 3 etazha, hapjet duhet të jenë në përputhje me arkitekturën tradicionele, dritaret nga druri, të përdoret ngjyra e bardhë ose ngjyra të zbehta vërehet se shumë pak është respektuar nga këto kritere. Zhvillimet në kundërshtim me kritere të lartëcekura kanë krijuar një imazh që nuk ofron komoditet vizuel. Rrugët e ngushta, trotuaret e ngarkuara me automjete të parkuara, rrjeti mbitokësor elektrik edhe më tëpër humb vlerën ambientale të zonës. Pasi që rrugët brenda zonës qarkullohen nga automjetet, siguria e këmbësorëve është thelbësore dhe rregullimi i qarkullimit është çështje që duhet të konsiderohet në të ardhmen. Prezenca e hapësirave gjelbëruese është pothuajse jo e pranishme. Aplikimi i metodave bashkëkohore të planifikimit sikurse regjenerimi do të ofronte mundësi që sado pak të përmirësohet imazhi i zonës.

Foto 21 Atik Mahalla, para dhe pas

9. Zona e Tregut Tradiciona (zona II) - Saraqhana

Shtrihet në pjesën qendrore të Qendrës Historike, në lindje të Banimi/Shfrytëzimi i Përzier (zona VI). Në këtë zonë dominojnë Xhamia e Saraçhanes dhe Kompleksi i Teqes Halveti. Gjatë zhvillimeve të ndryshme zona ka pësuar transformime të cilët kanë ndikuar në ndryshimin e funksionit dhe strukturës urbane

Harta 15
Zonën e Tregut Tradiciona / Saraqhana

Përkundër faktit që PZHU dhe PZHKHZP propozojnë ruajtjen dhe prezentimin e vlerave urb-arkitektonike kjo zonë shumë pak e ka ruajtur origjinalitetin. Pas vitit 1999 zona ka qenë e ngulfatur me automjete dhe ka shërbyer si vendparkim. Ringjallja e zejeve, bizneseve ka qenë e pamundur për shkak të mungesës së qarkullim nga ana e njerëzve.
Përmes hulumtimeve nga UN-Habitat janë identifikuar problemet. Duke pasur parasysh situatën e zonës me një bashkëpunim mes KK Prizrenit dhe UN-Habitat'it është vendosur që të përmirësohet gjendja në këtë zonë. Aplikimi i procesi pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës në metodologjinë e punës ka rezultuar me dhënjen e "pronësisë" qytetarëve të Prizrenit. Me rikthimin e disa elementeve urbane është ri-kthyer gjallëria e humbur në rrugën e

"Farkëtarëve". Ky projekt mund të shërbejë si model ku një rrugë automobilistike shëndrohet në ate për këmbësorë, ndërsa rruga tjetër ka qarkullim me shpejtësi të kufizuar. Me ndriçim të përmirësuar, rrjet elektrik nëntokësor, materiale të përdorura për rrugë kemi një imazh më të avancuar. Përdorimi i shenjëzimit jo të mirëfilltë, sikur tek të gjitha zonat edhe në këtë zonë mbetet sfidë që duhet të adresohet.

Foto 22 Rruga e Farkatarëve, para dhe pas

10. Zona e Tregut Tradiciona (zona II) - Arasta Mahalla

Shtrihet në pjesën veri-lindore të Qendrës Historike, që përveq minares së xhamisë tërësisht e ka të humbur autencititetin. Sot kjo mahallë ngërthen në vehte ndërtesa të larta të ndërtuara në pjesën e dytë të shek. XX që dominojnë në siluetën e qendrës dhe ndërprejnë vizurat nga pjesët e ndryshme të qytetit. Zona përfshin edhe sheshin ku zhvillohen aktivitetet komerciale dhe gjetjen arkeologjike për të cilën ende nuk është finalizuar hulumtimi.



Harta 16 Zona e Tregut Tradiciona - Arasta Mahalla

Edhe pse gjetja arkeologjike është resurs që mund të shfrytëzohet për atraksion turistik, ajo është e ekspozuar shkatërrimit nga kushtet atmosfirike edhe faktorit njeri. Për mbijetimin e saj mbrojtja e përshtatshme, menaxhimi i mirëfilltë është i domosdoshëm. Prania e lumit Lumbardh dhe pozita e saj ndërlidhëse me zonat tjera si ajo e Shadërvanit dhe zonës së

Marashit e shton edhe më tepër vlerën ambientale dhe natyrore. Për të ri-ngjallur më tepër këtë zonë është implementuar projekti i sheshit "Lidhje e Prizrenit" ku rruga për qarkullim të automjeteve është transformuar në zonë të këmbësorëve.

Imazhi i zonës gërshetohen periudha të ndryshme historike të cilët kanë lënë gjurmë në strukturë urbane duke filluar nga gjetja arkeologjike, minarja e xhamisë Arasta nga periudha Osmane, dhe ndërtesat e periudhës socialiste.



Foto 23 Arasta Mahalla, para dhe pas

11. Zona e Aksit Tregëtar (zona V) – Çarshia e Kovaqëve

Shtrihet në pjesën veriore të Qendrës Hıstorike dhe përfshin tërësinë e ndërtesave të natyrës komerciale nga të dy anët e rrugës kryesore (që lidhë qendrën me pjesët veriore të qytetit dhe kyçjen me autostradë). Në këto ndërtesa dykatëshe zhvillohen aktivitetet tregtare.

Harta 17Zona e Aksit Tregëtar – Çarshia e Kovaqëve

Zona gjatë viteve ka përjetuar transformime të dukshmë si në etazhitet, materiale që kanë ndikuar në strukturë e saj dhe imazhin e përgjithshëm. Përkundër faktit që PKZHZHP përcakton kritere të sakta që duhet të aplikohen gjatë ndërtimeve situata e tanishmë dëshmon për një situatë që është në kundërshtim me propozimet që dalin nga planet. Në kuadër të imazhit kemi praninë e llojllojshmërisë së elementeve në fasada që dëshmojnë për një zhvillim të pankontrolluar.

Zona ndahet në dysh nga rruga kryesore e qarkulluar nga automjetet e cila zvogëlon sigurinë e këmbësorëve. Përgjatë zonës kemi edhe praninë e parkingjeve ilegale që është një dukuri negative që duhet të adresohet.

Foto 25 Pajme nga Çarshia e Kovaqëve

12. Banimi/Shfrytëzimi i Përzier (zona VI) - Ralin Mahalla

Shtrihet në pjesën veri - lindore në vazhdimësi të zonës Arasta dhe është e ndarë në dy pjesë; pjesa përgjatë lumit që ndryshe quhet edhe Marashi që lidhet me hapësirën rekreative dhe ajo përgjatë rrugës që kufizohet me Zonën e Aksit Tregtar. Pjesa përgjatë rrugës përfshin një numër të madhë të objekteve të reja; dy dhe trekate me elemente të ndryshme të fasadës dhe lartësi të ndryshme.

Harta 18 Banimi/Shfrytëzimi i Përzier/ Ralin Mahalla

Prania e lumit Lumbardh shton freski në zonë dhe njëkohësisht bën ndërlidhjen e vlerave ambientale dhe natyrore. Modeli i rrugëve të ngushta është ruajtur mirëpo morfologjia urbane gjatë zhvillimeve ka përsuar ndryshime. Niveli i rrugës kryesore ka qenë në kotë të njëjtë me ate të lumit mirëpo gjatë ndërtimit të rrugës për Tetovë ky nivel ngritet gjë që ka ndikon në ndryshimin e imazhit të zonës. Prania e numrit të vogël të ndërtesave me vlera nuk kontribojnë shumë në strukturë urbane ngase tani mungojnë jazet që kanë kaluar nëpër oborre të shtëpive, mungon edhe prania e gjelbërimit të dikurshëm. Nëse rishiqohen kriteret e përcaktuara në KZHZHP për lartësi maksimale deri në tre etazha, shfrytëzueshmëri deri 60% për ndërtim, materialë të dritareve nga druri dhe me fomë tradicionale dhe krahasojmë situatën ekzistuese në zonë mund të vijmë në përfundim që kemi zhvillim të pakontrolluar por megjithate kemi një situatë më të mirë në krahasim me zona tjera.

Qarkullimi i automjeteve në rrugica, trotuaret e ngushta dhe të uzurpuara me automjete e vështirsojnë lëvizshmërinë e këmbësorëve dhe njëkohësisht siguria e tyre nuk është në nivelin e kënaqshëm. Ndriçimi ekzistues ka hapësirë për përmirësim në mënyrë që të përshtatet me arkitekturën e zonës. Prania e shenjëzimit jo të unifikuar tek ndërtesat me vlerë krijojnë një tërësi që nuk ofron shumë komoditet vizuel.

Si në zona tjera edhe në këtë zonë duhet të mbrohen dhe prezentohen vlerat kulturore, historike dhe natyrore si dhe integrimi i tyre në të gjitha strategjitë zhvillimore që avancojnë zhvillimin e turizmit dhe ate ekonomik.

Foto 26 Ralin Mahalla,para dhe pas

Konkluzion

Faktet që janë përmendur në këtë kapitull bëjnë të kuptojmë se Prizreni si një qytet i lashtë me zhvillim shumë shekullor bën pjesë në mesin e qyteteve me prani të lumit Lumbardh i cili përbën vlerën e saj natyrore. Në të dy anët e lumit janë të shpërndara struktura urbanistike dhe arkitektonike që formojnë imazhin e qytetit. Në siluetën e qytetit dominon Kalaja e vjetër që fatëkeqësisht sot nuk mund të shihet nga të gjitha anët për shkak të ndërprerjes së vizurave nga ndërtimet e larta.
Mund të konkludojmë që gjatë zhvillimeve të ndryshme Qendra Historike e Prizrenit është transformuar dhe ka humbur vlerën e saj të dikurshme. Si pjesë përbërëse e struktures urbane kanë ekzistuar shtëpitë e banimit me oborre të rrethuara dhe kopshte të pasura me gjelbërim dhe me prani te ujit-jazit që sot nuk mund të hasen. Në pjesët me terrene të pjerrta shtëpitë janë vendosur në mënyrë "amfiteatrale" por me tendencë që të mundësohet e drejta për vizura dhe insolim të mjaftueshëm. Për shkak të ndërtimeve të larta dhe të pakontrolluara në shumë zona kjo vlerë është tani më e humbur.
Qendra Historike edhe sot përfshin zona me formë organike (kanë qenë të fomuara në mënyrë të natyrshme) që kufizohen me rrugë të ngushta mirëpo struktura morfologjike ka pësuar transformime të dukshme me vendosjen e banesave të larta, hotelit Theranda, ndërrimit të lartësive tek ndërtesat, përdorimi jo adekuat i materialeve për shtruarjen e rrugëve, shënjëzimit jo adekuat, ndriçimi jo i unifikuar, humbja e hapësirave gjelbëruese, artit jo adekuat publik, memorjaleve etj. Përkundër veprimeve që nuk kanë qenë në harmoni me karakterin urbanistik dhe arkitektonik për të cilën është çmuar Prizreni dhe me kriteret e përcaktuara me PZHU, PKZHZHP dhe ligjet ekzistuese megjithatë ende ekziston mundësia e përmirësimit të imazhit. Aplikimi i metodave bashkëkohorë të planifikimit si Regjenerimi Urban mund të kontribojë në shtimin e vlerës ambientale dhe përmirësimin e imazhit. Duke pasur parasysh faktin që zonat janë të ngarkuara nga automjetet gjë që vështirëson lëvizshmërinë propozohet në të ardhmen që të bëhet rregullimi i qarkullimit të automjeteve. Në mënyrë që të shtohet siguria e këmbësorëve duhet të ri-shqyrtohet mundësia e shëndërrimit të rrugëve automobilistike në rrugë për këmbësorë dhe çiklistë (mbylljen e rrugëve për automjete parasheh edhe PKZHZHP). Mobileria e duhur urbane, shenjëzimi i unifikuar dhe sipas standardeve, ndriçimi në harmoni me arkitekturën tradicionale janë faktorë që do të kontribojnë në përmirësim të imazhit. Pasi që mbrojtja e trashëgimisë kulturore në kuadër të konceptit të qytetit është një ndër elementet fundamentale ky plan do të propozojë veprime që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit në mënyrë që të shërbejë si aset për zhvillimin e turizmit dhe atij ekonomik.

1.4

Palët e interesit dhe gjithpërfshierja në process



1.4 PALËT E INTERESIT DHE GJITHPËRFSHIERJA NË PROCESS

Njëra prej detyrave të para të ekipit përgjegjës për hartim të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit ka qenë identifikimi i palëve të interesit dhe pjesëmarrësve të tyre me të cilët do të punohet së bashku nëpër fazat e ndryshme të procesit. Ky aktivitet ka kërkuar një përfshirje të një numri të madh individësh, institucionesh e organizatash nga palët e ndryshme të interesit që lidhen direkt apo indirekt me Qendrën Historike të Prizrenit.

Analiza e pjesëmarrësve është bërë sipas fushave tematike dhe ka qenë proces dinamik i cili ka ndihmuar në identifikimin e legjitimitetit, interesit dhe rolit të secilit pjesëmarrës në proces të hartimit të këtij plani. Kujdes i posaçëm është dhënë involvimit të grupeve të ndjeshme si ato të grave/vajzave, të moshuarve, komuniteteve pakicë dhe atyre me nevoja të veçanta.

Involvimi i palëve në proces ka kërkuar edhe përmbushjen e disa kritereve të rëndësishme si në vijim:

- *Partneriteti;* duke përdorur qasjen e partneritetit pjesëmarrësit që duhet të punojnë së bashku
- *Udhëheqjes;* në mënyrë që të tejkalohen sfidat dhe të sigurohet rezultati në punë pjesëmarrësit duhet të kenë aftësi udhëheqëse
- *Vazhdimësia;* është thelbësore tek partneriteti dhe udhëheqja në mënyrë që të sigurohet strategjia afatgjate
- *Ndarja e vizionit;* vizioni duhet të ndahet dhe të dakordohet nga një grup më i gjerë i pjesëmarrësve
- *Implementimi i veprimeve;* pjesëmarrësit duhet të sigurojnë zbatimin e veprimeve që do të dalin nga ky plan.

Në mënyrë që procesi i hartimit të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit të jetë sa më gjithëpërfshirës janë identifikuar një numër i madhë i palëve të intëresit. Tabela vijuese përfshin palët e interesit dhe rolin i tyre në intitucione/organizata.

Foto 1. Pamje nga takimet konsultative me grupe të ndryshme të interesit

1. PALËT E IDENTIFIKUARA TË INTERESIT PËR PROCES TË PMQHP

Palët e interesit	Roli dhe mandati
NIVELI QENDROR	
Minisitria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Institucion qendror që merret me hartimin e politikave dhe strategjive për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Institucion qendror për ruajtjen dhe menaxhimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës.
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren	Institucion vartës i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe përgjegjëse për ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Komunën dhe regjionin e Prizrenit.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Mandati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor është përcaktuar me rregulloret e UNMIK-ut Nr. 2002/5 dhe 2005/15. Në kuadër të këtyre rregulloreve përgjegjësitë kanë të bëjnë me krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm në fushën e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit e Banimit[1]. MMPH është edhe inicuese e Ligjit të Qendrës Histrike të Prizrenit të aprovuar në vitin 2012.
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	MASHT është krijuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 (të ndryshuar me Rregulloren Nr. 2005/15 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë) për kryerjen e funksioneve në fushën e arsimit dhe shkencës. Sipas këtyre rregulloreve, MASHT është përgjegjës për: - Politikat dhe legjislacionin e arsimit në përgjithësi, përfshirë arsimin e lartë dhe mësimin gjatë jetës, - Hulumtimin dhe zhvillimin, - Bibliotekat[2]
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Institucion përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore për tregtinë e Kosovës me qëllim të përmirësimit të tregtisë aktuale, alokimit të tregjeve të reja, lidhjes së Marrëveshjeve tregtare me BE, dhe vendet e treta, nëpërmjet sigurimit të funksionimit të një tregu të lirë e çdo herë duke evituar sjelljen dëmtuese të tregut nga ana e kompanive të

[1] https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Ministria_e_Mjedisit_dhe_Planifikimit_Hapsinor_e_Kosov%C3%ABs

[2] https://map.rks-gov.net/getattachment/11b68209-82c1-467d-82e1-8ecf2aa4fe73/Ministria-e-Arsimit,-Shkences-dhe-Teknologjise.aspx

	ndryshme që vinë nga vendet e treta. Në kuadër të kësaj Ministrie vepron edhe Departamenti i Industrisë / Divizioni i Turizmit.
Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore – KKTK është agjenci e pavarur e themeluar në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. KKTK ka në mandat vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme si dhe detyra të tjera në përputhje me Ligjin për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88, Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr. 03/L-039, Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit Nr. 04/L-066, aktet e veta nënligjore dhe aktet e tjera në fuqi.
Instituti i Kosovës për Monumente	Institucion vartës i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe përgjegjëse për ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore në nivel vendi.
Instituti Arkeologjik i Kosovës	Institucion vartës i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe përgjegjëse për ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e trashëgimisë arkeologjike në Kosovë.
Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM)	Organ i përcaktuar sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr. 03/L-039/2008. Ka për detyrë të monitorojë zbatimin e dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë, duke përfshirë në veçanti dispozitat e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Qendrën Historike të Prizrenit dhe Fshatit Hoçë e Madhe.
NIVELI LOKAL	
Komuna e Prizrenit	Institucion lokal përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e qytetit në përgjithësi përfshirë këtu edhe Qendrën Historike të Prizrenit
Prokuroria Themelore e Prizrenit	Institucion i ndjekjes penale
Këshilli i Trashëgimisë Kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit	I themeluar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe ka rol këshillues në lidhje me aktivitetet që zhvillohen në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore.

Këshilli i Bashkësisë Islame i Prizrenit	Përfaqësues të komunitetit fetar islam që jetojnë në Prizren Pronarë i një numri të monumenteve që ndodhen në QHP Ngritje të vetëdijes fetare Edukim
Kisha Ortodokse Serbe	Përfaqësues të komunitetit fetar ortodoks Pronarë i një numri të monumenteve që ndodhen në QHP Ngritje të vetëdijes fetare Edukim
Administratura Apostolike e Kosoves,- Famullia e Prizrenit	Pronarë të kompleksit religjioz brenda QHP që është në listë të mbrojtjes dhe një numri të objekteve brenda QHP Ngritje të vetëdijes fetare Edukim
Kisha Protestane Ungjillore në Prizren	Përfaqësues të komunitetit fetar protestant që jetojnë në Prizren
Shoqata hebraike në Prizren	Përfaqësues të komunitetit fetar hebraik që jetojnë në Prizren
PËRFAQËSUES NDËRKOMBËTAR	
Bashkimi Evropian zyra në Kosovë	Zyra e BE në Kosovë luan një rol kyç në zbatimin e ndihmës institucionale dhe financiare të konsiderueshme të BE-së për Kosovën. EUSR ofron këshilla dhe mbështetje për Qeverinë e Kosovës në procesin politik; siguron koordinim të përgjithshëm për praninë e BE-së në Kosovë; dhe kontribuon në zhvillimin dhe konsolidimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë. Zyra punon nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë [3]
OSBE	Rolin udhëheqës në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe të demokracisë, si dhe të drejtat e njeriut në Kosovë. Misioni e përqëndron punën e vet, mes tjerash, në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve; barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen qytetare; aftësimin e personelit gjyqësor, Policisë së Kosovës dhe

[3] https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/7629/për-zyren-e-be-së-në-kosovëppbe_sq

	administratës publike; si dhe në ofrimin e mbështetjes në çështje të zgjedhjeve[4]
UNESCO	UNESCO (Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara) është përgjegjëse për koordinimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në arsim, shkencë, kulturë dhe komunikim[5]
Europa Nostra	Është federata pan-evropiane e OJQ-ve të trashëgimisë, e cila mbështetet nga një gamë e gjerë e organeve publike, kompanive private dhe individëve. Duke mbuluar 42 shtete në Evropë dhe 5 vende jashtë kontinentit, është rrjet më përfaqësues që punon në këtë fushë dhe në fushën e trashëgimisë në Evropë [6]
Ambasada e SHBA	Mban dhe zhvillon marrëdhëniet mes SHBA-ve dhe Kosovës
Ambasada e Britanisë së Madhe	Mban dhe zhvillon marrëdhëniet mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës
Ambasada e Turqisë	Mban dhe zhvillon marrëdhëniet mes Turqise dhe Kosovës
Ambasada e Shqipërisë, Norvegjisë, Luksemburgut, etj.	Ambasada të ndryshme që mbajnë dhe zhvillojnë marrëdhëniet mes Kosovës dhe shteteve respektive të ndryshme
TIKA	Agjencise Turke per Bashkepunim dhe Koordinim (TIKA) është një mekanizëm bashkëpunues për institucionet dhe organizatat shtetërore, universitetet, organizatat jofitimprurëse dhe sektorin privat[7][8]
PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE	
RrOK Prizren	Rrjeti i Organizatave Kulturore i Prizrenit është rrjet joformal i më se 23 organizatave të kulturës në komunën e Prizrenit. Misioni i këtij Rrjeti është arritja e një ekonomie të zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit

[4] https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/mandate
[5] https://en.unesco.org/about-us/introducing-unesco
[6] http:// www.europanostra.org/
[7] http:// www.tika.gov.tr/en/page/about_us-14650
[8] Përfaqësuasit ndërkombëtar sikurse, BE dhe ambasadat e sipërpërmendura janë potencuar për shkak të prezencës dhe investimit më të madh financiar në Qendrën Historike të Prizrenit. Kjo nuk përjashton edhe ambasadat e agjencitë tjera që kanë punuar apo investuar në QHP.

	dhe strukturimit të ofertës turistike bazuar në rritjen e cilësisë dhe vëllimit të aktiviteteve kulturore. Objektivat themelorëtë punës së Rrjetit në Prizren përfshijnë: pasurimin e jetës kulturore, ngritjen e cilësisë së aktiviteteve ekzistuese kulturore, strukturimin e ofertës kulturistike, përmirësimin e politikave kulturore në nivel komunal, menaxhimin e decentralizuar të kulturës, diversifikimin e financimit të aktiviteteve kulturore dhe nxitjen e qytetarisë aktive dhe të përgjegjshme.
EC Ma Ndryshe - anëtar i RrOK'ut	OJQ lokale e Prizrenit, promovues të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në hartim të politikave dhe ngritjen e vetëdijes për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore
Fondacioni Lumbardhi - anëtar i RrOK'ut	OJQ lokale e Prizrenit, e themeluar në prill të vitit 2015 si vazhdim i iniciativës për mbrojtjen e kinemasë Lumbardhi
DokuFest - anëtar i RrOK'ut	OJQ lokale e Prizrenit, festival ndërkombëtar i filmit të shkurtë dhe dokumentar në Prizren
CHwB Kosova - anëtar i RrOK'ut	Fondacion që merret me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në nivel Kosove
Autostrada Biennale - anëtar i RrOK'ut	OJQ lokale, përkrahës të fuqizimit të kulturës bashkëkohore dhe komunitetit të saj
Komuniteti i biznesit (1. Shoqata e Zejtarëve dhe Afaristëve Prizren, 2. Shoqata ESNAF dhe 3. Shoqata SOFRA)	OJQ-të lokale që përfshijnë anëtarësi të komuniteteve të ndryshme etnike dhe përfaqësojnë interesat e komunitetit të biznesit në Prizren.
DOWN Sindrom - Prizren	OJQ, mirret membrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e personave me sindromin Down
Handikos	OJQ, përkrahë personat me aftësi të kufizuara duke avokuar, lobuar dhe duke ofruar shërbime përmes rrjetit të shtrirë në të gjithë Kosovën
Asociacioni i arkitektëve të Kosovës	OJQ, bashkimi i arkitektëve për krijimin dhe zhvillimin e ambientit kreativ në Kosovë dhe krijimi i zërit të përbashkët që do të flas në emër të shumicës për të gjitha çështjet me rëndësi për profesionin, shoqërinë dhe ambientin jetësor

Asociacioni i ndërtimtarëve të Kosovës	OJQ, trupi i cili përfaqëson ndërtimtarët e Kosovës
Asociacioni i planerëve të Kosovës	OJQ, trupi i cili përfaqëson planerët
INSTITUCIONET ARSIMORE	
Universiteti "Ukshin Hoti"	Institucion i lartë arsimor dhe edukativ publik në Prizren
Universiteti "Hasan Prishtina"	Institucion i lartë arsimor dhe edukativ publik në Prishtinë
Shkolla e Muzikës "Lorenc Antoni"	Institucion arsimor dhe edukativ publik në Qendrën Historike të Prizrenit
PËRFAQËSUES TJERË	
FEMAktiv	Iniciativë e grave dhe vajzave të Prizrenit që synojnë të sfidojnë mendësinë patriarkale në diskursin publik të qytetit
Tur Operator	Ofrues të shërbimeve për turistë
Agjensioni Kosovar i Privatizimit – zyra në Prizren	Agjencion i autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore
TV Besa	Rrjet televiziv lokal që bën transmetime të ndryshme televizive
Televizioni Opinion	Rrjet televiziv lokal që bën transmetime të ndryshme televizive
TV Prizreni	Rrjet televiziv lokal që bën transmetime të ndryshme televizive
Biblioteka Rajonale e Prizrenit	Institucion edukativ
Pronarë të shtëpive tradicionale	Pronarë, shfrytëzues dhe përfitues
Lidhja e Prizrenit –QRTK Prizren	Muze që ndodhet brenda QHP
Policia e Kosovës	Siguria e qytetarëve

Pas analizës së pjesëmarrësve se a plotësojnë kriteret e lartëpërmendura, a ndikohen në mënyrë direkte, a kanë interes në çështjet specifike dhe se sa kanë ndikim, a kanë qasje apo kontroll mbi burimet (financiare, teknike, intelektuale) i kemi ndarë pjesëmarrësit në palë kyç që kanë ndikim direkt në Planin e Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe në palë

tjerë të rëndësishëm por të interesuar për këtë Plan. Në vijim në tabelë janë paraqitur palët kyç me ndikim direkt me rolin e tyre në Planin e Menaxhimit për zonën Historike të Prizrenit.

2. PALËT KRYESORE ME NDIKIM DIREKT NË HARTIM TË PMQHP	
Palët e interesit	**Roli i tyre në PMQHP**
Minisitria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Inicues dhe financues i hartimit të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit Themelues, udhëheqës dhe anëtar i Ekipit Punues të projektit Përgjegjës për zbatim të PMQHP dhe financimin e veprimeve që dalin nga ky Plan
Komuna e Prizrenit	Përgjegjës për zbatim të PMQHP dhe financimin e veprimeve që dalin nga ky Plan Pjesë e Ekipit Punues të projektit
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren	Ekspertiza profesionale për hartim të Planit të Menaxhimit (eksperti lokal) Pjesë e Ekipit Punues të projektit Pjesë e Ekipit Hartues të projektit
Këshilli i Trashëgimisë Kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit	Ekspertiza profesionale për hartim të Planit të Menaxhimit (eksperti lokal) Pjesë e Ekipit Punues të projektit Pjesë e Ekipit Hartues të projektit
RrOK Prizren	Pjesë e Ekipit Punues dhe Hartues të projektit përmes anëtarësisë së vet Palë kontraktuese (me Fondacionin Lumbardhi si sekretariat) me MKRS për hartim të projektit
EC Ma Ndryshe - anëtar i RrOK'ut	Koordinatori i PMQHP - përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e procesit të hartimit të PMQHP në kuadër të RrOK Prizren Ekspertiza profesionale Financues të aktiviteteve të veçanta të PMQHP Pjesë e Ekipit Punues të projektit Pjesë e Ekipit Hartues të projektit
Fondacioni Lumbardhi - anëtar i RrOK'ut	Sekretariat i RrOK për hartim të PMQHP dhe administrues i projektit Pjesë e Ekipit Punues të projektit Pjesë e Ekipit Hartues të projektit

Përveç palëve kyç kemi edhe grupin tjetër që kanë rëndësi dhe interes në çështjet specifike të menaxhimit. Në vazhdim në mënyrë tabelare do të paraqitet ky grup me rolin e tyre.

3. PALËT TJERË TË RËNDËSISHME QË KANË INTERES NË HARTIM DHE ZBATIM TË PMQHP	
Palët e Interesit	**Roli i tyre në PMQHP**
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Pjesë e Ekipit Punues të projektit
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Pjesëmarrës në aktivitete të procesit të hartimit
Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore	Pjesë e Ekipit Punues të projektit
Instituti i Kosovës për Monumente	Pjesë e Ekipit Punues të projektit
Instituti Arkeologjik i Kosovës	Pjesë e Ekipit Punues të projektit
Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM)	Monitorues i zbatimit të Planit në bazë të ligjit në fuqi
Këshilli i Bashkësisë Islame i Prizrenit	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Kisha Ortodokse Serbe	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Administratura Apostolike e Kosoves,- Famullia e Prizrenit	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Kisha Protestante Ungjillore në Prizren	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Shoqata hebraike në Prizren	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Bashkimi Evropian zyra në Kosovë	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP Donator potencial për financim të aktiviteteve qe dalin nga PMQHP
OSBE	Pjesë e Ekipit Punues të projektit Financues të aktiviteteve të veçanta të PMQHP Donator potencial për financim të aktiviteteve qe dalin nga PMQHP
DokuFest - anëtar i RrOK'ut	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP Implementues potencial të ndonjë veprimi që del nga PMQHP
CHwB Kosova - anëtar i RrOK'ut	Pjesë e Ekipit Punues të projektit

	Financues të aktiviteteve të veçanta të PMQHP përmes Autostradës Biennale Implementues potencial të ndonjë veprimi që del nga PMQHP
Autostrada Biennale - anëtar i RrOK'ut	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Komuniteti i biznesit (1. Shoqata e Zejtarëve dhe Afaristëve Prizren, 2. Shoqata ESNAF dhe 3. Shoqata SOFRA)	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Handikos	Pjesë e Ekipit Punues të projektit
Asociacioni i arkitektëve të Kosovës	Pjesëmarrës përmes anëtarëve të vet profesional në proces
Asociacioni i ndërtimtarëve të Kosovës	Pjesëmarrës përmes anëtarëve të vet profesional në proces
Asociacioni i planerëve të Kosovës	Pjesëmarrës përmes anëtarëve të vet profesional në proces
Universiteti "Hasan Prishtina"	Pjesë e Ekipit Punues të projektit
FEMAktiv	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Tur Operator	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Biblioteka Rajonale e Prizrenit	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Pronarë të shtëpive tradicionale	Disa pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP
Lidhja e Prizrenit –QRTK Prizren	Pjesëmarrës në proces dhe në konsultim për PMQHP

Vlen të theksohet se kemi edhe një grup të rëndësisë së veçantë që ka rol specifik brenda Zonës Historike të Prizrenit por nuk ka ndikim dhe interes në Plan të Menaxhimit. Në tabelën vijuese do të paraqitet ky grup dhe roli i tyre në Plan.

4. PALËT QË NUK KANË NDIKIM POR MUND TË NDIHMOJNË NË TË ARDHMEN NË ZBATIM TË PMQHP	
Palët e Interesit	**Roli i tyre në PMQHP**
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	Përfshirja në të ardhmen në zbatim të aktivitetev të dala nga PM QHP
Prokuroria Themelore e Prizrenit	Ngritja e aktakuzave për dëme në asete të trashëgimisë kulturore
UNESCO	Infromim i institucionit përkatës pas hartimit të PMQHP Asistencë potenciale në zbatim dhe financim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
Europa Nostra	Infromim i institucionit përkatës pas hartimit të PMQHP Asistencë potenciale në zbatim dhe financim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
Ambasada e SHBA	Asistencë potenciale në zbatim dhe financim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
Ambasada e Britanisë së Madhe	Asistencë potenciale në zbatim dhe financim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
Ambasada e Turqisë	Asistencë potenciale në zbatim dhe financim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
Ambasada e Shqipërisë, Norvegjisë, Luksemburgut, etj.	Asistencë potenciale në zbatim dhe financim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
TIKA	Asistencë potenciale në zbatim dhe financim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren	Palë zbatuese në të ardhmen përmes aktivitetve edukuese
Shkolla e Muzikës "Lorenc Antoni"	Palë zbatuese në të ardhmen përmes aktivitetve edukuese
Agjensioni Kosovar i Privatizimit – zyra në Prizren	Asistencë potenciale në zbatim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
TV Besa	Avokim në zbatim të aktiviteteve të dala nga PMQHP

Televizioni Opinion	Avokim në zbatim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
TV Prizreni	Avokim në zbatim të aktiviteteve të dala nga PMQHP
Policia e Kosovës	Ofrimi i sigurisë dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimis kulturore brenda kufirit të Qendrës Historike të Prizrenit

Element shumë i rëndësishëm i këtij plani është edhe gjithpërfshierja gjatë tërë procesit. Projekti, përmes formave të ndryshme të komunikimit si **takime joformale, takime zyrtare, takime konsultativeme grupe të ndryshme të shoqërisë, punëtori, etj** ka konsultuar deri më tani mbi 100 palë të interesit me të drejtat, detyrimet dhe interes në fushat e mbrojtjes, ruajtjes, promovimit dhe shfrytëzimin socio-ekonomik të Qendrës Historike të qytetit.

Foto 2. Pamje nga takimet konsultative me grupe të ndryshme të interesit

1.5

Hulumtimi i gjendjes ekzistuese

1.5 HULUMTIMI I GJENDJES EKZISTUESE

1.5.1 Qendra Historike e Prizrenit

Qëllimi kryesor i hulumtimit është reflektimi sa i më i saktë i gjendjes ekzistuese të të gjitha strukturave (gjithsej 1622) që gjenden në Qendrën Historike të Prizrenit përfshirë këtu asete të trashëgimisë, ndërtesa të reja, ura, përmendore, kroje, etj në mënyre që kjo gjendje të pasohet me hapa konkret të adresimit të sfidave qe i ka kjo zonë.

Metodologjia e punës ka konsistuar në: analizën e ndërtesave dhe monumenteve nga jashtë dhe në raste të caktuara edhe duke hyrë brenda, hulumtimin e dokumenteve zyrtare, hulumtimin e literaturës, takime të drejtpërdrejta me zyrtarë institucional, intervistim të profesionistëve që merren me fushën e trashëgimisë kulturore dhe të planifikimit hapësinor, intervista me pronarë të aseteve të trashëgimisë kulturore si dhe vizitat në terren në mënyrë që të arrihet një analizë sa më e plotë e gjendjes ekzistuese në terren.

Sipas të dhënave të bazuara nga Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme (Tetor 2016), Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (Tetor 2017) dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit - Shtojca II: Monumentet kulturore në QHP (Prill 2012), Qendra Historike e Prizrenit numëron: (Listën e plotë të aseteve shih në Shtojcën 1)

13 Xhami
3 Teqe dhe Tyrbe
10 ndërtesa të Kishës Ortodokse Serbe
1 ndërtesë të Kishës Katolike
14 Mulli dhe Kroje
6 Nishane
11 Ndërtesa publike
38 Ndërtesa e komplekse banimi
5 Institucione Arsimore
1 Raritet Natyror
5 Komplekse Arkitektonike

Foto 1. Ndër monumentet më të spikatura të Qendrës Historike të Prizrenit mund të përmenden: Kalaja e qytetit, Kisha e Shën Premtes, Xhamia e Sinan Pashës, Katedralja e Zonjës Ndihmëtare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Shtëpia e Shehzades, Hamami i qytetit, kroi i Shadërvanit, Ura e gurit, sahatkulla, etj.

Sipas ligjit të Qendrës Historike të Prizrenit edhe objektet e rralla ose objekte me vlerë të veçantë marrin statusin e objektit nën mbrojtje si psh. trupat ndriçuese nga shekulli XX, punëtori të vjetra, kinema, etj. Andaj nuk mund të rrumbullaksohen me numra objekte me vlerë dhe se ato që nuk janë në listë nuk kanë vlerë. Nuk duhet harruar se procesi i vlersimit është në vazhdimësi dhe nuk është përfunduar.[1] Për më tepër, ekziton një numër i konsiderueshëm i asetev që vetëm janë inventarizuar por nuk kanë status të mbrojtjes.

Më poshtë është dhënë përshkrimi dhe sqarimi mbi kriteret e përdorura gjatë hulumtimit dhe punës në terren:

Emërtimi i monumentit. Bëhet në bazë të Listës së Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme apo edhe Ligjit të QHP. Nëse aseti ka emërtim tjetër apo alternativ është shtuar edhe ajo.

Gjeoreferencimi. I gjithë territori i Qendrës Historike të Prizrenit është gjeoreferencuar dhe të dhënat janë përpunuar në platformën Geographic Information System (GIS). Ky sistem në të ardhmen mund të shërbejë për përditësim të të dhënave nga terreni dhe prodhimi i analizave të ndryshme.

Fotodokumentacioni. Është bërë fotografimi i të gjitha strukturave që gjenden në Qendrën Historike të Prizrenit (asete të trashëgimisë, ndërtesa të reja, ura, përmendore, kroje, etj) dhe është krijuar një databazë e fotografive duke përfshirë edhe fotografitë nga arkivi i QRTK Prizren.

Lokacioni. Është përcaktuar nëse ndërtesa gjendet brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit, në Zonën e Dytë të Mbrojtjes apo Kontakt Zonën.

[1] Shtojca e ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, faqe 14



Harta 1. Pozita e Qendrës Historike të Prizrenit në raport me Kosovën (sipër majtas) dhe zonën urbane të qytetit të Prizrenit (sipër djathtas).

Koha e ndërtimit. Është përcaktuar vjetërsia e ndërtesës, periudha historike dhe koha e ndërtimit (shekulli, viti apo data e përafërt).

Foto 2. Hulumtimet në terren

Etazhiteti i ndërtesave. Janë grumbulluar të dhënat e etazhitetit maksimal të lejuar me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit në fuqi dhe atyre ekzistuese në terren.

Gjendja fizike e ndërtesave. Në mënyrë që të përcaktohet gjendja e përgjithshme fizike, kriteret janë caktuar sipas llojit të dëmtimeve të elementeve të asetit/ strukturës tek: muret e jashtme, kulmin (mbulesën, oxhakun dhe olluqet), dyert dhe dritaret dhe enterierin, aty ku kishte qasje.[2]
Si rrjedhojë, kombinimi i llojeve të dëmtimeve që paraqiste një aset, ka dhënë një pasqyrë të gjendjes tyre fizike, duke e listuar asetin në njërën nga këto kategori:
E mirë: kur ndërtesa është në gjendje stabile në aspektin struktural, nuk ka dëmtime dhe nevojë për intervenime;
Mesatare: kur ndërtesa është në gjendje stabile në aspektin struktural, por që ka nevojë për riparime të vogla dhe mirëmbajtje të përgjithshme;
E keqe: dëmtime në mure, ose një kulm që rrjedhë, me dëmtime të shkaktuara nga ndikimet atmosferike, zakonisht të shoqëruara me dëmtime të një pjese të konsiderueshme të elemeteve të objektit.
Shumë e keqe: kur ndërtesa ka shembje të ndonjë pjese të strukturës dhe ka shenja të qarta të jo stabilitetit (keqësim në muraturë, dobësim në konstruksion të kulmit, shfaqje të lagështisë).
Pjesërisht e rrënuar: kur jo të gjitha pjesët strukturale të ndërteses dallohen, kanë formë dhe qëndrojnë ende mbi tokë apo edhe kur struktura e ndërtesës nuk vërehet, ose kur pjesë të

2 Historic England (2017) How to Assess Condition. E qasshme në: https://historicengland.org.uk/images-books/publications/guidance-delisting-building/

strukturës mund t'i hasim të shkapërderdhura në lokacion.

Pronësia e objekteve është analizuar në bazë të të dhënave zyrtare nga Komuna e Prizrenit. Fatëkeqësisht nuk është arritur grumbullimi i të gjitha të dhënave rreth pronësisë pasi që Komuna nuk i ka të përditësuara informatat për këtë kategori.

Tiplogjia dhe nëntipet arkitektonike. Në fillim është definuar tipi i përgjithshëm arkitektonik i ndërtesës sikurse: kala/fortifikatë, xhami, kishë, shtëpi, shkollë, tyrbe, teqe, mulli, hamam, përmendore/memoriale, etj. Poashtu janë grumbulluar të dhënat për periudhë historike dhe stil. Hapi i mëtutjeshëm ka qenë definimi i nëntipeve arkitektonike (aty ku aplikohej), sikurse në disa raste të paraqitura në tabelat e mëposhtme:

XHAMI		KISHË KATOLIKE
Me kupollë / kube	Me kulm	Me tri anijata
		
Xhamia e Sinan Pashës	*Xhamia e Suzi Çelebiut*	*Katedralja Zonja Ndihmëtare*

KISHË ORTODOKSE [3]			
Me tri anijata dhe pesë kupolla	Me tri anijata dhe një kupollë qendrore	Me një anijatë dhe një kupollë qendrore	Me një anijatë dhe kulm
Kisha e Shën Premtes (Levishës)	*Kisha e Shën Gjergjit (Sinodale)*	*Kisha e Shën Dielës*	*Kisha e Shën Gjergjit (Runoviq)*

3 Qasja në monumente dhe të dhënat detaje janë siguruar nga Kisha Ortodokse Serbe dhe QRTK Prizren

SHTËPITË TRADICIONALE [4]		
Shtëpi përdhesë	Shtëpi e mbyllur me kat	Shtëpi me çardak
Shtëpi me sallë qendrore	Shtëpi me qoshk	Shtëpi me zgjidhje të veçantë

Tabela 1 Tiplogjitë dhe nëntipologjitë arkitektonike

Funksioni i tanishëm. Janë përcaktuar të gjitha funksionet që aplikohen në ndërtesa, sikurse banimi, biznesi, edukimi, administrata, etj. Në raste të shpeshta në paraqitur dy ose më shumë funksione në një ndërtesë. Këto funksione janë analizuar edhe nëse janë të shfrytëzueshme apo jo.

Vlerat dhe harmonia e ndërtesave. Fillimisht është përcaktuar nëse ndërtesa posedon vlera të trashëgimisë kulturore. Nëse po, atëherë është elaboruar më në detaje se çfarë lloje të vlerave posedon ndërtesa (për më shumë info rreth analizës së vlerave shih kapitullin 5.Vlerat, rëndësia dhe autenciteti). Kategori tjeter e analizës ka qenë nëse ndërtesat që nuk kanë vlera të trashëgimisë (kryesisht ato të ndërtuara vonë) janë në harmoni apo jo me kontekstin urban historik.

Në faqet në vijim gjeni të bashkangjitura hartat nga hulumtimi në terren. Për kualitet më të lartë të hartave, shih Aneks 3.

Konkluzion

Rekomandohet që të dhënat e databazës së QHP të përditësohen në baza vjetore në mënyrë që të kontrollohen trendet e ndërtimit dhe tejkalimet eventuale.

4 Klasifikimi i shtëpive është bërë në bazë të studimit të Emin Rizës "Banesa popullore e Prizrenit" botoi: Akademia e Shkencave e Shqipërisë

LEGJENDA / LEGEND
- Çarshia e Arastës / Arasta Bazaar
- Çarshia e Kovaqëve / Blacksmith Bazaar
- Çarshia e Kujunëhve / Jeweler Bazaar
- Çarshia e Saraçhanës / Saddler Bazaar
- Çarshia e Sinan Pashës / Sinan Pasha Bazaar
- Çarshia e Vjetër (e Popit) / Old (priests) Bazaar
- Mulinjtë-Valavicat / Mills
- Tabakhane e sipërme / Upper Tabakhane-saddler

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA03. Qendra Historike e Prizrenit dhe çarshitë nga shek.XVI-XVII me nënzona të Planit të Konservimit
MAP03. Historic Center of Prizren and bazaars from the XVI-XVII century with the sub-zones of Conservation Plan

LEGJENDA / LEGEND
- Arasta Mahalla / Neighbourhood
- Atik Mahalla / Neighbourhood
- Ilyaz Kuka Mahalla / Neighbourhood
- Kurrila Mahalla / Neighbourhood
- Marash Mahalla / Neighbourhood
- Mehmet Pasha Mahalla / Neighbourhood
- Muderiz Ali Efendi Mahalla / Neighbourhood
- Nënkalaja / Nënkalaja Neighbourhood
- Sedji Beg Mahalla / Neighbourhood
- Sinan Pasha Mahalla / Neighbourhood
- Suzi Çelebi Mahalla / Neighbourhood
- Tabakhana / Tabakhana Neighbourhood
- Terzi Mahalla / Neighbourhood
- Çatip Sinan Mahalla / Neighbourhood

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA04. Qendra Historike e Prizrenit dhe mahallat nga shek.XIXMAP05.
MAP04. The Historic Center of Prizren and the mahalla's (neighbourhoods) from the XIX century



LEGJENDA / LEGEND

- Arasta Mahalla / Neighbourhood
- Atik Mahalla / Neighbourhood
- Iljaz Kuka Mahalla / Neighbourhood
- Kurila Mahalla / Neighbourhood
- Marash Mahalla / Neighbourhood
- Mehmet Pasha Mahalla / Neighbourhood
- Muderiz Ali Efendi Mahalla / Neighbourhood
- Nënkalaja / Nënkalaja Neighbourhood
- Sedji Beg Mahalla / Neighbourhood
- Sinan Pasha Mahalla / Neighbourhood
- Suzi Çelebi Mahalla / Neighbourhood
- Tabakhana / Tabakhana Neighbourhood
- Terzi Mahalla / Neighbourhood
- Çatip Sinan Mahalla / Neighbourhood

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA05. Mahallat nga shek.XIX në raport me nënzona të Planit të Konservimit
MAP05. The mahalla's (neighbourhoods) from the XIX century in relation with sub-zones of Conservation Plan



LEGJENDA / LEGEND

- Nën mbrojtje të përhershme / Under permanent protection
- Nën mbrojtje të përkohshme / Under temporary protection
- Nën mbrojtje të përkohshme-Komplekset arkitektonike / Under temporary protection–Architectural complexes
- Të inventarizuara / Inventorised
- Të painventerizuara / Uninventorised
- Raritet natyror / Natural rarity
- N/A

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA06. Statusi ligjor i aseteve të trashëgimisë kulturore
MAP06. The legal status of cultural heritage assets

LEGJENDA / LEGEND
- Më të vjetra se 50 vjet / Older than 50 years (22%)
- Të reja / New (73%)
- N/A (5%)

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA07. Mosha e ndërtesave
MAP07. Age of the buildings

LEGJENDA / LEGEND
- Max. 3 etazha / floors
- Max. 2 etazha / floors
- N/A

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA08. Etazhiteti i lejuar sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit (2009)
MAP08. Permitted height of buildings by the Conservation and Development Plan (2009)

LEGJENDA / LEGEND

- 0.5 kat / floor
- 1 kat / floor
- 1.5 kate / floors
- 2 kate / floors
- 2.5 kate / floors
- 3 kate / floors
- 3.5 kate / floors
- 4 kate / floors
- 4.5 kate / floors
- 5 kate / floors
- 5.5 kate / floors
- 6.5 kate / floors
- 9 kate / floors
- N/A

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA09. Etazhiteti i ndërtesave
MAP09.The height of the buildings

LEGJENDA / LEGEND

- E mirë / Good (86%)
- Mesatare / Average (5%)
- E keqe / Bad (1%)
- Shumë e keqe / Very bad (1%)
- Pjesërisht e rrënuar / Partially ruined (5%)
- N/A

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA10. Gjendja fizike e ndërtesave
MAP10. Physical state of buildings

LEGJENDA / LEGEND
E mirë / Good (69%)
Mesatare / Average (19%)
E keqe / Bad (5%)
Shumë e keqe / Very bad (4%)
Pjesërisht e rrënuar / Partially ruined (3%)
N/A

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA11. Gjendja fizike e aseteve të trashëgimisë më të vjetra se 50 vjet
MAP11. The physical condition of heritage assets older than 50 years

LEGJENDA / LEGEND
Bibliotekë / Library 1
Dyqan / Shop 59
Hamam / Turkish bath 1
Hamam - Sahatkullë / Turkish bath - Clocktower 1
Hambar / Barn 2
Han / Inn 1
Kala / Fortress 1
Kishë katolike / Catholic Church 1
Kishë ortodokse / Orthodox Church 11
Kinema / Cinema 1
Lokalitet arkeologjik / Archeological site 1
Medrese / Madrasah 1
Memorial / Memorial 5
Minare / Minaret 1
Mulli / Mill 1
Ndërtesë administrative-publike / Admin-public buildings 8
Objekt përcjellës banimi / Storage 8
Shkollë / School 5
Shtëpi tradicionale / Traditional houses 139
Tabakhane / Saddler 1
Teqe / Masjid 3
Trafo / Transformer 2
Tyrbe / Shrine 3
Urë / Bridge 9
Varreze / Graveyard 2
Xhami Mosque 12
Çezme / Fountain 11
N/A

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA12. Tipologjia arkitektonike
MAP12. Architectural Typology



LEGJENDA / LEGEND
Banim / Residence (47%)
Banim-Biznes / Residence-Business (19%)
Biznes / Business (19%)
Qendër tregtare / Shopping center (0%)
Edukim / Education (1%)
Fetar / Religion (2%)
Kulturë / Culture (1%)
Administratë / Administration (2%)
N/A (9%)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA13. Funksionet e tanishme
MAP13. The current functions

LEGJENDA / LEGEND
E shfrytëzueshme / Used (73%)
Pjesërisht e shfrytëzuehme / Partially used (10%)
E pa shfrytëzueshme / Not used (11%)
N/A (7%)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA14. Shfrytzueshmëria
MAP14. Building use



LEGJENDA / LEGEND
Ka vlerë të trashëgimisë kulturore / There is heritage value (23%)
Nuk ka vlerë të trashëgimisë kulturore / There is no heritage value (77%)

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA15. Posedimi i vlerave të trashëgimisë kulturore
MAP15. Possession of cultural heritage values



LEGJENDA / LEGEND
Ka vlerë të TK / There is heritage value (23%)
Nuk ka vlerë të TK por në harmoni / No heritage values but in harmony (35%)
Nuk ka vlerë të TK dhe në dis-harmoni / No heritage values and not in harmony (42%)

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA16. Vlera dhe harmonia me kontekst urban-historik
MAP16. Values and harmony with the urban



LEGJENDA / LEGEND
Ka vlerë të TK / There is heritage value (23%)
Nuk ka vlerë të TK por në harmoni / No heritage values but in harmony (35%)
Nuk ka vlerë të TK dhe në dis-harmoni / No heritage values and not in harmony (42%)
Hapësirat publike / Public spaces

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA17. Vlerat, harmonia dhe hapësirat publike
MAP17. Values, harmony and public spaces



LEGJENDA / LEGEND
Gjelbërimi i lartë / Higher green areas
Gjelbërimi i ulët / Lower green areas

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA18. Zonat e gjelbërta
MAP18. Green areas

LEGJENDA / LEGEND
Sipërfaqe me bari / Grass areas
Sipërfaqe me drunj të përzier / Mixed trees ares
1. Bli / Lime tree 209
2. Dushk / Oak 90
3. Frashër / Ash tree 79
4. Gështenjë e egër / Wild chestnut 2
5. Mani / Mulberry 1
6. Mështekën / Birch tree 21
7. Pisha e argjendtë / Silver pine 21
8. Pisha e zezë / Black pine 4
9. Pishë / Pine 7
10. Pishë dekorative / Decorative pine 3
11. Plep kanadez / Canadian poplar 12
12. Plepi oriental / Oriental poplar 9
13. Rrap / Plane tree 52
14. Shelg / Willow
15. Shelgu vajtues / Crying willow 1
16. Shkurre dekorative / Decorative shrub 16

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA19. Llojet e drunjëve të mbjellur në hapësira publike
MAP19. Types of planted trees in public spaces

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA20. Zonat e parkingjeve
MAP20. Parking areas

LEGJENDA / LEGEND
Private 44
Publike 106

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA21. Pronësia e parkingjeve
MAP21. Parking ownership



LEGJENDA / LEGEND
Tek institucionet / At institutions 4
Tek pronat private / At private properties 32
Tek rrugët ilegale / Roads-illegal 59
Tek rrugët legale / Roads-legal 39
Tek trotuaret ilegale / Sidewalks-illegal 12
Tek trotuaret legale / Sidewalks-legal 4

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA22. Kategorizimi i parkingjeve
MAP22. Parking categories

1.5.2 Hapësirat publike

Përshtypja jonë për një qytet, pos identitetit historik e urban formësohet edhe nga kualiteti i hapësirave publike. Ato duhet të jenë të këndshme, të qasshme dhe të ofrojnë siguri. Për më tepër, ato kanë rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe ekonomike të komuniteteve që jetojnë dhe i gëzojnë këto hapësira.

Gjatë vitit 2017 është kryer hulumtimi[5] i të gjitha hapësirave publike të Qendrës Historike të Prizrenit. Hulumtimi përmban të dhëna mbi tri kategori kryesore të hapësirave publike:

1. Hapësirat publike ekzistuese,

2. Hapësirat gjysëm-publike (kryesisht ato tek monumentet kulturore e në veçanti tek ato fetare) dhe

3. Hapësirat që kanë potencial të shëndrrohen në hapësira publike në të ardhmen.

Gjatë hulumtimit janë analizuar funksionet e tanishme të të gjitha hapësirave të identifikuara, elementet që i karakterizojnë ato përfshirë edhe mobilarinë urbane ekzituese, qasjen për persona me aftësi të kufizuara dhe elementet që i mungojnë këtyre hapësirave. Shfrytzueshmëria e hapësirave është përcaktuar pas marrjes parasysh të të gjitha faktorëve të sipërpërmendur dhe shfrytëzimit të tyre në baza vjetore.



Harta 2. Kufiri i Qendrës Historike të Prizrenit dhe hapësirat e trajtuara në hulumtim. Hartat tjera të hulumtimit gjenden në Shtojcën 3

5 Kjo pjesë e Planit të Menaxhimit të QHP, përpos MKRS-së është kryer me përkrahje shtesë të OJQ EC Ma Ndryshe të përkrahur financiarisht nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, KFOS dhe u realizua në kuadër të projektit "Thellimi i dijes europiane në planifikim dhe zhvillim urban".

Çka janë hapësirat publike?

Ndërmjet ndërtesave të qytetit ekziston një rrjet i hapësirave që krijojnë dhe forcojnë lidhjet në mes të njerëzve. Kur ne i referohemi rrugëve apo hapësirave tjera të një qyteti ne aktualisht flasim për vet identitetin e qytetit. Hapësirat publike janë hapësira shoqërore që janë të hapura dhe të qasshme për njerëzit. Këto hapësira kanë rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe ekonomike të komunitetit. Një hapësirë e mirë publike është hapësirë që reflekton diversitet dhe inkurajon njerëzit të jetojnë së bashku pa përpjekje, duke i siguruar kushte të nevojshme.

Në një përkufizim të gjerë, hapësirat publike janë hapësirat ku të gjithë gëzojnë bashkëjetesën dhe përfaqësojnë kolektivitetin dhe interesin e përbashkët duke e zbërthyer diversitetin e tyre.

Foto 3. Sheshi Shadërvan si pikë referente e hapësirave publike në Prizren. Autor: Berat Hoxha

Kualiteti i hapësirave publike dhe siguria në këto hapësira varen nga disa faktorë[6]:

Llojllojshmëria e shrytëzueshmërisë: Llojllojshmëria gjeneron aktivitete të ndryshme që kontribuojnë në sigurinë e hapësirës. Kjo llojllojshmëri e funksioneve duhet të aplikohet në çdo kohë të ditës. Nëse hapësirat publike janë të shfrytëzuara vetëm ditën, ato përsëri do të mbeten hapësira të pasigurta.

"Fasadat aktive": Lidhja midis ndërtesave, trotuarit dhe rrugës kontribon në sigurinë dhe atraktivitetin e hapësirave publike. Përveç kësaj, kjo lidhje ndikon në perceptimin e njerëzve për qytetin dhe mënyrën se si ata duhet ta përdorin atë.

Dimensioni social dhe vitaliteti urban: Si një grumbullues i njerëzve, hapësira publike ka ndikim mbi dimensionin social. Rrugët, sheshet, parqet, trotuaret, shtigjet e biçikletave dhe mobileria urbane, me qasje gjithpërfshirëse nxisin ndërveprimin midis njerëzve dhe mjedisit, krijojnë një përdorim pozitiv të hapësirës dhe rrisin vitalitetin urban.

Proporcionet humane: Ndërtimi i hapësirave me proporcione të mëdha mund të ndikojë negativisht në shëndetin e njerëzve. Në studimet e tij në terren, Jan Gehl vuri në dukje se njerëzit priren të ecin më shpejt kur kalojnë në zonat e zbrazëta ose jo aktive, ndryshe nga ritmi më i ngadalshëm dhe i qetë i ecjes në mjedise më të jetueshme dhe më aktive. Ndërtimet në shkallë të njeriut ndikojnë pozitivisht në perceptimet e njerëzve për hapësira publike.

Ndriçimi: Ndriçimi efektiv dhe i orientuar drejt njerëzve lehtëson shfrytëzimin e hapësirave publike gjatë natës, duke rritur sigurinë dhe duke krijuar kushte të nevojshme për të lëvizur më sigurt në mungesë të dritës natyrore.

Stimulimi i ekonomisë lokale: Hapësirat publike kualitative jo vetëm që u ofrojnë njerezve zona të lira, por gjithashtu kanë potencial për të rritur ekonominë lokale.

6 Public Spaces: 10 Principles for Connecting People and the Streets (The City Fix: World Resources Institute, Ross Center)

Identiteti lokal: Hapësirat publike duhet të integrojnë edhe bizneset e vogla që karakterizojnë vendin. Ndërmarrjet e mëdha mund të kontribuojnë në ekonominë në përgjithësi, por bizneset e vogla dhe sipërmarrjet kanë impakt të rëndësishëm afatgjatë, si dhe i japin karakter dhe formësojnë identitetin e vendit. Gjatë planifikimit të hapësirave publike është e nevojshme të merren parasysh dinamikat sociale dhe specifikat kulturore të zonës, në mënyrë që të krijohet një lidhje e mirë mes njerëzve dhe vendit. Faktor i rëndësishëm është edhe përdorimi i materialeve ndërtimore lokale dhe që janë miqësore me mjedisin.

Zonat me gjelbërim: Përveç që kontribuojnë në cilësinë e ajrit dhe ndihmojnë në uljen e temperaturave të larta në verë, zonat publike me gjelbërim kanë fuqinë të humanizojnë qytetin duke tërhequr njerëzit në aktivitete në natyrë. Përderisa qytetet bëhen më të dendura, qasja në hapësira publike të gjelbra do të bëhet edhe më e rëndësishme, pasi pyllëzimet urbane mund të ulin nivelet e stresit të njerëzve dhe të rrisin mirëqenien në qytete.

Pjesëmarrja sociale: Përfshirja e banorëve në projektimin, planifikimin dhe administrimin e hapësirave publike është thelbësore për të ruajtur cilësinë e këtyre hapësirave. Përfshirja e banorëve (përfshirë këtu edhe përfaqësimin gjinor të barabartë) siguron që natyra dhe përdorimi i hapësirës publike të përmbushin nevojat e veçanta të komunitetit. Nëse një hapësirë nuk pasqyron kërkesat dhe dëshirat e popullsisë lokale, ajo nuk do të përdoret ose mirëmbahet. Pjesëmarrja sociale është një element qendror për ndërtimin e zonave publike të sigurta dhe të barabarta.

Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë gjendjen ekzistuese të të gjitha hapësirave publike në Qendër Historike nëse ato i plotësojnë kushtet optimale për jetesë dhe i shtojnë vlera kontekstit urban e historik qendrës së qytetit. Për më tepër, ky hulumtim mëton të jep edhe sygjerime e rekomandime se si këto hapësira do të përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe do të ishin më të shfrytëzueshme nga banorët e zonës por edhe vizitorët e turistët e shpeshtë që e frekuentojnë.

Gjatë vitit 2017 është kryer hulumtimi i të gjitha hapësirave publike të Qendrës Historike të Prizrenit. Qendra Historike e Prizrenit e mbrojtur me ligj të veçantë ngërthen në vete vlera të larta historike e kulturore. Kjo qendër pos monumenteve të spikatura ka një rrjet organik urban që lidh këto monumente duke formësuar kështu një karakter specifik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Për më tepër qendra e qytetit të Prizrenit është një nga qytetet më të vizituara në Kosovë.

Metodologjia dhe të dhënat nga terreni

Hulumtimi i hapësirave publike është bërë me anë të identifikimit dhe vlerësimit të gjithsej 36 hapësirave publike në terren, ku është bërë grumbullimi i të dhënave dhe foto-dokumentimi i tyre. Pas analizës së të dhënave për çdo hapësirë publike, bazuar edhe në shfrytëzimin e hapësirës gjatë ciklit të një viti është bërë edhe vlerësimi i shfrytëzueshmërisë së tyre. Foto-dokumentimi ekzistues është bërë nga kënde të ndryshme. Këtu janë shtuar edhe fotografitë e aktiviteteve të ndryshme që mbahen në hapësira specifike në mënyrë që të ipet një perceptim i plotë i shfrytëzimit të hapësirës.

Të gjitha hapësirat publike janë përpunuar në platformën Geographical Information System (GIS) dhe janë kodifikuar në mënyrë që të shfrytëzohen edhe për hulumtime të mëtutjeshme. Për qëllime të thellimit të hulumtimit, disa hapësira publike shkaku i karakterit të tyre dhe funksioneve që posedojnë janë fragmentarizuar në disa pjesë, si psh; Keji i Lumbardhit nuk është trajtuar si një hapësirë e vetme por është analizuar në tetë segmentet e veta. Arsyeja qëndron aty

se disa pjesë të Kejit të Lumbardhit shfrytëzohen më shumë dhe kanë funksione tjera dhe disa pjese nuk shfrytëzohen dhe aq.



Foto 4. Shembulli i kartelës / formularit për çdo hapësirë publike të identifikuar. Të gjitha kartelat e hulumtimit gjenden në Shtojcën 4.

Identifikimi i hapësirave

Qendra Historike e Prizrenit ka gjithsej sipërfaqe prej 62,88 Hektarë dhe vetëm 9% e kësaj sipërfaqeje shfrytëzohet si hapësirë publike. Hulumtimi është fokusuar vetëm në hapësirat publike me funksion dhe në këtë përqindje nuk është përfshirë rrjeti i rrugëve dhe në disa raste edhe i trotuareve.



Qendra Historike e Prizrenit	Sipërfaqja (m2)	%
Hapësira publike ekzistuese	53,929.4	9%
Hapësira private dhe të tjera	574,828.2	91%
Totali	628,757.6	100%

Tabela 2. Qendra Historike e Prizrenit karakterizohet me përqindje të ulët të hapësirave publike.

Kodi GIS	Emërtimi i hapësirës publike	Sipërfaqja (m2)
PS01	Keji i Lumbardhit 1	2,279.3
PS02	Keji i Lumbardhit 2	188.5
PS03	Keji i Lumbardhit 3	618.4
PS04	Keji i Lumbardhit 4	623.7
PS05	Keji i Lumbardhit 5	122.3
PS06	Keji i Lumbardhit 6	81.5
PS07	Keji i Lumbardhit 7	649.8
PS08	Keji i Lumbardhit 8	1,860.9
PS09	Kalaja e Prizrenit	11,282.2
PS10	Marash 1	1,803.8
PS11	Marash 2	5,861.8
PS12	Sheshi i Dëshmorëve	3,801.9
PS13	Sheshi Shadërvan 1	2,208.2
PS14	Sheshi Shadërvan 2	1,834.0
PS15	Sheshi Shadërvan 3	2,490.7
PS16	Ish Qendra Zejtare	1,295.0
PS17	Muzeu i Hapur Arkeologjik	1,661.0
PS18	Hapësira para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit	371.0
PS19	Hapësira prapa Shtëpisë së Gani Dukagjinit	235.1
PS20	Rruga "Saraçët"	1,598.4
PS21	Rruga "Farkatarët"	1,114.4
PS22	Hyrja e Postës	479.5
PS23	Oborri i Xhamisë së Sinan Pashës	2,414.4
PS24	Oborri i Xhamisë së Emin Pashës	792.8
PS25	Oborri i Xhamisë së Gazi Mehmet Pashës	1,312.3
PS26	Oborri i Hamamit të Gazi Mehmet Pashës	887.1
PS27	Oborri i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit	950.7
PS28	Oborri i Katedrales së Zonjës Ndihmëtare	1,294.9
PS29	Oborri i Kishës së Shën Gjergjit	1,739.7
PS30	Oborri i Kishës së Shën Premtes	831.5
PS31	Platoja e Kompleksit Europa	630.7
PS32	Hapësira prapa Qendrës së Mjekësisë Familjare 1	613.9
PS33	Rruga "Marin Barleti"	785.7
PS34	Rruga "Adem Jashari"	2,976.7
PS35	Rruga "Remzi Ademaj"	5,350.9
PS36	Zona e pompës së benzinës	1,525.7

Tabela 3. Lista e hapësirave publike të analizuara bashkë me kodifikimin në GIS.

Kategorizimi i hapësirave

Në mënyrë që të analizohen tipologjitë e gjithsej 36 hapësirave publike të identifikuara, ato janë kategorizuar në tre grupe të paraqitura në vijim:

1. Hapësirat ekzistuese publike: Hapësirat ekzistuese që janë gjithmone të hapura dhe lehtësisht të qasshme për qytetarë.

Foto 5. Rruga e Farkatarëve është një rrugë e qarkullueshme këmbësorike dhe në të njëjtën kohë edhe hapësirë publike që shfrytëzohet në masë të madhe.

2. Hapësirat gjysëm-publike: Hapësira që rrethojnë një ndërtesë publike (apo edhe oborr) dhe menaxhohen nga menaxheri i ndërtesës ose ofruesi i shërbimit. Këto hapësira nuk janë plotësisht të hapura dhe janë të kontrolluara. Rastet më të shpeshta janë monumentet fetare apo edhe ato profane, si psh Hamami. Ka raste që ato janë janë të qasshme me pagesë apo me leje të veçantë.

Foto 6. Kisha e Shën Gjergjit bashkë me oborrin e saj paraqet një shembull të një hapësire gjysëm publike.

3. Hapësirat potenciale publike: Hapësira që kanë potencial të konvertohen në hapësira publike për qytetarë. Kjo kategori është përcaktuar duke u marrë për bazë numri i vogël i hapësirave publike në Qendër Historike dhe mund të shërbejë në të ardhmen për planifikim nga institucionet komunale.

Foto 7. Pompa e benzinës në pjesën perëndimore të QHPz nuk përkon me karakterin urban dhe historik të zonës. Ajo paraqet një hapësirë potenciale të konvertimit në një hapësirë publike për komunitetin.



Qendra Historike e Prizrenit	Numri i hapësirave	Sipërfaqja (m2)	%
Hapësira publike ekzistuese	22	42,461.4	66%
Hapësira gjysëm-publike	10	11,468.0	18%
Hapësirat potenciale publike	4	10,639.0	16%
Totali	36	64,568.4	100%

Tabela 4. Kategorizimi i hapësirave publike dhe përqindja e tyre në sipërfaqe.

Funksionet, elementet dhe mobilaria urbane e hapësirave

Funksioniet ekzistuese: Në hapësirat publike janë shqyrtuar të gjitha funksionet ekzistuese veçmas për secilën hapësirë. Këto të dhëna janë pasqyruar për të gjitha funksionet që mund të ketë një hapësirë publike gjatë një viti kalendarik. Një hapësirë publike mund të ketë disa funksione dhe në detaje ato janë paraqitur në grafikonin e mëposhtëm dhe në kartelat në Shtojcën 4.

Elementet dhe mobileria urbane: gjatë vlerësimit të hapësirave publike janë marr parasysh të gjitha elementet ekzistuese dhe mobilaria urbane. Poashtu në bazë të karakterit të hapësirës janë identifikuar edhe elementet që mungojnë në mënyrë që ato të plotësohen dhe të jenë plotësisht funkionale.

Qasja për persona me aftësi të kufizuara

Në kuadër të hulumtimit, të gjitha hapësirat janë analizuar edhe për qasje të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër mund të përmendim që këto kushte do të ishin të përshtatshme edhe për prindër me fëmijë me karroca. Hapësirat janë klasifikuar në grupe:

1. Të qasshme - Hapësirat në të cilat nuk ekziston asnjë pengesë për lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara.

2. Të qasshme vetëm me përcjellje - Hapësirat në të cilat personat me aftësi të kufizuara nuk mund të lëvizin lirshëm për shkak të rampave jo adekuate apo pengesave tjera dhe ku lëvizja e tyre është e mundur vetëm me përcjellje.

3. Të paqasshme - Hapësirat në të cilat ekzistojnë barriera dhe lëvizja e personave me aftësi të kufizuara është e pamundur.

Lloji i funksionit të hapësirës publike	Numri i hapësirave publike ku paraqitet funksioni	%
Pushimore	19	15%
Lëvizje e qytetarëve	14	11%
Kafeteri / restaurant	12	10%
Hapësirë për shumë qëllime	8	6%
Dyqane	8	6%
Lokacion fotografimi	7	6%
Koncert	6	5%
Dyqan suvenirësh	6	5%
Institucione publike / zyre	6	5%
Zonë me qarkullim të veturave	6	5%
Parking për vetura	5	4%
Kinema verore	4	3%
Shitës ambulant	4	3%
Ceremoni fetare	4	3%
Çeshme për ujë të pijshëm	4	3%
Panair	3	2%
Çeshme për abdest	3	2%
Rekreacion	2	2%
Nuk ka asnjë funksion	2	2%
Varreza të vjetra	2	2%
Pompë benzine	1	1%
	126	100%

Tabela 5. Funksionet më të shpeshta të hapësirave publike në QHPz janë ato për pushim, qarkullim të qytetarëve si dhe funksionet komerciale sikurse kafiteritë.

Elementet & mobileritë urbane prezente në hapësira publike	Numri i hapësirave publike ku paraqitet elementi	%
Gjelbërim i ulët	30	19%
Ndriçim publik	27	17%
Gjelbërim i lartë	25	16%
Shportë e mbeturinave	24	15%
Ulëse	22	14%
Fontanë	5	3%
Art publik	5	3%
WC publike	5	3%
Rampë për P.A.K. (8%)	3	2%
Jaz	3	2%
Memorial	3	2%
Këndi lojërave	3	2%
Paking për biçikleta	2	1%
Nuk ka elemente / mobileri	2	1%
	159	100%

Tabela 6. Hapësirat publike dominohen nga gjelbërimi dhe një pjesë e konsiderueshme kanë edhe ndriçim publik përderisa vërehet hapësira më pak për fëmijë dhe parking për biçikleta.

Elementet & mobileritë urbane që mungojnë në hapësira publike	Numri i hapësirave publike ku paraqitet mungesa	%
Rampë për P.A.K. (8%)	24	29%
Paking për biçikleta	15	18%
Ulëse	10	12%
Shportë e mbeturinave	10	12%
Ndriçim publik	6	7%
Gjelbërim i ulët	5	6%
Nuk aplikohet	4	5%
WC publike	3	4%
Nuk ka mungesë të mobilerisë urbane	3	4%
Kënd i lojërave	2	2%
Gjelbërim i lartë	1	1%
	83	100%

Tabela 7. Shumica e hapësirave publike kanë nevojë për rampa të përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara dhe parking për biçikleta..



.

Qasshmëria për P.A.K.	Numri i hapësirave publike	%
Të qasshme	9	25%
Të qasshme vetëm me përcjellje	18	50%
Të paqasshme	9	25%
Totali	36	100%

Tabela 8. Hapësirat publike në Qendër Historike nuk janë të përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara.

Foto 8. Në kuadër të ditëve të mbajtjes së Bienales Ndërkombëtare të Artit Bashkëkohor në Prizren, EC Ma Ndryshe dhe Autostrada Biennale kanë organizuar performancë publike si reagim për mosshfrytëzimin e shtratit të lumit si hapësirë publike.

Shfrytëzueshmëria e hapësirave

Pas analizës së të gjithë faktorëve që ndërlidhen me hapësirat publike si dhe informatat e grumbulluara se sa një hapësirë publike shfrytëzohet gjatë cikli të një viti, hulumtimi përmbyllet me kategorizim të shfrytzueshmërisë, dhe atë në katër grupe:
1. Plotësisht e shfrytëzueshme - Hapësirat publike të cilat shfrytëzohen më së shumti.
2. Relativisht e shfrytëzueshme - Hapësirat publike të cilat shfrytëzohen shumë, sidomos në periudha të caktuara të vitit.
3. Pak e shfytëzueshme - Hapësirat publike të cilat shfrytëzohen vetëm gjatë një periudhe të caktuar të vitit apo në ditë të caktuara.
4. Aspak e shfrytëzueshme - Hapësirat publike të cilat për shkak të arsyeve e pengesave të ndryshme nuk shfrytëzohen aspak.



Shfrytzueshmëria e hapësirave publike	Numri i hapësirave publike	Sipërfaqja (m2)	%
Plotësisht e shfrytëzueshme	5	12,029.6	19%
Relativisht e shfrytëzueshme	14	32,288.0	50%
Pak e shfrytëzueshme	11	7,893.2	12%
Aspak e shfrytëzueshme	6	12,357.6	19%
Totali	36	64,568.40	100%

Tabela 9. Përqindja më e madhe e hapësirave publike janë të shfrytëzueshme edhe pse kanë nevojë për përmirësim në raste te caktuara.

Konkulzione e rekomandime

Në bazë të analizave të prezantuara në këtë hulumtim, në vijim gjendet një listë me konkluzione e rekomandime për institucionet relevante dhe rreth hapësirave publike në Qendër Historike të Prizrenit:

- Komuna e Prizrenit, si autoritet vendimmarrës për krijim të kushteve dhe mirëmbajtje të hapësirave publike duhet të adoptojë qasje gjithpërfshirëse në trajtim dhe në përshtatje të hapësirave publike për nevojat e komunitetit dhe atë harmoni me Qendrën Historike të Prizrenit dhe në konsultim me QRTK Prizren dhe Këshillin e QHP.
- Komuna e Prizrenit duhet të aplikojë konkurs publik dhe qasje gjithpërfshirëse në krijim të hapësirave të reja.
- Komuna duhet të rrisë efikasitetin në grumbullimin e mbeturinave, me theks të veçantë në QHPz.
- Keji i Lumbardhit duhet të trajtohet në bazë të konfiguracionit të vet natyror dhe 't'i kthehet' qytetarëve. Ajo duhet të trajtohet si pjesë integrale e qendrës së qytetit duke investuar në segmente të caktuara me elemente të ndryshme sikurse gjelbërimi, WC publike dhe funksione shtesë.
- Edhe pse gjelbërimi është prezent në shumicën e hapësirave publike, Komuna duhet të investojë edhe më shumë në këtë drejtim. Mungesë evidente vërehet në Kejin e Lumbardhit dhe atë më së shumti gjatë sezonit të verës.
- Të bëhet sanimi i të gjitha trotuareve të hapësirave publike në mënyrë që të jenë të qasshme për persona me aftësi të kufizuara dhe prindëve me karroca. Të ndërtohen rampa në të gjitha hapësirat publike, dhe rampat egzistuese qe nuk janë të qasshme për persona me aftësi të kufizuara të rindërtohen me përqindje të pjerrësisë adekuate.
- Kalaja e Prizrenit, si një nga monumentet më të spikatura të Qendrës Historike të krijojë qasje të plotë për P.A.K. pa e dëmtuar dhe zhverësuar vlerat kulturo-historuke të monumentit-lokalitetit.
- Sheshi i Shadërvanit, si pika e referimit për shumë qytetarë e turistë duhet të shkarkohet nga disa funksione si psh: shitësit mobil, standet e përkohshme komerciale, etj në mënyrë të mos cënohet integriteti urban dhe historik i saj. Operatorët e ndryshëm duhet të gjejnë alternativa tjera që aktivitetet e tyre të organizojnë në hapësira tjera të cilat nuk janë plotësisht të shfrytëzueshme si dhe në hapësira/kiosqe të dizajnur enkas për këto qëllime.
- Muzeu i hapur arkeologjik që gjendet pranë Lidhjes së Prizrenit duhet të rikonceptohet sepse shumica e qytetarëve nuk janë të njoftuar për këtë muze dhe shumë pak vizitohet. Kjo hapësirë frekuentimin më të madh e ka gjatë sezonit të verës, kur hapet çajtorja verore.
- Tek hapësira para Postës kryesore dhe Hotel Theranda duhet të mënjanohen barrierat për lëvizje të lirë të qytetarëve.
- Monumentet fetare, bashkë me hapësirat përreth duhet të jenë më të qasshme dhe të hapura për publik. Në shumicën prej tyre nuk janë të shënuara oraret e vizitave apo edhe ndonjë kontakt për vizitë.
- Në hapësirat publike ku kushtet e sigurisë janë në nivel, duhet të projektohen kënde për lojëra të fëmijëve.
- Për arsye të jo sigurisë së lëvizjes në mungesë të dritës natyrore, të shtohet ndriçimi efektiv në hapësira që janë të identifikuara në hulumtim.
- Duhet të shtohen fontanat me ujë të pijshëm si një nga elementet historike urbane të Prizrenit.
- Duhet të shtohen parkingjet për biçikleta nëpër hapësira publike. Lidhur me këtë, poashtu Komuna duhet të bashkëpunojë me organizatat / kompanitë që japin në dispozicion biçikleta me qera.

- Gati gjysma e hapësirave publike nuk shfrytëzohen sa duhet. Komuna duhet të ridizajnojë dhe të rrisë kualitetin e tyre në mënyrë që të ketë më shumë alternativa për qytetarë.
- Arti publik është pjesë integrale e shumë hapësirave publike. Në rastin e Qendrës Historike të Prizrenit duhet të kemi kujdes që ky art mos ta dëmtojë integritetin e trashëgimisë kulturore.
- Të krijohet një hapesirë për zhvillimin e aktiviteteve të artizanateve për prodhim dhe shitje të tyre.
- Të konceptohet dizajni adekuat për shitës ambulant, kiosqe, nën stacione autobusi lokal, tabela për njoftime të ndryshme publike, etj. Të gjitha këto duhet të kenë një "emërues të përbashkët" në dizajnin e tyre dhe nuk duhet të ketë laramani pa koncept dhe harmoni me karakterin historik të qendrës.
- Reptësisht duhet ndaluar vendosjen e pllakatave, shpalljeve edhe njoftimeve të ndryshme nëpër trupat e pemëve (lisave), vitrinave, mureve të ndërtesave, urave, etj.
- Për shkak të hapësirave publike të limituara duhet të ketë planifikim strategjik rreth rritjes së tyre, dhe atë:

1. Të bëhet rigjenerimi urban i hapësirës tek rruga ”Marin Barleti” dhe ”7 Korriku” (ish qendra zejtare)
2. Të gjendet një alternativë tjetër e qarkullimit të veturave në rrugën ‘Remzi Ademaj‘ dhe rrugen ‘Adem Jashari‘ në mënyrë që të rritet sipërfaqja e hapësirave publike në Qendrën Historike të Prizrenit;
3. Tek Sheshi i Deshmoreve, (apo ish Arasta) të bëhet një ridizajnim i hapësires publike, duke marrë parasysh ruajtjen dhe prezantimin e denjë të monumenteve nga periudha të ndryshme: lokaliteti arkeologjik, Minarja Arasta dhe fontana (nga periudha otomane), memoriali i dëshmorëve nga Lufta e Dytë Bortërore dhe memoriali i dëshmorit nga lufta e vitit 1999; dhe
4. Të bëhet dislokimi i pompës së benzinës që gjendet brenda kufirit të Qendrës Historike të Prizrenit dhe të konvertohet në hapësirë publike.
5. Hapësira tek Rrapi i vjetër (Platanus orientalis) në lagjen Marash është rezikuar nga kafer-restauranti dhe teqeja me prerjen e degëve si dhe nga hyrja e makinave motorike në këtë pjesë. Ky monumet natyror duhet të ketë prezantim të denjë sikurse rrethoja, ndriçimi, gjelbërimi përreth, etj.

Pjesa përmbyllëse e hulumtimit përmban dy anekse ku paraqiten hartat dhe kartelat e prodhuara për çdo hapësirë të analizuar (Aneks 4).

1.5.3 Muzetë e qytetit

Muzeu është institucion që kujdeset për koleksion të artefakteve dhe objekteve të tjera me rëndësi artistike, kulturore, historike ose shkencore. Këto artefakte, muzetë i vënë në dispozicion të publikut përmes ekspozitave që mund të jenë të përhershme ose të përkohshme.[7]

Muzetë më të mëdhenjë gjenden në qytetet e mëdha në gjithë botën, ndërsa mijëra muze lokale ekzistojnë në qytete, qyteza dhe zona rurale më të vogla.

Muzetë kanë qëllime të ndryshme, duke filluar nga shërbimi për studiues e specialistë e deri tek shërbimi i publikut të gjerë. Qëllimi i shërbimit të studiuesve gjithnjë e më shumë po zhvendoset me atë të shërbimit për publik të gjerë.

Që nga vitet 2010, përshpejtimi i vazhdueshëm i digjitalizimit të informacionit, e kombinuar me rritjen e kapacitetit të ruajtjes së këtyre informacioneve, po shkakton që modeli tradicional i muzeve të zgjerohet në përfshirje të ekspozitave virtuale multimediale dhe një qasje më kreative të edukimit të publikut.

Qyteti i Prizrenit, krahas epitetit të kryeqytetit kulturor të Kosovës, sipas perceptimit të përgjithshëm të publikut kosovar është qytet me vlera të lashta kulturore dhe historike dhe mban edhe epitetin e "Qytetit muze".

Muzetë e qytetit të Prizrenit, ku shimica e tyre gjenden në Qendrën Historike të saj janë paraqitur në hartën dhe fotografitë në vijim:



Harta 2. Hartëzmi i muzeve në qytetin e Prizrenit

7Edward Porter Alexander, Mary Alexander; Alexander, Mary; Alexander, Edward Porter (September 2007). Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums. Rowman & Littlefield, 2008. ISBN 978-0-7591-0509-6. Retrieved 6 October 2009.

Foto 9. Muzeu i Komple ksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Foto 10. Muzeu arkeologjik - Hamami i Shemsidin beut dhe Sahatkulla

Foto 11. Muzeu etnologjik - Shtëpia e shehzades

Foto 12. Muzeu i hapur arkeologjik

Foto 13. Muzeu i elektroekonomisë - Hidroelektrana "Prizrenasja"

Foto 14. Muzeu i Nënë Terezës

Epiteti i "Qytetit Muze" domosdoshmërisht reflekton ruajtjen e strukturës historike të qytetit dhe rrjedhimisht nënkupton edhe promovimin e kësaj pasurie tek publiku i gjërë. Edhe Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ tek rajoni jugor ku përfshihen Komuna e Prizrenit, e Suharekës dhe e Dragashit (të cilat në aspekt hapësinor ky Plan i koncepton si Kopshte të Kosovës) tek vizioni dhe qëllimet e përgjithshme përmend që Prizreni duhet të shpallet dhe të promovohet si "Qytet muze".

Duke e ditur se qyteti i Prizrenit është një nga qytetet më të vizituara në Kosovë, një nga mjetet e promovimit të kësaj pasurie të Prizrenit janë edhe muzetë që mes tjerash kanë po këtë mision. Mirëpo a e meriton një epitet të tillë sot Prizreni? Sa muze sot gjenden në Prizren dhe sa prej tyre janë funksionale e të hapura për publik? Në çfarë gjendje janë dhe çfarë ofrojnë muzetë e këtij qyteti? Sa reflektohet diversiteti kulturor i këtij qyteti në muzetë e saj?

Sipas hulumtimeve më të reja[8] muzetë e qyteti të Prizrenit nuk i plotësojnë në tërësi standardet ndërkombëtare të aplikueshme. Rrjedhimisht, epiteti "Qytet muze" përfshi këtu humbjen dhe degradimin e viteve të fundit në lokalitetet e trashëgimisë kulturore, duket të jetë i pameritуar.

Dy nga gjithsej gjashtë muzetë e qytetit nuk janë të hapura fare për publikun dhe nuk janë funksionale. Edhe gjendja në katër muzetë tjera të qytetit nuk duket të jetë në nivel të kënaqshëm profesional dhe teknik.

Problemet e përgjithshme që paraqiten në këto katër muze që janë në funksion fillojnë që nga ajo se asnjëra nga to nuk përfaqësohen në asnjë iniciativë ndërkombëtare apo rajonale; nuk e përfaqësojnë denjësisht diversitetin kulturor të qytetit të Prizrenit; nuk kanë shërbime bashkëkohore me të cilat do të ishin atraktive për vizitorë; nuk janë fare gjithpërfshirëse në aspekt të trajtimit të nevojave të audiencës bashkëkohore por edhe të audiencës së personave me aftësi të kufizuara, etj.

Edhe pse muzetë ekzistuese kanë fond të vlefshëm dhe të pasur të koleksionit, prezantimi i tyre në disa raste nuk bëhet në mënyrë adekuate, sikurse pluhuri në eksponate, xhamat e vitrinat e dëmtuara, veshjet tradicionale të gozhduara në mure, etj.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme për nga pesha, në muzetë e qytetit vërehet mungesë e madhe e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale.

Në vijim gjendet një listë me rekomandime të adresuara në tri nivele të ndryshme se si të trajtohen problematikat dhe sfidat e paraqitura në muzetë e qyteti të Prizrenit:

<u>Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</u>

- Të adpotohet sa më parë ligji që rregullon themelimin dhe funksionimin e muzeve nëpër komuna të Kosovës
- Të adoptohet udhëzimi administrativ për Komuna ku definohen tipologjitë e muzeve dhe kërkesat ligjore që duhet të përmbushen për themelim dhe funksionim të tyre
- Të tejkalohet koncepti i muzeve etnologjike/etnografike duke u përkrahur konceptet e reja të muzeve që kanë interaksion / komunikim më të lartë me publikun
- Të krijohet një databazë e të dhënave dhe statistikave të vizitorëve të muzeve që menaxhohen nga ky institucion përfshi edhe të hyrat që gjenerojnë ato
- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale të stafit të muzeve që menaxhohen nga ky institucion

8 Hulumtimi "Prizreni, "qytet muze" pa muze?" EC Ma Ndryshe 2018

- Muzeu i Lidhjes së Prizrenit dhe Muzeu Arkeologjik të kalojë nën ombrellë të Komunës së Prizrenit për menaxhim sa më efikas. Aktivitetet e muzeve mund të finacohen bashkarisht nga MKRS dhe Komuna e Prizrenit
- Konsultim publik dhe gjithpërfshierje në menaxhim të muzeve ekzistuese dhe planifikim të ndërtimit të muzeve të reja
- Hapja dhe funksionalizimi i muzeut të Hidroelektranës
- Hapja dhe funksionalizimi i muzeut të Nënës Terezë
- Hapja dhe funksionalizimi i muzeut të Kalasë së Prizrenit

Komunës së Prizrenit

- Të krijohet një databazë e të dhënave dhe statistikave të vizitorëve të muzeve që menaxhohen nga ky institucion përfshirë edhe të hyrat që gjenerojnë ato
- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale të stafit të muzeve që menaxhohen nga ky institucion
- Konsultim publik dhe gjithpërfshirje në menaxhim të muzeve ekzistuese dhe planifikim të ndërtimit të muzeve të reja
- Monumentet e qytetit që nuk kanë funksion të adaptohen në muze me tematike kreative në mënyrë që të parandalohet degradimi dhe mosshfrytëzimi i tyre
- Të themelohet Muzeu i Qytetit të Prizrenit ku do të prezantohej historia dhe zhvillimi urban i qytetit, shtresimet kulturore përgjatë historisë ku do të bëhej edhe prezantimi i diveristetit kulturor të qytetit. Muzeu do të duhej të përfshinte edhe pjesën e personaliteteve të rëndësishme të qytetit përgjatë historisë, apo të trajtohet edhe si muze në vete
- Të themelohet Muzeu për aktorin e njohur Bekim Fehmiun

Muzeve të qytetit të Prizrenit

- Të krijohet një sistem menaxhimi efikas i sistemimit të stafit profesional dhe teknik
- Të pasurohet fondi ekzistues i muzeve që menaxhohet duke bërë interpretim bashkëkohor të koleksionit në të gjitha gjuhët zyrtare lokale dhe atë angleze si dhe përfshierja e audio guidave, video projeksioneve, ekpozitave virtuale, etj
- Të ndërrohet orari i punës së muzeve nga ditët e zakonshme të punës. Gjatë fundjavës qyteti ka vizitorë më të shumtë dhe rrjedhimisht edhe muzetë duhet të jenë të hapura
- Orari publik, bashkë me kohën e vizitës, çmimin e biletave, telefonin dhe webfaqen duhet të vendosen në tabelën hyrëse të muzeut
- Ofrimi i biletave të përbashkëta ku vizitorët me një biletë të çmimit më të volitshëm do të mund të vizitojnë disa apo të gjitha muzetë e qytetit
- Muzetë e qytetit të riadaptohen në mënyrë që të shfrytëzohen për aktivitete të ndryshme, sikurse konferenca, seminare, punëtori. Në këtë mënyrë do të krijoheshin edhe të ardhura shtesë për qëndrueshmërinë e muzeve
- Të planifikohen programe të veçanta edukative dhe interaktive për nxënës dhe studentë në mënyrë që të jenë sa më atraktive për ti vizituar, p.sh. krijimi i këndeve të veçanta me kopje të artefakteve që mund të preken, përpunohen dhe të vizatohen
- Të eliminohen barrierat fizike në muze dhe të adaptohen për përdorim edhe për persona me aftësi të kufizuara, p.sh. rampa e përshtatshme në hyrje të muzeut, qasja e papenguar (pa pragje) në brendi të muzeut, WC për persona me aftësi të kufizuara, interpretimi i koleksionit

në alphabet Braille për të verbër, shenjëzimi i përshtatshëm për persona pjesërisht të verbër, etj

- Të planifikohen programe të veçanta edukative dhe interaktive për persona me aftësi të kufizuara në mënyrë që të jenë sa më atraktive për ti vizituar
- Në mënyrë që të krijohet vetëqëndrueshmëria financiare duhet të aplikojnë forma të ndryshme të biznesit në mënyrë që të mos jenë të varur plotësisht nga fondet publike (këndi i kafes/çajit/pijeve, dyqan suvenirësh, librari, etj). Në këtë mënyrë do të krijoheshin edhe vende të reja të punës
- Të dizajnohen publikime të veçanta për koleksionin ekzistues të muzeve
- Të krijohen web faqet për muzetë përfshirë edhe vizitat virtuale
- Të shtohen kanale të ndryshme të komunikimit në faqet e mediave sociale duke e marrë parasysh shfrytzueshmërinë e lartë të tyre, sidomos mes të rinjve

1.5.4 Shenjëzimi dhe reklamimi

Sinjalistika rrugore, shenjëzimi i lokaliteteve të trashëgimisë dhe tabelat interpretuese të këtyre lokaliteteve janë pjesë përbërëse, në mos esenciale të promovimit të një lokaliteti të trashëgimisë kulturore por edhe natyrore.

Në botë ekzistojnë standardet e përcaktuara për sinjalistikë rrugore dhe shenjëzim të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Edhe pse ato mund të variojnë nga shteti në shtet ajo që është e përbashkët është ngjyra e kaftë/e artë e cila e simbolizon këtë standard ndërkombëtar.

Përshtypja e parë e një vizitori kur e viziton qytetin e Prizrenit është mungesa e shenjëzimit adekuat të lokaliteteve të trashëgimisë apo edhe në raste tjera laramania apo shumëllojshmëria e shenjave dhe reklamave që paraqiten. Kjo laramani shpesh le përshtypje kaotike për një qytet historik i cili do të duhej të ishte tërheqës edhe në aspekt vizuel.

Edhe lokalitetet e trashëgimisë botërore të UNESCO-s përmbajnë të njëjtin standard vetëm se shënohet qartë edhe simboli mbrojtës i UNESCO-s. Shenjëzimi në nivel ndërkombëtar përpos sinjalistikës, orientimit të vizitorëve dhe promovimit të lokaliteteve, përdorë edhe standarde të veçanta dhe mund të përqojë edhe mesazhe të ndryshme.

Sipas hulumtimeve të fundit[9], në qytetin e Prizrenit dhe në mënyrë të veçantë, në qendrën historike të saj gjendja e shenjëzimit si dhe e reklamave komerciale paraqitet më se kaotike. Arsye për këtë është niveli jo i kënaqshëm i normativave ekzistuese, moszbatimi i tyre por edhe mungesa e udhëzuesve teknik për biznese që do të rregullonte këtë fushë. Kjo problematikë shprehet edhe më shumë kur kemi një nivel të ulët të vetëdijes qytetare duke mos aplikuar standarde ndërkombëtare të shenjëzimit të një qyteti historik.

Foto 15. Shenjëzimi në QHP

Plani i konservimit dhe i zhvillimit i zonës historike të Prizrenit

Plani i konservimit dhe i zhvillimit i zonës historike të Prizrenit i hartuar më 2006 dhe i adoptuar më 2009 si Plan Rregullues i Hollësishëm jep rekomandime të përgjithshme por jo dhe udhëzues grafik për rregullimin e shenjëzimit në qendrën historike të qytetit. Rekomandimet specifike janë dhënë në vijim:

Materialet e shenjave dhe skema e ngjyrave duhet të respektojnë materialin dhe skemën e ngjyrave të objektit, si dhe karakterin e pamjes rrugore. Materialet e lejuara janë druri, druri i ngjyrosur, metal i petëzuar, hekuri i farkuar, bronzi, apo legura të tjera, gur, xham apo material plastik vetëm si fleta të petëzuara. Materialet që nuk janë të lejuara janë alumini i anodizuar,

[9] "Shenjëzimi dhe reklamimi kaotik në Qendrën Historike të Prizrenit" EC Ma Ndryshe, 2018

azbesti dhe fletat e plastikës apo vinilit të shtypura digjitalisht, të përdorura në ndonjë mënyrë tjetër pos asaj të specifikuar.10

Shenjat për dyqane individuale duhet të vendosen në atë mënyrë që të mos mbulojnë ndonjë detaj integral arkitektonik. Shenjimi i trashëgimisë historike, sikurse gdhendjet tradicionale në llaq, relievet në dru ose gdhendjet në gurë, etj. të cilat dëshmojnë informata për emrin origjinal të objektit, vitin e ndërtimit, emrin e pronarit të vjetër ose të gjitha informatat tjera të trashëgimisë historike duhet të ruhen.11

Ligji për Qendrën Historike të Prizrent

Sipas këtij ligji, neni 6, një ndër aktivitetet e kufizuara në këtë zonë paraqet vendosjen e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve penguese me sipërfaqe më të madhe se një metër katror (1m^2) dhe pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

Për më tepër, sipas Nenit 21 të po të njëjtit ligj, Komuna e Prizrenit, në kuadër të fushëveprimit të saj, themelon një Zyrë për Qendrën Historike të Prizrenit. Kjo zyrë ka katër fushëveprimtari, prej të cilave e katërta ka mandat të nxjerrjes dhe shpërndarjes së informatave të sakta sa i përket Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë hartat informuese, listën e shërbimeve të ofruara, agjendat kulturore dhe reklamat. Kjo Zyre, që nga viti 2012, shkaku i neglizhencave institucionale të nivelit qendror por edhe atij lokal ende nuk është themeluar.

Vendimi mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit

Komuna e Prizrenit, në vitin 2015, pas aprovimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit adopton edhe një Vendim të veçantë mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit, përfshi edhe ato në Qendrën Historike të qytetit.

Sipas këtij Vendimi lejimi për vendosjen e Tabelave dhe Reklamave në Qendrën Historike të Prizrenit do të përcaktohet sipas kushteve dhe kritereve duke respektuar vlerat kulturore-historike të objekteve dhe lokacioneve. Nenet më specifike të këtij vendimi janë përshkruar më poshtë:

Në nenin 2.1 të këtij Vendimi thuhet se "Vendosja e reklamave, shenjave private, dekorimeve nuk duhet te jetë në sipërfaqe më të madhe se një metër katror (1m^2),dhe me pëlqim paraprak të Insitutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit. Por varësisht prej madhësisë dhe natyrës së ndërtesës, institucioni kompetent (QRTK Prizren) mund të kërkojë që këto reklama të jenë edhe më të vogla ose te mos lejohet vendosja fare".

Neni 2.2: Reklamat nuk lejohen të vendosen në pullaz të ndërtesës, në elemente dekorative të saj si dhe në pjesë ku ajo e rrezikon strukturën e ndërtesës si dhe në pjesën ku ajo pengon vizurat në vet ndërtesën apo ndërtesat përreth saj.

Neni 2.3: Varësisht nga madhësia e fasadës, reklama nuk duhet te zë me shumë se 20% e sipërfaqes ku ajo vendoset.

Neni 2.6: Materiali i reklamës nuk mund të jetë emetues (rrezatues) i dritës (në formë ekrani) ose që brenda saj të ketë burim drite.

[10] Normativat për detajet dhe dekorimet nga Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit (2009)

[11] Detajet dhe ornamentet e arkitekturës qytetare nga Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit (2009)

Neni 2.7: Reklama nuk lejohet të formohet me drita fluroshente, as me drita lëvizëse (dinamike).

Neni 2.9: Kur natyra e ndërtesës nuk mundëson vendosjen e reklamës, ose kur ndërtesa ka vlerë të lartë kulturore, historike etj, ateherë reklama vendoset në xham të vitrinës ose të aneksuar (sipas udhezimeve të QRTK-së);

Neni 2.10: Materiali i reklamës nuk guxon të dëmtojë ndërtesen ose kalimtarët në çfarëdo mënyre;

Neni 2.11: Reklama mund të shkruhet në materiale të ndryshme (në përputhje me pikën 5) dhe ajo (reklama) mund te ndriçohet me një dritë të bardhë (jo me ngjyra) jashtë saj.

Foto 16. Tabelë interpretuese në Kala

Në fund, duhet të ceket poashtu se në Qendrën Historike të Prizrenit vërehet një mungesë evidente e tabelave të interpretimit si në muzetë e qytetit por edhe në monumente të trashëgimisë, ku përjashtim bën ndoshta vetëm Kalaja e Prizrenit.

Nga ky hulumtim janë identifikuar gjithsej 224 ndërtesa që kanë tabela dhe reklama komerciale të bizneseve të ndryshme që janë në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Vendimin mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit.

Foto 17. Reklamat që nuk janë në pajtim me ligjin dhe vendimet në fuqi

Në bazë të të dhënave të prezantuara në këtë hulumtim, gjendja e shenjëzimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Qendrën Historike të Prizrenit përfshirë këtu edhe vendosjen e shenjave dhe reklamave në fakt reflekton edhe gjendjen e përgjithshme të kësaj fushe në nivel vendi.
Filllimisht mungon legjislacioni në nivel qendror, përderisa në nivel lokal edhe pse ekzistojnë disa dokumente, ligje dhe vendime që rregullojnë këtë lëmi vërehet një mosvullnet i zbatimit të tyre qoftë nga institucionet apo edhe nga vet bizneset dhe qytetarët.
Komuna e Prizrenit ka dëshmuar se nuk mund ta kontrollojë gjendjen duke mos aplikuar gjoba për shkelësit e ligjit si dhe nuk jep udhëzime detaje se si duhet të dizajnohen ato. Për më tepër, Komuna nuk gjeneron edhe të ardhura nga këto reklama gjë që në vendet tjera është praktikë që aplikohet.
Në përgjithësi vërehet një tendencë tek partitë politike, organizatat por edhe tek bizneset që reklamat të vendosen pa leje dhe pëlqim të organeve kompetente të trashëgimisë kulturore. Si rrjedhojë evidentohen edhe dëmtime fizike në monumente dhe degradim i përgjithshëm vizuel në qendër historike për qëllime reklamimi.

Rekomandime

<u>Institucioneve të nivelit qendror</u>

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë përcaktimin e legjislacionit për standardizimin e sinjalistikës rrugore për lokalitetet e trashëgimisë kulturore.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe dhe Ministria e Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë udhëzuesin për komunat e Kosovës ku do të përcaktohej formati teknik i shenjave për sinjalistikë rrugore dhe atë këmbësorike përfshi edhe çështjen e shumëgjuhësisë që duhet të paraqitet tek shenjat e trashëgimisë kulturore.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë përcaktimin e legjislacionit për standardizimin e sinjalistikës rrugore për lokalitetet e trashëgimisë natyrore.

<u>Komunës së Prizrenit</u>

- Përditësimi dhe përmirësimi i Vendimit mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit duke i shtuar disa nene përkatëse dhe duke qartësuar disa të tjera.
- Hartimi i udhëzuesit grafik për shenja dhe reklama në Qendrën Historike të Prizrenit. Ky udhëzues duhet të trajtojë saktë se si adresohen këto reklama në ndërtesa të trashëgimisë kulturore dhe ato të reja.
- Pas përditësimit të Vendimit dhe hartimit të udhëzuesit teknik, paralajmërimi i të gjithë pronarëve në Qendrën Historike të Prizrenit për tejkalim në reklamave dhe përcaktimi i një afati (propozim: 3 mujor) për përmirësim të tyre nga vet pronarët.
- Të aplikohen tarifa të veçant dhe taksa për reklamim në mënyrë që Komuna të gjenerojë të ardhura.
- Në rast të mosrespektimit nga ana e pronarëve, të aplikohen gjoba sipas ligjit në fuqi dhe të largohen reklamat që janë në kundërshtim me Ligjin për qendrën historike të Prizrenit dhe Vendimit mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit.
- Pas aprovimit të standardeve nga niveli qendror, dizajnimi dhe vendosja e sinjalistikës rrugore këmbësorike për lokalitetet e trashëgimisë kulturore me aprovim të institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore.
- Dizajnimi dhe vendosja e paneleve interpretuese në monumentet e Qendrës Historike të Prizrenit me aprovim të institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore.
- Hartimi i aplikacioneve për telefona të mençur të cilat do të bashkëvepronim me barkod të vendosur në muret e jashtme të monumenteve të qytetit të Prizrenit.

1.5.5 Zona e Dytë e Mbrojtjes

Në bazë të analizave, të dhënave dhe konform parimeve ndërkombëtare për zonim të vlerave të trashëgimisë kulturore, Plani Zhvillimor Urban 2003-13 definon 3 (tri) Zona nën Mbrojtje në kuadër të qytetit të Prizrenit. Kufijtë e zonave nën mbrojtje janë paraqitur në hartën e mëposhtme:



Harta 3. Zonat nën mbrojtje sipas Planit Zhvillimor Urban 2003-2013

Zona e Dytë e Mbrojtjes do të përfshinte pjesët e qytetit të vjetër me integritet më të vogël urbanistik dhe arkitektonik por i cili mund të identifikohet si sistem i tërësishëm urban dhe i cili detyrimisht kërkon forma të koordinuara të veprimit. Kjo zonë akoma reflekton me komplekse sikurse ai i Karabashit dhe objekte me vlera historike, arkitektonike e ambientale por të cilat janë transformuar ashtu që është vënë në rrezik karakteri historik, arkitektonik dhe ambijental i zonës. [12]

Ekipi i projektit të Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit, në mënyrë që hulumtimi i strukturtës urbane dhe historike të mos përkufizohet vetëm në kufij të QHP, është zgjëruar edhe në Zonën e Dytë të Mbrojtjes dhe një pjesë të Zonës së Kontaktit. Kriteret e hulumtimit (edhe pse të reduktuara në disa aspekte) janë mbajtur të njetja me ato të QHP. Në hulumtim janë përfshirë mbi 2000 struktura. Në vijim gjeni të bashkangjitur të gjeturat nga kjo pjesë e hulumtimit:

12 Plani Zhvillimor Urban

Në vijim gjeni të bashkangjitura hartat nga hulumtimi në terren. Për kualitet më të lartë të hartave, shih Shtojcën 2.

Legjenda / Legend
Kufiri i QHP / Borders of HCP
Zona e Dytë e Mbrojtjes / Second Protection Zone

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA23. Kufiri i Qendrës Historike të Prizrenit dhe Zona e Dytë e Mbrojtjes
MAP23. The border of the Historic Center of Prizren and the Second Protection Zone

Legjenda / Legend
Kufiri i QHP / Borders of HCP
Zona e Dytë e Mbrojtjes / Second Protection Zone
Zona e hulumtuar / Research area

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA24. Zona e hulumtuar (Zona e Dytë e Mbrojtjes + një pjesë e Kokltakt Zonës)
MAP24. Research area (Second Protection Zone + part of Contact Zone)

Legjenda / Legend

- Ndërtesa të reja / New buildings (89%)
- Ndërtesa më të vjetra se 50 vjet / Buildings older than 50 years (11%)
- Të tjera-Pa info / Other-no info

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA25. Koha e ndërtimit
MAP25. Building age



Legjenda / Legend

- Ndërtim e sipër / Under construction
- Monument / Mounment
- Pa info / No data
- 1
- 1,5
- 2
- 2,5
- 3
- 3,5
- 4
- 4,5
- 5
- 6
- 6,5
- 7,5
- 8
- 11

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA26. Numri i etazhave të ndërtesave
MAP26. Number of stories in the buildings

Legjenda / Legend

- E mirë / Good (94%)
- Mesatare / Medium (3%)
- E keqe / Bad (1%)
- Shumë e keqe / Very bad (0%)
- Pjesërisht e rrënuar / Partially demolished (0%)
- E rrënuar / Demolished (0%)
- Pa info / No data

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA27. Gjendja fizike e ndërtesave
MAP27. Physical condition of buildings

Legjenda / Legend

- E mirë / Good (56%)
- Mesatare / Medium (26%)
- E keqe / Bad (11%)
- Shumë e keqe / Very bad (3%)
- Pjesërisht e rrënuar / Partially demolished (4%)
- E rrënuar / Demolished (1%)
- Pa info / No data

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA28. Gjendja fizike e ndërtesave më të vjetra se 50 vjet
MAP28. Physical condition of buildings older than 50 years

Legjenda / Legend

Xhami me kupolë / Mosque with dome	1	Shtëpi me zgjidhje të veçantë / House with special solutions	19
Xhami me kulm / Mosque with roof	2	Shtëpi me qoshk / House with closed galery	4
Teqe / Masjid	1	Shtëpi me sallë qendrore / House with central hall	5
Shtëpi / House	100	Shtëpi me qardak / House with open galery	3
Postë	1	Shtëpi e mbyllur me kat / House with closed story	4
Ndertese administrative	1	Shtëpi përdhese / Groundfloor house	13

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport
rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA29. Tipologjia dhe nëntipet arkitektonike
MAP299. Typology and architectural subtypes



Legjenda / Legend

- E shfrytëzueshme / Used (83%)
- Pjesërisht e shfrytëzueshme / Partially used (2%)
- E pashfrytëzueshme / Not used (15%)
- Pa info / No data

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport
rrok

PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
MANAGEMENT PLAN FOR PRIZREN HISTORIC CENTER

HARTA30. Shfrytzueshmëria e ndërtesave
MAP30. Usability of bulings



Konkluzion

Në bazë të hulumtimi të zonës së Dytë të Mbrojtjes si dhe një pjese të Zons së Kontaktit, rekomandohet që të kryhet inventarizim i plotë i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe dhënia e statusit të mbrotjes atyre që i plotësojnë kriteret. Për më tepër kjo zone përmban edhe fragmente të komplekseve të ndryshme arkitektonik që duhet të ruhen dhe konservohen.

Duke e pasur parasysh rrjedhën e kompleksit të dyqaneve tek Rruga Adem Jashari ato formësojnë një kompleks arkitektonik me vlera të veçanta. Ky kompleks arkitektonik, me kufirin e QHP ndahet në dysh dhe rekomandohet që në të ardhmen të zgjrohet kufiri i QHP deri tek Shtëpia e Bardhë/Kuvendi i Komunës.

1.6

Analiza SWOT

1.6 ANALIZA SWOT

Në takimet e ndryshme joformale e formale, takime konsultative dhe punëtori të organizuara gjatë procesit të hartimit të Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit është hartuar edhe analiza SWOT. Kjo analizë ka definuar përparësitë, mangësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në QHP dhe faktorë tjerë në kontekstst më të gjërë të Komunës së Prizrenit. Kjo analizë në masë të madhe ka shërbyer edhe si mjet për definimin e vizionit, synimeve dhe objektivave kryesore për mbrojtjen dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit.

SWOT analiza është njëra nga mjetet për vlerësim të gjendjes ekzistuese e cila shërben për të mbledhur ide të ndryshme nga përfaqësuesit e sektorit të caktuar, të cilët marrin pjesë në proces në mënyrë aktive. Emri i SWOT analizës rrjedh nga shkronjat e para të fjalëve në gjuhën angleze:

Përparsitë / Strengths – atributet pozitive të brendshme të QHP.

Dobësitë / Weaknesses – atributet negative të brendshme të QHP.

Mundësitë / Opportunities – faktorë të jashtëm të cilët mund të përmirësojnë gjendjen e QHP.

Rreziqet / Threats – faktorë të jashtëm të cilët mund të rrezikojnë dhe përkeqësojnë gjendjen e QHP.

Puna me palë të ndryshme interesit të kyqur në proces të hartimit të projektit rezultoi me këto të dhëna në pesë fusha të ndryshme tematike:

Foto 1. Pamje nga punëtoritë gjatë procesit të hartimit të PMQHP

1. Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Përparësitë	1. Mbrojtja ligjore – Numri i madh monumenteve që kanë status/mbrojtje të veçantë – Infrastruktura ligjore ekzistuese – Kapacitet i mjaftueshëm profesional dhe njerëzor për avancimin e TK – Ekzistimi i mekanizmave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (KTKQHP & QRTK) 2. Prezenca në Listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s – Kisha e Shën Premtes si pjesë e katër monumenteve mesjetare të Kosovës në listën e trashëgimisë në rrezik të UNESCO-s 3. Llojllojshmëria e aseteve të trashëgimisë – Laramania e trashëgimisë kulturore (stilet e ndryshme arkitekturore dhe llojllojshmëria brenda një sipërfaqeje të vogël) – Ansamble të ruajtura (Papaz Qarshija, Sheshi Shadërvan, Rruga e Farkatarëve, Kompleksi i Marashit, Kompleksi i Lidhjes se Prizrenit, pjesërisht Adem Jashari) – Struktura karakteristike urbane (prania e natyrës në zonë urbane) 4. Prania e projekteve të ndryshme investive në kuadër të QHP – Projekti i adaptimit dhe interpretimit të Kalasë së Prizrenit 5. Trashëgimia natyrore dhe ambienti – Prania e lumit në Qendrën Historike të Prizrenit – Qyteti i rrethuar me male (Malet e Sharrit) – Biodiversitet i pasur – Prania e zones së gjelbëruar në afërsi të zonës urbane Shadërvan-Marash – Bashkëdyzimi mes natyrës dhe arkitekturës (uji, druri dhe guri) – Komunitet i qytetarëve që merret me rekreacion 6. Hapësirat publike – Festivali "Bunarfest" – promovimi për kujdesin ndaj natyrës nëpërmjet festivalit – Shtegu për ecje Marash – Kala
Mangësitë	1. Zbatimi jo i kënaqshmëm i ligjit dhe mungesa e vullnetit politik – Mos-respektimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e QHP – Mos-implemenetimi i ligjit (tejkalimet & lejet e ndërtimit, reklamat, uzurpimi i hapësirave publike, etj) – Mungesa e koordinimit të instituconeve dhe akterëve – Mungesa e vullnetit politik në nivel lokal dhe pjesërisht qendror për ruajtjen e trashëgimisë kulturore – Mungesa e stafit të kualifikuar në drejtorinë e inspektorateve në Komunën e Prizrenit – Mungesa e qasjes së Drejtorisë së Urbanizmit në monumente (vetëm MKRS e ka këtë kompetencë) – Mungesa e përkrahjes nga policia e Kosovës për funksionim adekuat të inspektorëve në terren 2. Sfidat në restaurim të monumenteve – Mungesa e investimeve për mirëmbajtje dhe restaurim te monumenteve – Mungesa e mirëmbajtjes së monumenteve – Mungesë e fondeve për restaurim – Mirëmbajtje e kushtueshme 3. Sfidat në funksionalizim të monumenteve – Mungesa e funksionimit të monumenteve të restauruara

	– Mungesa e Muzuet të Historisë së Qytetit – Mungesë e menaxhimit dhe funksionimit të monumenteve 4. Shenjëzim jo i mirëfilltë – Mungesa e shenjëzimit dhe e përshtatjes me ate ekzistuese – Shenjëzimi jo adekuat 5. Qasje jo e qëndrueshme për të gjithë – Mungesa e qasjes për Persona me Nevoja të Veçanta – Hapësirat nën menaxhim të Kishës Ortodokse Serbe nuk ofrojnë qasje të lirë për qytetarë dhe vizitorë 6. Sfidat në legjislacion – Statusi i padefinuar ligjor i pronave private nën mbrojtje – Uzurpimi i hapësirave publike dhe i monumenteve – Qasja e kufizuar në ndërtesave të vjetra – Kontekstet pronësore – sfidë për zbatimin e punimeve brenda Qendrës Historike të Prizrenit – Mungesa e dënimit / ngritja e kallëzimeve penale ndaj shkelësve të ligjit brenda QHP 7. Mungesa e Menaxhimit të mirëfilltë – Plani i menaxhimit për Kalanë e Prizrenit nuk parasheh ndonjë hap konkret për zhvillim të ndërhyrjeve konservuese/ restauruese në hapësirën e Kalasë. – Mungesa e drejtorisë / seksionit për trashëgimi kulturore brenda Komunës së Prizrenit – Angazhimit joserioz i Komunës së Prizrenit rreth monitorimit të zbatueshmërisë së ligjeve – Funksionimi i parkingjeve ilegale të ndërtuara në vend të shtëpive të vjetra dhe mos ndëshkimi i tyre nga Komuna e Prizrenit – Dështimi i institucioneve për adresimin e duhur të çështjeve lidhur me punët konservuese/ rindërtuese në Kalanë e Prizrenit. Ndërtimi i Muzeut në Kala (rindërtim mbi themelet egzistuese) dhe refuzim i rindërtimit të xhamisë në Kala pas peticionit të organizuar nga komuniteti (rindërtim mbi themelet egzistuese) ka krijuar model jotransparence dhe standard të dyfishtë të trajtimit të çështjeve. – Tejkalimi i lejeve dhe punimet pa leje nga ana e Kishës Katolike në hapësirat e kompleksit të Kishës së Zonjës Ndihmëtare në Prizren 8. Mungesa e infrastrukturës për trashëgimi natyrore – Mungesa e rampave të përshtatshme në zonë – Mungesa e hartave për trashëgimi natyrore 9. Sfidat ambientale – Zvogëlimi i hapësirave të gjelbëruara – Mungesa e avokimit për mbrojtje të natyrës – Ndotja akustike (zhurma, muzika) – Mungesa e faunës në lum – Mungesa e gjelbërimit – Mungesa e komunitetit të organizuar të ambientalistëve të qytetit – Ndotja akustike e papërballueshme për banoret (max 70db) 10. Sfidat në hapësirat publike – Problemi i mbeturinave dhe dobësitë e sistemit të menaxhimit të higjienës – Dizajnimi jo adekuat i hapësirave publike – Uzurpimi i hapësirave publike – Lokaliteti arkeologjik pa përkujdesje adekuate tek sheshi i Lidhjes – Mosmirëmbajtja e hapësirave publike në Marash – Mungesa e adresës për lajmërim të emregjencave në QHP

	– Mungesa e toaleteve publike, shportave, etj – Mungesa e menaxhimit të hapësirave publike – Mungesa e këndeve të përshtatshme për fëmijë – Mungesa e qasjes për persona me aftesi të kufizuara
Mundësitë	1. Themelimi i Zyrës së QHP për zbatim të Planit të Menaxhimit të QHP dhe lehtësimi i koordinimit mes institucioneve dhe palëve të ndryshme 2. Procesi gjithpërfshirës i hartimit të Planit të Menaxhimit të QHP 3. Hartimi i Planit të ri / revidimin i Planit te Konservimit te QHP/Planit Rregullativ 4. Revidimi i Planeve ekzistuese 5. Interesimi i donatorëve për investim në QHP 6. Ngritja e QHP-se si prioritet për investim në nivelin qendror 7. Qendra Historike e Prizrenit prioritet i agjendes shtetërore të Kosovës 8. Zyra për QHP duhet të mbledhë akterët kryesorë: Komuna e Prizrenit, MKRS / QRTK dhe shoqërinë civile 9. Instalimi i misioneve diplomatike apo entiteteve tjera administrative në QHP 10. Gjentrifikimi i planifikuar i procesit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore 11. Konvertimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në funksione kreative përmes ripërdorimit adaptiv 12. Gjenerimi i të ardhurave nga monumentet 13. Shfrytëzmi i hapësirave të pashfrytëzuara për qëllime të ndryshme (Kulturë, OJQ, Bamirësi, Shëndetësi) 14. Trashëgimia natyrore dhe ambienti – Integrimi (rikthimi) i lumit Lumbardh në hapësirën urbane dhe në jetën shoqërore – Kontrollimi i hyrjes në Kala dhe krijimi i ekipit menaxhues për zhvillimin e qëndrueshëm të saj – Integrimi i Kalasë dhe Dalltullumit në pjesën historike – Riciklimi i mbeturinave – Edukimi i gjeneratave të reja për trashëgimi natyrore 15. Hapësirat publike – Rifunksionalizimi i Kino Lumbardhit si hapësirë publike alternative – Krijimi i hapësirave të qëndrueshme për shfrytëzim gjatë tërë vitit – Mundësia e hapjes së hapësirave rreth monumenteve për aktivitete alternative – Ri-dizajnii i shesheve dhe hapësirave ekzistuese publike – Identifikimi i pronave publike në pronësi të Komunës së Prizrenit dhe ridestinimi i tyre për aktivitete kulturore
Kërcënimet	1. Dështimi në anëtarësim në UNESCO 2. Politizimi i trashëgimisë në kontekst të QHP 3. Mungesa e Strategjise se Zhvillimit te Qëndrueshëm bazuar në potencialet e QHP 4. Zhvillimet e pakontrolluara urbane dhe ekonomike 5. Uzurpimi i monumenteve, ndërtesave dhe objekteve publike 6. Ndotja akustike nga zhurma e kafiterive dhe lokaleve, sidomos në Xhaminë e Sinan Pashës, Saraçhanes dhe Sejdi Beut 7. Intervenimet joprofesionale adekuate në monumente dhe në strukturë urbane 8. Humbja e strukturës së vjetër urbane 9. Humbja e teknikave tradicionale të ndërtimit 10. Mungesa e tregut të materialeve tradicionale 11. Getoizimi i qendrës historike (hapësirat e 7 korrikut, Pantelisë, Nënkalasë) 12. Degradimi i pronave private 13. Ndotja e mjedisit, ujit (kanalizimi që derdhet në lum), erozioni i tokës në Kala

	14. Zhdukja e florës dhe faunës në Lumbardh 15. Projekti i betonizimit (kaskadave) te Lumbardhit

2. Edukimi, trashëgimia shpirtërore dhe aktivitetet kulturore

Përparësitë	1. Kultura dhe vetëdija kolektive – Qytet me diversiteti kulturor, fetar e gjuhësor – Ndërlidhja e tashëgimisë urbane me ato shpirtërore – Kujtesa kolektive për qendrën historike, gjegjësisht qyteti, ndërtimet dhe ngjarjet – QHP si burim i institucioneve të rëndësishme kulturore (Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Shkolla e Muzikës, SHKA Agimi, Teatri, Kinemaja, Dogri Yoli dhe SHKA-të) – Pozita qendrore në jetën shoqërore dhe publike 2. Komunitet aktiv për mbrojtje të TK – Monumentet publike dhe fetare me komunitet e veta aktive – Vetëdija e lartë kolektive dhe e shoqërisë civile për vlerat e trashëgimisë kulturore të qytetit 3. Numër i madh i festivaleve, konkurrent i denjë edhe i kryeqytetit të Kosovës 4. Trashëgimia shpirtërore – Folklori – Llojllojshmeria në kulinari – Folklori-veshjet popullore – Zakonet – Tradita në zeje si Filigran
Mangësitë	1. Mungesa e mbështetjes dhe menaxhimit të mirëfilltë – Mungesa e (përditësimit) kalendarit të aktiviteteve kulturore – Mospërkrahja e artizanateve – Mungesa e qeverisjes kulturore 2. Infrastruktura jo e duhur për zhvillim kulturor – Mungesa e hapësirave për organizimin e aktiviteteve kulturore (sheshe, objekte, salla koncertale, etj) 3. Dokumentimi jo adekuat – Mungesa e inventarit të digjitalizuar të Trashegimisë Shpirtërore (shekullit XX, XIX, XVIII, veshjet/stolitë...) 4. Organizimi jo i qëndrueshëm i shoqatave kulturore / zejtare – Mosfunksionimi dhe moskoordnimi i shoqatës së artizanateve (politizimi i shoqatës) – Problemet në SHKA Agimi 5. Vetëdijesimi jo adekuat – Sensibilizimi i ulët mbi vlerat e trashëgimisë shpirtërore 6. Promovimi dhe zhvillimi jo i mjaftueshëm – Oferta shumë e kufizuar nëpër restorane që promovojnë kuzhinën tradicionale – Turizmi sezonal dhe jo i distribuar në tërë vitin 7. Prania e ndotjes akustike – Ndotja akustike nga kafenetë që pengon zhvillimin e aktiviteteve kulturore sikurse Dokufesti – Ndotja akustike nga aktivitetet muzikore të zhvilluara brenda QHP 8. Sfidat në promovimi të monumenteve – Mungesa e promovimit regjional dhe ndërkombëtar të QHP dhe TK të Prizrenit – Mungesa e narrativës dhe interpretimit të monumenteve, shtëpive dhe qendrës

	– Mungesa e promovimit online (digjital) 9. Sfidat rreth burimeve njerëzore – Mungesa e investimit në kapacitete njerëzore – Mungesa e resurseve njerëzore dhe kapaciteve profesionale (Restaurim, TK, Turizem, Menaxhim i Kultures) – Mungesa e kompanive të licensuara për restaurim 10. Edukimi dhe vetëdijesimi jo i mjaftueshëm – Mungesa e edukimit formal e joformal mbi trashegimi – Rrënimi i qëllimshëm i ndërtesave të vjetra – Mungesa e vullnetit të pronarëve privat për ruajtje të shtëpive të vjetra – Mungesa e pakove edukative për TK & QHP
Mundësitë	1. Përkrahja insitucionale e organizateve kulturore 2. Caktimi i kritereve për financim të aktiviteteve kulturore 3. Trajnimi dhe licencimi i stafit- ciceronave profesional për trashëgimi kulturore dhe natyrore dhe përkrahja e zyres së turizmit me kapacitete profesionale 4. Koordinimi-bashkëpunimi ndërmjet organizatave të kulturës dhe institucioneve lokale 5. Përkrahja e artizanateve - Filigran, Farkatarëve, Plis punuesit, qilim punuesit, punimet me lëkure-këpucë 6. Krijimi i hapësirave për organizim të aktiviteteve kulturore (salla koncertale, galeri, etj 7. Trajnimi i stafit në kulinari tradicionale 8. Interpretimi i legjendave, miteve, traditave urbane... 9. Brendimi i qytetit përmes figurave si Bekim Fehmiu, Suzi Celebiu etj. 10. Rikthimi i sharmit të qytetit nëpërmjet funksionalizimit të disa zakoneve të vjetra: funksionimi i topit në Kalanë e Prizrenit për të shënjuar ditët e veçanta fetare dhe zyrtare 11. Integrimi i potencialit njerëzor të Universitetit Publik në QHP / edukimi me punë praktike
Kërcënimet	1. Zejet në zhdukje 2. Mosinteresimi i gjeneratave të reja për zeje dhe kultivim të zejeve 3. Rrënimet e pakontrolluara të ndërtesave të vjetra

3. Zhvillimi ekonomik lokal

Përparësitë	1. Potenciali ekzistues i monumenteve të trashëgimisë kulturore – Rivitalizimi i Kalasë – Prania e aktiviteteve kulturore / festivalet (Dokufest, Zambaku i Prizrenit, Ngom Festi, 40Bunar Fest, etj) – Organizimi i panaireve tradicionale 2. Potenciali ekzistues i bizneseve – Remitenca nga diaspora gjate verës – Numri i madh i bizneseve të vogla aktive (NVM) – Numri i madhe i vizitorëve – Hapja e hoteleve dhe restoraneve 3. Potenciali njerëzor – Burime të mjaftueshme njerëzore 4. Peisazhi natyror dhe karakteri historik i qytetit i përshtatshëm për zhvillim të turizmit
Mangësitë	1. Mospërmbushja e përgjegjësive institucionale – Mungesa e informatave adekuate për trashëgimi në ueb faqe – Mungesa e strategjisë për zhvillim ekonomik dhe strategjisë për zhvillim turistik – Mungesa e përkrahjes së info qendrës nga qeveria lokale – Mungesa e organizimit të aktiviteteve për turistë 2. Senzibilizim jo i mjaftueshëm – Ndërgjegjësim jo i mjaftueshëm rreth rëndësisë dhe përfitimeve nga Qendra Historike e Prizrenit 3. Mungesa e turizmit dimëror – Mungesa e vizitoreve gjatë dimrit 4. Mungesa e infrastrukturës /lëvizshmërisë së mirëfilltë – Mungesa e aktiviteteve cross-border (ndërkufitare) – Mungesa e transportit të qëndrueshëm për turist; nga aeroporti në Prizren, transporti regjional Brenda kufive të komunës së Prizrenit – Informimi jo i mjaftueshëm rreth aktiviteteve dhe vlerave edhe në regjion të Prizrenit 5. Prania e aktiviteteve pa leje – Laramania e tepërt e e reklamave tek shitoret që prishin karakterin historik të qytetit – Prezenca e kiosqeve jo adekuate që prishin karakterin historik të qytetit
Mundësitë	1. Trashëgimia kulturore dhe turizmi të konsiderohen bosht i zhvillimit ekonomik për Prizrenin 2. Zhvillim i turizmit katërsezonal (turizëm malor, kulturor, natyror, rekreativ) 3. Përtërirja e aktiviteteve turistike: kajak, ngjitja, ecje në mal 4. Rritja e numrit të festivaleve në Prizren 5. Gjenerim më i madh i të hyrave nga Prizreni për Prizrenin 6. Krijimi i fondit nga monumentet për menaxhim të trashëgimisë kulturore 7. Rritje e numrit të punësuarve në sektorin e turizmit kulturor dhe zhvillim i qëndrueshëm ekonomik 8. Zhvillimi i aktiviteteve ndërkufitare natyrore e kulturore 9. Promovimi i Prizrenit jashtë kufijve të Kosovës 10. Organizimi i lidhjeve të transportit për lëvizshmëri më të mirë

Kërcënimet	1. Zvogëlimi i numrit të vizitorëve / turistëve 2. Ulja e standardit ekonomik 3. Jostabiliteti politik 4. Humbja e investitorëve-donatorëve të jashtëm

Foto 2. Prezantimi i grupeve punuese të analizës SWOT

4. Ndërtesat e banimit tradicional / çështjet e banimit

Përparësitë	1. Kultura e banimit – Vazhdimësia e traditës së banimit në qytet – Mishërmi i arkitekturës tradicionale, aktiviteteve kulturore, kuzhinës dhe mikpritjes pizrenase 2. Arkitektura e pasur tradicionale – Arkitekturë e pasur tradicionale të shtëpive të vjetra – Shtëpi të vjetra të ruajtura nga periudha të ndryshme – Diversitet të tiplogjive dhe stileve arkiteketonike 3. Adaptimi i shtëpive të vjetra për funksione të reja të banimit – Shfrytëzimi i shtëpive për akomodim gjatë Dokufestit dhe gjatë tërë vitit – Shëndrimi i shtëpive në restorane dhe përfshirja e ushqimit tradicional në meny
Mangësitë	1. Mirëmbajtja dhe restaurimi i pamjaftueshëm – Mungesa e mirëmbajtjes së shtëpive tradicionale – Mungesa e fondit për mirëmbajtjen e shtëpive tradicionale – Mungesa e njohurisë bazike se si mund të transformohen dhe të shfrytëzohen shtëpitë e vjetra 2. Prania e shtëpive të pabanuara / të zbrazëta – Një pjesë e zonës me shtëpi të zbrazura - të pabanuara 3. Mungesa e bashkëpunimit institucion - pronarë – Mospërgjegjësia e institucioneve komunale (inspektoratit) – Mospërgjegjësia konstante e institucioneve qendrore (inspektoratit) – Mungesa e informimit adekuat të pronarëve të shtëpive të vjetra se prona e tyre është nën mbrojtje – Injorimi i mendimit të pronarëve gjatë përfshirjes së shtëpive të tyre në listë të mbrojtjes – Mungesa e lehtësimeve nga institucionet shtetërore për investime në shtëpitë e vjetra tradicionale – Mungesa e mbështetjes nga autoritetet lokale për të këshilluar dhe vetëdijesuar për hapat që duhen ndjekur për transformim të shtëpive të vjetra në biznes: hostel, bujtinë 4. Çështjet pronësore të pazgjidhura – Problemet me pronësi (dhe shumë pronarë) nëpër objekte të banimit 5. Infrastruktura dhe qasja jo e volitshme në lagjet e banimit – Infrastrukturë fizike joadekuate – Mungesa e qasjes për persona me nevoja të veçanta – Mungesa e ndriçimit në lagjet e banimit – Mungesa e këndit të lojërave në lagjet e banimit – Problemi i mbledhjes së mbeturinave në rrugët e ngushta të banimit 6. Hapësirat në Kornizën ligjore – Ligji aktual i trashëgimisë kulturore nuk ofron mekanizma për mbështetje të pronarëve të shtëpive tradicionale – Mungesa e kritereve të sakta se cilat shtëpi duhet të prioretizohen për mbrotje dhe intervenime
Mundësitë	1. Ripërtëritja e shtëpive tradicionale sipas prioriteteve në mënyrë të vazhdueshme 2. Shfrytëzimi i hapësirave rreth shtëpive për shume qëllime 3. Ofrimi i alternativave se si mund të shfrytëzohen shtëpitë e vjetra për zhvillim lokal

	4. Promovimi i arkitekturës tradicionale të banimit nga ana e organeve kompetente 5. Materializim/standardizim i objekteve të banimit 6. Përfaqësimi i pronarëve të shtëpive të vjetra në procese vendimmarëse 7. Edukimi dhe vetëdijesimi i pronarëve të shtëpive të vjetra për vlerat dhe potencialin e pronave të tyre 8. Stimulimi i pronarëve të shtëpive të vjetra me ide kreative, jo vetëm me investim direkt dhe financim 9. Propozimi i një forme për të ofruar komunikim më të mirë pronarë - inspektorë 10. Shërbime këshillimi falas për pronarët e shtëpive brenda QHP, konsultime ekonomike, financiare, arkitektonike, ndërtimore 11. Organizimi i pronarëve të shtëpive të vjetra në formë të shoqatës për avokim, organizim, dhe menaxhim më të lehtë të çështjeve në lidhje me konservimin dhe adaptimin e shtëpive të vjetra. 12. Mjetet e grumbulluara nga inkasimi i tatimit mbi pronë brenda QHP, të investohen për restaurim të shtëpive të vjetra brenda QHP
Kërcënimet	1. Shkatërrimi i shtëpive tradicionale për nevoja të biznesit (parkingje, hotele, etj) 2. Mbipopullimi i QHP 3. Humbja e imazhit të zonës nga ndërtimet e reja 4. Mungesa e investimeve tek pronat private 5. Rezistenca e pronarëve të shtëpive të vjetra për të përfshirë në Listë të mbrojtjes për pronat / ndërtesat e tyre

Foto 3. Pamje nga punëtoritë gjatë procesit të hartimit të PMQHP

5. Infrastruktura dhe mobiliteti / lëvizshmëria

Përparësitë	1. Pozita e volitshme gjeografike – Qasja adekuate – Afërsia gjeografike me Shqipërinë dhe Maqedoninë – Afërsia me resurse malore dhe bregdetare 2. Infrastruktura e volitshme ekzistuese – Infrastruktura ekzistuese e hapësirave publike – Numri i madh i urave (lidhja e qytetit ndërmjet dy anëve të lumit) – Qytet miqësor për këmbësorë – Infrastrukturë relativisht e mirë rrugore – Qasja e lehtë në monumente
Mangësitë	1. Mungesa e Planit të mobilitetit – Numri i madhë i veturave – Qasja e pakontrolluar e veturave në QHP – Rruga kryesore që kalon përmes QHP – Mosrespektimi orarit të qarkullimit të veturave në QHP; – Keqpërdorimi i lejeve për qarkullim dhe parkim që lëshohen nga drejtoria e Shërbimeve Publike 2. Pamjaftueshmëria e parkingjeve – Mungesë e parkingjeve publike të organizuara – Parkingje private të pakontrolluara nga autoritet përgjegjëse – Mungesa e garazhave në objektet e banorëve të QHP – Numri i madh i parkingjeve ilegale – Mosrregullimi dhe moskontrollimi i çmimeve të parkingjeve gjatë sezonit veror 3. Mungesa e qasjes për persona me nevoja të veçanta – Ndërtesat, rrugët të paqasshme për persona me nevoja të veqanta – Mungesa e shtegut adekuat për personat e verbër 4. Prania e mbeturinave – Mosmenaxhimi mbeturinave, sidomos në QHP 5. Shenjëzimi jo-adekuat – Mungesë e shenjëzimit adekuat rrugor – Mungesë e shenjëzimit të duhur për monumente; Mungesa e informimit për trashëgiminë kulturore (tabela sinjalizuese); Mosunifikimi i tabelave sinjalizuese (UNESCO, MKRS dhe donatorë tjerë) 6. Mungesa e shtigjeve – Mungesë e shtegut për çiklistë 7. Instalimet joadekuate teknike (rrymë, rrjet kabllovik, internet) – Mungesa e sigurisë dhe ndriçimit publik (rruga për në Kala, shtegu Marash-Kala, parku në Marash) – Rrjeti elektrik/internet mbitokësor në QHPz – Mungesa e Planit për infrastrukturë nëntokësore (Shpërndarja e gypave të kanalizimit për impiant në Shatërvan dhe tjerat duhet të bëhen në mënyrë të koordinuar) 8. Mungesa e planit të sigurisë – emergjencave, e në veçanti ato për asete të trashëgimisë kulturore 9. Mungesa e transparencës së autoriteteve lokale për planet ekzistuese infrastrukturore – Jotransparence në hartimin e projekteve (teleferiku në Kala, kaskada në lumin Lumbardh, etj) 10. Prezenca e pompës së benzinës në QHP në kundërshti me karkaterin historik të zonës

Mundësitë	1. Hartimi i planit të mobilitetit për Komunën e Prizrenit dhe në veçanti planin dhe regjimin e posaçëm të transportit automobilistik për Qendrën Historike të Prizrenit me qëllim të sigurimit të lëvizjes së lehtë dhe të vazhdueshme, duke promovuar mjetet jo-motorike të transportit si obligim i Ligjit të QHP (neni 12) 2. Hartimi i Planit për mbrojtjen e QHP kundër zjarrit, rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera 3. Fuqizimi i transportit publik për një lëvizshmëri më të mirë 4. Ofrimi i zgjidhjeve adekuate për qasjen në Kala 5. Krijimi i fondit nga parkingjet publike 6. Ofrimi i mundësive për parkingje jashtë QHP 7. Mundësi alternative e mbylljes së rrugës për vetura, hapja e rrugës nëntokësore për vetura dhe parking (rruga Remzi Ademaj) 8. Integrimi i monumenteve në hapësira publike duke larguar barrierat fizike (rrethojat) 9. Menaxhimi i mbeturinave nga automjetet e pandotshme (elektrike) në orar të përshtatshëm 10. Hartimi i udhëzuesit për kriteret e dizajnit të mobilierisë urbane (reklamat, çadrat, karrigat, tavolinat, ndriqimi…) 11. Hartimi i udhëzuesit për kriteret e dizajnit të artit publik në QHP
Kërcënimet	1. Ndotja e ajrit nga mbingarkesa e transportit motorik 2. Qarkullimi motorik i pakontrolluar brenda QHP



Foto 4. Prezantimi i grupeve punuese të analizës SWOT

1.7

Analiza socio-demografike



1.7 ANALIZA SOCIO-DEMOGRAFIKE

Hyrje

Prizreni ka karakteristika diverse demografike dhe sociale. Popullsia e Prizrenit, edhe pse me shumicë Shqiptare, (rreth 82 përqind), ka rreth 10 përqind Boshnjak, rreth 5 përqind Turq, dhe rreth 1.63 përqind pjesëtarë të komunitetit Rom. Ky diversitet i madh etnik karakteristikë e rëndësishme e identitetit të Prizrenit. Sidoqoftë, grupe të caktuara etnike kanë gjasa më të mëdha për të bërë pjesë në grupe te grupe të ndjeshme, qoftë nga aspekti ekonomik apo ai social.



Foto 1: Përbërja etnike e popullsisë në Prizren Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në Qendrën Historike të Prizrenit, sidoqoftë, përbërja e popullsisë nuk e reflekton tërësisht popullsinë në tërë Prizrenin, duke qenë që në këtë zonë ka koncentrim më të madh të popullsisë së etnisë serbe. Programe të ndryshme ndërkombëtare në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit kanë investuar në kthimin e familjeve të etnisë serbe në këtë zonë.[1] Këto programe janë konsideruar si tejet të rëndësishme, posaçërisht duke pasur parasysh statusin e trashëgimisë kulturore të shtëpive të cilat janë restauruar para kthimit të familjeve serbe.

Analizë

Karakteristikat demografike, sidomos ato të ndërlidhura me moshën e popullsisë kanë implikime shumë të rëndësishme për qendrat historike të mbrojtura me ligj. Sipas UNSECO, ndryshimet demografike, posaçërisht në vendet ku popullsia është më e moshuar. Rritja e përqindjes së popullsisë së moshuar kërkon përshtatje të kushteve të jetës, qoftë nëpërmes ndryshimeve infrastrukturore, për t'i mundësuar qasje më të lehtë të moshuarve, qoftë duke rezultuar në numër më të madh të shtëpive dhe objekteve nën mbrojtje të cilat mbesin të zbrazëta. Aktualisht, shpërndarja demografike sipas grup moshave në Prizren ende anon kah popullsia e moshës më të re.

[1] Sustainable partnerships for assistance to minority returns to Kosovo (SPARK) e implementuar fillimisht nga UNMIK dhe UNDP, dhe në fazën e dytë nga Danish Refugee Council.

Vetëm 7 përqind e popullsisë janë mbi moshën 65 vjeçare. Mbi 50 përqind e popullsisë janë nën moshën 30 vjeç. Kështu, edhe nëse marrim parasysh faktin që ka tendencë që popullsia më e vjetër të jetë e koncentruar në qendrat historike dhe ato të mbrojtura, Qendra Historike e Prizrenit ende nuk ballafaqohet me problemet që rrjedhin nga popullsia e moshuar.



Foto 2: Përqindja e popullsisë sipas grup moshës Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Karakteristikë tjetër që ka ndikim në mirëmbajtjen e qendrave historike është edhe gjendja socio-ekonomike e popullsisë së koncentruar në këto zona. Në rastet kur nuk ka investime publike në mirëmbajtjen dhe potencialisht restaurimin e objekteve në zona historike, dhe këto janë të nevojshme, mundësia ekonomike e pronarëve është kyçe në qëndrueshmërinë e zonave të mbrojtura. Numri i familjeve të cilat janë të regjistruara për përfitim nga skemat sociale, në Prizren ka shënuar rënie. Këto të dhëna mund të përdoren si matës të përafërt të gjendjes ekonomike të përgjithshme, në mungesë të të dhënave specifike.

Sidoqoftë, të dhënat tregojnë një trend në rritje të rrënimit të objekteve në Qendrën Historike të Prizrenit, dhe përdorim i hapësirës për parkingje private, po ashtu, trend rritës i tjetërsimit të objekteve të mbrojtura me ligj. Ky trend tregon tendencë për tjetërsim në funksion të përfitimeve ekonomike afat-shkurtër, që mund të jetë edhe rezultat i kushteve jo të favorshme ekonomike të familjeve që jetojnë në këtë zonë.



Foto 3: Numri i familjeve që përfitojnë nga ndihma sociale Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Një burim tjetër i problemeve në zonat e mbrojtura historike në vendet në zhvillim janë kontestet pronësore. Në Qendrën Historike të Prizrenit, një numër i konsiderueshëm i shtëpive tradicionale familjare kanë kontest pronësor. Bazuar në nivelin e ulët të zgjidhjes së kontesteve pronësore me anë të testamenteve, problemet e tilla mbesin të përhapura. Në analizë të numrit mesatar të anëtarëve për ekonomi familjare, shihet ka pasur një trend rritës deri në fillim të viteve 1980, i cili është ndikuar dukshëm edhe nga rritja e popullsisë në mënyrë jo-proporcionale me rritjen e vendbanimeve. Numri më i madh i anëtarëve për ekonomi familjare, e rritë edhe numrin e trashëgimtarëve potencial të vendbanimit.

Bazuar në të dhënat e Ec Ma Ndryshe, 49 përqind e objekteve të regjistruara me funksion biznesi, shërbejnë si ndërtesa me funksion të dyfishtë – banim dhe biznes. Duke projektuar me numrin mesatar të anëtarëve të familjeve në Prizren, rreth 1,700 banorë të Qendrës Historike të Prizrenit, banojnë në ndërtesa me funksion të dyfishtë. Kjo rritë vështirësinë e intervenimit në restaurim të objekteve.



Foto 4: Numri mesatar i anëtarëve për ekonomi familjare Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Këto probleme e vështirojnë mundësinë për të zbatuar plane të veprimit ofrim të integruar të shërbimeve në Qendrën Historike të Prizrenit, të cilat mund të realizohen me anë të bashkëpunim të banorëve të zonës.

Përveç këtyre, qasjes në këtë zonë mbetet e limituar për grupet e ndjeshme. Mungesa e ndriçimit publik ndikon në mungesë të sigurisë, dhe rezulton në qasje të limituar për rininë, për personat me aftësi të kufizuara, si dhe gratë. Në hulumtimin që analizon qasjen në Qendrën Historike të Prizrenit, për persona me aftësi të Kufizuara, Ec Ma Ndryshe, gjen që shumica e hapësirave janë ose të paqasshme, ose pjesërisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Në vetëm 25 përqind të rasteve, hapësirat e Qendrës Historike janë plotësisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Emërimi i Qendrës Historike si zonë e mbrojtur ka rritur edhe koncentrimin e qytetit drejt promovimit të trashëgimisë kulturore si veçanti e Prizrenit, duke e fokusuar kështu edhe një pjesë të mirë të brendimit të qytetit. Mirëpo, turizmi si një ndër aktivitetet kryesore ekonomike të Prizrenit, kërkon edhe ngritje të kapaciteteve të fuqisë punëtore për të akomoduar kërkesat turistike.

Edhe pse Prizreni ka Universitetin Publik, si dhe një numër të konsiderueshëm të shkollave profesionale dhe qendrave të kompetencës, kurrikula e këtyre institucioneve arsimore nuk përkon me nevojat e ekonomisë në kuadër të turizmit. Shkollat profesionale, janë të fokusuara në drejtime të cilat përkojnë pak me nevojat e tregut të punës në Prizren. Si rezultat oferta dhe kërkesa në tregun e punës kanë diskrepancë, duke ndikuar kështu në rritjen e papunësisë. E njëjta vlen edhe për Universitetin Publik të Prizrenit, drejtimet e të cilit janë të ngjashme me ato të ofruara nëpër universitetet tjera publike në Kosovë. Ngritja e kapaciteteve të fuqisë punëtore, për t'u përshtatur me përbërjen e ekonomisë dhe fokusin e zhvillimit, siguron edhe uljen e nivelit të papunësisë.

Përfundime dhe rekomandime
Hapat e ardhshëm

Për të trajtuar problemet demografike dhe sociale të Qendrës Historike të Prizrenit, qasja është e shumë-anshme.

(1) Komuna duhet të dizajnojë politika mbështetëse sociale të destinuara për banorët në zonat që i përkasin Qendrës Historike të Prizrenit, duke zvogëluar kështu rrezikun për tjetërsim të objekteve të mbrojtura, apo edhe rrënimit të tyre.

(2) Vetëdijesimi i qytetarëve për rëndësinë e regjistrimit të pronës, zgjidhjes së kontesteve pronësore, dhe për të ardhmen, vendimmarrjen për trashëgimi të pronës. Kështu, rriten gjasat e zgjidhjes së kontesteve pronësore në mënyrë që të lehtësojnë zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta të banorëve të zonave në Qendrën Historike të Prizrenit.

(3) Themelimi i shoqatave të banorëve të Qendrës Historike të Prizrenit, sipas fushëveprimit të tyre, duke i rritur kështu mundësitë për organizim të përbashkët të shërbimeve komplementare.

(4) Duhet të krijohen mekanizmat të cilat i japin prioritet bizneseve lokale për t'i blerë pronat e atyre familjeve të cilat nuk janë më të interesuara për të qëndruar në Qendrën Historike të Prizrenit.

Kështu do të eliminohej rreziku i tjetërsimit të pronave, si dhe do t'i mundësohej pronarëve origjinal të jenë të përfshirë në përcaktimin e zhvillimit të qendrës. Kjo ka rëndësi të posaçme për ndërtesat në pronësi të familjeve serbe, të cilët janë kthyer në Qendrën Historike të Prizrenit me anë të programeve të ndryshme ndërkombëtare në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, mirëpo që në rast të mungesës së integrimit, preferojnë të zhvendosen.

(5) Krijimi i infrastrukturës për qasje të grupeve të ndjeshme, posaçërisht të personave me nevoja të veçanta. Kjo masë përfshinë mundësimin e qasjes fizike në objekte dhe hapësira publike, sigurimin e ndriçimit, si dhe në periudhën afatmesme, ofrimin e shërbimeve të transportit për këto zona.

(6) Bashkërendimi i nevojave të tregut me fuqinë punëtore, duke i ri-shikuar dhe ndryshuar kurrikulat dhe specializimet e ofruara në shkolla profesionale, qendra të kompetencës, dhe Universitetin Publik. Një masë e tillë, e ndërmarrë në bashkëpunim me qeverinë qendrore, do të rezultonte në ngushtimin e hendekut të punësimit, dhe do të nxisë po ashtu ide dhe inovacion në fushën e turizmit.

1.8

Zhvillimi ekonomik

1.8 ZHVILLIMI EKONOMIK

Hyrje

Rëndësia e turizmit dhe kulturës ne zhvillim ekonomik

Turizmi është një ndër shtyllat kryesore të ekonomisë lokale në vendet të cilat kanë potencial turistik, qoftë ai natyror, apo kulturor. Në Kosovë, e posaçërisht në Prizren, turizmi është sektor qendror për zhvillim ekonomik. Turizmi në Prizren bazohet në turizëm kulturor, sidomos në trashëgimi kulturore. Si i tillë, Prizreni ka potencial turistik i cili nuk ka vartësi sezonale. Mirëpo, siç shihet edhe nga të dhënat, kalendari i aktiviteteve kulturore, i cili është i bazuar në sezonin e verës, krijon një përqendrim më të madh të turistëve gjatë kësaj sezone. Duke i pasur këto parasysh, plani strategjik i zhvillimit të turizmit në Prizren, dhe të gjitha dokumentet e përpiluara, duhet të jenë në përputhje me planin e zhvillimit të turizmit gjatë gjithë vitit – duke i kontribuar kështu ekonomisë lokale drejtpërdrejt gjatë tërë vitit.

Sfondi

Prizreni është qyteti i dytë më i madh në Kosovë, me vlerësimin e fundit të popullsisë në 185,000.[1] Sektori kryesor ekonomik në Prizren është tregtia, pasuar nga shërbimet, kryesisht ato që lidhen me turizmin. Duke qenë një nga destinacionet kryesore turistike në Kosovë, Prizreni ofron mundësi për zgjerim ekonomik në turizëm. Bazuar në Ligjin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës të vitit 2006, Qendra Historike e Prizrenit është shënuar si fushë e konservimit arkitekturor nën mbrojtje të përkohshme në vitin 2016.

Ky vendim, ndonëse i mirëpritur, ka hasur në ngecje në zbatim. Ligji i vitit 2012 për Qendrën Historike të Prizrenit përfshin 1,000 ndërtesa në listën e zonës së mbrojtur, nga të cilat 104 janë monumente kulturore. Për më tepër, nga 388 shtëpi tradicionale në Qendrën Historike të Prizrenit, aktualisht kanë mbetur vetëm 155, ndërsa nga tjerat 233 janë shkatërruar, ose kanë ndryshuar destinim të përdorimit.[2] Nga ato ndërtesa që janë në gërmadha ose funksioni i të cilave është ndryshuar, një numër shumë i madh, saktësisht 34, janë konvertuar në parkingje, e cila është përdorur si ide e shpejtë e biznesit, fitimprurëse posaçërisht gjatë kohës kulmore të turizmit.

Në veçanti, ndërtesat në Qendrën Historike të Prizrenit kanë destinime të ndryshme, të cilat ndikojnë edhe në zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik lokal. Specifikisht, rreth 38 përqind e ndërtesave në Qendrën Historike të Prizrenit kanë funksion biznesi, ndërsa 62 përqind tjera kanë funskione të ndryshme. Nga ndërtesat të cilat kanë të deklaruar funksion biznei, 49 përqind operojnë me funksion të dyfishtë – banimi dhe biznesi, ndërsa 51 përqind kanë vetëm funksion biznesi. Ky funksionalizim i objekteve në Qendrën Historike të Prizrenit duhet të shërbej si sinjal socio-ekonomik i zhvillimit, duke i dhënë rëndësi të shtuar objekteve të cilat janë duke kryer funksion të dyfishtë.

[1] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vlerësimi i Popullësisë

[2] Ec Ma Ndryshe, Gjendja e fizike e monumenteve dhe shtepive tradicionale te qytetit, http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/171123103319_Reduced_Gjendja_fizike_e_monumenteve_dhe_shtepive_tradicionale_te_qytetit.pdf



Foto 1. Hartëzimi i funksioneve të biznesit në QHP

GIS kodi	Nr i bizneseve	Përqindja	Lloji i biznesit
ATM	1	0.14%	ATM i veçuar i bankës
BI ANK	10	1.37%	Avokat; Noter; Kontabilist
D	10	1.37%	Depo të biznesit
DPH H	20	2.75%	Hotel; Hostel/bujtinë
DPH RK	110	15.11%	Restaurant; Kafeteri; Qebaptore; Çajtore; Pizzeri; Fast-food; ËmbËltore; Farëshitës
DPT B	94	12.91%	Butik (veshje, çanta, vello, këpucë, çarçafë, syze, mobil-shop, kozmetikë, bizhuteri, parfimeri, perde, orëtar)
DPT G	6	0.82%	Studio profesionale (Gjeodezi, Arkitekturë)
DPT IC	3	0.41%	Internet qendër; Sony-playstation
DPT K	11	1.51%	Kurse muzike; Autoshkolla; Aftësim profesional; Kurs i gjuhëve të huaja; Kurs vizatimi
DPT KS	24	3.30%	Kompani e sigurimeve; Agjension udhëtimesh; Patundshmëri; Pagesa
DPT L	8	1.10%	Librari
DPT M	29	3.98%	Mediume (TV, radio, portal, agjenci reklamash, shtyp, fotokopje, fotograf, ftesa për dasma, music shop)
DPT O	31	4.26%	Ordinanca private mjekësore; Barnatore; Barnatore bujqësore
DPT PF	2	0.27%	Paisje fiskale
DPT PSH	12	1.65%	Paisje shtepiake (llambadarë, teknikë e bardhë, aksesorë dhe dekorime, pjesë teknike për aparatura, sanitari, roletna)
DPT S	22	3.02%	Servis (servis i klimave, i telefonave, automekanik, autolarje, rentacar, meaknik i bicikletave, pastrim kimik)
DPT SHU	23	3.16%	Dyqan ushqimor (markete, kafeblurës, vezëshites, kasap)
DPT SU	13	1.79%	Dyqan suveniresh
DPZ AR	46	6.32%	Artar; Argjendar; Filigran
DPZ AU	2	0.27%	Autolarje
DPZ F	40	5.49%	Frizere; Berber; Salon bukurie dhe ondulimi
DPZ FA	32	4.40%	Farkatar; Xhamprerës; Zdrukthtar; Çelëspunues; Rrobaqepës; Këpucëndreqës; Lëkurëpunues;
DPZ FU	2	0.27%	Furrë
DPZ L	9	1.24%	Lulishte, dekorime të ndryshme
DPZ M	3	0.41%	Mafesxhi
DSH F	2	0.27%	Fitnes qendër
FDP	1	0.14%	Funksion i padefinuar (në ndërtim e sipër)
NSH P	4	0.55%	Përkthyes gjuhësor
NTSH E	3	0.41%	Elektricist
OJQ IMF	1	0.14%	Institucioni mikrofinanciar
QT	1	0.14%	Qendër tregtare
SHA IF	8	1.10%	Institucion financiar / Bankë; Këmbimore
SHPK IM	4	0.55%	Paisje per ventilim; Klima; Ujësjellës
SHPK PB	1	0.14%	Pompë benzine
SHPK TK	5	0.69%	Telekomunikim / Telefoni mobile
X	135	18.54%	Dyqan i zbrazët
TOTAL	728	100.00%	

Foto 2. Statistikat e bizneseve në QHP

Sa i përket sektorit privat, firmat që veprojnë në Prizren tregojnë trend pozitiv të investimeve dhe të punësimit. Më shumë se gjysma e bizneseve në Prizren kanë investuar gjatë vitit të fundit, dhe këto investime kanë arritur vlerën mesatare 6,000 euro.[3] Megjithatë, sa i përket qarkullimit vjetor, më shumë se 75 përqind e bizneseve kanë qarkullim vjetor nën 100,000 euro. Me shumicën dërrmuese të rasteve në fakt, bizneset qarkullojnë më pak se 50,000 euro në vit.

Edhe pse historia dhe kulturën që ofron Prizreni kanë ndikim të madh në tërheqjen e turizmit në këtë vend, vetëm 30 përqind e bizneseve veprojnë në sektorë të lidhur me turizmin. Më problematike se për Prizrenin në tërësi, janë aktivitetet e bizneseve në Qendrën Historike të Prizrenit, ku vetëm rreth 15 përqind të bizneseve janë të regjistruara për aktivitete gastronomike dhe rreth 3 përqind për aktivitete hoteliere. Të ndërlidhura me turizmin, dhe biznese që përfitojnë nga turizmi, gjithashtu janë pk, duke përfshirë këtu, rreth 6 përqind të bizneseve që janë të regjistruar si arëtari, argjendari, apo filigran, dhe rreth 2 përqind të bizneseve që janë dyqane suveniresh. Përveç këtyre bizneseve drejtpërdrejt të ndërlidhura me aktivitete turistike, rreth 13 përqind të bizneseve që operojnë në Qendrën Historike të Prizrenit janë biznese tregtare të veshjeve dhe të ngjashme. Kategoria me numrin më të madh të bizneseve, është ajo e objekteve/dyqaneve të zbrazëta. Kjo, edhe pse brengosëse, mund të shihet si potencial për funksionalizim më të lehtë të këtyre bizneseve në të ardhmen, pa nevojë për ndryshim të aktivitetit ekonomik.



Foto 3: Aktiviteti ekonomik në Qendrën Historike të Prizrenit Burimi: PM QHP

Në planifikimin strategjik të Prizrenit, duhet të integrohet edhe ideja e grupimit të bizneseve strategjike turistike në zonat që kanë karakter historik dhe kulturor. Më specifikisht, kjo ide duhet të implementohet në Qendrën Historike të Prizrenit, ku duhet t'i jepet prioritet aktivizimi i bizneseve me karakter kulturor, historik dhe tradicional, dhe të ndërlidhur me karakterin turistik të qendrës.

Mirëpo, përtej kësaj, në përgjithësi numri i firmave që operojnë në sektorin e turizmit ka shënuar rritje të vazhdueshme, po ashtu ka pasur një rritje të vazhdueshme edhe të numrit të vizitorëve, si dhe rritje në numrin e netëve të qëndrimit për person.

[3] Instituti Riinvest, Klima e Biznesit në Kosovë 2017



Foto 4. Numri i vizitorëve dhe netëve të qëndrimit Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Megjithatë, derisa rritja e aktivitetit turistik është zhvillim pozitiv, turizmi në Prizren ndikohet kryesisht nga festivalet dhe ngjarjet kulturore që janë të grumbulluara në kohë të caktuara të vitit, duke rezultuar kështu në influks më të madh të turistëve gjatë këtyre kohëve, e jo në shpërndarje të numrit të turistëve gjatë gjithë vitit. Siç mund të shihet në Figurën 2, numri më i madh i vizitorëve është i regjistruar gjatë tremujorit të tretë të vitit, duke shënuar rënie të dukshme në tremujorin e katërt, i cili po ashtu shënon numrin më të vogël të vizitorëve. Për të siguruar përfitime të qëndrueshme ekonomike nga turizmi, Prizreni duhet të fokusohet më tej në zhvillimin dhe promovimin e turizmit përgjatë tërë vitit.



Foto 5. Numri i vizitorëve nëpër tremujorë Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Ndikimi ekonomik i festivaleve, i cili i grumbullon numrin më të madh të vizitorëve gjatë tremujorit të tretë të vitit, është pasqyruar edhe në kalkulime të ndikimit specifik të festivaleve në Bruto Produktin Vendor (BPV). Më specifikisht, Instituti GAP ka kalkuluar ndikimin ekonomik

të festivalit të filmit dokumentar DokuFest në vitin 2011 dhe ka projektuar ndikimin ekonomik të festivalet për vitet në vijim. Sipas GAP, DokuFest ka pasur ndikim vjetor rreth 3.1 milion euro në BPV nëse ndikimi matet me numër të vizitorëve, ndërsa ky ndikim arrin shifrën prej 3.8 milion, kur llogariten edhe shpenzimet e konsumit të vizitorëve.[4] Duke pasur parasysh që DokuFest ka shënuar rritje në vizitorë nga viti në vit, mund të hamendësojmë me nivel të arsyeshëm të besimit që ndikimi ekonomik i DokuFest, në BPV të Kosovës, dhe posaçërisht në ekonominë lokale të Prizrenit, ka pasur rritje po ashtu. Me planifikim të duhur, ndikimi i DokuFest, dhe aktiviteteve tjera kulturore në Prizren, mund të shpërndahet gjatë tërë vitit.

Sa i përket punësimit, Prizreni ka karakteristika të ngjashme punësimi dhe papunësisë si pjesa tjetër e Kosovës. Nga të punësuarit, rreth 86 përqind kanë vend pune fiks, 9 përqind nuk kanë vend pune të fiksuar, dhe 3 përqind e të punësuarve, punojnë nga shtëpia. Në aspektin e ndarjes gjinore të popullsisë së punësuar, 80 përqind janë burra dhe 20 përqind gra. Megjithatë, gratë janë më të përqendruara në punët tradicionale me një vend pune fiks, ku përqindja e grave është më e madhe se në total, krahasuar me vendet e punës që nuk janë fikse, ku vetëm 7 përqind e totalit janë gra.



Foto 6. Të punësuar sipas llojit të vendit të punës Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Megjithatë, rritja e aktivitetit ekonomik, edhe pse e dobishme për ekonominë lokale, ka ndikuar negativisht në trashëgiminë kulturore dhe historike. Raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën deklaron se edhe pse ka pasur përparim në aspektin e dispozitave ligjore të ndërlidhura me Qendrën Historike të Prizrenit, kjo zonë gjithashtu është degraduar dhe ka pësuar rrënim të trashëgimisë kulturore. Megjithëse ka pasur rritje të numrit të inspektorëve, kjo rritje nuk ka treguar rezultate konkrete, sidomos në rritjen e numrit të sanksionimeve kundër autorëve.[5] Degradimi i trashëgimisë kulturore në Prizren është bërë në funksion të fitimeve ekonomike afatshkurtra. Derisa mungesa e vetëdijes së popullsisë ka luajtur një rol të madh në këtë drejtim, ekziston ende nevoja thelbësore për zbatimin e ligjit nga institucionet lokale dhe qendrore. Rrënimi i trashëgimisë kulturore në Prizren, përveç ndikimit historik, ka pasoja afatgjata sociale dhe ekonomike të cilat duhet të merren parasysh.

[4] Instituti GAP – Impakti ekonomik i DokuFest, 2011
[5] Komisioni Evropian: Kosovo Report, 2016

Roli i qeverisë qendrore dhe i politikave fiskale

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit parashikon hartimin dhe zbatimin e udhëzimeve të nevojshme administrative që do të sigurojnë mbështetje fiskale dhe buxhetore për mirëmbajtjen, restaurimin dhe zhvillimin e qendrës historike. Megjithatë, mungojnë masa specifike. Pakoja fiskale 2.0, e cila u miratua në vitin 2017, parasheh masa të përgjithshme që ndikojnë në mënyrë indirekte në qendrën historike të Prizrenit.

Masa e parë që parashihet është modifikimi/zgjerimi i listës së produkteve të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar të TVSH-së prej 8 për qind, të përdorura në veprimtari kulturore, artistike, turistike, të akomodimit dhe rekreative.[6] Kjo normë e zvogëluar e TVSH-së konsiderohet si stimul për sektorët që mund të përfitojnë nga ajo. Duke marrë parasysh strukturën e ekonomisë së Prizrenit, stimuj të tillë mund të jenë të dobishëm, megjithatë, ndikimet afatgjata mbeten për t'u parë.

Masa e dytë që ndikon në Qendrën Historike të Prizrenit është Udhëzimi Administrativ për pushimet në tatime, të kufizuara për investime në sektorë me potencial të punësimit, përfshirë turizmin. Këto pushime tatimore janë të zbatueshme vetëm për një periudhë të caktuar kohore, si dhe janë të kushtëzuara nga gjenerimi i punësimit.

Së fundi, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Qeverisë së Kosovës parashikon financim prej 40,350 euro për Qendrën Historike të Prizrenit.[7] Ky angazhim buxhetor mund të përdoret nga Komuna e Prizrenit për të zbatuar aktivitetet që janë propozuar dhe parashikuar nga ekspertët vendorë, të cilët do të kontribuojnë pozitivisht në qendrën historike të Prizrenit.

Treguesit e ndikimit ekonomik dhe turizmit

Qendrat e trashëgimisë kulturore kanë vlerë të shtuar, megjithatë matja e vlerës së shtuar për shoqërinë, dhe sidomos ekonominë është shpesh problematike. Duke pasur parasysh se matja e vlerës ekonomike të trashëgimisë kulturore, megjithëse subjekt i shumë analizave ekonomike, është ende problematike, është e rëndësishme të përdoret një metodë e ndarjes në përpjekjet për të kapur më së miri vlerën e përgjithshme ekonomike.

Siç është prezantuar nga Pagiola (1996), koncepti i vlerës totale ekonomike përdoret për të vlerësuar ndikimin ekonomik të qendrave të trashëgimisë kulturore. Një dekompozim i vlerës totale ekonomike përfshin dy komponentë kryesorë, që janë: (1) vlera e përdorimit, e cila përfshin vlerën e shfrytëzimit të jashtëm dhe vlerën e përdorimit të brendshëm, dhe (2) vlerën e mos përdorimit.[8] Për qëllimin e këtij dokumenti, do të diskutohet një komponent tjetër, vlerësimi i punësimit të shtuar. Duke pasur parasysh se vlera e përdorimit të jashtëm ka të bëjë me vlerën e mallrave që mund të nxirren nga vendi historik, kjo nuk është e nevojshme për qëllimin e këtij dokumenti, kështu që ky kapitull do të përqendrohet në vlerën e përdorimit të brendshëm dhe vlerën e mos përdorimit , të Qendrës Historike të Prizrenit.

[6] Zyra e Kryeministrit – Pakoja Fiskale 2.0, 2017
[7] Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020
[8] Stefano Pagiola, "Economic Analysis of Investments in Cultural Heritage: Insights from Environmental Economics
Environment Department", World Bank, 1996

Komponentët e vlerës së përdorimit janë ato që mund të maten me anë të gatishmërisë për të paguar. Vlerat kryesore të shfrytëzimit të brendshëm për Qendrën Historike të Prizrenit janë vlerat estetike dhe rekreative. Për të matur ndikimin e Qendrës, sa i përket vlerës estetike që ajo ofron, është e rëndësishme të kuptojmë se matjet e tilla janë objektive. Megjithatë, matja e vlerës estetike të Qendrës qëndron në sigurimin që estetika historike të mbetet e paprekur përmes restaurimit të objekteve që aktualisht janë të degraduara dhe duke siguruar fonde të vazhdueshme për nevojat e ardhshme të restaurimit. Përmes kësaj, Qendra Historike e Prizrenit do të mbajë vlerën e saj estetike, e cila rezulton në ndikim pozitiv në fitimet turistike dhe ekonomike të qytetit.

Vlera rekreative e Qarkut Historik të Prizrenit është e lidhur ngushtë me tërë komunën e Prizrenit. Vlera rekreative mbështetet në një kombinim të trashëgimisë kulturore, burimeve natyrore, si dhe shërbimeve të ofruara në mënyrë që ata që janë të interesuar të jenë në gjendje të përfitojnë prej tyre. Kështu, përmes funksionalizimit të zyrave të informimit dhe ofrimit të shëtitjeve me ciceron të qytetit, me fokus të veçantë në Qendrën Historike, duke ofruar edhe shtigje dhe aktivitete të tjera të lidhura me natyrën, vlera rekreative e qytetit do të rritet dhe kështu të kontribuojë në turizmin e mëtejshëm dhe fitimet ekonomike.

Në terma specifike të matjes, gatishmëria për të paguar e vizitorëve, për vlerën estetike dhe rekreative mund të llogaritet përmes grumbullimit të të dhënave të numrit të turistëve dhe kalkulimit të vlerës së përafërt monetare të gatishmërisë për të shpenzuar.

Ekzistenca e Qendrës Historike të Prizrenit, në vetvete, i jep vlerën e mos përdorimit që kontribuon në vlerën e përgjithshme ekonomike të vendit. Megjithatë, degradimi i vazhdueshëm të cilit Qendra po i nënshtrohet zvogëlon në mënyrë drastike vlerën e mos përdorimit. Si rezultat, përmes matjeve të ndikimeve negative, mund të llogaritet edhe vlera ekonomike e Qendrës Historike. Si rezultat, sigurimi i mbrojtjes së Qendrës Historike të Prizrenit, ka jo vetëm kuptim kulturor dhe sentimental, por edhe kuptim ekonomik.

Për më tepër, një tregues tjetër i vlerës së shtuar nga Qendra Historike e Prizrenit është ndikimi në punësim. Ndikimi në punësim mund të jetë indirekt ose i drejtpërdrejt. Ndikimi indirekte i punësimit përfshinë rritjen e punësimit nga sipërmarrjet e biznesit që lidhen me Qendrën, përfshirë turizmin (ciceronët, punonjësit në zyrat e informacionit, bizneset e vogla që ofrojnë rekreacion të turistëve), akomodimin dhe furnizimin me ushqim, si dhe aktivitete të tjera të biznesit që rrjedhin nga Qendra Historike. Ndikimi i drejtpërdrejtë në punësim përfshinë punësimin në restaurim, që janë aktivitete të bazuara në fuqi punëtore, si dhe punësimin e drejtpërdrejtë që ka të bëjë me mirëmbajtjen dhe promovimin e Qendrës Historike. Përmes matjeve statistikore të aktiviteteve të gjenerimit të punësimit, vlera e shtuar ekonomike e Qendrës Historike të Prizrenit mund të matet më tej.

Përmes këtyre masave, indeksi për vlerësimin e vlerës totale ekonomike të Prizrenit është lehtësisht i ndërtuar, edhe pse vlerësimi i këtyre treguesve është sfidues, ky udhëzues duhet të shërbejë si bazë për grumbullimin e të dhënave, në mënyrë që ndikimi të mund të matet.

Indeksi për matjen e vlerës totale ekonomike (TEV) të Qendrës Historike të Prizrenit duhet të përfshijë:

$$TEV = UV_{estetike+rekreacionale} + NV_{mos-përdorimi} + LV_{punësimit}$$

Ku:

- TEV është indeksi i Vlerës Totale Ekonomike
- UV është Vlera e Përdorimit, përfshirë vlerën estetike dhe rekreacionale
- NV është Vlera e Mos-përdorimit dhe mund të jetë negative
- LV është Vlera e Punësimit

UV – Në vlerë të përdorimit përfshihen bizneset aktive në Qendrën Historike të Prizrenit, ku bizneset të cilat ndikojnë turizmin dhe ndikohen nga turizmi – që do të të thotë nga vlerat e Qendrës, kanë ndikim më të madh pozitiv. Këtu përfshihen bizneset të cilat janë të regjistruara për aktivitete hoteliere, restorante dhe të ngjashme, si dhe bizneset të cilat kryejnë aktivitete si filigran, apo tregti suveniresh. Në total, në Qendrën Historike të Prizrenit, këto biznese përbëjnë rreth 23 përqind të bizneseve në total.

Përvec vlerës së përdorimit rekreacional, vlerë të shtuar ka edhe përdorimi estetik, duke nënkuptuar këtu ndikimin pozitiv të bizneseve që kanë vlerë estetike e cila është në linjë me karakterin historik të Qendrës Historike të Prizrenit. Si të tilla, objektet të cilat devijojnë nga karakteri i qendrës, kanë ndikim negativ.

NV – Në vlerën e mos-përdorimit përfshihen të gjitha objektet dhe mundësitë të cilat nuk janë në shfrytëzim, që në Qendrën Historike të Prizrenit përfshinë mbi 18 përqind të objekteve afariste.

LV – Vlera e punësimit matet në periudha të ndryshme, me kujdes të shtuar në punësimin sezonal, duke mundësuar kështu llogaritjen e ndikimit në punësim, të aktiviteteve të ndryshme, dhe duke e bërë të mundshme izolimin e ndikimit të bizneseve dhe operimit të tyre në Qendrën Historike.

Përfundime dhe rekomandime
Mundësitë e zhvillimit ekonomik duke shfrytëzuar qendrën historike

Derisa pjesa më e madhe e degradimit që është bërë në Qendrën Historike të Prizrenit është bërë në përpjekje të fitimit ekonomik, në periudhë afatgjatë, rrënimi dhe mungesa e mbikëqyrjes në Qendrën Historike ka ndikim negativ ekonomik, për qytetin si një tërësi. Qasja për të siguruar që Qendra Historike e Prizrenit nuk konsiderohet vetëm si një vend i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore, por i tillë që mund të shfrytëzohet për përmirësimin e kushteve socio-ekonomike në Prizren, duhet të përqendrohet në ndërhyrjet afatshkurtra dhe afatgjata.

Në periudhën afatshkurtër, institucionet vendore duhet të fokusohen në ndërhyrjet e zbatueshme që kanë pak ose hiç implikime buxhetore. Ndërhyrjet afatmesme dhe afatgjata duhet të eksplorojnë bashkëpunimin me qeverinë qendrore, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.

(1) Të vazhdojë dhe të rritet përkrahja për festivalet dhe aktivitetet tjera kulturore e tradicionale të cilat kanë ndikim pozitiv në turizëm stimulojnë ekonominë lokale.

(2) Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe stimulimi i revitalizimit të objekteve me destinim të para-caktuar që ndërlidhet me vlerat kulturore dhe historike të Prizrenit.

(3) Duhet të parashihen investime në infrastrukturë për forma alternative të transportit, si p.sh. korsi për biçikleta. Në afat të mesëm, kjo ndërhyrje mund të zgjerohet për të përfshirë stacionet

e biçikletave dhe të ofrojë turne për vizitorët. Zhvillimi i qytetit që është miqësor për biçikleta jo vetëm që do të ndikojë në atraktivitetin e qytetit, por gjithashtu do të stimulojë përdorimin e biçikletave si një mënyrë transporti, duke ulur kështu nevojën për makina. Si rezultat, rënia e kërkesës për parkim, do të çojë në ulje të ofertës së parkingjeve, dhe kështu të ndalohet shndërrimi i shtëpive tradicionale në parkingje private.

(4) Pakot stimuluese dhe promovuese për bizneset e vogla dhe për inovacion. Në bashkëpunim me qendrat e inovacionit dhe inkubatorët e biznesit, duhet të bëhet përmirësimi i mjedisit për idetë e reja dhe të qëndrueshme të biznesit.

(5) Stimulimi i ringjalljes së artizanateve të vjetra duke krijuar sinergji me inovacion dhe teknologji moderne. Investim në sektorin e teknologjisë dhe sinkronizimit të inovacionit me tradicionalen në biznes. Duke i dhënë rol të veçantë inovacionit në rimëkëmbjen e tradicionales, rriten edhe interesimi dhe mundësitë për tradicionalen. Specifikisht, të shikohen mundësitë për investim në edukim joformal në filigran, rrobaqepësi – specifikisht të jorganëve dhe tjerave që janë karakteristike për Prizrenin. Po ashtu të konsiderohet bashkëpunimi me kurse dhe shkolla profesionale për të ofruar specializim në sektorë karakteristik për Prizrenin. Si rezultat, të krijohen mundësitë për ri-aktualizim të tradicionales për tu përshtatur me nevojat e tregut modern.

(6) Lëshimi i lejeve për idetë e bizneseve *pop-up*, dhe në afat të mesëm duke siguruar infrastrukturën fizike për ta bërë këtë (siç janë ofrimi i kabinave), në të cilat mund të operojnë bizneset specifike. Sidomos të ofrohet një ambient mbështetës për artistët lokalë për ofrimin e kurseve të fotografisë ose të pikturës - të përqendruara në Qendrën Historike të Prizrenit. Periudhat e provës mund të përfshijnë kohën më të zënë të sezonit të turizmit, megjithatë, këto sipërmarrje mund të ofrohen gjatë gjithë vitit.

(7) Funksionalizimi i zyrave turistike dhe të informacionit dhe krijimi i klubit të ciceronëve turistik. Zyrat e informimit plotësisht në dispozicion dhe me informata të përditësuara mund të shërbejnë si adresë për turistët. Themelimi i një klubi të ciceronëve turistik mund të ofrojë po ashtu mundësi punësimi për të rinjtë dhe/ose qytetarët e moshuar, të cilët mund të punojnë me grupe për të ofruar vizita të ndryshme.

(8) Në bashkëpunim me agjencitë turistike të zhvillohen dhe të ofrohen paketa udhëtimi që përfshijnë Prizrenin si pjesë e një paketave më të gjera turistike. Bashkëpunimi me qytetet në rajon, mund të funksionojnë për të siguruar pako turistike të përbashkëta.

(9) Zbatimi i projekteve të rigjenerimit urban, gjegjësisht restaurimit të fasadës së ndërtesave në qendrën historike, me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Për bizneset që veprojnë në zonën e mbrojtur, të përpilohen udhëzime të detyrueshme për dizajnin e tarracës dhe fasadës, për të siguruar një që kjo zonë të ketë pamje në linjë me trashëgiminë kulturore dhe historike.

1.9

Programi i edukimit për trashëgimi kulturore



1.9. PROGRAMI I EDUKIMIT PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Fillimisht, është shumë e rëndësishme që të theksohet nevoja për zhvillimin e iniciativave edukative në Kosovë, të cilat inkorporojnë kulturën, artin dhe trashëgiminë kulturore. Mungesa e implementimit sistematik të aktiviteteve edukative (formale dhe jo-formale) të cilat e inkoroprojnë artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore, është duke kontribuar në harresën e vlerave të kulturës lokale.

Nëse ky trend vazhdon, rritet rreziku që komuniteti lokal mos ta vlerësoj jetën tradicionale, folklorin dhe vlerat e kulturës lokale - gjëra të cilat do të kenë impakt në identitetin kulturor dhe kujtesën kolektive të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Sistemi formal i edukimit në Kosovë pasqyron në mënyrë simetrike problemet dhe tranzicionet e një shteti të ri; me një kurrikulë të ngarkuar përtej kapaciteti, qasje të kufizuar në tekonologji nëpër shkolla, mësues të pa motivuar, ndikojnë që nxënesit ti vuajnë pasojat në të ardhmen. Në këtë kontekst, mësimi për kulturë dhe trashëgimi kulturore nuk përbën përjashtim.

Ne anën tjetër, as organizatat e shoqërise civile nuk kanë bërë mjaft në këtë drejtim. Duke i lënë anash disa fushata vetëdijësimi të bazuara në donacione dhe disa publikime rreth trashëgimisë kulturore të cilat nuk kanë pasur mjaft qarkullim, OJQ-të në Kosovë fillojnë të interesohen për trashëgiminë kulturore vetëm kur ajo është e dëmtuar ose vetëm kur bëhet çeshtje e ndjeshme në rrethanat momentale të shtetit – gjë që në kontekstin e Kosovës është kur çështja e trashëgimisë politizohet.

Në qytetin e Prizrenit, Qendra Historike e inkorporon pjesën bërthamore të vlerave lokale: larminë kulturore të komuniteteve që jetojnë në Prizren. Manifestimi i diversitetit kulturor përmes trashëgimisë nuk është i shprehur aq mire në asnjë qytet tjetër të Kosovës.

Gjithsesi, niveli i degradimit urban të Qendres Historike të Prizrenit është në gjendje alarmante. Edhe pse Qendra Historike gëzon mbrojtje ligjore, palë të papërgjegjshme në mënyrë të vazhdueshme kontribojnë në degradimin dhe shkatërrimin e vlerave të saj.

Duke qenë një aset kulturor kaq ekskluziv, palët përgjegjëse për mbrojtjen e Qendrës Historike duhet të prioritizojnë zbatimin e aktiviteteve edukative duke rritur bashkëpunimin mes Drejtoratit Komunal të Arsimit, Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren, Muzeve dhe anëtarëve të Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren. Për këte arsye, një memorandum i mirekuptimit në mes të ketyre palëve duhet të ishte hapi i parë që ndërmiret për të siguarar aktvitete edukative të qëndrueshme, të cilat kanë për qëllim rritjen e njohjes se vlerave lokale kulturore.

Trashëgimia në shkolla: Kurrikula

Duke u bazuar në statistikat e edukimit[1], Komuna e Prizrenit ka 71 shkolla fillore (klasa 1-9) dhe 14 shkolla të mesme (klasa 10-12). Duke u bazuar në drejtorinë e Arsimit të Komunës, 31,957 nxënës në 58 shkolla fillore dhe te mesme janë pjesë e edukimit formal.

[1] http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2016-17-shqip.pdf

Duke u bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011[2], komuna e Prizrenit i ka 177,781 banorë. Sipas këtij numri, 17.9 përqind e të gjithë popullatës së Prizrenit janë nxënës.

Në vitin 2010 projekti i përbashkët në mes Këshillit të Europës dhe BE-së "Promovimi i Diversitetit Kulturor në Kosovë (PCDK)", realizoi një hulumtim për inkoroporimin e trashëgiminë kulturore në literaturë të edukatës shoqërore/qytetare të klasave 3 deri 9. Hulumtimi është realizuar për çështje të brendshme të projektit, por rezultatet treguan se trashëgimia kulturore mësohet vetëm sipërfaqësisht, ku referencat kryesore janë vetëm në reprezentimet religjioze dhe etnike (kisha, manastire, xhamia dhe). Aspektet e rëndësishme të praktikave të trashëgimisë shpritërore apo monumenteve relevante historike, siteve dhe ansambleve nuk përmendeshin fare.

Vlen të përmendet se në periudhën në mes viteve 2010-2015, PCDK ka organizuar vizita edukative HAJDE me mbi 5000 pjesëmarrës, përfshirë këtu nxënës, prindër e mësues të 20 shkollave fillore në Kosovë. Ky process u zgjërua në diskutime të përbashkëta, trajnime të mesuesve për trashëgimi kulturore dhe përpilimi i doracakut për mësues rreth trashëgimisë dhe Diversitetit[3]. Në vitin 2015, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e miraoi këtë doracak për trashëgimi dhe diversitet si një mjet ekstra-kurikular në lënden "Shoqëria dhe natyra" (klasa 3 deri 9). Zyrtari i bashkëpunimit në mes të MASHT dhe PCDK, Arbër Salihu ka deklaruar që disa pjesë të doracakut për trashëgimi dhe diversitet janë inkorporuar në kurrikulën formale të arsimit.

Duke u bazuar ne një përcjellje jo formale të punës së 24 mësuesve që fillimisht kanë qenë të involvuar në projekt, është parë që vetëm 6 prej tyre vazhdojnë ta përdorin si metodë opcionale (joobligative) doracakun në mësimin që ata e zhvillojnë.

Në vitin 2017, Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lansoi kurrikulën e në të gjitha shkollat e Kosovës[4] dhe temat rreth trashëgimisë kulturore janë pjesë e lëndës *Shoqëria dhe Mjedisi*.

Trashëgimia në kurrikulën bazë:

- *Në kurrikulën bazë të klaseve fillore të ulëta (klasët 1-5)*[5] në kapitullin ku shpjegohen proceset natyrore dhe shoqërore në kuadër të lëndës *Shoqëria dhe mjedisi*, theksohet se "ky koncept përfshin njohurinë, qasjen dhe vlerësimin e shoqërisë për vlerat trashëgimisë kulturore dhe natyrore, bashkëjetesën, solidaritetin, traditat, festat dhe të gjitha proceset tjera shoqërore që spjegojnë ndryshimet në jetën e përditshme.
- *Në kurrikulen bazë të klasave fillore të larta (klasët 6-9)*[6] në lëndën *Shoqëria dhe mjedisi*, në kapitullin që shpjegon mjedisin, burimet dhe zhvillimin e qëndrueshëm, nënvizohet se "ky koncept përfshinë edhe njohuri për hapësirën/universin (Tokën dhe sistemin diellor), fenomenet dhe proceset socio-gjeografike, fetë si dhe njohjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe mbrojtjen e tyre".

[2] http://www.osce.org/kosovo/13128?download=true
[3] Doracak per mesimdhenes – Njesi mesimore per trashegimine kulturore dhe diversitetin kulturor - https://rm.coe.int/16806ae5c8
[4] http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf (Page 42)
[5] http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf (Page 64)
[6] http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-2-final_1.pdf (Page 67)

- *Në kurrikulën bazë të shkollave të mesme (klasët 10-12)*[7] në lëndën *Shoqëria dhe mjedisi*, në kapitullin që shpjegon mjedisin, burimet dhe zhvillimin e qëndrueshëm, nënvizohet se "ky koncept përfshin njohuri dhe vetëdijësim për mbrojtjen e ambientit, burimeve dhe energjisë, ruajtjen e objekteve të trashegimisë kulturore e natyrore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm."

  Duke i parë trendet aktule, mund të konkludohet se shihet një tendencë që trashëgimia kulturore të jetë një temë e cila ka mundësi të përfshihet në kurrikulen e re për shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës. Në këtë drejtim, paraqiten dy probleme kyqe në mësim nxënien e trashëgimisë kulturore:

- Mungesa e njohurive dhe trajnimit adekuat të mësuesve për terminologjinë dhe konceptet bazike të trashëgimisë kulturore dhe vlerave të saja në shoqëri, dhe
- Mungesa e çasjes praktike për mësimin e trashëgimmisë kulturore.

Insitucionet zyrtare të trashëgimisë (Muzetë, Hamamet, etj) në Prizren nuk kanë marrë ndonjë veprim për dizajnimin dhe implementimin e aktiviteteve ose programeve edukative me shkollat lokale.

Janë gjithsejt 6 muze në Prizren, por vetëm 4 prej tyre janë të hapur për publikun. Aktivitete të shpeshta por jo sistematike organizohen në Hamamin e Prizrenit, Qendrën Beledije dhe Kino Lumbardhin. Këto qendra mund të përdoren për zhvillimin dhe inkorporimin e aktiviteteve edukative, pasi që struktura arkitektonike e objekteve është e përshtatshme për organizimin e aktiviteteve të tilla. Gjithashtu, duhet të përpilohet një hulumtim me qëllim të zbulimit të pronave potenciale – publike ose private – të trashëgimisë, të cilat mund të përdoren për realizimin e aktiviteteve edukative.

Shërbimet të cilat ofrohen nëpër muze janë të limituara, si psh audio-guidë apo ndonjë kënd ku mund të shiten suvenire. Gjithashtu, shumica e eksponateve nuk janë të interpretuara, ose janë të emërtuara vetëm shqip – e kjo kufizon të kuptuarin dhe interpretimin e eksponateve për turistë. Gjithashtu, në asnjë muze të Prizrenit nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.

Përpos mungesës së programeve edukative, poashtu mungon përfshierja e komunitetit në aktivitetet të muzeumeve. Në këtë sens, mungesa e kulturës së vullnetarizmit në raport me ruajtjen dhe promovimin e aseteve të trashëgimisë kulturore është evidente.

Qendra Rajonale e Trashëgimise Kulturore e Prizrenit e cila menaxhon muzete dhe Hamamin, konfirmon se në aktivitetet e tyre komponenta e edukimit nuk eshte e perfshirë. Sipas Jusuf Xhibo, u.d. i drejtorit të QRTK-së në Prizren, bashkëpunimet kryesore edukative të institucionit të tyre në Prizren ndodhin me studentët e arkitekturës në Prishtinë dhe me studentët e nivelit Master në Universitet të Prizrenit. Nuk është e ditur nëse do të ketë vullnet apo ndonjë iniciativë për përfshirjen dhe pilotimin e komponentës edukative në QRTK.

Aspekti i edukimit përmes argëtimit në raport me trashëgiminë kulturore është përgjithësisht i mangët jo vetëm në Prizren por gjihtkund në Kosovë. Përveç aktiviteteve njëditore me qasje pjesëmarrëse si 40 Bunar Fest, festivali i Stripave apo aktiviteteve të vogla edukative kuadër të

[7] http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-3-final.pdf (Page 67)

DokuFest, aktivitete të kësaj natyre janë të kufizuara. Është nevojë immediate që edhe artizanët lokal (p.sh. filigrani), teatri lokal, ansamblet e muzikës dhe folklorit (Agimi), kinemaja publike (Lumbardhi) apo eventet tradicionale (p.sh. Hasi Jehon) të përfshihen në aktivitete vetëdijësuese edukative me shkolla.

Për ta pasur një pamje të qartë të qështjes, duhet t'i hedim një sy gjithë veprimeve të hisedarëve të përfshirë në aktivitete edukative në Qendrën Historike të Prizrenit.

Siç u cek edhe më sipër, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore por edhe Këshilli për Trashëgimi Kulturore i Prizrenit nuk janë të angazhuar në aktivitete edukative për trashëgimi kulturore.

Organizatat e shoqërisë civile në Prizren janë zëri i vetëm aktiv që i adreson problemet me kohë. Një numër i organizatave janë duke punuar në shumë fronte si dhe organizojnë aktivitete të shpeshta për vetëdijësim dhe promovim të vlerave të trashëgimisë në Qendër Historike. Puna e tyre përfshin mobilizimin e qytetarëve dhe synimin e krijimit të një platforme të hapur për qytetari aktive për ti kundërshtuar veprimet e paligjshme në Qendrën Historike. Për shembulll, *OJQ EC Ma Ndryshe* punon si organizatë *watchdog*, dhe ka prodhuar një numër të hulumtimeve për Qendrën Historike dhe angazhohet për monitorimin e trendeve dëmtuese dhe raportimin e tyre drejt mediave dhe autoriteteve qendrore të kulturës. Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren - RrOK i përfshin mbi 20 organizata lokale përfshirë DokuFestin dhe përmes një peticioni publik ka arritur ta vendosë Kino Lumbardhin në listën e monumenteve të mbrojtura të Trashëgimisë Kulturore duke e ndalur procesin e rindërtimit dhe tjetërsimit të saj në qendër tregtare; ndërsa organizatat rinore (si: IPSIA, THY dhe të tjera) promovojnë diversitetin kulturor tek gjeneratat e reja përmes aktiviteteve të ndryshme.

Institucionet Edukative (shkollat) nuk kanë fokus në tema dhe çështje relevante për kontekstin. Institucionet e edukimit formal duhet ti kushtojnë më shumë vëmendje ruajtjes së aseteve të trashëgimisë dhe njohjes së vlerave të Qendrës Historike të Prizrenit. Përderisa dëmtimi i aseteve të trashëgimisë dhe indeferenca e institucioneve të kulturës arrin një nivel alarmant, investimi në edukim duket të jetë rruga më premtuese për ta përmirësuar këtë imazh në një periudhë më afatgjate.

Sidoqoftë, me dinamikat aktuale të implementimit të kurrikulës, shkolla nuk do të arrijnë implementimin e qëndrueshëm të aktiviteteve edukative të ndërlidhura me trashëgimi sepse mësuesit nuk janë të gatshëm apo të trajnuar t'i implementojnë ato module në klasë apo jashtë saj.

Vlen të përmendet se Strategjia Kombëtare e Kosovës për Trashëgimi Kulturore[8] (2017 – 2027) i kushton një rëndësi periferike edukimit mbi trashëgimi. Përveç muzeve lokale dhe kombëtare, strategjia dështon ti adresojë trupat tjerë të përgjegjshëm për implementimin e aktiviteteve formale dhe joformale të edukimit për trashëgimi. Poashtu, nuk ka pasur asnjë hap drejt implementimit të pjesës edukative të strategjisë. Në këtë aspekt, një bashkëpunim në mes Ministrisë së Kulturës dhe asaj të Edukimit është i domosdoshëm, në mënyrë që të ndërrohet trendi pasiv.

Në rastin e Prizrenit, një fasilitues i mundshëm i programit edukativ për trashëgimi mund të jetë Zyra e Qendrës Historike që do të themelohet në vitin 2018. Mandati i kësaj zyre duhet të jetë

[8] http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf

dizajnimi, revidimi, monitorimi dhe vlerësimi i punës së Drejtorisë së Arsimit, QRTK-së, Muzeve të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Kulturës si implementuesit kryesor të këtij aktiviteti.

Programet e rekomanduara

Aktivitet edukative të cilat janë propozuar më poshtë, fillimisht, kanë për qëllim që të familiarizojnë nxënësit me rëndësinë e konventës së Faro-s dhe t'i kuptojnë vlerat e trashëgimisë në shoqëri. Gjithashtu, në këtë propozim janë të përfshira disa aktivitete të domosdoshme, të cilat iu drejtohen të gjithë mësuesve që kanë deshirë ti avancojnë dhe përforcojnë metodat e tyre profesionale për trajnimin dhe mësimin e çështjeve të trashëgimisë kulturore.

Metodologjia e të mësuarit, i nxit të gjithë prindërit dhe mësuesit që të jenë pjesë e procesit. Kjo është arsyeja pse aktivitetet janë të ndara në këto blloqe:

BLLOKU 1 – ***Program i trajnimit të mësimdhënësve:***

- 1.1 Nje program i trajnimit për mësimdhënës me aktivitete të propozuara mund të gjendet këtu.[9]:. Një trajnim dy-ditor për mësuesit do të fokusohet në komponentet e trashëgimisë kulturore dhe diveritetit kulturor.
- 1.2 Një doracak për mësuesit për kulturën dhe diversitetit mund të shihet këtu.[10]: Njësitë mësimore që shpjegojnë konceptet themelore të trashëgimisë kulturore dhe diversitetit, duke u bazuar në metodologji eksperienciale.
- 1.3 Shtojcat e doracakut të mësimdhënësve mbi kulturën dhe diversitetin mund të gjinden këtu[11]. Këtu ipen materiale trajnuese shtesë për njësitë specifike mbi trashëgiminë dhe diversitetin kulturor.

.

BLLOKU 2 – *Trashëgimia nëpër shkolla;*

- *2.1 Java e trashëgimisë në shkollë (shkolla fillore – klasa 6-9)*

  Përshkrimi i aktivitetit: Çdo vit, një grup i 20 studentëve dhe koordinatorësh (prindër/mësues) dizajnojnë një aktivitet 5 ditor i cili do të përfshijë vizita në lokacione të trashëgimisë, vizitë tek artizanatet, përgaditje të ndonjë ushqimi tradicional, tregime në klasë, projektim të filmave me tematikë trashëgiminë/dokumentarë, diskutime rreth trashëgimisë, ekspozitë me fotografi/piktura të objeteve ose lokacioneve të trashëgimisë.

- 2.2 *Klubet e trashëgimisë (shkolla e mesme – klasa 10-13)*

  Përshkrimi i aktivitetit: Të dhëhequr nga fascilitatori (mësuesi), grupet e nxënësve (për shkollë) do të marrin pjesë në programe sistematike të cilat janë të lidhura me trashëgimi, si psh: ekspozitë e fotografive, ligjeratë në shkollë mbi trashëgiminë nga një ekspert i fushës, ose kuize për trashëgimi.

BLLOKU 3 – *Trashëgimia jashtë shkollës*

[9] Program trajnim – mësimi mbi trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturore, https://rm.coe.int/16806ae6af

[10] Doracak per mësimdhënës – Njësi mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor - https://rm.coe.int/16806ae5c8

[11] Shtojcë për njësite mësimore për trashëgimine kulturore dhe diversitetin kulturor - https://rm.coe.int/16806ae5c7

- *3.1 Përvetëso (adopto) një lokalitet të trashëgimisëhapësirë (shkolla e mesme – klasa 10-13)*

  Përshkrimi i aktivitetit: Studentët dhe koordinatoret (mësues ose prind) e zgjedhin një lokalitet të trashëgimisë relevant për komunitetin,. Aktivitetet që do të zhvilloheshin mund të jenë pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirës, si dhe projeksionet e filmave me tematikë trashëgiminë, ligjeratë dhe diskutime mbi çështjet e trashëgimisë dhe ekspozimin e ushqimit tradicional.

- *3.2 Çfarë më kanë treguar gjyshërit e mi12 (shkolla fillore – klasa 6-9; shkolla e mesme – klasa 10-13).*

  Përshkrimi i aktivitetit: Studentët punojnë me të mohuarit (gjyshin ose gjyshen) në përmbledhjen e tregimeve për qytetin dhe lagjen. Tregimet fokusohen në elemente e praktika të ndryshme të trashëgimisë shpirtërore, siç janë ushqimi, artizanatet, veshtjet, ritualet, festat, këngët, instrumentet, dhe elemente të tjera të ngjajshme që e kompletojnë imazhin dhe perceptimin e jetës në Prizren ndër vite. Ideja është që të ndajmë dijen kolektive dhe ti kalojmë vlerat nga një gjeneratë në tjetrën. Një shembull gjindet këtu.

- *3.3 Ditët e Trashëgimisë Europiane (DTE) (Shkollat fillore- klasa 6-9; shkollat e mesme – klasa 10-13).*

  Përshkrimi i aktivitetit: Koordinatorët e OJQ-ve do të përgadisin një program shkollor i cili do të prezantohet gjatë DTE-së në Prizren. Aktivitetet mund të përfshijnë prezantime të multimedias të cilat do të përgaditen nga studentët, kuize për trashëgimi (garë në mes shkollave), vizita të lokaliteteve, ekspozitë të artizanateve, ushqim tradicional, vizitë në shtëpi të vjetra apo diskutime për ruajtjen e trashëgimisë në Prizren.

- *3.4 Muzetë e Hapur/Nata në Muze (shkollat e mesme – klasa 10-13).*

  Përshkrimi i aktivitetit: Gjatë aktivitetit të natës në muze (Muzeu etnologjik, Muzeu arkeologjik, Hamami i qytetit, Kompleksi I Lidhjes së Prizrenit) studentët do të mund të përgadisin programin e tyre me aktivitete specifike të cilat do të përfshijnë artizanatet në muze, projektimin e filmave për trashëgimi, ekspozitë të fotove familjare, tregime në muze, lexim të poeteve lokal dhe ftesa e muzikantëve lokal.

- *3.5 Kino Trashëgimia (+ diskutim) (shkolla të mesme – klasa10-13)*

  Përshkrimi i aktivitetit: Një herë në muaj, nxënësit marrin pjesë në projeksion të filmave të cilat kanë tematikë trashëgiminë (shembull në Lumbardh). Gjatë seancës së dytë, nxënësit inkurajohen të marrin pjesë në diskutime rreth filmit, ku mësuesit e moderojnë bisedën.

- *3.6 Shkolla Verore e Trashëgimisë / Olimpiadat e Trashëgimisë (për të dy nivelet)* të zhvilluar nga OJQ lokale.

[12] Rrefime te urta - https://rm.coe.int/16806ae5ca
Tregimet e gjysherve tane - https://rm.coe.int/16806ae5c3

BLLOKU 4 - *Edukimi përmes Argëtimit*

- *4.1 Shtegu i zbulimeve (lojë elektronike)* – Ekziston modeli digjital që do të mund të adaptohej në kontekst të Prizrenit. Loja e zbulon rrugën e aseteve të trashëgimisë në Kosovë dhe jep detaje bazike për historinë e tyre.

- *4.2 Zbulo Qendrën Historike - lojë në tavolinë.* Ekziston modeli i lojës "Zbulo Junikun" i prodhuar nga projekti PCDK i Këshillit të Europës. Të adaptohet në kontekst të Prizrenit/Qendrës Historike.

- *4.3 Klasat e artizanëve* – Të mësohen aftësitë nga artizanët lokal dhe transferohen dija dhe vlerat e praktikave të trashëgimisë shpirtërore drejtuar gjeneratave të reja (p.sh. filigran).

1.10

Identiteti vizual dhe brendimi



1.10 IDENTITETI VIZUAL DHE BRENDIMI

Në kuadër të hartimit të procesit të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit, është mbajtur edhe punëtoria dyditore "Brendimi i qytetit të Prizrenit". Qëllimi i punëtorisë ishte prezantimi i koncepteve të brendimit të qyteteve, diskutimi gjithpërfshirës mbi elementet e brendimit të qytetit të Prizrenit dhe hartimi i planit të veprimit të kësaj fushe specifike. Punëtoria e mbajtur për herë të parë për një temë të tillë në Prizren, mblodhi ekspertë dhe pale të ndryshme të interesit të cilët diskutuan hapur për mundësinë dhe nevojën e brandimit të Prizrenit, rëndësinë e këtij procesi dhe dhe mënyrën se si do të duhej të zhvillohej një proces i tillë nëse ndodh.

Brendimi i një vendi (duke përfshirë **marketingun e një vendi** dhe **promovimin e një vendi**) është një term i ri ombrellë që përfshinë brendimin e një kombi, rajoni apo qyteti. [1] Brendimi i një vendi është procesi i komunikimit të imazhit në një treg të synuar. Është pa dyshim e lidhur me nocionin që vendet konkurrojnë me njëra tjetrën për njerëzit, resurset dhe biznese; konkurrenca globale e qyteteve vlerësohet të ketë 2.7 milion qytete të vogla, 3.000 qytete të mëdha dhe 455 metropole.[2] [3] [4] [5] Brendimi i një vendi / qyteti mund të përkufizohet si proces i udhëhequr nga administratat publike për të synuar krijimin e markës së një vendi. "Një brend i një vendi është një rrjet i asociacioneve në mendjen e konsumatorëve bazuar në shprehjen vizuale, verbale dhe të sjelljes së një vendi dhe palëve të saja të interesit. Këto asociacione ndryshojnë në ndikimin e tyre brenda rrjetit dhe për rëndësinë për sjelljet e konsumatorëve të atij vendi"[6]. Prandaj synon të ndikojë në perceptimet e një vendi dhe të pozicionojë atë në mënyrë të favorshme (pozitive) në mendjet e grupeve të synuara. Brendimi i vendve mund të konsiderohet edhe si një "strategji qeverisjeje për projektimin e imazheve dhe menaxhimin e perceptimeve rreth vendeve të caktuara"[7] Brendimi i një vendi sugjeron që vendet, qytetet, rajonet apo shtetet mund të konsiderohen si markë, për aq kohë sa perceptohen kështu. Në këtë drejtim, shumë administrata publike zbatojnë strategjitë e tyre të brendimit.

Për të shpalosur më tutje konceptin e brendimit, në punëtori u prezantuan aspekte të brend-it si produkt dhe si proces në nivele dhe kontekste të ndryshme. Cili është dallimi bazë midis Brendimit dhe Marketingut dhe ku duhet të bëjmë kujdes duke qenë se brendi duhet të jetë i besueshëm dhe i

[1] "City branding: a state-of-the-art review of the research domain", produced by Andrea Lucarelli and Per-Olof Berg, Journal of Place Management and Development, Vol. 4 Iss: 1, pp.9 - 27, 2011

[2] "Understanding Sustainable Cities: Competing Urban Futures", written by Simon Guy & Simon Marvin, University of Newcastle, European Urban and Regional Studies 6(3) 1999

[3] "Global Market of Cities", produced by Metti & Bronner 2011

[4] Competitive Advantage of Nations, written by Michael E. Porter, Harvard University Business School, Free Press 1998

[5] "Competitive Identity", written by Simon Anholt, Palgrave Macmillan 2006

[6] Zenker, S. & Braun, E. (2017): Questioning a "one size fits all" city brand: Developing a branded house strategy for place brand management. Journal of Place Management and Development. 10(3), 270-287. Link: https://doi.org/10.1108/JPMD-04-2016-0018

[7] Braun, Erik, Eshuis, Jasper, & Klijn, Erik-Hans. (2014). The effectiveness of place brand communication. Cities, 41, 64-70.

vërtetë gjithnjë duke aspiruar zhvillimin dhe reprezentimin e denjë. Në këtë process u diskutuan nivele të ndryshme të brandimit si brandimi i vendit, qytetit, kombit, regjioneve, hapësirave publike, etj.

Më pas fokusi kryesor ishte në faktorët që ndikojnë brendimin – si faktorët e fortë që lidhen me infrastrukturën dhe shërbimet dhe faktorët e butë me pjesën emocionale dhe ndjenjën e përkatësisë dhe identifikimit me vendin. Ndërmjet tyre faktor i rëndësishëm është menaxhimi i resurseve që e krijojnë brendin dhe rrisinë reprezentimin dhe identifikimin me vendin. Me këtë rast u prezantuan edhe vlerat e zonës historike të qytetit të Prizrenit mbi të cilat është ndërtuar vizioni dhe objektivat për zhvillimin dhe menaxhimin e kësaj zone.

Foto 1. Pamje nga punëtoria e brendimit

Pjesa e punës në grupe kishte për qëllim që përmes një procesi gjithëpërfshirës të shpalosen ide dhe mendime për elementët kryesor material dhe jomaterial që e shquajnë Prizrenin si qytet dhe rrethinë. Në këtë mënyrë u fouan dy fokus grupe, ajo që punoi në elementet jomateriale si dhe grupi tjetër në elemente materiale.

Në punëtori u prezantua dhe u simulua se si do të mund të brendohej Prizreni duke nisur nga fjala kyqe e cila mund ta identifikojë atë edhe në dhomat virtuale (sikurse #prizrening) dhe tutje tek elementet e brendshme dhe të jashtme të tij. Për më tepër u prezantuan detaje rreth elementeve përfaqësuese përmes dizajnit dhe përdorimi i tyre në dokumente, stema dhe elemente të tjera të qytetit.

Foto 2. Pamje nga punëtoria e brendimit

Specifikat e brendimit për qytetin e Prizrenit

Brendimi ka si qëllim kryesor identifikimin e potencialeve kryesore të qytetit dhe ato ti sjellë në pah për rëndësinë që e kanë për komunitetin si dhe për publikun e jashtëm të targetuar. Ai duhet të jetë i besueshëm, i matshëm dhe i prekshëm në mënyrë që ta fuqizojë aspektin unik dhe identitar të Prizrenit në raport me qytetet e tjera në rajon dhe përtej. Andaj në rastin e Prizrenit cilat do të ishin specifikat kryesore në procesin e brendimit të tij?

Foto 3. Pamje nga punëtoria e brendimit

Në kuptim hapësinor janë tre qarqe mbi të cilat mund të ndërtohej rrëfimi / brendimi i Prizrenit: 1. Zona Historike, 2. Qyteti/Komuna si dhe 3. Rajoni i Prizrenit. Këtu mund të hyjnë të gjitha karakteristikat mjedisore e fizike të shtresuara nga kohë të caktuara, andaj nuk mund të lëmë pa përmendur pejzazhin malor, ujin si element i rëndësishëm në shtrirjen dhe zhvillimin e qytetit, jazet, mullinjt, krojet si dhe kultin e nanës së ujit. Poashtu elementet fizike si kalanë e Prizrenit, objektet e kultit dhe shumë shtëpi banimi karakeristike për pejzazhin urban të shtresuar nëpër kohë. Në anën tjetër shtresimi shpirtëror i trashëguar dhe ai në kujtesën e banorëve të vjetër të qytetit është poashtu një element tjetër i rëndësishëm. Prizreni është imazhi i harmonisë së të gjitha feve, bashkëjetesës dhe tolerancës. Poashtu edhe elementet e tjera të ”buta” apo trashëgimia shpirtërore si muzika (Zambaku i Prizrenit), veshjet (sidomos përpunimi i lëkurës) dhe ushqimi me recetat specifike (mishi i qengjit, djathi i sharrit, hashlama) zënë vend të rëndësishëm.

Përtej elementeve të fuqishme identitare të trashëguara, brendi mund të ndërtohet edhe mbi elemente të reja të cilat kanë filluar të lënë gjurmën e tyre dhe ta vënë Prizrenin në hartën e rëndësishme të komunikimit global (DokuFest, NgomFest, 40BunarFest, si dhe së fundi Bienalja e parë e artit bashkëkohor në Kosovë dhe e vetmja e këtij lloji në regjion - Autostrada Biennale).

Në gjithë këtë paletë shenjuesish nëpër kohë cilët mund të jënë atributet kryesore të lexueshmë në shikim të parë për brendmin e Prizrenit dhe cilët mund të jenë elementet përkrahës të këtij brandi? Kjo varët edhe nga qasja jonë se a duam të bëjmë brendim për qytetin dhe banorët e saj duke aluduar në formësimin dhe rritjen e krenarisë kolektive apo duam të brendojmë Prizrenin për një publik më të gjerë duke aluduar edhe në platformën e turizmit kulturor se çfarë mund të ofroj Prizreni brenda zonës urbane dhe në rajon.

Foto 4. Qendra Historike e Prizrenit; Lidhja Shqiptare e Prizrenit; Festivali Zambaku i Prizrenit; veshjet tradicionale të komuniteteve në Prizren

Kujtesa kolektive

Kujtesa kolektive si koncept relativisht i ri ka mundësuar që përtej kujtesës dhe historisë së legjitimuar të një konteksti të ofroj hapësirë për rrëfime shtesë dhe histori të vogla të cilat e pasurojnë dhe i japin një ngjyrim e shije tjetër rrëfimit për qytetin. Andaj është shumë e rëndësishme që elementet, shtresimet dhe rrëfimet të cilat janë të rëndësishme si traditë e Prizrenit si qytet dhe rajon nëse nuk janë arkivuar dhe legjitimuar, apo edhe mund të jenë në zhdukje e sipër si tradita, të hulumtohen dhe të sillen në pah përmes historisë gojore dhe materialeve personale të individëve dhe familjeve prizrenase.

Në fakt kujtesa kolektive si e tillë dhe humbja e saj ishte ajo që u vu theks edhe gjatë punëtorisë së mbajtur për brendimin e Prizrenit. Sot ende nuk egziston nje koncenzus minimal i domosdoshëm qytetar se cilat janë vlerat e përbashkëta të Prizrenit – si kënga e saj, gatimi, pija, monumenti/et, tradita, historia, tregimet, shkrimtari, piktori, ngjyra apo motivi i përbashkët me të cilën identifikohet Prizreni. Prandaj gjatë procesit të ndërtimit të brendit është i domosdoshem krijimi i nje mase kritike

të qytetarëve të vetëdijshëm për vlerën e qytetit të tyre. Pa e kuptuar vet qytetarët e Prizrenit vlerat e veta vështire se mund të i "shesin" të njejtat vizitorëve të saj. Ky proces është shumë i rëndësishëm në rrugën e legjitimimit të kujtesës kolektive si bazament i krenarisë kolektive për qytetin dhe brendimin si rrëfim i besueshëm i tij.

Foto 5. Dokufest; Ngomfest; 40Bunarfest; Autostrada Bienale.

Format e brendimit

Brendimi mund të jetë organik apo i konstruktuar. Brendimi organik përbëhet nga elementet që i gjejmë brenda një qyteti e vendi dhe që janë pjesë e identitetit të qytetit në mënyrë të natyrshme. Në anën tjetër brendimi i konstruktuar është ai brend i cili ndërtohet me qëllim për të realizuar një vizion apo konceptim ideor për atë se çfarë dëshirojmë të jetë qyteti në të ardhmen dhe të shquhet

më ndonjë element të ri në garën e përgjithshme të identifikuese të qyteteve në botë. Theksi si e para duhet vënë edhe një herë në rëndësinë e vetëdijes e më pas edhe në rrafshin e identitetit. Shquarja e identitetit dhe ngritja e vetëdijes kolektive mbi shtresimet identitare si vlerë e qytetit mbi të cilën mund të ndërtohet platforma e zhvillimit ekonomik do të krijojë hapësirë dhe dëshirë për identifikim si proces i rëndësishëm i mishërimit të banorëve me qytetin dhe si nevojë e re për ti shërbyer atij në procesin e mundësive që qytetit do të mund të ua ofroj atyre.

Foto 6. Llogo e qytetit të Prizrenit duke integruar elementet kryesore identifiuese të saj (Autor: Jeton Jagxhiu)

Në procesin e brendimit të Prizrenit si pikënisje mund të mirren edhe raste të tjera studimi nga qytete të tjera me tipare të përafërta – gjatë punëtorisë u shpalos brendimi i qytetit të Portos në Portugali. Bashkangjitur me këtë dokument është edhe një prezentim vizuel i brandimit të qytetit të Portos së bashku me elementet brenduese dhe procesin e rimendimit të tyre për të krijuar brendin si llogo, si shënjues në qytet dhe si paket të përgjithshëm edhe për njerëzit lokal por edhe për turistët.

Foto 7. Elementet e brendimit të qyteti të Portos në Portugali.

Qendra Historike e Prizrenit

Rëndësi të veçantë duhet kushtuar në vlerat, vizionin dhe objektivat e Qendrës Historike të Prizrenit duke e lokalizuar tashmë rrëfimin në vet qytetin e Prizrenti dhe duke i sjellë në pah elementet kryesore fizike dhe vlerat e tyre përbrenda zonës së vjetër të qytetit. Theks duhet vënë në rrezikun e humbjes së statusit si qëndër historike në të ardhmen për shkak të shkatërrimeve të shumta në zonë dhe tjetërsimit të saj që sërish ktheu debatin të mungesa e vetëdijes kolektive për këto të mira të përbashkëta dhe trashëgiminë kulturore.

Gjatë brendimit duhet spikatur historinë 2000 vjeçare të qytetit e cila është e dukshme në copëza. Duhet të krijohet një hartë e kujtesës e cila e orienton rrëfimin e zonës historike dhe vlerave të saj.

Njëkohësisht duhet të ketë një strategji për të gjitha shtëpitë e banimit brenda zonës të cilat kanë si qëllim të ndryshojnë funksionin nga banimi në funksion publik, oborret e tyre të hapen kundrejt hapësirës publike me qëllim të krijimit të dhomave të reja të hapura urbane dhe shtimit të hapësirës publike si të tillë. Ky proces i sjell në dukje më shumë dhe i hap ato kundrejt banorëve dhe vizitorëve. Shenjimi dhe ndriçimi do jenë element të rëndësishem brenda zonës urbane. Ndriçimi duhet të jetë në harmoni me përmasat e ndërtesave dhe imazhin e përgjithshëm të zonës dhe si i tillë duhet të vë theks në momentet e rëndësishme arkitektonike dhe mjedisore duke i potencuar ato në pejsazhin e natës. Shenjimi duhet poashtu të kornizohet në madhësi dhe disa lloje tipografishë brenda të cilit shumëllojshmëria e ideve të ndërrmarësve mund të vij në shpreje por ende të jetë në frymën e përgjithshme të zonës.

Ambienti përreth qytetit

Komuna e Prizrenit është komunë me sipërfaqe më të madhe në Kosovë. Shtrihet prej naltësisë më të ulte mbidetare (285m) e deri në naltësitë alpine (2660m). Nëpërmjet grykës së lumit Drini i Bardhë deri në qytet depërton klima mesdhetare (60%) e cila fuzionohet me klimen kontinentale (40%) që vie nga malet e Sharrit. Për shkak të këtij konfiguracioni dhe fuzionimi klimatik në rajon kultivohen kultura bimore nga më të ndryshmet – prej fikut, kivi, bamje, mushmullë, magdanoz, kopër, shalqin, speca e domate e deri te qershiat, arrat, llojet e ndryshme të mollave dhe polloshkat që rriten në naltësira.

Në aspektin artistik, Kalaja dominon siluetën e Qendrës Historike dhe konturat e saj janë të dukshme nga secila rrugë dhe shtëpi, duke e shndërruar ate në njërën nga simbolet e qytetit. Gjithashtu shikuar nga Kalaja kah qyteti, vlerat estetike janë të ndërsjella, duke ofruar një pamje gjithëpërfshirëse të qytetit, luginës dhe maleve, përtej vendosjes së Prizrenit në kontekstin e tij urban dhe natyror.
Në aspektin ambiental, Kalaja është e rrethuar nga natyra, e ndarë nga qyteti me një brez të gjelbërt dhe e bashkangjitur me Parkun në anën lindore. Kjo pozitë e volitshme mundëson zhvillimin e florës dhe faunës, brenda perimetrit të Qendrës Historike.
Përfundimisht, Kalaja ka vlerë të lartë ekonomike, duke qenë një destinacion i vizituar nga njerëzit, që ofron pamjen e siluetës së qytetit dhe është vendngjarje për shfaqeje filmash e aktivitete tjera kulturore. Afërsia dhe distanca e saj nga qendra e qytetit e bëjnë vendndodhje të përsosur për ngjarje të tilla, duke lejuar qasje të lehtë por të kufizuar.

<u>Udhëzimet dhe Kufizimet</u>
Duke marrë parasysh vlerat e lartpërmendura, kjo zonë duhet të trajtohet me një kujdes të shtuar. Përkundër faktit se Kalaja shfrytëzohet si vend për aktivitete kulturore, struktura e saj historike duhet të ruhet me kujdes të shtuar. Çdo ndërhyrje apo instalim i përkohshëm duhet paraprakisht të aprovohet nga autoritetet përgjegjëse dhe të largohet pas përfundimit të aktivitetit. Ndërtimet/ shtimet e reja brenda apo mbi muret rrethuese nuk duhet të lejohen, ngase do të degradonin vlerat e mbetura artistike, historike, shkencore dhe ambientale.
Ndërhyrjet e rekomanduara në këtë zonë, përfshijnë veprimet për përmirësim të sigurisë, me vendosjen e ndriçimit, dhe qasje gjithëpërfshirëse për personat me nevoja të veçanta, duke u mundësuar me rrugë motorike në anën lindore.

Foto 2. Shfrytëzimi i Kalasë për koncerte dhe si kinema e hapur, @Dokufest

2.2. Zona e Nënkalasë

Zona e Nënkalasë së bashku me lagjet Panteli dhe Potok Mahallë janë ansamble të listuara në listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përkohshme 2017-2018. Kjo zonë shtrihet mbi kodrën e cila gjendet nën Kalanë e Prizrenit, duke prezantuar prezencën e jetesës në hapësirën nën Kala.
Shkatërimi i shtëpive të vjetra ka filluar gjatë viteve '70-ta të shek. XX, kur shumë prej tyre janë rindërtuar me materiale të reja.
Trazirat në mbarë Kosovën, më 17-18 mars 2004 shkaktuan dëme edhe te monumentet ortodokse dhe në lagjen e Nënkalasë, duke ndikuar në humbjen e autenticitetit të shtëpive të vjetra tradicionale.
Kisha e Shën Shpëtimtarit e vendosur në këndin jugor, paraqet një prej pikave kryesore referuese, duke përfshirë edhe Kishën e Shën Dielës – Dëftimi i Shën Mërisë, Kishën e Shën Magjistarit, dhe Shkollën e Muzikës.

Përpos ndërtesave me vlerë të trashëgimisë kulturore, në këtë zonë gjenden ndërtime të reja të shtëpive të banimit të cilët janë projektuar në bazë të udhëzimeve të paraqitura në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit[16]. Përpos disa rasteve që bëjnë përjashtim, në këtë zonë mbizotërojnë ndërtimet e reja që janë në harmoni me strukturën historike të qendrës.

Kjo zonë është shfrytëzuar si zonë e banimit dhe ende e ruan funksionin fillestar, përpos faktit që është pjesërisht e banuar dhe e ka humbur gjallërinë.

Ngjarjet e hidhura në të kaluarën kanë ndikuar në humbjen e origjinalitetit, rrjedhimisht të vlerave historike dhe artistike të shtëpive të vjetra tradicionale. Por në anën tjetër, mënyra e vendosjes së shtëpive dhe rrjeti i ngushtë i rrugëve u janë përshtatur konfiguracionit të terrenit, duke krijuar një bashkëdyzim ndërmjet ansamblit arkitektonik dhe natyrës.

<u>Udhëzimet dhe Kufizimet</u>
Pozita qendrore e kësaj zone, duke qenë nën Kala dhe duke ofruar pamje të qytetit, si dhe qasja e lehtë i japin vlera ekonomike kësaj zone. Kombinimi i funksionit të banimit me funksionin shërbyes (hotelieri, restorant dhe kafe) mund të propozohet, por duhet të merret parasysh rreziku potencial dhe ndikimet që funksionet shërbyese mund t'i sjellin lagjes së banimit. Menaxhimi dhe propozimi i funksioneve në këtë zonë është më i vështirë duke marrë parasysh se një numër i shtëpive është në pronësi të serbëve dhe është i pabanuar.
Në aspektin teknik, struktura e hapur e ndërtimit duhet të mirëmbahet pasi që mundëson insolim të mirëfilltë dhe ofron pamje drejt qytetit që shtrihet poshtë kësaj kodre. Prandaj, ekuilibri aktual ndërmjet hapësirës së ndërtuar dhe asaj të gjelbërt, duhet të ruhet nëpërmjet koeficientit të ndërtimit, të definuar saktësisht. Ky raport ndërmjet ndërtimit dhe hapësirës gjelbëruese, njëkohësisht mundëson edhe izolimin e Kalasë dhe të monumenteve në zonë.

[16]Enes TOSKA editor, *Plani i Konservimit dhe i Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, Përparësitë dhe sfidat e zbatimit*, Prishtinë: CHwB, 2010.

Foto 3. Pamje e mahallës së Nënkalasë

2.3. Zona e banimit (me strukturë organike) – Pantelia



Pantelia së bashku me Nënkalanë dhe Potokmahallën janë ansamble të listuara në listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përkohshme 2017-2018. Kjo zonë shtrihet në anën jugore të Qendrës Historike, apo në perëndim të Nënkalasë. Zona është e koncentruar me ndërtime të reja që datojnë nga fundi i shek. XX dhe fillimi i shek. XXI. Ndërtimet e reja nuk kanë respektuar as mbulueshmërinë e parcellës, dhe as lartësinë e ndërtimit të lejuar në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit.

Disa shtëpi të vjetra tradicionale të cilët janë në gjendje të keqe fizike si dhe konfiguracioni i terrenit janë elemente të vetme të ruajtura nga e kaluara. Kjo zonë është e dominuar tërësisht me ndërtime të reja të cilët nuk kanë respektuar konfiguracionin e terrenit dhe balancin ndërmjet ndërtimit dhe natyrës.

Kjo zonë është shfrytëzuar si zonë banimi dhe e ruan funksionin fillestar, por struktura urbane historike dhe ndërlidhja ndërmjet shtëpive dhe ambientit rrethues, si tipare janë humbur.

<u>Udhëzimet dhe Kufizimet</u>

Gjendja aktuale në këtë zonë është kritike për shkak të numrit të madhë të ndërtimeve pa leje dhe tejkalimeve të lejeve, të ndërtuar me materiale dhe proporcione jo të përshtatshme. Në këtë mënyrë kjo zonë krijon një imazh negativ për Qendrën Historike të Prizrenit.
Përkundër gjendjes së keqe aktuale, kjo zonë është një pjesë integrale e siluetës historike, dhe ka potencial për zhvillim të vlerave **ekonomike dhe ambientale**. Këto vlera mund të zhvillohen falë pozitës së volitshme të kësaj zone, që ofron qasje të përshtatshme në qendër, dhe lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e cila e kufizon anën jugore të saj.
Rrjedhimisht balanci ndërmjet natyrës dhe ndërtimit, hapësirës së lirë dhe zhvillimit, dhe funksionit rezidencial dhe komercial, do të duhet të ruhet me përpikshmëri.
Ndërhyrjet e kujdesshme, që përfshijnë **rehabilitimin e fasadave** së bashku me **regjenerim urban** janë hapa të propozuara për rikthim të karakterit historik urban të zonës. Ndërtimet joadekuate dhe ndërhyrjet e palejuara duhet të parandalohen me zbatimin e ligjeve ekzistuese.

Foto 4. Pamje e mahallës Pantelia

2.4. Zona e banimit (sipas trendeve aktuale të ndërtimit) - Potok Mahalla/Papas Çarshia



Kjo zonë karakterizohet me koncentrim të monumenteve të tri religjioneve, ndërtesat publike dhe utilitare, dhe numër të konsiderueshëm të shtëpive tradicionale. Përkundër disa ndërtimeve të reja që nuk janë në harmoni me strukturën historike urbane, mund të konsiderohet që tiparet kryesore arkitektonike të zonës janë ruajtur në një masë domethënëse. Kompleksi i Kishës Katolike dhe ndërtesat përreth, të vendosur në kryqëzim të rrugëve, dominojnë siluetën e kësaj zone. Në ndërlidhje të ngushtë me kompleksin, në jug shtrihet Kisha e Shën Nikollës dhe shkolla e vjetër. Në veri të kompleksit të Kishës Katolike gjendet xhamia e vjetër e Myderiz Ali Efendisë, e cila daton nga shek. XVI.

Struktura urbane ndërmjet monumenteve karakterizohet me rrugë të ngushta dhe zonë të dendur banimi, me një numër të konsiderueshëm të shtëpive të vjetra tradicionale të cilët ende i rezistojnë kohës. Kjo zonë ka qenë një pjesë e rëndësishme e qytetit gjatë shek. XIX, kur funksionet kryesore adminisrative dhe diplomatike kanë qenë të koncentruar në pjesën jug-perëndimore të qytetit. Krahas kompleksëve fetare, të Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse, vlen të theksohen edhe Xhamia e Myderiz Ali Efendisë, Hani dhe Nallbani i Kovaçëve, Trafostacioni i vjetër, Xhamia e Iljaz Kukës, Kroi i Binbashit, dhe hoteli i parë i qytetit. Prezenca e kompleksëve të tri religjioneve, së bashku me ndërtesat publike dhe ekonomike kontribuojnë në ruajtjen e strukturës historike urbane.

Pozita e Kishës Katolike historikisht ka gravituar popullsinë e besimit katolik që ka jetuar në këtë zonë. Kjo zonë ende banohet me popullsi të besimit katolik, dhe kryesisht ka funksion banimi, me disa vende ku zhvillohen aktivitete komerciale.

Brenda kësaj zone gjenden hapësira pubike potenciale të përqendruara rreth ndërtesave kryesore fetare, duke filluar nga oborri i xhamisë së Myderiz Ali Efendisë, oborri dhe hapësira para kompleksit të Kishës Katolike, dhe oborri i Qendrës së Mjekësisë Familjare që mund të ri-dizajnohen dhe ofrohen si hapësira publike. Kjo do të kontribuonte në ngrijten e vlerës ambientale të kësaj zone.

<u>Udhëzimet dhe Kufizimet</u>

Në përgjithësi kjo zonë ka vlera **historike, artistike, shoqërore dhe fetare**.
Në mënyrë që të ruhen këto vlera, ndërtesat e trashëgimisë kulturore duhet të konservohen dhe të restaurohen. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një programi për rehabilitim të strukturave, rehabilitim të fasadave dhe restaurimit të tërësishëm të ndërtesave.
Një listë e prioriteteve për ndërhyrje në hapësira publike duhet të hartohet. Sa i përket ndërtesave private, programi i restaurimit duhet të shoqërohet me një projekt të vetëdijesimit, rreth kufizimeve dhe përfitimeve të mundshme në rast të ndërhyrjes në pronat e tyre. Pronarët duhet të njoftohen në lidhje me obligimet e tyre ndaj ruajtes së vlerave të trashëgimisë, si dhe të stimulohen nëpërmjet ofrimit të ndihmës profesionale pa pagesë, ndërhyrjet konservuese dhe lehtësirave fiskale.

Për të siguruar ruajtjen e vlerave fetare,duhet të ofrohet ndihmë profesionale për institucionet fetare të cilët veprojnë në këtë zonë. Ndihma profesionale duhet të ofrohet nëpërmjet takimeve të rregullta, ku prezantohen udhëzime për mënyrën e mirëmbajtjes, riparimit dhe ndërhyrjeve renovuese në monumente fetare. Njëkohësisht, institucionet fetare duhet të vetëdijesohen për

rëndësinë e ndërtesave të tyre në kontekst më të gjërë, për zonën dhe Qendrën Historike në përgjithësi.
Vlerat shoqërore ndërlidhen ngushtë me ato fetare, dhe rrjedhimisht mund të mbrohen në mënyrë të ngjashme, duke përfshirë edhe trajtimin e hapësirave publike. Hapësirat publike ofrojnë mundësinë e shoqërimit të grupeve të ndryshme të komunitetit, dhe duhet legalisht të mbrohen nga uzurpimet dhe keqpërdorimet.

Për të përmirësuar karakterin historik urban, në këtë zonë ndërtesat me vlerë të trashëgimisë kulturore duhet të konservohen, kurse rastet që nuk përputhen me siluetën historike duhet të trajtohen nëpërmjet **rehabilitimit të fasadave**.

Foto 5. Pamje e kompleksit të Kishës Katolike dhe Trafostacioni i vjetër

2.5. Zona e tregut tradicional – Shadërvani, Kujumxhilluk, çarshia e Sinan Pashës

E vendosur në qendër të bërthamës historike, kjo zonë paraqet njërën prej pjesëve më të frekuentuara. Pozita dominuese e xhamisë së Sinan Pashës – aset i trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme, Ura e Gurit së bashku me kroin dhe sheshin e Shadërvanit, dhe kompleksi i Kishës së Shën Gjergjit, paraqesin pikat kryesore referente të kësaj zone dhe të qendrës historike në përgjithësi.

Kjo zonë paraqet ndërlidhjen dhe integrimin e transformimeve historike të qytetit nëpër kohë gjatë periudhave të ndryshme. Në pjesën lindore dominojnë ndërtesat të punuara me fasadë Neoklasike, që datojnë nga fillimi i shek. XX. Ndërtesat e orientuara kah ana perëndimore e sheshit ende ruajnë trajtën dhe atributet arkitektonike tradicionale që datojnë nga shek. XIX, përderisa në pjesën perëndimore gjendet çarshia e rimodeluar e cila daton nga gjysma e dytë e shek. XX.

Kjo zonë është shfrytëzuar si çarshi ku janë zhvilluar punëtori të ndryshme të zejeve tradicionale. Funksioni i çarshisë ende është ruajtur, por funksioni i zejeve tradicionale është zëvendësuar me funksion të tregtisë. Humbja e zejeve tradicionale dhe zëvendësimi me funksione moderne ka

ndryshuar pjesërisht karakterin e kësaj zone, por shpirti i zonës është ruajtur. Në këtë zonë janë përqendruar monumente të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, ku struktura urbane ndërmjet këtyre monumenteve e plotëson pamjen gjenerale duke i dhënë shpirt dhe karakter këtij vendi. Krahas strukturës urbane, sheshi Shadërvan paraqet vendtakimin kryesor për banorët e qytetit si dhe për vizitorët.

Sheshi Shadërvan paraqet njërin prej hapësirave publike më të mëdha brenda Qendrës Historike. Ky shesh është vend ku zhvillohet jeta e përditshme por në të njëjtën kohë edhe pikë referente për organizim të aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe shoqërore, dhe paraqet vendtakimin kryesor për banorët e qytetit si dhe për vizitorët.
Hapësira publike vazhdon kah ana lindore, në pjesën e pasme të Xhamisë së Sinan Pashës, si dhe në hapësirën para xhamisë, ku nëpërmjet hapësirës pranë bregut të lumit (Keji) është tentuar të krijohet një lidhshmëri me lumin.

Udhëzimet dhe Kufizimet
Kjo zonë parqet bërthamën komerciale të Qendrës Historike me vlerë të lartë **historike, arkitektonike, shoqërore dhe ekonomike**. Prandaj në këtë zonë do të duhej të shfrytëzohej **qasje konservative dhe zhvillim i kontrolluar**.
Vlerat ekonomike në kuadër të një zonë tregtare janë shpesh në konflikt me vlerat tjera, ngase pronarët e bizneseve tentojnë të zmadhojnë hapësirat e tyre vepruese, dhe të sjellin ndryshime nëpërmjet renovimit të fasadave. Andaj duhet të zhvillohet një program informimi, ku secili operator ekonomik i cili vepron në këtë zonë të jetë i informuar saktë në lidhje me kuzifimet dhe mundësitë.
Një pikë e rëndësishme është se vlerat ekonomike jo medoemos duhet të jenë në kundërshtim me vlerat tjera të trashëgimisë kulturore. Ruajtja e vlerave historike dhe artistike, në të shumtën e rasteve ndikon në zhvillimin e vlerave ekonomike në aspektin afatgjatë.

Foto 6. Pamje e Shadërvanit

2.6. Zona e bregut të lumit



Karakteristikë kryesore e kësaj zone është pozita e saj përgjatë dy brigjeve të lumit Lumbardhi, i cili e ndan qendrën historike përgjatë aksit lindje-perëndim.
Transformimet urbane si rezultat i ndryshimeve shoqëro-ekonomike kanë pasur ndikim negativ në shkallë të madhe në këtë zonë. Tejkalimet e lartësisë, përdorimi i materialeve joadekuate, shkalla dhe proporcionet joadekuate të ndërtesave në relacion me strukturën historike urbane, janë disa nga problemet e paraqitura. Një numër i vogël i monumenteve të trashëgimisë kulturore të shpërndarë nëpër zonë, humbin dukshmërinë dhe ndikimin e tyre për shkak të humbjes së strukturës historike urbane ndërmjet tyre.

Disa fragmente të arkitekturës tradicionale të shek. XIX të prezantuara nëpërmjet shembujve të shtëpive të vjetra të cilët gjenden në pjesën perëndimore të zonës së bregut të lumit. Në pjesën lindore shtrihen disa ndërtesa publike dhe komerciale që shënojnë procesin e modernizimit urban gjatë pjesës së dytë të shek. XX, sikurse Kinemaja Lumbardhi dhe Qendra e Mallrave. Ndërtesa e Qendrës së Mallrave daton nga mesi i shek.XX, dhe për nga forma, gabariti dhe proporcionet nuk është në harmoni me strukturën historike. Ndërhyrjet në fasadë me përdorim të materialeve joadekuate që janë bërë gjatë viteve të fundit, kanë përshkallëzuar disharmoninë e kësaj ndërtese me zonën rrethuese.
Pjesa tjetër e zonës karakterizohet me ndërtime të reja, të cilët në masë të madhe degradojnë vlerat e trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike.

Orientimi i ndërtesave kah rruga kryesore ka ndikuar në zhvillimin e aktiviteteve komerciale, sidomos në katin përdhes. Bazuar në zhvillimet aktuale, është paraqitur një trend i transformimit të funksionit të banimit në aktivitete komerciale.

Lumi Lumbardhi kalon përgjatë aksit lindje-perëndim, por muret rrethuese të larta nuk lejojnë ndërlidhje të drejtpërdrejtë në mes të zonës dhe lumit. Rruga në anën jugore të lumit është pjesërisht e mbyllur për qarkullim të automjeteve, por në vend të hapësirës publike kjo pjesë shfrytëzohet si parking.

<u>Udhëzimet dhe Kufizimet</u>
Kjo zonë paraqet bërthamën e gjelbërt të Qendrës Historike me vlera historike, arkitektonike, shoqërore, ambientale dhe vlera të rëndësishme ekonomike. Kundërthënia ndërmjet vlerave ekonomike me vlerat tjera të trashëgimisë kulturore, ka rezultuar me një numër të madhë të ndërhyrjeve të pa autorizuara për të përfituar nga përparësitë që ofron pozita e volitshme. Në përgjithësi kjo zonë ka humbur karakterin historik urban, përpos disa fragmenteve që kanë mbetur të izoluar të shpërndarë në pjesë të ndryshme të zonës. **Regjenerimi urban** që do të të përfshijë **rehabilitim të fasadave** si dhe të trajtojë mobilerinë urbane dhe hapësirat publike, paraqitet si hap i nevojshëm për të rikthyer vlerat e humbura të trashëgimisë në këtë zonë.

Për të ruajtur vlerat historike, arkitektonike dhe artistike të kësaj zone duhet të ndërmerren hapat e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi i udhëzuesve të qartë në lidhje me kriteret që duhet të plotësojnë ndërtimet e reja, si dhe masat që duhet të ndërmeren për adaptim të ndërtesave që gjenden në mes të monumenteve dhe degradojnë strukturën historike urbane.
- Vetëdijesimi i pronarëve të pronave private në lidhje me rëndësinë dhe vlerat e kësaj zone, si dhe kufizimet dhe procedurat ligjore që duhet të ndiqen.

Një prej vlerave që theksohet është vlera ambientale. Kjo zonë ndahet përgjatë aksit tërthor nga lumi Lumbardh dhe brigjet e saj, që paraqet një hapësirë publike të rëndësishme jo vetëm për banorët dhe vizitorët, por edhe për zogjtë migrues.

Foto 7. Zona e bregut të lumit nga kënde të ndryshme

2.7. Zona perëndimore –Tabakhana dhe Mahalla e Suzi Çelebisë

Mahalla e Suzi Çelebisë dhe Tabakhane gjenden në anën perëndimore të Qendrës Historike të Prizrenit. Në këtë zonë vërehen transformimet drastike dhe ndryshimet e rrethanave socio-ekonomike që kanë ndikuar në ndryshimet e strukturës urbane. Xhamia e Suzi Çelebisë së bashku me ndërtimet rrethuese, sikurse biblioteka e vjetër, varrezat dhe ura, dominojnë në siluetën e kësaj zone. Në bregun verior të lumit gjenden mulliri i vjetër, dhe

punëtoria për përpunim të lëkurës, të vetmet ndërtesa që kanë mbetur nga punëtoria e tabakëve, zeje tradicionale e përpunimit të lëkurës e cila është zhvilluar në këtë zonë.
Në këndin lindor të kësaj zone gjendet një prej ndërtesave më karakteristike të periudhës së modernizmit, e cila fillimisht ka funksionuar si bankë, kurse tani akomodon hapësirat e Komunës së Prizrenit. Përballë Komunës së sotme gjendet ndërtesa Beledije e shek. XIX, e cila ka shërbyer si ndërtesë e Komunës deri në gjysmën e parë të shek. XX.

Kjo zonë karakterizohet me mbetjet e periudhave të ndryshme historike duke filluar nga kompleksi fetar i shek. XVI, te zona e punëtorisë së përpunimit të lëkurës e cila ka mbetur e izoluar, e rrethuar me ndërtime të reja, dhe kontrasti ndërmjet ndërtesave publike nga shek. XIX dhe XX, të Komunës së Prizrenit. Ndërtimet aktuale të ndërtuara ndërmjet këtyre pikave referente ndërprejnë konsistencën e strukturës historike urbane.

Industrializimi i prodhimtarisë së lëkurës në pjesën e dytë të shek. XX, dhe ndryshimet në nivel të shtratit të lumit, kanë ndikuar në zhdukjen e funksionit fillestar të zejes tradicionale të përpunimit të lëkurës. Tani zona pjesërisht ka funksion banimi, të kombinuar me aktivitete komerciale dhe administrative.

Bregu verior i lumit është dizajnuar në formë të një hapësire publike duke krijuar një ndërlidhje ndërmjet strukturës urbane dhe lumit. Në bazë të vlerësimit të bërë, kjo hapësirë është relativisht e shfrytëzueshme, por vetëm si pushimore. Hapësira prapa Beledijes e cila është dizajnuar në formë të një parku të vogël, gjithashtu është pak e shfrytëzueshme dhe vetëm si pushimore.

Udhëzimet dhe Kufizimet

Kjo pjesë e Qendrës Historike ngërthen vlera të rëndësishme **historike, shoqërore, ambientale dhe ekonomike**. **Qasje sensitive të konservimit** në kombinim me **regjenerimin urban** janë metoda që do të duhej të përdoren për rikthimin e identitetit të humbur të kësaj zone.
Pronarët e pronave private dhe të bizneseve që veprojnë në këtë zonë, duhet të informohen në lidhje me rëndësinë e imazhit dhe siluetës së qytetit. Për këtë qëllim duhet të zhvillohet një kampanjë vetëdijesimi dhe informimi që përfshinë të gjithë akterët e kësaj zone.
Kjo zonë paraqet portën perëndimore të Qendrës Historike, prandaj për të përmirësuar kualitetin e dizajnit urban duhet të hartohet një projekt gjithëpërfshirës që trajton adaptimin e ndërtesave ilegale, mobilerinë urbane dhe shenjëzimin.

Foto 8. Tabakhane dhe kompleksi Suzi Çelebi

2.8. Zona e shfrytëzimit të përzier dhe e banimit - Atik Mahalla

Kisha e Shën Premtes (Levisha) gjendet në pjesën veri-perëndimore të kësaj zone, dhe paraqet njërën prej pikave referuese më të rëndësishme të Qendrës Historike. Kjo kishë është monumenti i vetëm në Prizren, i cili është listuar në Listën e Trashëgimisë Botërore në rrezik, të UNESCO-s[17]. Në këtë zonë gjenden Muzeu Arkeologjik me Sahat Kullë, Xhamia e Haxhi Ramadanit, Kroi i Çoragës, Shtëpia e Musa Shehzades, dhe shtëpitë e vjetra tradicionale të shpërndarë nëpër pjesë të ndryshme të zonës, të cilët janë asete të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme dhe paraqesin tiparet kryesore arkitektonike.

Atik Mahalla konsiderohet njëra prej mahallave më të vjetra të Prizrenit. Kisha e Shën Premtës ngërthen në vete periudhat e ndryshme historike që prezantojnë zhvillimin e qytetit. Muzeu Arekologjik me Sahat Kullë në anën tjetër paraqet transformimet funksionale nëpër kohë; përderisa funksioni fillestar i kësaj ndërtese ka qenë Hamam – banjo publike, gjatë gjysmës së dytë të shek. XX është shndërruar në muze arkeologjik.
Një numër i konsiderueshëm i shtëpive të vjetra tradicionale të shek. XIX gjenden në këtë zonë, por të shpërndarë dhe të penguar nga ndërtimet e reja të cilët reduktojnë vlerat e trashëgimisë kulturore, duke ndërprerë strukturën historike urbane. Ndërtesat moderne të gjysmës së dytë të shek. XX ku janë akomoduar funksionet publike, gjenden në pjesën lindore të zonës.

Në këtë zonë nuk ka hapësira publike, përpos oborrit të Kishës së Shën Premtes – Levisha, e cila nuk është e hapur për publikun, përpos rasteve me aranzhim të veçantë .

<u>Udhëzimet dhe Kufizimet</u>
Kjo zonë paraqet njërën prej pjesëve më problematike të Qendrës Historike të Prizrenit. Këtu gjenden disa nga monumentet më të rëndësishme, por ndërhyrjet dhe ndërtimet joadekuate kanë shkaktuar humbjen e strukturës dhe karakterit historik urban.
Hartimi i një projekti të hollësishëm të **dizajnit urban** që do t'i adresonte problemet e kësaj zone, duke filluar nga shenjimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore, trajtimi i elementeve të fasadave, projektet e veçanta të interpolimeve dhe të mobilerisë urbane është i domosdoshëm për rikthimin e identitetit të humbur të kësaj zone,dhe për ruajtjen e vlerave ekzistuese.

[17]Update of the List of Ëorld Heritage in Danger (Retained Properties), http://whc.unesco.org/en/decisions/6926, accessed January 10, 2018.

Në mënyrë që të ruhen këto vlera, ndërtesat e trashëgimisë kulturore duhet të konservohen dhe të restaurohen. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një programi për rehabilitim të strukturave, rehabilitim të fasadave dhe restaurimit të tërësishëm të ndërtesave.
Një listë e prioriteteve për ndërhyrje në hapësira publike duhet të hartohet. Sa i përket ndërtesave private, programi i restaurimit duhet të shoqërohet me një projekt të vetëdijesimit, rreth kufizimeve dhe përfitimeve të mundshme në rast të ndërhyrjes në pronat e tyre. Pronarët duhet të njoftohen në lidhje me obligimet e tyre ndaj ruajtes së vlerave të trashëgimisë, si dhe të stimulohen nëpërmjet ofrimit të ndihmës profesionale pa pagesë, ndërhyrjet konservuese dhe lehtësirave fiskale.
Për të siguruar ruajtjen e vlerave fetare,duhet të ofrohet ndihmë profesionale për institucionet fetare të cilët veprojnë në këtë zonë. Ndihma profesionale duhet të ofrohet nëpërmjet takimeve të rregullta, ku prezantohen udhëzime për mënyrën e mirëmbajtjes, riparimit dhe ndërhyrjeve renovuese në monumente fetare. Njëkohësisht, institucionet fetare duhet të vetëdijesohen për rëndësinë e ndërtesave të tyre në kontekst më të gjërë, për zonën dhe Qendrën Historike në përgjithësi.

Foto 9. Pamje e Kishës Shën Premte me rrethinë

2.9. Zona e tregut tradicional – Saraçhana



Shtrihet në qendër të Qendrës Historike dhe karakterizohet me ndërtesat e periudhave të ndryshme historike. Në anën perëndimore, mbetjet e strukturës urbane të shek. XIX janë ruajtur pjesërisht deri sot, kurse në anën lindore gjenden ndërtesat publike që rezultuan si rezultat i procesit të modernizimit gjatë pjesës së dytë të shek. XX.
Rruga e Farkëtarëve ka ruajtur strukturën origjinale me rrugë të ngushtë dhe ndërtesat tradicionale të vendosura në varg, me fasadën ballore të orientuar kah rruga. Kompleksi i Teqes Halveti së bashku me Xhaminë e Kukli Mehmed Beut krijojnë një atmosferë ekzotike me vlera të larta historike, artistike, shoqërore dhe ambientale. Ndërtesa e Postës e vendosur në anën lindore të zonës, paraqet një dëshmi të ndërtesave publike të ndërtuar gjatë periudhës socialiste. Ndërhyrjet e vonshme në ndërtesën e Hotel "Therandës", që gjendet në këndin jug-lindor, kanë reduktuar vlerat e trashëgimisë të kësaj zone në përgjithësi.

Çarshia e Saraçhanes fillimisht është shfrytëzuar si zonë ku është zhvilluar zeja tradicionale e saraçëve (përpunimi i lëkurës), ku janë koncentruar funksionet e zhvillimit të zejes – punëtoritë dhe funksioni i tregtisë. Me procesin e modernizimit dhe zhvillimit të teknologjisë, zejet tradicionale kanë filluar gradualisht të shuhen. Në këtë zonë, tani janë përqendruar aktivitete të kombinuara të banimit, fetare, komerciale dhe shërbyese.

Pjesa para ndërtesës së Postës dhe Hotelit paraqet një hapësirë publike e cila ndahet me hapësirën tjetër përballë, nga rruga. Në anën jugore, sheshi Shadërvan vazhdon dhe lidhet me rrugën Farkatarët nëpërmjet Urës së vjetër të Gurit. Përkundër prezencës së infrastrukturës urbane ekzistuese, hapësira publike nuk shfrytëzohet pasi që është e ngarkuar me parkingje.

Udhëzimet dhe Kufizimet

Kjo zonë ngërthen vlera të rëndësishme **historike, artistike, shoqërore dhe ekonomike.** Ridizajnimi i fasadës së hotelit duke rikthyer karakteristikat dhe tiparet e periudhës moderne, dhe ridizajnimi dhe ri-funksionalizimi i hapësirës publike do të kontribuonin në ruajtjen e vlerave historike dhe ekonomike dhe në revitalizimin e imazhit të zonës.

Foto 10. Rruga Farkatarët dhe Saraçhanja sot

2.10. Zona e aksit tregtar - Arasta Mahalla

Kjo zonë vazhdon në lindje të Saraçhanes dhe paraqet një pjesë gërshetohen periudha të ndryshme historike të cilet kanë lënë gjurmë në strukturën urbane të qytetit. Mbetjet arekologjike të gjetura në shesh supozohet që datojnë nga Antikiteti i vonë (shek. IV- V p.e.s), Minarja e xhamisë Arasta dhe kroi i gurit që datojnë nga shek. XIX, dhe ndërtesat shumëkatëshe që datojnë nga periudha Moderne, paraqesin dëshmitë materiale të kulturave të ndryshme që kanë dominuar në Prizren.

Në këtë pjesë deri në gjysmën e parë të shek. XX gjendej Çarshia e Arastës e cila përbëhej nga ndërtesat një katëshe, ku zhvilloheshin aktivitete të prodhimit të zejeve dhe tregtia, një xhami në mes të sheshit, si dhe ura e mbuluar Arasta, ku kanë qenë të vendosur dyqanet në dy anë të saj. Gjatë procesit të modernizimit struktura urbane e kësaj zone ka ndryshuar në mënyrë drastike, që ka ndikuar edhe në shkallën dhe karakterin e qendrës historike në përgjithësi.

Pjesa e zonës e cila shtrihet kah lumi Lumbardhi është organizuar në trajtë të një sheshi të hapur, ku janë koncentruar funksione shërbyese dhe komerciale (restaurante dhe kafene). Lokaliteti arekologjik në mes është lënë i hapur pa ndonjë kujdes të mirëfilltë, duke rrezikuar lokalitetin, dhe në të njëjtën kohë duke mos mundësuar qasje dhe prezantim adekuat për vizitorët. Përpos pamjes indirekte të shtratit të lumit, nuk ofrohet lidhja ndërmjet bregut të lumit dhe sheshit.

Udhëzimet dhe Kufizimet

Kjo zonë ka vlera të rëndësishme shoqërore ngase shpesh shfrytëzohet si hapësirë publike e frekuentuar nga komuniteti lokal dhe vizitorët. Vlerat e rëndësishme shoqërore të kombinuar me pozitën qendrore të volitshme të dedikuar për këmbësorë, kanë ndikuar në zhvillimin e vlerave ekonomike. Potenciali i vlerave ekonomike kanë ndikuar në zhvillimin e punimeve dhe tejkalimeve të lejeve të lëshuara, dhe shfrytëzim të materialeve të reja, jo adekuate për qendrën historike.

Përkundër zhvillimeve, kjo pjesë integrale e Qendrës Historike ngërthen në vete vlera të historike dhe artistike, të cilët duhet të rikthehen nëpërmjet qasjes **sensitive të konservimit** të kombinuar me **regjenerimin urban**.

Pronarët e pronave private dhe të bizneseve që veprojnë në këtë zonë, duhet të informohen në lidhje me rëndësinë e imazhit dhe siluetës së qytetit. Për këtë qëllim duhet të zhvillohet një kampanjë vetëdijesimi dhe informimi që përfshinë të gjithë akterët e kësaj zone.

Foto 11. Arasta sot

2.11. Zona e aksit tregtar – Çarshia e Kovaçëve dhe rruga Adem Jashari

Funksioni komercial vazhdon në pjesën veriore të Mahallave Saraçhane dhe Arasta, ku gjendet aksi tregtar ku është zhvilluar zeja e Kovaçëve (Farkëtarëve) gjatë shek. XIX. Hamami i Gazi Mehmet Pashës paraqet njërën prej pikave referuese kryesore të kësaj zone, së bashku me Xhaminë e Emin Pashës e cila gjendet në vazhdim të saj. Kjo zonë karakterizohet me ndërtesa të vendosura në varg, me fasadën ballore të orientuar kah rruga kryesore, ku aktivitete të ndryshme komerciale zhvillohen sot, me një numër të vogël të aktiviteteve zejtare që kanë mbijetuar nga e kaluara. Kulme të fshehura prapa mureve të kallkanit me formë të valëzuar, dekorimet plastike me motive gjeometrike përgjatë hapjeve janë disa nga atributet arkitektonike më karakteristike.

Në këtë zonë, krahas dyqaneve të orientuar përgjatë aksit rrugor, në brendi gjenden disa shtëpi të vjetra tradicionale të cilët janë ruajtur deri në ditët e sotme. Prej tyre vlen të theksohen Shtëpia e Familjes Sokoli me fasadën ballore të punuar me elemente të stilit Barok.

Kjo zonë paraqet njërën prej hyrjeve kryesore në qytet, prandaj edhe vlerat ekonomike janë të larta. Përpos disa ndërhyrjeve jo adekuate të cilët e ndërprejnë vargun e fasadave lineare të punuar me elemente të stilit Neoklasik, në përgjithësi ky aks ka ruajtur karakterin **historik** deri në një masë të konsiderueshme. Brezi i gjelbërt i formuar nga lisat e vendosur para ndërtesave kontribuojnë në vlerat artistike dhe ambientale të zonës.

Oborri i Hamamit është i rrethuar me gardh metalik, duke e kufizuar qasjen e lirë dhe shfrytëzimin e kësaj pjese si hapësirë publike. Rruga në veçanti paraqet një hapësirë potenciale publike.

Udhëzimet dhe Kufizimet

Së bashku me zonat rrethuese ky aks ka vlera të **larta historike, artistike dhe ekonomike**. Zona ka ruajtur shkallën humane në aspekt urban, nëpërmjet fasadave një-tri katëshe, trotuaret dhe brezit të gjelbërt. Aktivitetet komerciale në këtë zonë duhët të stimulohen edhe nëpërmjet një plani të **dizajnit urban të kombinuar me rehabilitim të fasadave.** Një plan i tillë do të ndihmonte në konservimin e vlerave artistike dhe ambientale, dhe në kufizimin e ndërtimeve, me proporcione jo të përshtatshme me identitetin e kësaj zone.

Foto 12. Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe rruga Adem Jashari

2.12. Zona e shfrytëzimit të përzier dhe e banimit - Ralin Mahalla

Kjo zonë gjendet në lindje të Qendrës Historike dhe funksionon sikurse një portë hyrëse në qytet. Kompleksi i Marashit paraqet një ansambël arkitektonik ku konfiguracioni i terrenit, ndërlidhja me lumin Lumbardhi, kodra e Kalasë, rrugët e ngushta dhe zona e banimit ofrojnë një shkallë intime të strukturës urbane historike. Ky ansambël funksionon gjithashtu si lidhje ndërmjet pjesës urbane dhe natyrore të qendrës historike.
Në këtë kompleks janë ruajtur disa shtëpi të vjetra tradicionale, xhamia e Maksut Pashës, Tyrbja e Musa Shehzades, mulliri i Pintollit dhe Rrapi i vjetër.
Përballë ansamblit të Marashit gjendet kompleksi monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ku kompleksi muzeal është i rrethuar me shtëpi të vjetra tradicionale, dhe kompleksin e xhamisë së Gazi Mehmet Pashës, që e dominon siluetën e kësaj zone. Në këtë zonë janë ruajtur një numër i konsiderueshëm i shtëpive të vjetra tradicionale.

Kompleksi monumental i Lidhjes së Prizrenit, së bashku me kompleksin e xhamisë, shtëpitë e vjetra tradicionale që shtrihen në pjesë të ndryshme të kësaj zone si dhe rrjeti i ngushtë i rrugëve, krijojnë ndjesin e një fragmenti të Prizrenit gjatë shek. XIX.

Funksioni i banimit dominon në këtë zonë, së bashku me shtëpitë e vjetra tradicionale që janë ruajtur deri më sot. Pjesa qendrore e zonës, ku gjenden Kompleksi i Lidhjes dhe lumi Lumbardhi shfrytëzohet për zhvillim të aktiviteteve kulturore, shoqërore dhe edukative.

Parku pranë kompleksit të Lidhjes së bashku me brigjet e lumit ofrojnë një hapësirë publike por që nuk është dizajnuar në mënyrë adekuate, dhe rrjedhimisht nuk kryen funksionin ashtu si do të duhej.

Udhëzimet dhe Kufizimet
Kjo zonë ka ruajtur shpirtin tradicional dhe karakterin historik urban, me vlera të rëndësishme **historike, artistike, ambientale dhe ekonomike**. Prandaj në këtë zonë duhet të zbatohen në mënyrë strikte, **qasje konservative dhe zhvillim i kontrolluar**. Rëndësia e kompleksit të Lidhjës Shqiptare të Prizrenit duhet të promovohet, për banorët e qytetit dhe vizitorët potencial.
Në mënyrë që të ruhen këto vlera, ndërtesat e trashëgimisë kulturore duhet të konservohen dhe të restaurohen. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një programi për rehabilitim të strukturave, rehabilitim të fasadave dhe restaurimit të tërësishëm të ndërtesave.
Një listë e prioriteteve për ndërhyrje në hapësira publike duhet të hartohet. Sa i përket ndërtesave private, programi i restaurimit duhet të shoqërohet me një projekt të vetëdijesimit, rreth kufizimeve dhe përfitimeve të mundshme në rast të ndërhyrjes në pronat e tyre. Pronarët duhet të njoftohen në lidhje me obligimet e tyre ndaj ruajtes së vlerave të trashëgimisë, si dhe të stimulohen nëpërmjet ofrimit të ndihmës profesionale pa pagesë, ndërhyrjet konservuese dhe lehtësirave fiskale.
Për të siguruar ruajtjen e vlerave fetare, duhet të ofrohet ndihmë profesionale për institucionet fetare të cilët veprojnë në këtë zonë. Ndihma profesionale duhet të ofrohet nëpërmjet takimeve të rregullta, ku prezantohen udhëzime për mënyrën e mirëmbajtjes, riparimit dhe ndërhyrjeve renovuese në monumente fetare. Njëkohësisht, institucionet fetare duhet të vetëdijesohen për

rëndësinë e ndërtesave të tyre në kontekst më të gjërë, për zonën dhe Qendrën Historike në përgjithësi.

Foto 13. Pamje e mahallës së Marashit dhe Rahlinit

3. Niveli i qytetit

Prizreni është një prej qyteteve më të vjetra të Kosovës i pasur me një karakter të veçantë urban dhe arkitektonik. Qyteti ngërthen një trashëgimi të pasur kulturore me vlera të larta estetike, shpirtërore, shkencore dhe ekonomike.

Prizreni është një qytet i pasur me kulturë, histori, gjuhësi dhe natyrë. Kisha e Shën Premtes, e cila gjendet në Listën e Trashëgimisë Botërore në rrezik gjendet në qendër të saj[18]. Qyteti gjithashtu akomodon Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, një monument kandidat për t'u propozuar në Listën e Trashëgimisë Botërore. Lidhja Shqiptare e Prizrenit paraqet ngjarjen historike, kur gjatë pjesës së dytë të shek. 19, janë vënë themelet e formimit të shtetit Shqiptar.

Prizreni është kryeqendra kulturore dhe shpirtërore e Kosovës, dhe gjithashtu edhe rajonale, falë diversitetit të pasur kulturor, gjuhësor dhe fetar. Në Prizren fliten së paku katër gjuhë nga banorët lokal, dhe ekzistojnë tri religjionet kryesore, muslimane, krishtere dhe hebreje. Këto vlera shoqërore pasurohen edhe më tej me vlerat ambientale, pasi që qyteti rrethohet në dy anë me male, ku shtrihet edhe Parku Kombëtar i Sharrit, i cili është vendbanim i specieve të ndryshme endemike.

VLERAT UNIVERZALE TË DALLUARA

Si mund të arrihet vlerësimi i të gjitha këtyre vlerave në nivel të qytetit?

Një prej metodave të shfrytëzuara për përshkrimin e vlerave të një aseti të trashëgimisë kulturore, është shfrytëzimi i kritereve të përcaktuara nga UNESCO me rast të listimit të një lokaliteti në Listën Botërore të Trashëgimisë.

Këto 10 kritere paraqesin metodat kryesore të punës së Konventës së Trashëgimisë Botërore dhe bazohen në konceptin e identifikimit të Vlerës së Dalluar Univerzale; që nënkupton vlerat të cilët veçohen si tipare reprezentative për gjithë njerëzimin. Lokalitetet e listuara në Listën e Trashëgimisë Botërore duhet të ruajnë, mbi të gjitha, këto kritere të përcaktuara, dhe konservimi i këtyre lokaliteteve monitorohet dhe vlerësohet duke u bazuar në këto kritere. Aplikimet e reja në Listën e Trashëgimisë Botërore përgatiten dhe vlerësohen duke u bazuar në këto kritere[19]. Ky vlerësim i Prizrenit duke i shfrytëzuar këto kritere, në të ardhmen mund të transformohet në një draft të dosjes së nominimit të qytetit në Listën e Trashëgimisë Botërore.

10 Kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:

(i) Të përfaqësoj një kryevepër të gjenialitetit kreativ human;
(ii) Të prezantojë një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore, gjatë një periudhe kohore ose brenda një zonë kulturore të botës, mbi zhvillimet në arkitekturë, teknologji, arte monumentale, planifikim urban ose dizajn të peizazhit;
(iii) Të bart një dëshmi unike apo së paku të jashtëzakonshme të një tradite kulturore apo të një civilizimi që ka mbijetuar apo është zhdukur;
(iv) Të paraqet një shembull të shquar të një tipologjie të ndërtmit, ansamblit arkitektonik apo teknologjik apo peizazhi i cili përfaqëson një (disa) fazë(a) të rëndësishme në historinë e njerëzimit;

[18]Update of the List of Ëorld Heritage in Danger (Retained Properties), http://ëhc.unesco.org/en/decisions/6926, accessed January 10, 2018.
[19] The Criteria for Selection, Operational Guidelines for the Implementation of the Ëorld Heritage Convention. http://ëhc.unesco.org/en/criteria/, accessed January 18, 2018.

(v) Të paraqet një shembull të shquar të një vendbanimi tradicional, shfrytëzimit të tokës, ose detërave, që paraqet një shembull reprezentativ të një (disa) kultura (ve), ose shkëmbimit ndërmjet humanes dhe ambientit, sidomos në rastet e pambrojtura nga ndikimet e ndryshimeve të pakthyeshme;

(vi) Të jetë i ndërlidhur në mënyrë direkte apo indirekte me ngjarjet apo traditat që jetojnë, me idetë ose besimet, me punimet artistike apo letrare me rëndësi unike universale. (Komiteti mendon që ky kriter do të duhej të përdoret në lidhje me kriteret tjera);

(vii) Të përmbajë fenomene superlative natyrore ose zona me bukuri të jashtëzakonshme natyrore dhe rëndësi estetike;

(viii) Të paraqet shembuj të shquar që përfaqësojnë fazat kryesore të historisë së tokës, duke përfshirë historinë e jetës, proceset gjeologjike të rëndësishme në zhvillim, në zhvillimin e formave të tokës ose karakteristika të rëndësishme gjeomorfike ose fiziografike;

(ix) Të paraqesin shembuj të shquar që përfaqësojnë procese ekologjike dhe biologjike të vazhdueshme në evoluimin dhe zhvillimin e ujërave tokësore, të burimeve, ekosistemet bregdetare dhe detare dhe komunitetet e bimëve dhe kafshëve;

(x) Të përmbajë habitatet më të rëndësishme dhe domethënëse natyrore për ruajtjen in-situ të diversitetit biologjik, duke përfshirë ato që përmbajnë specie të kërcënuara me vlera universale të shquara nga pikëpamja e shkencës apo konservimit.

Një ose më tepër kritere duhet të përmbushen në mënyrë që të fitohet e drejta për t'u nominuar në Listë. Bazuar në hulumtimet e kryera dhe në rezultatet e dala nga punëtoria e vlerësimit që është organizuar gjatë verës së vitit 2017 me palë të ndryshme të interesit, për Prizren janë përzgjedhë këto kritere:

V - Të paraqet një **shembull të shquar të një vendbanimi tradicional**, shfrytëzimit të tokës, ose detërave, që paraqet një shembull reprezentativ të një (disa) kultura (ve), ose shkëmbimit ndërmjet humanes dhe ambientit, sidomos në rastet e pambrojtura nga ndikimet e ndryshimeve të pakthyeshme;

Prizreni paraqet një shembull të një vendbanimi tradicional në lulëzim, që ende shfrytëzohet. Qyteti bart në vete dëshmi të kulturave të shumta nga periudha parahistorike, Romake, Bizantine, Osmane, Shqiptare dhe Serbe.
Prizreni nuk paraqet vetëm një vendbanim tradicional me arkitekturë vernakulare, por gjithashtu përmban shembuj të arkitekturës monumentale të shprehur në Xhaminë e Sinan Pashës e Kishën e Shën Premtes, vepra inxhinjerike sikurse Ura e Gurit, dhe arkitekturë të fortifikimit.
Gjetjet arkeologjike dëshmojnë se Kalaja e Prizrenit ka qenë e banuar që nga periudha e Bronzit, me të dhënat arkeologjike dhe historike që tregojnë një mbivendosje të vazhdueshme të shtresave kulturore që nga fundi i Eneolitit.
Kjo zonë dëshmon diversitetin urban dhe shoqëror nëpërmjet stileve të shtëpive të cilët kryesisht janë ndërtuar gjatë periudhës Osmane, që ofrojnë një ndjenjë përkatësie të komunitetit.
Është ky gërshetim i vendbanimit, arkitekturës dhe stileve që e bën Prizrenin një shembull të veçuar të një vendbanimi tradicional human.

VI - Të jetë i **ndërlidhur në mënyrë direkte apo indirekte me ngjarjet** apo traditat që jetojnë, me idetë ose besimet, me punimet artistike apo letrare me **rëndësi unike universale**.[20]

[20] Komiteti mendon që ky kriter do të duhej të përdoret në lidhje me kriteret tjera.

Prizreni është vendi i themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Të ballafaquar nga vendimet e marra në Traktet e nënshkruara në Evropë, përfaqësues të territoreve të banuara me Shqiptarë, nga Ballkani u mblodhën në Prizren, duke themeluar Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.[21] Kërkesa fillestare ishte ruajtja e integritetit në kuadër të Perandorisë Osmane, por kur kjo kërkesë nuk dha rezultate, kërkesa u drejtua rreth pavarësisë. Kjo është hera e parë ku qytetarët e territoreve të banuara me shqiptarë u bashkuan për të shprehur kërkesën themelore dhe universale për vetëvendosje dhe për ruajtjen nga coptimi i territoreve të banuar me shqiptarë. Ky takim paraqet një shembull për popujt tjerë në kuadër të Perandorisë Osmane për adresim të kërkesave të tyre, dhe një vizion për të ardhmen e rajonit.
Vlera univerzale e shprehur këtu është rëndësia e një ngjarjeje, ideje dhe besimi për të drejtën e vetëvendosjes së një kombi.
Krahas kësaj ngjarje të rëndësishme historike, Prizreni paraqet edhe një shembull të një qyteti unik ku tri religjionet kanë bashkëjetuar në harmoni për qindra vite me radhë.

II, III, IV Të prezantojë një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore; Të bart një dëshmi unike apo së paku të jashtëzakonshme të një tradite kulturore; dhe Të paraqet një shembull të shquar të një tipologjie të ndërtmit, ansamblit arkitektonik apo teknologjik apo peizazhi i cili përfaqëson një (disa) fazë(a) të rëndësishme në historinë e njerëzimit;

Këto kategori janë plotësuar dhe njohur në Kongresin e Trashëgimisë Botërore të UNESCOS në afreskat e shek. 14 që gjenden në enterier të Kishës së Shën Premtes. Kjo kishë paraqet një shembull të ndërthurjes së disa stileve, duke filluar nga stili Palaelogian i Rilindjes, me kombinim të ndikimeve të traditave Ortodokse Bizantine dhe Romanikës Perëndimore. Ky stil ka luajtur një rol vendimtar në artin pasardhës në Ballkan.

Kisha e Shën Premtes ngërthen në vete kultura të ndryshme, është një kishë mesjetare e shek. 14, e ndërtuar mbi themelet e një kishe paleokristiane, më vonë e shndërruar në xhami gjatë periudhës Osmane, dhe më pas përsëri e konvertuar në kishë në pjesën e parë të shek. 20.

Kriteret e ngjashme mund të aplikohen edhe në rastin e xhamisë së Sinan Pashës, e cila paraqet një shembull unik të arkitketurës monumentale fetare nga periudha Osmane.

VII - Të përmbajë fenomene superlative natyrore ose zona me bukuri të jashtëzakonshme natyrore dhe rëndësi estetike.

Në anën lindore, jugore dhe perëndimore Prizreni rrethohet me zonën e vazhdueshme malore me lartësi të madhe mbidetare të Maleve të Sharrit. Në këto male rriten bimë të ndryshme indigjene (vendore) sikurse Rrëqebulli i Ballkanit, specie e rrezikuar nga zhdukja.

Parku Nacional i Maleve të Sharrit shtrihet pjesërisht në territorin e Komunës së Ferizajit dhe të Prizrenit, dhe zë një sipërfaqe rreth 54 hektarësh. Ky Park gjendet në pjesën veriore të Maleve të Sharrit, të cilët vazhdojnë në pjesën veriore të Shqipërisë, në juglindje të Kosovës, dhe në veriperëndim të Maqedonisë.

[21]Jelavich, Barbara, "History of the Balkans: Eighteenth and nineteenth centuries", Cambridge University: Cambridge University Press, 1999, p. 361.

Parku ngërthen në vete terren të ndryshueshëm përfshirë liqenet akullnajore, peizazhe alpine dhe akulljnaja[22]. Malet që shtrihen në zonën rreth Prizrenit janë unike dhe dallojnë nga malet që shtrihen përgjatë kufirit me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Kosovën.

Ky peizazh unik i bukurisë së paprekur natyrore, edhepse nuk gjendet në qendër të Prizrenit, po është ngjit me te, do të duhej të vlerësohej si Vlerë Univerzale e Dalluar.

NARA GRID

Një metodë tjetër e vlerësimit është Nara Grid (Matrica) e cila është gjeneruar duke u bazuar në principet e cekura në Dokumentin Nara mbi Autenticitetin[23]. Kjo Matricë plotësohet si listë kontrolli dhe ndihmon në identifikimin e dimenzioneve të ndryshme dhe aspekteve që mbulojnë vlerat e atribuara në trashëgiminë arkitekturore[24]. Matrica Nara vizualizon ndërlidhjen ndërmjet aspekteve të lartpërmendura dhe dimenzioneve si një përmbledhje e vlerave multidiciplinore. Matrica mund të adaptohet ose të zgjerohet deri në identifikimin e vlerave specifike dhe unike që mund të përmbajë një lokalitet i caktuar i trashëgimisë kulturore[25].

Kjo metodë paraqet një matricë e cila liston dimenzionet e ndryshme të vlerave dhe i referencon duke u bazuar në aspektet e ndryshme të qytetit. Në këtë mënyrë vlerat e Prizrenit mund të klasifikohen, analizohen dhe të përshkruhen. Matrica në vijim, e adaptuar për Prizrenin, përmbledh vlerat kryesore të qytetit në një format të ngjeshur.

Dimenzionet e trashëgimisë	**Aspektet e burimeve** **Forma dhe dizajni; Materialet dhe përmbajtja**
